

SKENDER JASA

BIBLIOTEKA  
SHTETIT


8JH-51

734

# Brigjere të Erzenit

ROMAN





Skënder Riza Jasa ka lindur në vitin 1927 në Tiranë. Pas mbahimit të shkollës filllore dhe të gjimnazit në vendlindjen e tij, kreu studimet në Fakultetin e Inxhinierisë.

Ka marrë pjesë aktive qysh në fillim në Lëvizjen Nacionalçlirimtare duke luftuar me armë në dorë në radhët e çetave partizane dhe në vitin 1943 u pranua anëtar i Partisë Komuniste Shqiptare.

Nga viti 1952 ka punuar si inxhinier në disa sektorë dhe ndërmarrje të ndryshme ekonomike të vendit tonë.

Ka botuar tregime të shumta mbi heronjtë dhe mbi ngjarje të Luftës Nacionalçlirimtare, romane, skenarë filmash dokumentarë, midis të cilëve romanin «Guerilljet», monografinë historiko-letorraine «Cen Hysa» etj.

Eshtë anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve e Artistëve të Shqipërisë.

SH-21  
F 54

SKËNDER JASA

# BRIGJEVE TË ERZENIT

R o m a n historik



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

...Kryengritja e fshatarëve të varfër të Shqipërisë së Mesme, e ashtuquajtur nga feudalët «Kryengritja rebele», nën udhëheqjen e Haxhi Qamilit, kundër Esat Pashë Toptanit dhe feudalëve të Tiranës, të Beratit dhe të Elbasanit, tregon ngritjen dhe forcën revolucionare të vegjëlisë fshatare, që me shekuj ka luftuar kundër shkelësve dhe feudalëve...

ENVER HOXHA, Vepra, Vëll. IV, fq. 526

## DAULLJA ZURI TË GJËMONTE!

— Bjeri lodrës, po të them! Më fort, më fort! Ja kështu: dum-dum, ba-ba; dum-dum, ba-ba — sokëllinte Mali.

— Mos më merr më qafë! Obobo unë i shkreti! — i tha fshatarit kovaçi, që bënte edhe punën e lajmëtarit.

Lodraxhiu, një meso burrë i zi si arap, me ca duar të shkurterë, të rreshkura nga dielli dhe plot kallo, i binte me shkop herë njërsë faqe të daulles, që kishte filluar të çahet, herë tjetrës. Daullja, që varej deri në fund të këmbëve të zbatura, ishte lidhur pas qafës së kovaçit me një litar prej zhuku nyje-nyje. Lodraxhiu ngurroi t'i binte daulles në fillim, se ai e dinte shumë mirë se ku do ta nxirre kjo punë. Urdhërin për t'i rënë lodrës, që ishte një kushtrim për të ngritur në këmbë fshatarët, kishte të drejtë ta jepte kryeplaku, krahinari, beu ose ndonjë njeri i shquar i qeverisë, por jo një djalosh i ri fshatar siç ishte Mal Xhoka, që s'e zinte askush në numër. Kovaçi e shikonte tanë fare mirë se nuk kishte kurrsesi si t'i bënte bisht urdhërit që i jepnin dhe jo vetëm kaq, por e dinte se po të kundërshtonte sadopak do t'i kushtonte shumë shtrenjtë.

Daullja zuri të gjëmonte dhe buçima e saj, një buçimë sa e tmerrshme aq dhe e madhërishme, filloi të përhapej brigjeve të Erzenit, grykave, përrenjve dhe fushave larg fshatit Pishtar.

— Eeee... Oooo... Aaaa... — bërtiste me zë të lartë


Mali duke mbajtur ison e rrapëllimës së daulles. Ai tundte në ajër pushkën e gjatë italiane me aq forcë, sa krahu i zhveshur me muskuj, si një degë e ngjeshur ulliri, dridhej e përdridhej dhe dukej sikur po hidhte vallen e shqipeve. Mali kish qëndruar në majë të kodrës, prej së cilës dukej fshati si në pëllëmbë të dorës. Djaloshi kishte një trup të gjatë, të lidhur e të zhdërvjellët dhe kur hidhej me ato këmbët e zbathura dukej tamam si një sorkadhe. Ftyra e tij vezake, me qime të buta si push, apo ishte burrëuar. Mbi sup kishte hedhur një xhokë me thekë, belin ia shtrëngonte një brez i kuq pëlhere dhe mbi kokën e paqethur spikatte si një copë reje qeleshja e bardhë.

— Eee! Mblidhuni, burra! Mblidhuni, burra! Rrokni pushkët, rrëmbeni sopatat! Të gjithë në kuvend! — bërtiste Mali.

Lodraxhiu, që kishte një copë herë që i binte daulles, hapte e mbyllte gojën plot dhëmbë të bardhë dhe shfrynte nga lodhja si një gjyryk kovaçi. Ai e kishte harruar frikën e kryeplakut dhe si i dehur nga gjëmimet e kryengritjeve që pati dëgjuar se kishin shpërthyer anembanë krahinës, fshante nga thellësia e shpirtit «Ah, ah...». Ftyra e rreshkur, e zezë sterrë, i ishte mbushur me bulëza djerse dhe nga balli kishin filluar të kullonin djersët, si ato pikat e ujit që rrjedhin prej çative pas shirave të mëdha.

Mali dhe xhaxhai i tij Ram Leka kishin lajmëruar vetë gojarisht, ose me anën e shokëve e të miqve, që disa ditë përpàra, gjithë burrat e fshatit për kryengritjen që do të niste së shpejti edhe në fshatin e tyre. Fshatarët, sipas fjalës që kishin dhënë, duhej të linin parmandat, gratë e shtëpitë dhe të rroknin armët. Me të dëgjuar daullen me sinjalet e kushtimit «dum-dum... ba-ba», të gjithë burrat e aftë për pushkë duhej të mblidheshin te sheshi i fshatit buzë lumi Erzen.

Me të vërtetë pak kohë pasi kishte gjëmuar daullja e kovaçit, te sheshi nën rrapin shekullor, nga zgavra e të cilët buronte një ujë i kulluar si kristal, filluan të ngjiteshin si mizë lisi fshatarët. Burrat e pjekur e të moshuar



kishin hipur mbi kuaj, kurse më të rinjtë ecnin më këmbë me pushkët krahëqafë.

Të gjithë u mblohdhën dhe filluan të uleshin këmbë-kryq pranë burimit.

— Na duhet të zgjedhim një komandant — thanë disa zëra njëherësh.

— Poshtë bejlerët! — tha njëri nga fshatarët.

— Nuk paguajmë më taksa, as të dhjeta!

— Në litar Esat Pasha!

— Duam tokë, ajo është jona!

— Poshtë princ Vidi!

Bërtisin fshatarët të zemëruar e të revoltuar dhe se-cili, kur thoshte diçka, ngrinte pushkën lart dhe e tundte në ajër. Të gjithë kishin sjellë armatime. Aty kishte pushkë nga të gjitha markat e botës.

Fshatarët kishin sjellë me vete edhe ushqime. Ata ishin veshur dosido. Disa kishin mbathur opinga lope, ca të tjerë opinga llastiku; por kishte midis tyre edhe me cizme lëkure të vjetra e me këpucë me qafa ushtarake. Këta fshatarë tē veshur si gjysmë ushtarakë kishin shërbyer dikur në ushtrinë turke. Lam Leka pesë vjetët e ushtrisë i kishte kryer në Stamboll, kurse xha Asllani kishte qenë ushtar deri në Tarabulluz, bile i kishte rastisur tē luftonte me komitët e atij vendi, që ishin njerëz me lëkurë tē zezë, me flokë kaçurrela dhe që ecnin aq shpejt sa ai vetëm hijen u kishte parë. Kishte nga ata fshatarë që sapo ishin kthyer nga lufta e Shkodrës. Më pleqtë tregonin për luftërat e zhvilluara në Jemen. Shumica e kësaj turme fshatarësh që mbushnin sheshin ishin veshur me brekushe tē zeza, kurse mbi krye u zbardhnin qeleshet e pastra si dëbora e maleve.

— Ç'është kjo zabullimë? Kush dha urdhër tē bu-çasë daullja, e të mblidhet fshati? Ç'janë gjithë këto pushkë? Mos luajtët nga mentë? — pyeste fshatarët krye-plaku duke qëndruar mbi bregun e burimit që kishte krijuar një si pellg.

— Ç'do tē thuash, more? — i tha një fshatar nga ata që ishin ulur këmbëkryq në radhën e parë.

— Këtu pyetem unë, — thirri i inatosur kryeplaku,

kur vuri re se askush nuk po e përfillte e nuk pranonte t'i përgjigjej.

— E kush të ka zgjedhur ty kryeplak, ty, more, që dashke të të pyesim, e të mos bëjmë gjë pa lejen tënde? — i tha Ram Leka. — Ty të ka vënë kryeplak Xhavit Beu, ai le të të dëgjojë e le të të pyesë!

— Për besë ai qenka budalla — u tha xha Asllani bashkëfshatarëve dhe qeshi me zë të lartë: «hi...hi...hi...»

Në turmë shpërtheu zemërimi, që arriti kulmin kur kryeplaku hundështypur hoqi pushkën nga krahu dhe ua drejtoi fshatarëve.

— Do t'i dërgoj lajm Xhavit Beut që bujqërit e tij kanë ngritur krye dhe mjerë ju të mjerët! Do t'ju ngordhë në dru — tha kryeplaku, të cilit i dridheshin duart nga inati e nga frika.

— Shporru që këtej, o kryeplak i zgjebosur! — i bërtiti Mali dhe brofi e u gjend përpara tij. Me një lëvizje të rrufeshme ai ia rrëmbeu pushkën nga duart.

— Ikë, ore qen bir qeni, se po të ngordh në hu! — i tha xha Asllani dhe shtoi: — Na e ke sjellë në majë të hundës, ore sahanlëpirës i bejlerëve!

— Hiqeni që këtej! — dha urdhër Ram Leka. — Nuk kemi nge të merremi me të.

— Ky qenka budallallepsur — tha njeri nga fshatarët, që i ishte afruar fare pranë kryeplakut. — S'paska marrë vesh se ç'ka ndodhur këtu!

Mali dhe disa të rinj iu turrën kryeplakut, e mbërrthyen nga krahët e nga këmbët dhe, pasi e ngritën peshë, e hodhën në mes të pellgut të burimit. Pasi doli nga pellgu, i lagur e i bërë quall, duke u dridhur nga të ftohtët si qen i rrahur, ai filloj ta kuptonte se çfarë rreziku i kânosej. Fshatarët qeshnin me të madhe. Ata s'pyetën për kryeplakun dhe nuk e vunë më re largimin e tij nga sheshi i kuvendit.

Tanimë ishin mbledhur të gjithë burrat e Pishtarit të aftë për luftë. Kishte ardhur të paktën një luftëtar nga çdo shtëpi, kurse nga shtëpitë e mëdha dy dhe tre burra.

— Qetësi, o vëllezër! Qetësi, pra! — thirri Ram

Leka, që ishte ngritur në këmbë dhe po u drejtohej fshatarëve.

Turma ra në heshtje. Të gjithë prisnin me padurim se çfarë do të ndodhë e çfarë duhej bërë.

— Sot janë ngritur më këmbë fshatarët e të gjitha krahinave të Tiranës: të Kasharit, Pezës, Petrelës, Arbanës, Sharrës e Picarit, të krahinës së Shjakut, Peqinit, Kavajës e të tjerave.

— Thuajna se ç'duhet të bëjmë — tha një fshatar nga lagjja e epërme e Pishtarit.

— Të flakim tej një herë e përgjithmonë kularin që na kanë vënë në qafë bejlerët — tha Ram Leka.

— Duam tokë! — thirri Mali.

— Bejlerët nuk e lëshojnë tokën — shtoi xha Asllani.

— Atëhere nuk ka rrugë tjetër, ne do t'ua marrim me pushkë — u përgjegj Mal Xhoka. — Ne fshatarët kemi lindur e jemi rritur në këtë tokë, ne e punojmë atë. Ajo duhet të jetë jona.

— Bejlerët na kanë sjellë mbretin e huaj Vidin, — tha xha Asllani dhe shtoi me inat: — Esat Pashë Toptani e shokët e tij jo vetëm që nuk po pranojnë t'i japid tokën fshatarëve, por ata po i shtojnë për ditë çifligjet e tyre në kurriz të të varfërve.

— Poshtë Esat Pashë Toptani!

— Në litar Pashën!

— Jashtë Vidi nga Shqipëria!

— Mjaft dërdëllite, ore plak! — i tha njëri nga turma Ram Lekës. — I dimë të gjitha! Çorbë është bërë kjo punë. Përse harxhon frymën të na mbushni mendjen se çfarë të këqiash kanë bërë bejlerët!

— Të sulmojnë çifligjet e sarajet e bejlerëve, — tha Mal Xhoka.

— T'i djegim me zjarr sarajet e bejlerëve — briti xha Asllani.

— Të sulmojmë Durrësin! — tha Mali: — T'i vemë pushkën Vudit e ta hedhim në det.

— Të sulmojmë Tiranën! — tha Asllani.

— Përpara, o burrani!

— Në sulm!

— Përpara, përpara! — thërrisin fshatarët të revoltuar.

— Mos humbisni kohë! — thirri i nxehur dhe i paduruar Mali.

— Pritni, pritni! — tha Ram Leka, duke u munduar të mbante qetësinë e asaj turme.

— Edhe dhitë e duan një cjak me kumborë! — tha xha Asllani — cilët dëshironi të zgjedhim për këshillë të kryengritjes së fshatit Pishtar dhe cilin burrë për komandant ushtrie?

— Musa Hykën! — tha njëri nga ata të shtëpisë së Malëve.

— Nuk e duam atë, ore jo! — tha një tjetër.

— Ai, me nder s'ka fuqi të lidhë ushkurin e brekëve, e ju na dashkeni të na e veni të parë!

— Kësaj i thonë luftë dhe jo shaka — tha një fshatar tjetër në moshë të re.

— Duam një komandant trim, që të ketë krahë të fortë dhe këmbë të shpejta — tha Lami, që mbante një brez të bardhë ndryshe nga të gjithë fshatarët.

— Nuk ka folë ndonjëherë kaq drejt Lami me brez të bardhë — tha Myftari.

— Të vëmë komandar Mal Xhokën! — thirri një nga burrat e shtëpisë së Jataganëve, që dikur kishte qenë ndër ata trima që shoqëruan Ismail Qemalin, Luigi Gurakuqin, Isa Buletinin e patriotët e tjerë nga Durrësi në Vlorë në nëntor të vitit 1912.

— Malin! Malin! — thërriste turma e fshatarëve.

— Atë të vëmë komandar.

— Mali është trim, të merr gjak në vetull — tha xha Asllani.

Turma e fshatarëve kryengritës ngriten armët lart, shenjë që tregonte miratimin për zgjedhjen e komandantit pishtarak Mal Xhoka.

Njëri nga të rinxjtë e kuvendit, Naim Selita, që ishte një nga shokët e ngushtë të Malit, me t'u qetësuar turma, u ngrit më këmbë dhe thirri me zë të lartë:

— Mali është shqiptar i vërtetë! Rroftë flamuri i Shqipërisë! Rroftë liria!

— Urra, urra! Rroftë, rroftë!.. — thërrisin fshatarët e rinj kush më parë, e kush më prapa. Buçima e zérave të tyre mbushi qellin.

— Dëgjoni, burra! Unë jam me dauletin! Shqiptarizma, shkronjat shqipe, flamuri me sorrë janë gjëra të krishtera e të pafë. Rroftë flamuri me gjysmë hënë! Atë njoh unë për flamur! Sa për bejlerët, atyre fara mos u mbettë!

— u hodh e tha njëri nga pleqtë e fshatit.

— Edhe unë me ty jam — ia priti një tjetër bashkëfshatar në moshë të kaluar. — Jashtë nga vatani mbreti i krishterë! Duam për mbret një princ turk nga Stambollı!

Ky ishte Liu i Dajës, ai që kishte shërbyer tërë jetën në derën e Esat Pashë Toptanit.

— Dëgjoni, ju, vëllezër, dhe ti, o babë i nderuar! — tha Mali duke iu drejtuar turmës fshatare dhe njëko-hësisht duke i rënë në sup babait të shokut të tij, që e nderonte shumë. — Secili ka fenë e vet, po ama të gjithë ata që flasin një gjuhë, të gjithë ata që flasin gjuhën shqipe, janë të gjithë shqiptarë, qofshin muslimanë a të krishterë...

Fshatarët dëgjonin në heshtje e me vëmendje fjalët e Malit. Ata dy vjet më parë kishin luftuar për pavare-sinë e Shqipërisë dhe më 26 e 28 nëntor të vitit 1912 kishin brohoritur ngritjen e flamurit të Skënderbeut në Tiranë dhe shpalljen e pavare-sisë të vendit të tyre, mirëpo pas kësaj ngjarjeje punët ishin ngatërruar dhe disa njerëz kishin filluar të propagandonin nëpër fshatra sikur gjoja patriotët shqiptarë po prishnin fenë dhe se për të shpëtuar nga kjo e keqe e madhe duhej të rrrokeshin armët e të luftohej që Turqia të kthehej përsëri.

— Bejlerët gjithë jetën e tyre, brez pas brezi, u kanë shërbyer sulltanëve të Turqisë dhe ne të varférve na kani degdisur nëpër trojet e huaja. Tashti, që Turqia mori të tatëpjetën dhe po krijohen shtete më vete, bejlerët e pashallarët lanë Stambolin për të shpëtuar nga gjemia që po mbytej dhe bënë pre mbi ne fshatarët. Ata po na

e pinë gjakun si shushunjat ne të varfërve, — tha Ram Leka dhe vështroi përreth për të kuptuar se c'përshtypje po bënин fjalët e tij. Ai e dinte se disa fshatarë, e veçanërisht të moshuarit, nuk i kuptionin intrigat e xhontur-qve dhe qëllimet politike të bejlerëve, sidomos të Esat Toptanit.

Xha Asllani, që kishte luftuar në radhët e çetës shqiptare të Krujës, në vitin 1912, dhe që e kishte kuptuar disi se duhej luftuar në dy drejtime: për pavarësinë e Shqipërisë dhe për drejtësinë fshatare, doli përpara dhe tha:

— Shqipërinë do ta bëjmë pa bejlerët! Ne do të vendosim qeverinë dhe drejtësinë fshatare dhe nuk kemi punë me kralët e huaj.

— Poshtë bejlerët!

— Poshtë mbreti!

— Rroftë flamuri!

— S'kemi punë me kralat!

Plasi zhurma dhe grindja midis fshatarëve, sepse secili thoshte mendimin e vet. Përsa i përket luftës kundër bejlerëve dhe qeverisë së Vudit, që të gjithë kryengritësit ishin të një mendjeje, po sherri plasi për çështjen e flamurit dhe të vendosjes së një mbreti nga dera e Turqisë.

— Mos u grindni si gratë! Qetësi! Në më keni zgjedhur për komandar duhet të më dëgjoni! — u tha Mali fshatarëve dhe shtoi: — T'i lëmë mënjanë ndasitë! Qëllimi i kryengritjes është që të rrëzojmë bejlerët, të rrëzojmë qeverinë dhe të shporrim nga vatani mbretin e huaj! Qëllimi ynë është që të vendosim drejtësinë fshatare! Tani le të zgjedhim këshillin e kryengritjes dhe le të nisemi për në Shijak!

— Po! Po! Ashtu është! — u përgjegjën njëzëri ata.

Turma e fshatarëve të egërsuar ra prapë në heshtje dhe kjo tregonte që ata pranonin fjalët e komandantit të tyre, Mal Xhokës, i cili, ndonëse në moshë të re, u ngjallte respekt edhe të moshuarve për trimëritë që kishte trenguar. Jo vetëm kaq, po Mali ishte nga ata djem të paktë në krahinë që kishte mësuar shkrim e këndim aq sa për



t'u lexuar fshatarëve letrat, librin me vjersha të Naim Frashërit dhe historinë e Skënderbeut.

— Unë propozoj që në këshillë të jenë Ram Leka si kryetar dhe xha Asllani, Arifi e Ymeri si anëtarë — tha Xhevdeti, njëri nga burrat më të urtë e më të nderuar të fshatit.

— Po, po!.. — thirrën prapë njëzëri kryengritësit.

— Le të dalë këshilli aty përpara! — thirri Naimi.

Të gjithë fshatarët ngritën pushkët lart duke votuar me këtë gjest për këshillin kryengritës të fshatit Pishtar.

— Që nga kjo ditë këshilli do të jetë qeveria e fshatit! — tha Rama. — Dhe tashti po ia jap fjalën përsëri komandarit.

— Dëgjoni, vellezër! — thirri Mali. — Çdo dhjetë vetë do të kenë një komandar. Komandarin do ta zgjidhni ju, sipas dëshirës. Lufta ka ligje ushtarakë. Ai që nuk do t'u bindet urdhërave, ose do të tradhëtojë kryengritjen tonë fshatare, pasi të gjykohet nga këshilli e nga populli, do të dënohet me varje në litar!

— Të zgjedhim edhe një zëvëndëskomandar, se luftë i thonë! — tha xha Asllani.

Naimin! — thirri një fshatar.

— Mirë e ke! — iu përgjegj Mali. — Naimi është trim dhe i urtë!

— Të hedhim barutin në zjarr! — thirri xha Asllani. Mali ngriti pushkën dhe shtiu tri herë në ajër. Pas tij filluan të gjuanin të gjithë njëri pas tjetrit... Të gjithë ishin të një mendjeje për rrugën që do të ndiqnin: kryengritje!

— Çeta pas meje! — thirri Mali, dhe ashtu siç ishte, i kthyer nga fshatarët, me pushkën ngritur pezull, bëri përpara.

— Për Shijak! — tha Rama, që e cte në radhët e para të togës, i shoqëruar nga xha Asllani, Lami e shokët e tij të ngushtë.

— Do të vij edhe unë me ju — tha lodraxhiu me daullen varur pas supit të djathtë dhe me një nga ato koburet e karadakut me muli dhe me gjashtë fole në brez.

Fshatarët, që i hapën rrugë kovaçit për t'u radhitur

në mes tyre, miratuan guximin e tij, duke thënë: «Të lum-të! Lodra jote do të na japë zemër në luftë!»

Bami, shoku i fëmijnisë të Malit, qëndronte kokulur, sepse ai nuk iu përgjegj thirrjes së kryengritësve, pasi kish-te shumë halle.

Mugëtira po përfshinte krahinën, ndërsa larg në horizont skuqte ende një copë re, që dukej si një njollë e madhe gjaku. Këmbët gjysmë të zbathura të fshatarëve kryengritës shkelnin në tokën e papunuar, që vende-vende ishte plasaritur duke krijuar figura të parregullta gjeometrike.

## SHTËRGATA SHKON DREJT DETIT

Pishtarakët kryengritës, që po vërshonin për në Shijak, atë natë ishin ndalur nën disa ullinj dhe qenë struktur në një shpellë në faqe të një boke fare të zhveshur.

— Ngulini thikat në tokë dhe mos i mbani pushkët rëpër supe! — u dha urdhër kryengritësve Ram Leka. — Hekuri e thith rrufenë dhe ia përcjell tokës. Pushkët i vini pirg njëra mbi tjetren!

Fshatarët iu bindën këshillës së Ram Lekës dhe menjëherë i hoqën thikat e bajonetat nga trupi e i ngulën në tokë, disa metra larg shpellës. Disa prej tyre i ngulën thikat në një rrap të gjymtar nga natyra.

Re të murime vinin nga deti dhe era që frynte i shtynte ato si kuçedra të tërbuara drejt kodrave e vargma-leve të lindjes. Poshtë prej fshatit filloi të ngrivej një spirale pluhuri, e cila ngjitej lart dhe pastaj zhdukej në qie-llin e pafund e të nxirë sterrë. Shiu binte me shtamba. Herë pas here shkrepëtinte dhe për një çast drita verbuese zbulonte një copë qiell të kaltër. Rrufetë, si disa disqe të zjarra fluturuese, qëllonin tokën pa mëshirë.

Kjo shtërngatë, që erdhi nga lindja, po ikte shpejt drejt detit duke vazhduar ende me gjëmime tashmë të largëta dhe vezullime të zbeta vetëtimash. Në vendin ku po pushonin kryengritësit dielli i majit lëshoi përsëri rrezet e tij të ngrohta dhe gjethet e pemëve filluan të shëndris-nin, kurse kaltërsia e qiellit zbuloi përsëri gjithësinë e pafundme qiellore.

Mali, që rrinte mbështetur pas zgavrës së një ulliri,




me dorën në karafilën që e pati ndërruar me Asllanin kishte tretur mendjen diku larg në horizont. Megjithëse i mahnitur nga pamja e magjishme e natyrës pas shiut, ai vazhdonte të bluante në trurin e tij ngjarjet e kryengritjes.

Mali kishte mbetur jetim qysh në moshën dy vjeç. Babain ia kishte vrarë hasmi, kurse nëna i kish vdekur nga një sëmundje e pashërueshme që fshatarët e quanin «qimza». Malin e kishte rritur xhaxhi i tij Ram Leka. Rama kishte një karakter të çuditshëm. Ai e trajtonte Malin edhe si shok. Ata pinin raki e duhan së bashku në shogëri e në miqësi, qëllonin në shenjë me pushkë, punonin tokën barabar me parmandë dhe me qyrek, qanin hallet e shtëpisë dhe bisedonin për punët e fshatit e të vendit tok me miqtë e me bashkëfshatarët. Mbiemri i tyre ishte Xhoka, por Ramës i kishte mbetur «Leka» që kur kishte lufتuar në Kosovë më 1910-1912. Me këtë emër të ri e kishte pagëzuar atë Isa Buletini, kur kishte ardhur me Hasan Prishtinën, njërin nga organizatorët e kryengritjes patriotike kosovare, nga Stambolli në Kosovë. Isa Buletini e kishte thirrur për herë të parë «Ram Leka» për të treguar se ai vinte nga pjesa tjetër e Shqipërisë.

Mali, i ndikuar nga xhaxhai dhe miqtë e tij patriotë të flaktë, që kishin marrë pjesë në disa lëvizje e kryengritje për çështjen e pavarësisë dhe të të drejtave shqiptare, ishte preqatitur jo vetëm si luftëtar, por edhe si patriot shqiptar, ndryshe nga disa moshatarë të tij në fshat, që kishin mbetur të paditur, si barinj. Mali ishte njojur e lidhur me miq tiranas, shijakas, kosovarë, shkodranë, bile ai kishte një mik të ngushtë, një lab nga Tërbaçi, i cili pati zbritur në Vlorë qysh nga dita e 28 Nëntorit të vitit 1912. Atë labin e quanin Beqo Labi. Ai kishte ardhur dy herë si mik në Pishtar në shtëpinë e Ram Lekës. Herën e parë kishte bujtur dy net, kurse pas gjashtë muajsh, labi kishte ndejtur te Lekajt plot dy javë.

- Nisemi, vëllezër! — ia ndërpren Rama mendimet.
- Ngjishni armët e jataganët!
- Mos humbni kohë! — u thërriste Naimi fshatarëve kryengritës, që s'po luanin nga vendi.



— Merre shtamën, more derdimen! — i tha xha Asllani Lamit.

— Bjeri daulles, o Ali Kovaçi — thirri një nga kryengritësit. — Të zgjohet milet!

Karvani i kryengritësve të fshatit Pishtar, që ishte bashkuar edhe me një çetë tjetër të revoltuarish, u vunë përsëri në ecje. Prapë filloi kënga! Disa nga fshatarët bisedonin me zë të lartë, ca të tjerë shanin bejlerët me fjalë të ndyra. Në krye të ushtrisë fshatare, që numëronte rrëth dyqind e ca vetë, printe Mali, Naimi dhe fill pas tyre ecnin dosido Ram Leka e Asllan Fikasi.

Pas disa orësh kryengritësit mbërriten në një përrua, të cilin e kapërcyen dhe bënë përpara gjer te maja e kodrës, që ngjante si e veshur me kadife të gjelbërt nga bari i njomë që sapo kishte mugulluar dhe shkëlqente nga vesa.

— C'është ky quell që qenka rrafsh me tokën? — pyeti Lami Ramën, që kishte mbërritur më parë në majë të kodrës.

— Deti, more tarallak! — tha Rama duke qeshur.

— Au... u... ky është deti! Për besë nuk kam pa kurrë në jetën time det me sy! — pohoi Lami dhe shtoi: — Pas dyzet vjetëve vëllai yt po hudh këmbën jashtë prafit\* të Tiranës!

Fshatarët kryengritës, që kishin arritur në kodër, puhuan një copë herë. Shumica e tyre ishin të mahnitur nga madhështia e detit Adriatik atë mëngjlez pranvere të vitit 1914.

— Shih... shih! Një gjemi! — tha Naimi.

— Ja edhe një tjetër më tutje, duket si një njollë e zezë! — ia priti Mali, që kishte vënë dorën si strehë mbi ballin e lartë të nxirë nga dielli.

— Janë gjemitë e Italisë — tha Ram Leka, që ishte i informuar për gjendjen e krijuar.

— Ai që nxin atje larg, rrëzë atyre kodrave andej nga buza e detit, është Durrësi! — tregonte Asllani duke zgjatur dorën e rreshkur në drejtim të qytetit.

\* prafit = prag (dial.)

— Atje është pallati i mbretit dhe i Esad Pashës! — tha Mali dhe shtoi: — Për së shpejti do të vijë dita të sulmojmë kryeqytetin dhe t'u japim një dru të mirë bejlerëvet dhe qeverisë së tyre.

Poshtë në fushë ishin ngritur disa kasolle me kashtë, por midis tyre dalloheshin fare qartë shtëpitë e ndërtuara me gurë e qerpiçë.

— Puna e parë që do të bëjmë — tha Rama — është që në çdo fshat ku të kalojmë të rrëzojmë kryeplakun. Në qoftë se do të ketë mbetur ndonjë xhandar i qeverisë duhet ta çarmatosim, po të kundërshtojë t'i japim plumbin kokës.

— Të ngremë këshillat e kryengritjes fshatare atyku ende nuk janë bërë zgjedhjet, dhe ata vetë të kullandrisin punët e tyre! — tha Mali.

— Pjesa më e madhe e kësaj fushe është çiflig i Esad Pashës! — tregoi një nga fshatarët kryengritës, që e kishte shtëpinë jo shumë larg që këtej.

Kur hynë kryengritësit në fshat, njérëzia kishin dalë që t'i prisnin. Kryeplaku, i cili ishte një aga fshati me dyzet dynym tokë, dyqind krerë bagëti të imta, dy kuaj, njëqind rrënje ullinj dhe dy palë qe, shërbente edhe si qahaja i beut. Selim Aga, kur pa se të gjithë fshatarët dolën të prisnin kryengritësit, u vesh shpejt e shpejt, e, pasi vuri fesin e zi prej kadifeje, u turr t'i dilte përpara komandantit të kryengritjes. Pasi bëri një temena duke u përkulur gjer në tokë, agai hapi sytë të shquante se cili ishte komandanti, që ta ftonte në gosti. Selim Aga menjëherë mendoi se komandanti nuk do të ndodhej midis kryengritësve. E cili nga ata fshatarë, të mbathur me gjysmë opinge, me brekushe të shqyera e me qeleshe jo fort të pastra mund të ishte komandanti?

— Cili je ti? — e pyeti me ton mospërfillës Mali.

— Selim Aga, turk elehamdylilah! — i tha ai, dhe me qesëndi shtoi: — Jam miku i Musa efendiut, myftiut të Tiranës, që është kryetari juaj.

— Po kryeplaku kush është?

— Unë jam! — tha Selim Aga, që po e merrte veten pak nga pak. — Kërkoi të takohem me komandantin tuaj.

— Komandant jam unë — ia priti Mali dhe e vësh-troi me qesendi, pasi vuri re habinë e agait.

— Ky është edhe qahajaji i beat! — ndërhyri e tha një djalosh i bëshëm, që ishte prej atij fshati.

— Është edhe fajdexhi! — shtoi një fshatar tjetër.

— S'ka lënë gjë pa bërë në kurrizin e fshatarëve! Ky ka katër gra në shtëpi! — tha një plak i gjatë si hosten.

— Lidheni! — urdhëroi Mali.

Kryengritësit pasi ia përdrodhën dhe ia lidhën duart Selim Agës e nxorën përpara fshatarëve, që ishin mble-dhur në një shesh të vogël para shtëpive të fshatit.

Agai rrinte kokulur dhe çuditej me punën e çetës së Pishtarit. Kishin kaluar në atë fshat sa e sa toga e turma të tjera fshatarësh kryengritës, po Selim Agën jo vetëm që nuk e kishin prekur, por përkundrazi ishin këshilluar me të në çdo pikëpamje. Ndraqakët, të komanduar nga Mustafa Agë Ndraqi, ai i kishte ftuar në gosti. Ata kishin pranuar menjëherë e qenë shtruar paq në sofér të tij. Mendimet e tyre për rrëzimin e qeverisë së Princ Vudit, si mbret i krishterë dhe zëvendësimi i tij me një trashë-gimtar nga derë e sulltanit të Turqisë përputhesin krejtësisht. Gjatë gjithë asaj darke ata s'kishin përmendur asnjëherë Esad Pashën, të cilit Selim Aga i shërbente si qahaja. Madje, vetë qahajai kishte qenë një ndër ata njerëz të besuar të Esad Pashës që ca kohë më parë ishin shpërndarë nëpër fshatra të ndryshme për të nxitur popullin në kryengritje kundër mbretit të krishterë «që po e prishte fenë më të drejtë të botës, fenë muhamedane», e për të hipur në fron në vend të tij një princ musliman. Fshatarëve nuk u thuhej se cili do të ishte ky princ musliman, por nëpër dyert e agallarëve të Arbanës, të Kasharit, të Ndraqit e të katundeve të tjera, nxitësit e kryengritjes thoshin haptazi se mbret i ardhshëm do të ishte Esad Pashë Top-tani.

— Selim Aga! — i thirri xha Asllani. — A do të heqësh dorë nga shërbimi për Esad Pashë Toptanin?

Mali, që ishte ndejtur mbështetur pas një mani me duar të lidhura nën gjoks, ia plasi gazit.

— Nuk ka më bejlerë e agallarë, jo! — thirri komandari, që nxori nga brezi i qillotave dhjetëshen turke dhe ia drejtoi Selimit.

Agai e shikoi djaloshin e panjohur me një sy të tmerruar dhe habitej me këta njerëz kaq të guximshëm, që kishin ngritur krye kaq egërsisht kundër gjithë bejlerëve dhe agallarëve pa bërë asnjë dallim.

— Cilët jeni ju? — pyeti me gjysmë zëri Selim Aga dhe ndërkaq u hodhi një vështrim bujqve, që e kishin rrëthuar.

— More ky derdimen s'po e kuption ende se çfarë po ndodh — tha Ram Leka duke ndjerë gjendjen e hutar që kishte plakosur buqit. — E, vëllezër, si thoni, ç't'i bëjmë Selim Agës? Gjykatës, tani, jeni vetë ju, nuk ka më kadilerë! Në doni të mbani prapë zgjedhën e bejlerëve në kurriz, në doni të punoni ende tokën tuaj dhe bereqetin t'ua jepni bejlerëve, në doni ende të mbeteni pa shtëpi, pa katandi e pa tokë nga faizi i agallarëve dhe të dhjetat, nga xhelepi e nga taksat, rrini kështu si jeni dhe bëjini temena Selim Agës, në mos...

Kur pa se buqit morën zemër dhe filluan të lëviznin, Ram Leka e ngriti zërin dhe thirri me zemërim:

— Gjykojeni pa frikë!

— Ta shtrojmë në dru! — thirri një fshatar i veshur me një këmishë bezeje pa kopsa, e cila mezi ia mbulonte gjoksin leshtor e tërë kocka.

— T'i djegim shtëpinë! — tha një tjetër.

— More ta djegim e t'i japim yll! — ia priti një plak i kërrusur mbi një shkop dhe që dukej menjëherë se ishte i sëmurë sa mezi mbahej në këmbë.

— O burrani, të mos humbim kohë! — thirri një fshatar në moshë të pjekur, që mbante në sup një pushkë të vjetër austriake.

— Prisni! — tha Mali dhe ngriti dorën lart.

Fshatarët, që ishin drejtuar për te shtëpia e Selim Agës, një kullë dykatëshe ndërtuar me mure tulle, mbajtën këmbët të dëgjonin.

— Mos më prekni! — thirri i tmerruar Selim Aga dhe,

si pér t'u mbrojtur, ngriti duart e lidhura që të mbulonte fytyrën e mavijosur. — Do ta pësoni nga Pashai. Ai do të...

— Njëqind e një shkopinj! — dha vendim Mali.

Agai, duke vështruar komandarin me sy të çakërdisur po e kuptonte pak nga pak se përse ishin mbledhur atje gjithë ata njërez të armatosur dhe se sa shumë e urrenin bujqit e tij.

Naimi dhe dy fshatarë të tjerë të fuqishëm e kapën again pér zverku e nga këmbët dhe, sa hap e mbyll sytë, e shtrinë pér tokë. Njëri nga ata i hoqi këpucët me qafa, e tjetri i zgjidhi pantallonat dhe e la në të mbathura.

— Largohuni që këtej! — tha njëri nga bujqit, një fshatar me fytyré vrarë lije. Dua të marr pjesë edhe unë, se atë që më ka bërë ky i poshtër nuk ka gojë ta tregojë.

— Të bëjmë një udhë e dy punë — tha njëri nga bujqit, që ishte më i moshuari. — Ta rrahim përpala shtëpisë së vet dhe pastaj t'i japim flakën asaj. Kështu, ky katil, duke ngrënë shkopinjtë, të shohë edhe se si digjet kulla e tij.

— Shumë mirë!.. Të lumtë!... Sa mirë të ra në mend! — thërrisin fshatarët.

Selim Agën e tërhoqën zvarrë dhe e hodhën në një vend me driza përpala shtëpisë.

— Pasi të kryejmë këtë punë — tha Ram Leka — të zgjedhim edhe këshillin e kryengritjes së fshatit.

Disa nga kryengritësit, të ndihmuar nga bujqit, pasi kishin hequr nga kthinan disa plaçka që i nxorën në fushë jashtë rrezikut, i vunë zjarrin shtëpisë. Njëra nga gratë e Selim Agës qante me kuje, kurse ajo e katërtë, që ishte në moshë të re, ecte me fytyrë zbuluar dhe dukej most-përfillëse pér ato që po i shihnin sytë. Ajo pa Selim Agën, të shtrirë pér tokë në një gjendje qesharake dhe dëgjoi rënkimet e tij nga shkopinjtë që i binin në kurriz njëri pas tjetrit. Enkas grua ja e re e guximshme i kaloi fare pranë burrit të saj të urryer, që ia kishte nxirë tërë jetën. Selim Aga i hodhi asaj një vështrim qortues. Gruaja e re vete-tëve të fundit, kur fati e kish sjellë të bëhej njëra nga

gratë e atij plakushi pesëdhjetëvjeçar shpirtkazëm e tekanoz.

Edhe pasi u largua përtej gardhit të asaj shtëpie të urryer, për të mos u kthyer më kurrë, gruaja e re vazhdoi të dëgjonte rënkitet e atij dhe të qeshurat e shakatë që hidhnin fshatarët përreth.

— Po tani ç'të bëjmë me aganë? — pyeti ai fshatari me fytyrën e vrarë lije, që kishte ndihmuar kryengritësit për të zbatuar vendimin.

— A do të keni frikë përsëri po të ngjallet?! — pyeti një fusharak duke vështruar me sy hetues fshatarët.

— Tashti ky edepsëz nuk ka më fytyrë të ngrihet kundër nesh! — tha një fusharak tjetër dhe shtoi: — Kulla dhe malli i tij u bënë shkrumb e hi.

— Bëni si të doni! — tha Ram Leka. — Ne nuk kemi nge të merremi më me këtë punë. Duhet të nisemi! Ata që janë burra e trima të vërtetë le të vijnë pas nesh!

Kulla e Selim Agait filloj të rrënohej, ndërsa flaka po merrte çatinë. Lodraxhiu, sipas urdhërit, filloj të qëllonte me shkop daullen me një notë të re «trampa... trampa...», ndryshe nga ç'i kishte rënë në Pishtar. Kryengritësit u vunë në radhë dhe u bënë gati për t'u nisur. Disa fshatarë të armatosur nën komandën e Naimit, po ngarkonin në një qerre thasët e fundit të miellit të misrit, që i ishin sekustruar Selim Agës. Një turmë fshatarësh, nga ata që nuk u bashkuau me ushtrinë e kryengritësve fshatare, kishin sjellë nga shtëpitë ushqime për shokët e tyre.

— Ja se si do të ushqehet ushtria jonë! — tha Mali me zë të lartë duke iu përgjegjur kështu më tepër një pyetjeje që ia bënte vetes vazhdimisht që kur ishin nisur nga Pishtari. Por në kokën e tij kishte edhe mjaft çështje të tjera që e mundonin dhe që ai djalosh nuk dinte t'u jepte zgjidhje.

— Populli do të na ushqejë e do të na strehojë! — iu përgjegj Rama.

— Sarajet e bejlerëve janë plot me ushqime dhe këto duhet t'i përkasin ushtrisë! — tha Asllani.

— Si t'ia bëjmë plackës që i kemi zënë Selim Agës?  
— pyeti komandanti i togës një nga fusharakët.

— Le t'ua ndajë këshilli i fshatarëve — tha Mali duke u vënë në krye të togës kryengritëse.

Pas një ore rrugë, njëri nga kalorësit vuri re se si nga fshati përbri po zbrisnin, pothuajse me vrap, një varg i gjatë fshatarësh.

— Është toga e kryengritësve të fshatit Erzen të Shijakut, — tha njëri nga ata fshatarët që sapo ishte bashkuar me Pishtarakët.

— Kjo është si sëmundje ngjitëse! — tha Rama, që kishte qëndruar në vend dhe mezi po shquante nëpër muzg njerëzit që po vinin drejt tyre. Tani ata ishin aq afër sa mund t'ua shquaje qartë armatimet.

— Cili është udhëheqësi i kësaj kryengritjeje? — pyeti befas Mali të ungjin, që po i rrinte në krahë.

— Nuk e di! — ngriti supet Ram Leka.

— Si nuk e ditke! — i tha i çuditur i nipi.

— Ndoshta do ta zgjedhim në Shijak! — i tha Rama.

Të dy grupet e kryengritësve vazhduan rrugën drejt Shijakut.

## NJË MISION I JASHTËZAKONSHËM

Atë natë që kryengritësit e Pishtarit dhe të disa fshatrave të tjera hynë në Shijak, njëri nga udhëheqësit kryesorë, siç e quante ai veten, bisedoi krye më krye me Ram Lekën dhe po atë natë Mal Xhoka, fill i vetëm, u nis për në Durrës. Pela e bardhë, që ai kishte shaluar, eci revan rrugës së vjetër të Durrësit dhe hyri në lagjen e parë të qytetit. Ndërkojë agu mëngjezor po ia zbulonte kaltërsinë detit.

Mali trokiti tri herë në portën e vjetër e të nxirë nga koha dhe këtë e përsëriti edhe katër herë pas një intervali prej disa minutash. I zoti i shtëpisë, që ishte një ndër anëtarët kryesorë të kryengritjes, e kuptoi shenjën. Ai hapi derën dhe pasi e vërejti vetëtimthi djaloshin e gjatë të veshur me qillota, tha:

— Hyni brenda!

— Erzeni del nga gryka e Pëllumbasit dhe pasi përshkon Mulletin, Arbanën vjen në Shijak dhe derdhet në det! — i tha Mali të panjohurit, që ishte një burrë i thyer në moshë me flokë të rënë, me një shtat mesatar thatim.

Shijakasin, që banonte në Durrës që nga koha e Hyriitet dhe merrej me punimin e qelesheve, e kishin shpërndarur çifligarët nga trualli i tij si shumë fshatarë të tjerë.

— Ecni pas meje! — i tha shijakasi Malit dhe i priu përpëra. Në anën tjetër të oborrit të shtruar me kalldrëm ishin dy dhoma të vogla përdhese të mbuluara me tjegulla dore, me çati aq të ulët, sa tavanin e arrinte dora.

Pasi hynë në një nga kthinat e shtëpisë dhe u ulën

pranë një oxhaku, rrëth të cilit ishin shtruar lëkurë dashi, i moshuari dhe i riu biseduan mbi gjendjen e krijuar. Ata rrahën disa nga çështjet që e shqetësonin ushtrinë e fshatarëve kryengritës.

Ishte ditë e diel. Në kryeqytet ishin bërë preqatitje të mëdha. Mbreti dhe mbretëresha Sofia do të shkonin në kishë për të marrë pjesë në meshën e së dielës, që ishte organizuar nga kleri katolik për nder të çiftit të shkëlqyer të aristokracisë prusiane.

Mali kishte dëgjuar për ardhjen e princ Fon Vilhelm Vudit si mbret i Shqipërisë, por ende nuk e kishte parë me sy. Ja, tani fati po e sillte që ky djalë fshatarë të takohej me mbretin që e kishin sjellë nga Gjermania për të qeverisur vendin. Takimi do të ishte i jashtëzakonshëm!

Përveç të ungjit, djaloshit fshatar i kishte folur për ngjarjet dhe historinë e Shqipërisë shpeshherë një miku i tyre tiranas, që zotëronte një nga mjeshtëritë sekrete të kohës, mjeshtërinë e telegrafistit. Ai merrej vesh me kazatë e tjera, bile edhe me Beogradin, Romën, Athinën dhe vende të tjera me anën e disa shenjave të çuditshme që ia bënin pi... pi... pi... dhe që shënonin në një shirit pika e viza. Tiranasi i kishte folur Malit për disa nga telegramet sekrete që Ismail Qemali u kishte dërguar të gjitha qyteteve të Shqipërisë. Disa muaj më parë qeveria shqiptare e Ismail Qemalit, e formuar më 28 nëntor 1912, kishte dhënë dorëheqjen. Fill pas Vlorës kishte dhënë dorëheqjen edhe kryetari i pleqësisë së Durrësit Esad Pashë Toptani, që përbënte një qeveri rebele në Shqipërinë e Mesme, kundër qeverisë së Vlorës dhe kundër bashkësisë kombëtare. Pushteti i vendit kishte kaluar në dorën e komisionit të fuqive ndërkombe të K.N.K. Delegacioni shqiptar prej 14 vetësh, i kryesuar nga Esad Pashë Toptani, kishte shkuar në Noi-Vid të Gjermanisë Jugperëndimore dhe më 21 shkurt 1914 i kishte ofruar zyrtarisht princit Fon Vid kurorën e mbretit të Shqipërisë. Kështu, më 7 mars 1914 princ gjerman, i shoqëruar nga luftanijet e Austro-Hungarisë, Anglisë, Francës dhe Italisë kishte zbritur në Durrës.

Koloneli gjerman zbriti në Durrës në atë kohë kur

midis dy shtatmadhorive franceze dhe angleze u lidh konventa e fshehtë ushtarake-detare kundër Gjermanisë. Nga ana tjetër Gjermania po pregatitej për luftën ekspansioniste imperialiste. Austro-Hungaria po pregatitej për luftën që, përvëç përfitimeve të tjera, të kishte hegemoninë edhe në trevën e Ballkanit, duke përfshirë edhe territorin shqiptar. Kështu Vidi nuk ishte as princ, as trashëgimtar i Naldirgëve, as politikan, as albanolog, as edhe mik i Shqipërisë.

Atë ditë në port ishte ndodhur edhe Ram Leka, që kishte qenë i pranishëm kur mbreti i huaj, i shoqëruar nga xhandarët e fuqive evropiane, kishte shkelur në Durrës. Fshatarit i kishte bërë përshtypje prania e Esad Pashë Toptanit në krah të Vudit dhe kishte thënë me vete: «Esad Pashë Toptani është tradhtar.» Të gjitha këto Rama ia kishte numëruar fije e për pe të nipit, ashtu si edhe gjithë ç'kishte parë e ç'kishte biseduar në Durrës me miqtë e tij të vjetër patriotë.

Fuqitë e mëdha, të detyruara nga lufta e kryengritjet e vazhdueshme të shqiptarëve, kishin pranuar pavarësinë e Shqipërisë, por ata e cunguan vendin duke u plotësuar dëshirat e lakmitë e fqinjëve shovinistë serbë, malazezë dhe grekë.

Pas shpalljes së pavarësisë, gjendja ishte keqësuar shumë. Ram Leka, një nga burrat e rrallë e të urtë të popullit, e kishte humbur pusullën dhe nuk dinte nga t'ia mbante.

Tani në Durrës qeveriste mbreti i huaj, i cili kryesisht mbahej nga fuqitë e mëdha imperialiste, por edhe nga bazonetat e kryeçifligarit Esad Pashë Toptanit, që kishte zënë dy postet më të rëndësishme të qeverisë: Ministrinë e Brendshme dhe atë të Luftës. Ky çifligar i madh, tani që ishte kthyer nga Turqia, ua kishte shtrënguar edhe më shumë lakun në fyt fshatarëve e bujqve të tij në Tiranë, Durrës e Krujë. Lami ia kishte përsëritur të nipit disa herë mendimin e tij të prerë për Esadin: «Pasha është gjarpër i madh! Ai do ta hajë edhe Vidin! Do ta shohësh!» Këtë mendim Malit ia kishte përforcuar edhe telegrafisti tiranas, i cili kishte treguar edhe disa fakte e

sekrete të telegrameve që kryetoptanasi kishte këmbyer me disa miq të tij nëpër kazatë e vendit. Tani për të gjithë buqit dhe fshatarët e mesëm dukej sheshit se qeveria e Vudit, e formuar nga bejlerët, kërcënonte interesat e tyre.

Fshatarët thoshin me plot gojën «Tashti erdhi fundi. Tokat tonë i mori lumi. Bejlerët do të mundohen të zgjerojnë dita-ditës çifligjet e tyre».

Mal Xhoka, sipas porosisë, ia tregoi shijakasit mikut të kryengritësve fshatarë, qëllimin e ardhjes së tij në Durrës. Ky, kur dëgjoi aktin që do të kryente Mal Xhoka, mbeti si i gozhduar dhe iu tha pështyma në grykë.

— Përse u trondite, o mik! — i tha Mali, që e kuptoi hutimin e qeleshepunuesit të Durrësit. Derri vritet me plumb!

Ishte e dyta herë që Mal Xhoka vinte në Durrës, por megjithatë kishte nevojë që të shoqërohej nga miku i tij për të njojur edhe më mirë disa skuta të këtij qyteti.

— Në fund të asaj rruge, pothuajse afér skelës, në të majtë, është pallati i Esad Pashë Toptanit! — i tha Malit me zë të ulët shijakasi, ndërsa po e shoqëronte nëpër qytet. Dyqanet e bakejve dhe të manifikurës ishin mbyllur me qepenë që ishin kyçur me drynj të mëdhenj. Tregëtia e Durrësit ishte e perënduar dhe tregëtarët, shumica e të cilëve kishin rënë në krizë, ankokeshin duke mallëkuar Esad Toptanin si pengesë kryesore për zhvillimin e tregëtisë. Grumbuj fshatarësh, që përbën shumicën dërmuese të popullsisë, hynin e dilnin nëpër dyqane pa blerë asgjë.

— Po mbreti ku rri? — e pyeti Mali shijakasin, pasi kishin marrë kthesën.

— Rri në atë pallatin përbri Pashës. — Pastaj ai shtoi: — Kisha katolike është në fund të kësaj rrugice, ja atje, në rrëzë të kalasë!

Qyteti kishte filluar të zgjohet dhe ndonjë gjellëtore aty-këtu po tërhiqte ndonjë sevdalli të paçes, të pilafit e të simiteve me salep.

Mjegulla e lehtë, që ngrihej ngadalë, po zbulonte tashmë kaltërsinë e pafundme të detit.

Të dy shokët u kthyen prapë në shtëpi dhe aty ndej-tën edhe një copë herë duke biseduar disa hollësi për detyrën që i ishte ngarkuar Malit. Nga bisedat që bëri me djaloshin fshatar shijakasi e kuptoi se kishte të bënte me një njeri që kishte një farë përvoje në punët e trimë-risë, bile kishte njoħuri edhe për çeshtjet e politikës. Edhe ai vetë nuk kishte qenë i paktë në kohën e rinisë. Vrasja e tagrambledhësit, në kohë të hyrjetit, kishte bërë bujë atëherë në të gjitha fshatrat e krahinës dhe trimit populli i kishte nxjerrë një këngë.

Më vonë në bisedë e sipër, shijakasi nxori si me cen-gela një të fshehtë që i takonte veprimtarisë së Mal Xhokës: vrasjen e krahinarit që kishte fyer fshatarët. Kë-të vrasje Mali e pati kryer pa i mbushur ende të tetë-mbëdhjetat.

Ora e meshës po afrohej. Dielli po ngjitej në zenit. Xhandarët dhe disa civilë të policisë sekrete mbretërore filluan të patrullonin nëpër rrugët e ngushta të qytetit. Mali nuk pranoi të shoqërohej më nga shijakasi, i cili në fillim nguli këmbë që ta kryenin së bashku detyrën e jashtëzakonshme. Shijakasi ishte njeri familjar, ishte në moshë të thyer dhe Mali mendonte se ai më shumë mund të prishte se sa të ndreqte punë, prandaj atij i kërkoi veç mundësinë e strehimit në rast rreziku.

Mal Xhoka zuri vend në një qoshe të rrugës, mbësh-tetur pas qepenave të dyqanit të një armëpunuesi, nga pritej të kalonte kortezhi mbretëror dhe qeveritar për të marrë pjesë në meshën e së dielës. Kur hodhi sytë nga rrugica, fshatari pa se ajo ishte e shtruar me sixhade deri te dera e kishës. Kjo gjë i bëri shumë përshtypje. Mali shtangu në vend kur pa që po afroheshin gjithë ata njerëz të veshur me uniforma ushtarake e me grada të larta, gra me flokë të shkurtëra të veshura me fustane të gjata.

Banda udhëhiqte mbretin dhe suitën mbretërore, pas tyre vinte kavaleria. Populli, i grumbulluar në të dyja

anët e rrugës, i veshur keq, rrinte si i ngurosur dhe shihte atë luks, fare të huaj për të.

— Ja tek po vijnë! — tha një hamall i portit, i veshur me një bluzë vija-vija të zbërdhylur nga dielli.

— Cili është mbreti? — pyeti si i hutuar Mali.

— Ai më i gjati me kapele me pupël; në krah të djathtë të tij është mbretëresha, kurse tjetri, që po flet me zonjën, është Pasha — tha hamalli duke i hedhur një vështrim të çuditur fshatarit, që dukej i shqetësuar nga ardhja e trupës mbretërore.

Dyqanet e vogla me qepena të mbyllura ishin zbuluar me flamurë kombëtarë kuq e zi dhe me harqe dafinash.

— Të bëhet zemra mal! — tha një burrë i pashëm, veshur me rroba të zeza e me republikë në kokë, që kundërmonte erë parfumi.

— Zoti avokat, ky është mbreti i shqiptarëve! — i tha atij miku që kishte në krah.

— Rroftë mbreti! Rroftë mbreti! — thirri avokati me një entuziazëm të patreguar.

Avokat Maksuti ishte anëtar i një organizate nacionaliste intelektualësh. Maksuti nuk i donte bejlerët dhe në fjalimet e tij të zjarria i thumbonte duke i quajtur donkishotë. Po avokati gjithashu ishte në kundërshtim edhe me pikëpamjet ekstremiste që shfaqte në klub arësimtari rebel i Shënavlashit për të nxjerrë jashtë klubit bejlerët e për ta ngritur Shqipërinë pa bejlerë.

Avokati dhe shumica e klubit të tij ishin të mendjes se bejlerët, duke qenë në radhët e nationalistëve do t'i ndihmonin çështjes kombëtare, në saje të ndikimit që ushtronin tek bujxit dhe tek fshatarët e krahinave ku sundonin. Mbi të gjitha ata kishin miqësi me personalitetë politike, diplomatike e qeveritare të shteteve ballkanike e evropiane, të cilat, sipas tyre, do të mbështetnin krijimin e shtetit të ri shqiptar.

— Po ti pse nuk brohorit për mbretin! — i tha avokati Malit, kur ndeshi në vështrimin e tij të ngrirë.

— Më është ngjirur zëri, zotëri! — iu përgjegj aty

për aty Mal Xhoka, që po vriste mendjen për të vendosur se kur duhej qëlluar kundër Esad Pashës.

«Të erdhi ora, o Mal Xhoka! — tha me vete ai dhe me guxim futi dorën në brez për të nxjerrë armën. — Po qëlloj më parë atë edepsëzin, Pashën dhe po munda po ia shkreh edhe mbretit».

Suita mbretërore, e përbërë nga oficerë të lartë, të huaj, nga bejlerë e aristokratë të vendit, nga bajraktarë, nga ministra të qeverisë dhe nga garda, tani ishin fare pranë fshatarit. Në atë çast një patrullë e armatosur e xhandarmërisë shtyu radhët e popullit dhe me kondakët e pushkëve mbërtheu pas muri një turmë njerëzish, midis të cilëve edhe avokatin, Mal Xhokën, hamallin dhe një bakall kruetan, që kishte ardhur atë ditë në Durrës për tregëti.

Në çastin më të volitshëm për të kryer atentatin, kur mbreti dhe Pasha kaluan fare afër tij, Mal Xhoka u ndodh i mbërthyer pas murit nga xhandarët holandezë, roja personale e mbretit dhe nuk pati mundësi as të nxirrte dorën nga xhepi. Fshatarit iu duk sikur e kishin zbuluar. Xhandarët, kur panë se suita mbretërore tanimë kishte hyrë në kishë, bënë përpara. Këmbanat e kishës binin papushim. Avokati mallëkoi xhandarët, që u suallën egërsisht me popullin, që nuk thirri dot «rroftë mbreti». Hamalli pështyu për tokë dhe i këputi një të sharë vendçë mbretit. Mal Xhoka rrinte mbështetur pas murit me gurë, i dëshpëruar që nuk kish mundur të kryente misionin e jashtëzakonshëm, që i kishin ngarkuar në Shijak. Fshatar, megjithatë, nuk e humbi shpresën dhe mendoi ta vinte në zbatim planin, pasi mbreti e pasha të dilnin nga kisha.

Avokati, që vuri re hutimin e fshatarit, kur po matej të ikte tha: — Të premtën që kaloi mbreti ishte në xhami, por atë ditë nuk pati rrëmujë si sot!

Fshatarit s'i hiqej nga mendja pamja e atyre sundimtarëve, bejlerë e aristokratë, armiqve të betuar të tij.

Dy gra, me kapele me rreth të gjërë e me fustane të gjata deri në fund të këmbëve, i venin nga pas mbretëreshës, që ishte veshur me shumë madhështi. Ajo kish-

te një shtat mesatar, po kur ecte përkrah Vilhelmit dukej e shkurtër. Princ Vidi ishte i gjatë dhe i pashëm. Ai i kishte kaluar të dyzetat, por me gjithatë ishte i mbajtur mirë dhe për këtë dëshmonin trupi i tij i lidhur dhe ecja elegante me trupin drejt si q'ri. Në mes kishte ngjeshur një rryp të gjerë lëkure të qëndisur me fije ari. Një fjongo mëndafshi kuq e zi i varej mbi supin e majtë. Kjo fjongo kalonte tërthor pas gjoksit të mbushur më dekorata e me kryqe, të cilat ia kishte falur mbreti i gjermanëve për merita të shquara ushtarake. Njërin nga ato kryqe ia kishte vënë me dorën e vet në gjoks Viktor Emanueli, kur kishte vajtur për vizitë në pallatin e tij në Romë. Në kokë, mbreti Vid kishte vënë një kapele me pupul shpendi të rrallë dhe me një emblemë mbretërore. Fytyra e tij e çelur dhe e qeshur tregonte se ai ishte i kënaqur për pozitën e lartë që kishte arritur duke u shpalllur mbret i një shteti, duke siguruar kështu një pushtet absolut, pasuri, lumturi dhe jetë luksoze. «Për t'u arritur këtyre qëllimeve duhet guxim, durim, zgjuarësi dhe kohë». Këto mendime Vilhelmi ia kishte përsëritur disa herë gruas së tij, e cila nuk kishte qenë e kënaqur me ardhjen e tyre në Shqipëri dhe ishte pesimiste për realizimin e planeve që bënte i shoqi.


Pasha, që ecte në krah të saj, i thoshte herë pas here ndonjë fjalë dhe zonja e lartë buzëqeshte mbi erashkën e bukur me pendë palloï.

Esad Pasha ecte kryelartë dhe serbes, duke u shtënë frikën gjithë bejlerëve e feudalëve të tjerë që i shkonin pas. Uniforma ushtarake prej gjenerali turk i rrinte pas trupit. Në kokë kish vënë feste të zezë prej kadifeje, ku ishte qendisur me fije ari shqiponja dykrenare.

Kavaleria e gardës mbretërore, që e shoqëronte mbretin, e komanduar nga oficerë të huaj të ardhur nga Hollandë, qëndronte në krye të rrugicës.

Suita mbretërore dhe ministrat që e shoqëronin, tanimë kishin hyrë në kishë dhe priftërinjtë kishin filluar meshën. Mbretëresha ishte ulur në një fron prej druri arre.

Vidi rrinte si fyell me vështrimin të mbërthyer në



ikonat dhe te Krishti i gozhduar. Atij as që mund t'i shkonin ndër mend qëllimet poshtëruese që kishte filluar të kurdiste Esadi ndaj së shoqes. Një mushkonjë malarike, nga ato mijëra që fshiheshin nëpër moçalet që rrethonin Durrësin e atyre kohëve, kryeqytetin e mbretërisë së Vilhelm Vudit, fluturoi nga Pasha dhe iu vërvit qafës së gjatë të Vudit dhe, pasi lëshoi helmin e malarjes, fluturoi mbi kokën e mbretëreshës. Mbreti i ra me shputë qafës, për të shtypur mushkonjën që tashmë kishte flutuar dhe pa i vënë rëndësi ngjarjes i foli diçka gjermanisht Esadit rrith malarjes.

Mbretëresha Sofia, kur pa t'i afrohej mushkonja, u tmerrua. Asaj iu kujtua sakaq një ngjarje që kishte lejuar në një roman. Iu kujtuan aventurat e disa njerëzve në moçalet shqiptare. Të huajt, që kishin shkuar të pushtonin Shqipërinë, pasi disa prej tyre ishin infektuar nga mikrobi i malarjes, kishin thirrur një plakë fshatare, për të cilën ishin informuar se e dinte ilaqin që shëronte ethet shqiptare. Ky ilaq ishte një lëng i trashë si musht. Ushtarakët, që nuk i besuan plakës, e detyruan më parë atë vetë ta pinte ilaqin në prani të tyre. Vetëm pas kësaj prove ata do t'uaj jepnin atë të sëmurëve që rënkonin e dridheshin nga ethet e forta, Ushtarakët e huaj të armatosur e ruajtën plakën në një çadër. Të nesërmen, kur panë se shqiptarja nuk pësoi asgjë, ata vendosën t'uaj jepnij të sëmurëve ilaqin. Si masë profilaktike, madje, ata ua dhanë edhe të shëndoshëve ta 'pinin. Plakën e shpërblyen sipas premitimit, me sheqer, kafe dhe miell të bardhë. Disa orë pasi plaka që larguar nga kampi i tyre, ata që nuk ishin të sëmurë u prekën nga ethet shqiptare, ndërsa të sëmurët u rënduan edhe më shumë nga malarja dhe të nesërmen tërë kompania e aventurierëve të ardhur për të pushtuar tokën e shqiptarëve, vdiqën.

Mbretëresha Sofia, kur kishte mësuar nga i shoqi se do të shkonin në Shqipëri, ishte tmerruar.

Mal Xhokës, që po priste jashtë, as që mund t'i shkonte fare nëpër mend se ç'po bëhej në kishë. Atij i rrihte mendja te atentati, te mënyra si do ta përmbushte misjonin që i kishin ngarkuar. Pikërisht në këto çaste fsha-

tarit kryengritës i ndodhi një e papritur. Selim Aga, qahajai i Pashës, veshur me uniformë ushtarake, kishte qëndruar në qoshen e rrugicës dhe po vështronte Malin, armikun e tij, që e kishte zhdëpur në dru dhe i kish djegur kullën. Selimi e njoju fshatarin dhe, pa humbur kohë, u largua nga rrugica. Mal Xhoka, që e nuhati se çfarë do të bënte armiku i tij, menjëherë vendosi të ikte në drejtim të kishës. Selim Aga ndërkokë kishte dhënë alarmin. Në krye të një patrulle xhandarësh, që e cni pothuajse me vrap, qahajai i Pashës doli në krye të rrugës. «Ah! Ta marrë djalli! — tha me vete Mali. — Dësh-tova! Por, dijeni se prapë do të kthehem!» Kryengritësi, pasi kaloi kishën, iku me vrap në drejtim të skelës dhe, duke rënë buzë detit, u largua në drejtim të Kavajës. Duke ecur mendonte: «Selim Aga duhet vrarë pa më-shirë! Ujku qimen e ndërron, por zakonin s'e harron! Duhet qëruar nga faqja e dheut ajo farë e keqe!»

Atentati kishte dështuar. Mali, para se të arrinte te shkëmbi i Kavajës, mori majtas, drejt Shijakut.

## SHIJAKU, KRYEQENDËR E KRYENGRIJES

Asko në Shqipëri kishin ngritur dy kryeqytete: Durrësi për mbretërinë e Fon Vilhelm Vudit e të kryeçifligarit toptanas Esad Pashës dhe Shijaku për kryengritësit fshatarë.

Mali arriti në Shijak me një frymë. Atij i vinte rëndë që nuk e kishte kryer misionin e ngarkuar. Mali kalonte nëpër rrugët e qytetit dhe u hidhte vështrime të habitura turmave fshatare, të shpérndara anembanë, për të gjetur shokët e tij të Pishtarit. Kryengritësit rrinin në grumbull. Aty ishin mbledhur fshatarë nga të gjitha fshatrat e rrethit të Tiranës, të Shijakut dhe të Kavajës. Kryengritësit, kur kalonin nëpër fshatra, mblidhnin të tjerë dhe ushtria e tyre shtohej e shumohej si ortek dëbore. Kudo nëpër fshatra ishte pjekur kryengritja, mjaftonte të hidhje një shkëndijë që flaka të shpërtente menjëherë, sikur të mbinte nga toka. Shkaqet që i kishin nxitur fshatarët të linin shtëpitë dhe të hidheshin me armë në dorë ishin të shumfa. Çdo fshatar thoshte shkaqet e veta, dhe këto ndryshonin nga njëri-tjetri. Bujqit e Esad Pashës thonin se luftonin për tokën. Disa nga fshatarët e Dajtit bërtisin se nuk paguanin më faiz. Një pjesë tjeter, sidomos fshatarë të moshuar, ankoreshin se qeveria e Vudit dhe e Esad Pashë tradhëtarit po prishnin fenë muslimane, prandaj kërkonin që në krye të shtetit të vihej një princ nga dera e Stambollit. Një pjesë e fshatarëve ndiqnin tarafin e Mustafa Ndraqit, ca të tjerë

i binin pas myftiut të Tiranës, Musa Qazimit. Këta fshatarë nuk dinin se prapa Musa Qazimit fshiheshin agjentët xhonturq, kurse prapa Mustafait, Osman Balit, Sheh Rujbékës e ca krerëve të tjerë, kishte gisht Esad Pashë Tophani, i cili kërkonte të zinte vendin e Vilhelmit. Midis turmave fshatare kishte edhe grupe si ata të Pishtarit, që mendonin të hiqnin qafe zgjedhën e bejlerëve të përfraqësuar nga pushteti i Vudit dhe i Esadit, që ata e quanin qeveria e pashallarëve.

— Ej, ku po shkel ashtu, more djalosh! — i tha Malit një plak i shtrirë sa gjatë gjerë përpara pijetores.

— Po kérkoj shokët — iu përgjegj me drojtje Mali.

— Këtu jemi të gjithë shokë! — tha fshatari i panjohur dhe e shtyu me këmbë Malin.

— Ah, kaur i pafé, po pi raki! — i bërtiti një fshatar i parruar me një qe'leshe të bardhë në kokë, i cili nga pamja dukej i vjetër, por në të vërtetë sapo i kishte mbushur të tridhjetë e pesat.

— Muhamed i ka bërë haram për të paudhët si ti, ore mjekërcejap! — iu përgjegj bashkëfshatari pa e prishur qejfin.

Fshatarët kishin mbushur sheshin para godinës së khandarmërisë, e cila tani shërbente si selia e udhëheqësve të kryengritjes. Dy pijetoret e qytetit ishin mbushur plot e përplot me njerëz të armatosur, që pinin raki e hanin meze, duke biseduar me njëri-tjetrin me zë të lartë dhe fare pa rregull. Kockat i hidhnin nga dera në rrugën e shtruar me kalldrëm. Ata fshatarë të shkujdesur, të parruar, me barkun të fryrë nga malarja shekullore, të paveshur dhe me gjysmë opinge në këmbë, të paditur e analfabetë, ato ditë e kishin harruar gjendjen e tyre të mjerueshme dhe ishin shndërruar në njerëz të gëzuar dhe ngadhnyses. Njerzit bënin shakara, qeshnin, tregonin lloj-lloj historish kërcenin, këndonin, i binin me grushte tryezave, shtinin me pushkë e kobure lart nga çatia pa tavan dhe gajaseshin së qeshuri. Kjo turmë e revoltuar gjente kënaqësi kur disa prej tyre fillonin të shanin e të talleshin mbarë e prapë me bejlerët dhe zonjat e tyre. Sipas urdhërave e ligjeve të vjetra turke,

shumë nga vëllezërit, prindërit dhe të afërmit e tyre kishin lënë kockat në vende të huaja e të largëta si në Edrene, Jemen Tarabolluz e nëpër luftërat për pushtimet mizore të sulltanëve të Stambollit. Shumë prej tyre ishin bujqër dhe brez pas brezi kishin punuar tokat e bejlerëve për një kothere bukë, por edhe fshatarët e tjerë, që zotëronin disa parcela toke, ishin të detyruar të paguanin lloj-lloj taksash me aspra e prodhime në natyrë, që shkonin në dobi të bejlerëve. Tani kjo masë fshataresh e kishte prishur prapë qetësinë dhe ata kishin shpërthyer në revoltë. Të shtypurit, kur ngrenë krye, marrin hov dhe nuk kanë më frikë nga zotërit e tyre. «Kemi fituar lirinë, — thoshin ata, — dhe tani bëjmë ç'të duam».

— Ju jeni turq, mor derra! — u bërtiti pijanecëve një fshatar nga Ndroqi, që i kishte kaluar të gjashtëdhjetat. — Sheriati nuk pranon qafirllëqe.

— Ikë, ore plak, në punën tënde dhe mos u përzje me rakinë tonë — i tha një pezak me moshë të re.

Në dyqanin ushqimor dhe në një kafe të vjetër ndërtuar me qerpiç, që ishte aty ngjitur, disa fshatarë, që e mbanin veten për muslimanë të vërtetë, pinin kafe dhe bënин muhabet të shtruar.

Malit, që kërkonte bashkëfshatarët e tij, kur hyri në kafenënë me taftaben, i kapi veshi një bisedë të shkurter, nisur nga një plak i armatosur, që kishte ardhur nga Vora:

— Esad Pasha është tradhëtar i fesë islame. Ai qafir e ka sjellë mbretin e krishterë dhe duan ta bëjnë vendin kaur! Bejlerët nuk po lënë gjë pa punuar në kurriz të fshatarëve dhe e kanë shqelmuar sheriatin. Por ne do të vendosim drejtësinë fshatare, sipas sheriatit dhe në krye të qeverisë do të sjellim një princ turk.

Mali kishte dëgjuar edhe nga fshatarë të tjerë që të flisin për fenë, për sheriatin. Një hoxhë në fshatin e tij kishte thënë se nuk duhej të shkëputeshin nga Turqia. Ja, edhe këtu në Shijak, ai po dëgjonte përsëri kësi fjalësh. Fshatari patriot, që kishte rrëmbyer armën dhe ishte hedhur në kryengritjen e armatosur kundër Esad Pashë Toptanit e bejlerëve të tjerë, i rrëmbyer nga idea-

let e pavarësisë të Shqipërisë, mendonte se fshatarët duhej të luftonin edhe kundër zgjedhës së bejlerëve për të vendosur të drejtën e fshatarësisë. Në kryeqendrën e kryengritjes Mali po dëgjonte mendime dhe qëllime të errëta, të mbjella në turmat fshatare nga turkomanët midis tyre dhe nga disa hoxhallarë fanatikë e dredharakë. Atë e pushtoi një shqetësim i parrëfyesëm. Ai shqetësohej se kryengritja fshatare po shkonte drejt një qorrssokaku. Këto biseda ai i kishte rrahur disa herë me të ungjin, Ram Lekën, dhe me telegrafistin tiranas, nga i cili kishte mësuar për herë të parë edhe shkrim e këndim në gjuhën shqipe.

— Dëgjoni, vëllezër! — e mori fjalën Mali kur dëgjoi fshatarët duke biseduar për sheriatin dhe për nevojën e ardhjes në fuqi të një princi turk. — Turqit le të qeverisin në Turqi, serbët në Serbi, grekët në Greqi, po në Shqipëri kanë vend vetëm shqiptarët. Dhe, sa për fenë, secili ka besimin e tij. Ne, fshatarët, kemi rrokur armët kundër qeverisë së Vudit e të pashallarëve për të rregulluar punët tonë dhe s'kemi punë me Stambollin, as me Beogradin, as me Athinën.

— Për besë ky qenka qafir! — briti plaku nga Vora.

Mali iu hakërrua fanatikut dhe, pasi bëri një gjest me dorë, që shprehte mospërfillje dhe zemërim, doli nga kafeneja në rrugë.

Si kaloi rrugën e shtruar me kalldrëm mori drejt lumit dhe shkoi te një dyqan gjysmë i rrënuar, ku ishin grumbulluar një turmë kalorësish, që po prisnin radhën për të mbathur kuajt te nallbani.

— Hej, ju pishtarakë, ku dreqin qenkeni futur! — briti djaloshi i gëzuar duke parë dy nga bashkëfshatarët e tij që po merreshin me kuajt.

— Këtu s'e merr vesh i pari të dytin, o vëlla, jemi bërë lesh e li! — i tha Lami.

— Po Ram Leka ku është? — pyeti Mali.

— E kanë thirrur në Këshillin e përgjithshëm të kryengritjes.

— Më duhet ta takoj! — tha Mali.

— Ja, atje e ke — ja bëri me dorë Lami.

Mali kaloi nga kovaçhana. Edhe atje ishin mbledhur shumë njerëz.

Rreth Shijakut ishin mbledhur mbi dymijë fshatarë të armatosur, që kishin ardhur nga fshatrat e Tiranës, të Shijakut, të Kavajës, të Vorës dhe të krahinave të tjera. Mali mezi po çante njerëzit, për të dalë tek godina e isl. xhandarmërisë, që ishte bërë selia e Këshillit të përgjithshëm të kryengritjes. Kur pishtari arriti para shkallëve të zyrave të hyqymetit, një nga rojet fshatare të armatosura e zuri prej krahu dhe e gozhdoi në vend.

— Ej, djalosh, ku po shkon?

— Lëshomë, të them! — i thirri Mali — hiqi duart, se të flaka tej si cingël!

— Kush je ti që më hakërrrohesh! — ia pat roja, një qelesheqyp nga Kavaja.

— Jam komandari i Pishtarit! — i tha Mali dhe bëri përparrë për t'iu ngjitur shkallëve të gurta.

— Lëre, lëre të vijë sipër! — i foli rojes një zë i njojur. Mali ngriti sytë dhe, kur pa se ai që foli ishte Ram Leka, buzëqeshi.

— Ram Leka qenke?

Prapa Ramës, në krye të shkallëve, doli një burrë i pashëm, i veshur me qillota ushtarake e i mbathur me një palë çizme prej lëkure boksi që shkëlqenin. Ky po i përdridhë mustaqet e zeza sterrë, që i vinin dredha-dredha.

— E, si shkoi puna? — e pyeti Ram Leka.

— Më zbuluan! — tha i dëshpëruar Mali, por unë do të kthehem prapë atje!

— Mos u mërzit, djalosh, pas humbjes vjen fitorja!

— i tha ushtaraku mustaqeli, që ishte zgjedhur nga këshilli Komendant i përgjithshëm i kryengritjes kundër qeverisë së Vudit.

Mali kokulur u tregoi fije e për pe se ç'i kishte ndodhur në Durrës. Ram Leka, që i kishte vënë dorën në sup, e shoqëroi të nipin në një dhomë, ku po bëhej një bisedë e zjarrtë midis burrave që kishin dalë në krye të Këshillit të përgjithshëm.

— Krahas betejës për pushtimin e Durrësit, unë propozoj të nisim një delegacion për në Stamboll, që të kërkojmë princin — tha një hoxhë i paktë nga trupi, që dridhej i tëri kur fliste.

— Jo, Musa efendi! — iu përgjegj prerë Haxhi Fejza. — Vendimi ynë tashti për tashti është dëbimi i mbretit gjerman dhe shpartallimi i Esad Pashë Toptanit. Ushtria të marshojë për në Durrës!

— Po çështja e flamurit si do të bëhet? — pyeti myftiu i Tiranës me një qëndrim plot qesëndi.

— Flamuri ynë është lufta kundër bejlerëve! — tha një anëtar i Këshillit.

— Folë, o mik! — iu drejtua myftiu një fshatari tjetër të imtë, me një mjekër të zezë sterrë, që po rrinte i heshtur me sytë përdhe, ulur në një qoshe të dhomës.

— Po — u përgjegj mjekëroshi i menduar dhe, pasi heshti një copë herë në një mënyrë të çuditshme, sikur ishte zënë në faj shtoi: — Ta djegim e ta bëjmë shkrumb e hi, të mos i lëmë as nam e nishan Esad Pashë Toptanit, atij gjakpirësi të popullit. Unë e njoh mirë atë, ai është farë e keqe. Im atë, që ka qenë pas tyre m'i ka treguar të gjitha poshtërsitë e krimet që kanë bërë toptanasit! Veli Beu është qen bir qenit, po Esadi, i vjehrri, është më edepsëz. Po. T'i vrasim bejlerët. T'ua djegim kullat e sarajet. Do të zbatojmë me drejtësi sheriatin — theksoi në fund fshatari me mjekér dhe ndërkaq i hodhi një vështrim të dyshimtë myftiut.

Haxhi Fejzua rrinte i menduar. Ram Leka shikonte të nipin në sy dhe rrudhët buzet e çara e të zverdhura nga duhani për të mbajtur djaloshin që ishte gati për të shpërthyer.

Ungji e njihetë të nipin, e dinte se ai merrte zjarr dhe druhej se mos shpërhente duke e hapur çështjen e flamurit, të shkronjave shqipe dhe të pavarësisë së Shqipërisë, e atëhere puna do të merrte udhë të keqe, sepse ai e dinte mirë që myftiu i Tiranës ishte një fanatic i tërbuar kundër Shqipërisë së pavarur dhe kundër patriotëve. Rama përkrahte mendimin e luftës kundër Vedit dhe kundër Esad Pashës, pastaj koha vetë do t'i rregu-

Ilonte mosmarrëveshjet. Secili nga këta krerë, myftiu i Tiranës, ose Mustafa Agë Ndraqi, Osman Bali, Sheh Rumbjeka, Man Picari e të tjerët kishin tarafet e tyre. Të shpreheshe, në ato rrethana, për flamurin kombëtar, për shkronjat shqipe dhe për pavarësinë, njerëzit e Musa efendiut të shtronin në dru dhe të hidhnin hekurat. Mali e kuptoi xhaxhanë dhe me grushta të shtërguara rrinte gojë kyçur. Ai tha me vete: «Kur e lyp nevoja heshtja është flori!». Pasi bëri një temena, djaloshi doli nga dhoma e Këshillit të përgjithshëm dhe zbriti shkallët përtu kthyer te shokët.

Ram Leka, Mal Xhoka, Asllani dhe shumë miq e shokë të tjerë nga radhët e fshatarëve kryengritës, nuk ishin dakord me vendimet e Shijakut për uljen e flamurit të Shqipërisë dhe ngritjen e flamurit me gjysmë hënë, përpërdorimin e gjuhës turke si gjuhë zyrtare dhe përkërkimin nga Stambolli të një princi turk. Po turmat fshatare as që bëheshin merak përvendimet që merrte Këshilli, ata në thelb i preokuponte lufta kundër qeverisë së pashallarëve për ndryshimin e gjëndjes së tyre të mjerueshme.

Ram Leka tani u bind se telegrafisti tiranas kishte pasur të drejtë lidhur me ngjarjet e fundit që kishin ndodhur në krahinat e Shqipërisë së mesme. Këshilli i përgjithshëm i kryengritjes, që u formua nga mbledhja e Shijakut, ishte i përcarë. Musa Qazimi, myftiu i Tiranës, duke gjetur terrenin e përshtatshëm e duke u mbështetur te Mustafa Agë Ndraqi e miqtë e tjerë, sidomos te klerikët e fanatikët muslimanë, i imponoi kryengritjes fshatare programin e tyre, që përshkohej fund e krye nga politika turkomane, e cila përkonte edhe me atë të xhon-turqve. Ismail efendi Kasabaja, mik i vjetër qysh nga shkolla e lartë e medresesë së Stambollit, i solli myftiut të Tiranës parullat dhe programin politik të përpunuar nga krerët turkomanë të Stambollit. Kryeagjenti i turkomaneve, Musa Qazimi, me dinakëri e duke përfituar nga gjëndja e prapambetur e fanatizmi i mbjellë shekuj me radhë nga panislamizmi, sidomos në fshatin shqiptar të Shqipërisë së Mesme, ishte futur, si turjela në dru, në

mes të kryengritjes, duke hedhur helm në turmat fshatare, me qëllim që kryengritja e tyre për çlirimin agraro-social të kthehej në dobi të qëllimeve politike të xhonturqve. Në Shijak ata vendosën që gjuha turqishtë të ishte gjuhë zyrtare. Dhe kur të shkruhej shqip të përdoreshin shkronjat turke. Kryemyftiu për Shqipërinë të zgjidhej nga Sheh-ul-islami i Stambollit. Parulla për zë-vendësimin e mbretit Vid me një princ prej Portës së Lartë kishte për qëllim ta nxirrte Shqipërinë nga asnjënesia dhe ta drejtonte për në bllokun ku anonte dhe Turqia. Bota ishte ndarë në zona të ndryshme influence, që u përgjigjeshin interesave kapitaliste e feudale. Po pregatitej një luftë e re botërore, ajo e vitit 1914!

Pas mbledhjes së Shijakut, më 3 qershori 1914, Ram Leka, Mal Xhoka e disa shokë të tjerë e kuptuan se kryengritja kishte hyrë në një qorrssokak. Ata po e shikonin se kjo po u shërbente të huajve. Aty kishte gisht Esad Pasha, që kishte për qëllim të zinte vendin e Vilhelm Vudit, dhe xhonturqit, që bënин përpjekjet e fundit për të ngjallur imperatorinë e tyre të vjetër të sulltanëve, duke i ndryshuar asaj ngjyrën.

Rama i tha Malit se çeta e pishtarit duhej larguar nga Shijaku. Këta e dinin se midis tyre kishte dhe fshatarë fanatikë, të cilët shkonin qorazi pas myftiut të Tiranës që të luftonin për vendosjen e shariatit, i cili po prishej me ardhjen e Vudit. Te këta njerëz fanatizmi fetar kishte rrënjosur mendimin se muslimanizmi dhe turqinizmi konsiderohej si një gjë e njejtë nga feja islame.

— Dëgjo, o Mal Xhoka! — i tha me ton të vendosur Leka të nipit. Ne duhet të largohemi nga Shijaku. Kjo çorbë nuk është për ne.

— T'u flasim haptazi bashkëfshatarëve se kërret e kryengritjes janë të poshtër. Disa prej tyre fshehin qëllimet e errëta si esadistë dhe ca të tjerë kërkojnë ta lidhin vendin me qerren e prishur të Stambollit, duke u përpjekur ta varrosin Shqipërinë. Kështu t'u themi kryengritësve të vërtetën pa ndrojtje — briti Mali dhe u quamë këmbë për të shkuar te çeta e pishtarakëve që të komunikonte vendimin.

Çeta kryengritëse e Pishtarit u largua nga Shijaku. Me përjashtim të Cakut të Dervish Lukës dhe Bimit të Cen Kasapit të tjerët ishin të vendosur për të ndjekur Ram Lekën e Mal Xhokën. Pishtarakët, ashtu siç bënë edhe shumë fshatarë të tjerë që kundërshtonin turkomanët, u ndanë më vete duke u endur fshatrave me armë në dörë.

\* \* \*

Një ditë ungj e nip ishin ulur pranë mullirit e ia kishin shtruar një bisede të koklavitur. Shokët e tyre të Pishtarit po hanin drekë disa metra më tutje, në një fushë me driza.

— Dëgjo, o Mal, o biri im! — i tha ungji të nipi. Ti e di se unë kam qenë ushtar disa vjet në Stamboll. Atje zura miqësi me Ismail Qemalin dhe Hasan Prishtinën. Në Stamboll njoha edhe Selim Agën, i cili shërbente asqer prapa Esad Pashës... Selim Aga gjithashtu hynte e dilte në disa nga dyert e agallarëve turq të Stambollit. Ky dallaveraxhi bënte spionllëqe dhe ne e kishim kuptuar punën e tij të poshtër, por ajo që ndodhi në parlamentin turk e mbushi kupën dhe nxori qartë në dritë fytyrën e këtij sahanlëpirësi të bejlerëve. Në kompaninë e gardës kishte trupa nga Tripoli, Edreneja, Misiri. Midis tyre kishte edhe arnautë siç na thërrisin turqit ne shqiptarëve. Atë vit kishin ngritur krye tridhjetëmijë kosovarë dhe i kishin vënë pushkën ushtrisë së sultanit për të drejtat e Shqipërisë. Kosova buçiste asokohe nga kryengritjet dhe më 1912 kudo, në të katër vilajetet, shqiptarët brohorisnin «Rroftë Shqipëria! Rroftë flamuri! Rroftë liria!» Viti 1912 e tundi krejt Shqipërinë. Atë kohë u zgjuan shumë forca të fjetura të popullit.

— Po Hasan Prishtina, Bajram Curri dhe Isa Buletini ku ishin në atë kohë? — pyeti Mali.

— Ata ishin udhëheqësit e organizatorët e kësaj kryengritjeje, ndërsa Ismail Qemali punonte fshehurazi me qeveritë e Evropës për të njojur pavarësinë e Shqipërisë.

— U larguam nga biseda. Si ishte puna e Selim Agës?  
— pyeti Mali.

— Haki Pasha, kryetari i qeverisë turke, e sulmoi ashpër deputetin Ismail Qemali. Aty u ndodha edhe unë si roje dhe dy shkallë më lart ishte edhe askeri ynë, Selimi. Një turk i tërbuar iu turr Ismail Qemalit dhe në mes të të gjithëve e qëlloi me shuplakë. Deputetët shqiptarë e kapën pér zverku turkun dhe e pérplasën përdhë. U bë një poterë dhe rrëmujë, sa nuk e merrte vesh i pari të dytin. Më del gjithnjë parasysh Hasan Prishtina, ashtu siç e 'pashë atë ditë, t'u dilte pérpara deputetëve turq, duke u treguar gjoksin. «Po ta them troç, këtu në shesh të burrave, o deputet i Serezit, se ti je një hiç, nuk vlen asnë grosh. Në je burrë, eja të dalim në dyluftim!» Këto fjalë, që tingëlluan si kushtrim lufte, ranë si rrufe mbi atë turmë turqish, që u shtangën nga guximi i kosovarit. Deputeti i Serezit uli kokën dhe me bisht në shalë ua mbathi këmbëve nga parlamenti, duke përfituar nga rrërijuja që ndodhi atë ditë. Besomë, o nip, se kur ai faqezi më kaloi pranë, m'u errën sytë dhe në çast nxora nagantën e desha ta qëllaja, po një mik shqiptar, që kisha afër, më ndaloi, se përpjekja ime do të ishte pa kuptim. Si e pashë që nuk munda ta qëllaja, e futa koburen në këllëf. Dëgjova një zë të njohur, që më fliste shqip: «Do të të arrestoj, o qafir!». Kur ktheva kokën, 'pashë se më fliste Selim aga me hakërrinë e tij. «Ikë, po të them se t'i hodha trutë në erë», i thashë Selimit dhe, kur ai e kuptoi që mua më kishte hipur gjaku në kokë nuk e bëri dy, po u largua. Si e mendova punën mirë e mirë, vendosa të largohesha nga parlamenti dhe vajta në shtëpinë e një miku shqiptar në Stamboll. Zhvesha rrobat ushtarake dhe u vesha tebdil. Të nesërmen në mesnatë i vajta Hasan Prishtinës në shtëpi dhe i tregova se si kishte ndodhur. I thashë edhe se isha gati t'i shërbeja dhe e pyeta mos kishte nevojë pér pushkën time. Ai u përgjegj se hë pér hë nuk kishte nevojë, por më porositi që të arratiseshë nga Stambolli. Pas katër ditësh, më ndihmën e Hasan Prishtinës, ia hipë një vaporë austriak dhe dola në Trieste. Prej andej, me anën e një miku po të Hasan Prishtinës, u

nisa për në Prishtinë. Në Kosovë u takova me Isa Buletin e hyra në qetët e atyre që luftonin për të drejtat shqiptare. Vetë Hasan Prishtina më thërriste Ram Leka dhe ky emër më ka mbetur deri më sot. E kuptove prase cili është Selim Aga?

— Të flasim hapur me Haxhi Qamilin si shok që e kemi e t'i themi që në Këshillin e përgjithshëm kanë hyrë tradhëtarët e spiunët e Esad Pashës! — i tha Mali, që ishte ngritur në gjunjë dhe po i fliste të ungjit duke e vështruar drejt në sy.

— Prit, duhet t'ia gjejmë kohën kësaj bisede — tha Ram Leka.

— Unë them se s'duhet të presim po duhet të bise-dojmë sa më parë me Haxhi Babën dhe fshatarët e tjerë e t'ia themi haptazi mendimin tonë — ngulte këmbë Mali.

## NJË VIZITË E PAPRITUR

Ram Leka dhe Mali vendosën t'i bënin një vizitë mikut të shtëpisë, mësuesit të gjuhës shqipe, Met Saukut. Ky ishte njeriu që i kishte mësuar Malit shkrim e këndim dhe fshatari i ishte shumë mirënjohës mësuesit. Shtëpia e mësuesit, një ndërtesë përdhese e rrëthuar me mure prej qerpiç dhe me një oborr të mbuluar nga pemë të shumëllojshme, dukej si e humbur midis fushës. Ai rronte vetëm me nënën. E shoqja i kishte vdekur në lindje e sipër, atë vit që ushtria e Turgut Pashës kaloi nëpër Shijak. Mësuesi Met Sauku jepte mësim në shkollën e Shijakut që nga fillimi i vitit 1912, po punën si mësues ilegal nëpër klube e kishte filluar që përpara vitit 1910, duke u mësuar shumë të rinxje shkrim e këndim me shkronja latine.

Rama trokiti disa herë në portën e myllur me lloz druri, por asnjeri nuk iu përgjegj. Shtëpia dukej si e shkretuar.

— Bjeri, bjeri prapë! — i tha Mali që filloi edhe vetë të godiste me grusht portën.

Pas një copë here të mirë, nga brenda u dëgjua një zë gruaje, që pyeti:

— Kush është?

— Jemi miq — iu përgjegj Ram Leka, që kishte mbështetur faqen te dera.

— Hapeni, hapeni! — i thirri Mali. — Jemi miq.

Të dy kryengritësit e armatosur filluan të dyshonin se mos kishte ndodhur ndonjë ngjarje e pazakontë në shtëpinë e mësuesit dhe u vështruan sy më sy duke mblidhur supet.

Një plakë e paktë nga trupi hapi derën dhe, pasi u hodhi një vështrim hetues, tha:

— Cilin kërkon?

— Nuk po më njeh! — i tha me buzë në gaz Ram Leka. Plaka, që po e vështron te me kujdes, hapi krahët duke thirrur:

— Ah! Ti qenke, o Ram Leka? Për besë u tremba!

Rama e përqafoi plakën dhe e pyeti pér shëndetin e saj e pér të birin.

— Ky është im nip! — i tha Rama plakës, që po e vrojtonte të panjohurin.

— Mali, i biri i Xhaferrit? — tha e gjëzuar plaka.

— Ai vetë! — iu përgjegj Leka.

Mali ishte kërrusur pér ta përqafuar nënën e mësuesit të tij të dashur me të cilin kishte nxënë pér herë të parë shkrimin shqip.

Plaka, pasi i vuri llozin derës, u priu të dy fshatëve të armatosur pér në dhomën e miqve. Oborri ishte i pastër dhe rrugica ishte shtruar me kalldrëm. Përparrë shtëpisë spikatte bardhësia e murit gjysmë të rrëzuar të pusit.

— Kanë ardhur kohë të vështira! — u tha plaka miqve, kur vuri re hutimin e tyre.

Leka, që po i shkonte pas, vuri buzën në gaz dhe nuk tha gjë. Të dy fshatarët u ulën në minder dhe s'e hapën më gojën. Ai kërkonte me sy fotografinë e një busti të Skënderbeut, të cilin mësuesi e kishte nxjerrë nga një revistë dhe e kishte varur në mur, futur brenda në një kornizë me xham. Tani fotografia ishte hequr dhe vendi ku kishte qenë korniza binte menjëherë në sy.

— Mirë se ardhët, o miq! — u tha mësuesi, që u dha të dera e dhomës: — U tremba, pér zotin e vërtetë! Kanë ardhur kohë të këqia.

Kryengritësit e Pishtarit rrinin si të hutuar dhe nuk e kuptonin se përsë ishte aq i trembur mësuesi.

— Përse trembeni, o Met efendi! — i tha Rama mësuesit, që po e shihte ashtu të trembur.

— Nuk po e kuptoj se çfarë po ndodh! — u përgjegj ai.

— Fshatarët kanë rrrokur armët kundër bejlerëve, kundër Esad Pashës dhe kundër mbretit të huaj, Vudit — iu përgjegj Ram Leka me një ton pak si të çuditshëm me të cilin shprehte habinë që mësuesi ende s'e kishte marrë vesh këtë gjë. Meti ishte një meso burrë thatim, me flokë të thinjur, i veshur me xhaketë e pantallona stofi të zi, me një këmishë të bardhë me pika të zeza dhe me një papion.

Mali vuri re se xhaketa e zezë, që mësuesi e mbante hedhur supeve, ishte tërë pluhur e rrjeta merimangash. Mësuesi e kupto i hutimin e djaloshit fshatar. Ai, me një të qeshur të hidhur, tha:

— Rri fshehur në tavan!

— E pse? — pyeti i çuditur Mali.

— Duan të më burgosin! Duan të më burgosin se u kam mësuar njerëzve gjuhën shqipe me shkronja latine. Kështu më akuzojnë se jam miku i bejlerëve. Ju e dini fort mirë, o Ram Leka, se unë i kam urryer gjithmonë bejlerët!

— Ashtu është! — pohoi Leka — Ti nuk i ke dashur kurrë bejlerët.

— Kam thënë unë Ram Leka. Në Këshillin e përgjithshëm të kryengritjes kanë hyrë tradhëtarët! — tha Mali, që tani po e kuptione qartë se përsë ishte i shqetësuar dhe përsë fshihej mësuesi. — Myftiu i Tiranës dhe Mustafa Ndraqi janë turkomanë të tèrbuar. Ah! Të mallëkuarit, përfitojnë nga padituria dhe fanatizmi i fshatërve dhe po i tèrheqin nga hundët!

Plaka i gostiti miqtë me kafe e me duhan dhe pak më vonë u shtroi drekën: një fërgesë me gjizë e vezë, kos, djathë të njomë dhe bukë misri.

— Mos na e vini re! Po ju presim me ato që na ndodhen! Kanë ardhë kohë të këqia! — përsëriste plaka.

Miqtë e vjetër biseduan shtruar për gjendjen e krijuar, për ngjarjet që po ndodhnin, për kryengritjen e fshatarëve kundër bejlerëve e Esad Pashës, për tradhëtinë e krerëve të Këshillit të përgjithshëm, për rrymën turko-shake në lëvizjen fshatare, për rrezikun e përqarjes kom-bëtare, për intrigat që po luante Esad Toptani, për lakinjtë e shteteve të huaja ndaj tokave shqiptare, për çoro-

ditjen e patriotëve dhe për shumë e shumë probleme të kohës.

Ram Leka e njihte mirë mësuesin shijakas dhe i respektonte ndjenjat e tij patriotike. Ata së bashku kishin marrë pjesë aktive në ngritjen e flamurit kuq e zi me shkabën dykrenore në Tiranë dhe kishin shoqëruar si vullnetarë të batalionit tiranas Ismail Qemalin, Luigj Gurakuqin e të tjerrët nga Durrësi në Vlorë. Më 28 Nëntor 1912, kur u ngrit flamuri dhe u shpall pavarësia e shtetit shqiptar, ata kishin qenë të pranishëm dhe kishin brohoritur së bashku me vlonjatët, labët e delegatët e krahinave të tjera të vendit, krijimin e Shqipërisë. Ram Leka ato ditë kishte zënë një mik nga Kanina, i cili dy ditë më vonë e kishte thirrur bashkë me mësuesin për darkë lart në kështjellë. Kaniniti atë natë kishte thirrur për darkë edhe një fshatar nga Tragjasi dhe një tjetër nga Tërbaçi. Kishin 'pirë raki kumbullash dhe kishin ngrënë meze të pre-gatitura me mish ejapi.

— Puna është e ngatërruar, — tha pas një heshtjeje mësuesi. — Kryengritësit fshatarë nuk marrin vesh nga politika. Ata po na prishin punë me parullat panislamike dhe janë bërë vegël e xhonturqve, që kërkojnë prapë të ringjallin perandorinë turke. Bejlerët janë njerëz me pushitet dhe kanë miq në qarqet e qeverive të Evropës dhe kështu nga këto pozita, ata mund të bëjnë diçka për pavarësinë e Shqipërisë, prandaj ne sot per sot aunet të bëjmë pajtim me ta për interesat e kombit! — Si tha kështu, ai hoqi syzat dhe i fshiu me një shami të bardhë.

— Dëgjo! — i tha Ram Leka, pak i zemëruar: Mos të të vijë keq, por unë i them në sy ato që mendoj. Ne nuk e presim shpëtimin nga bejlerët!

Mali, që po dëgjonte me kujdes për të kuptuar thelbën e bisedës, hodhi vështrimin nga Leka, i cili, si u mëdha një hop, tha:

— Po kërkesat e fshatarëve? Kur shpërthen fshat më fshat si shpërthen baruti në zjarr, kryengritja fshatare nuk pyet as bejlerët, as mua, as edhe mësuesin! Tashti është puna se kush do të vihet në krye të lëvizjes. Pa më thuaj, përsë ju, mësuesit, jeni struktur vrimave? Pse

nuk vini midis fshatarëve për t'i mësuar si të luftojnë për Shqipërinë pa bejlerë? Fshatarët duan liri, tokë, duan të heqin qafe zgjedhën e bejlerëve.

Mësuesi shijakas nuk e priste që Leka, ky fshatar fjalëpakë, të bënte një bisedë kaq të goditur dhe logjike. Atëherë ai, me atë entuziazmin që e karakterizonte, tha me zë të lartë, sikur të ishte zgjuar nga një gjumë i rëndë:

— Ke shumë të drejtë! Ne kemi vështruar punët si miopë — dhe, pasi heshti një hop, shtoi kokulur: — Po, tani është vonë!

— Nuk është kurrë vonë! — iu përgjegj Leka me një ton ngushëllues.

— Ejani edhe ju me ne! — i tha Mali, që kishte heshtur tërë kohën. — Të luftojmë kundër bejlerëve! T'u japim fshatarëve të drejtat e tyre dhe t'i tregojmë popullit kryengritës të vërtetën.

— Paçi fat! — i tha mësuesi i pezmatuar. Ai e dinte se i vetëm nuk ishte në gjendje të bënte asgjë. Disa nga patriotët kishin ikur jashtë shtetit, ca të tjerë ishin grumbulluar në Shkodër pranë Komisionit të fuqive ndërkombëtare dhe një pjesë e tyre po luftonin pas telave me gjemba, që kishtë ngritur mbreti për të mbrojtur Durrësin. Mësuesi e ndjente se po të dilte vetëm përpëra fshatarëve dhe t'u fliste të vërtetën, njerëzit e Mustafa Ndrotit e të Musa Qazimit do ta kapnin dhe do ta rrithnin përvdekje si «mikun e bejlerëve» ose si «kaur», që kërkon të prishë fenë muhamedane. Atij i kujtohej mirë skena dramatike e avokatit tiranas, të cilin një grup fshatarësh e kishin shtruar në dru.

— Unë, si mik që jù kam, ju këshilloj edhe ju që të kini mendjen dhe të mos bini në kurthet e atyre turkomanevë të tèrbuar! — tha mësuesi, kur po ndahej me të dy miqtë e tij të vjetër fshatarë.

Ram Leka dhe Mali u përqafuan me mësuesin. Ata e kuptionin mirë se sa gjendje e vështirë ishte krijuar.

## N E P A L L A T

— Ta shohim të vërtetën drejt në sy, sado e hidhur që të jetë — u tha Esad Pashë Toptani dy oficerëve besnikë që mbante pas vetes. Njëri nga këta ishte Selim Aga, që rrinte më këmbë si i ngrirë para zotit të tij ulur në kolltuk.

Oficerët dëgjonin dhe shikonin me frikë pashanë e tyre të zemëruar e të dëshpëruar. Një heshtje e madhe zotëronte në atë sallon, ku s'pipëtinte asgjë, veç jehonës së fortë që bënин fjalët e Esadit.

Pashai tiranas, me vështrimin nga deti, që atë ditë kishte dallgë prej erës së ngrohtë që frynte nga jugu, briti i zemëruar:

— Ne të gjithë jemi ulur në një fuçi baruti! Një thëngjill mjafton që të na hedhë të gjithëve në erë dhe punën tonë ta marrë lumi. Hymë në valle dhe tani nuk dalim dot prej saj! C'dreqin po bëjnë njerëzit tanë? — pyeti Esadi dhe vështroi Selim Agën.

— Shkëlqesi, edhe unë kujtoja se në krye të fshatarëve të armatosur do të ishin njerëzit tanë, por nga druri që hëngra ende më dhëmbin brinjët — iu përgjegj qahajai.

— Kjo është një lëvizje rebelësh! — tha Esadi dhe shtoi: — Na iku zogu nga dora! Musa Qazimi e miqtë e tij mendojnë ta çojnë ujin në mullirin e turkomanëve e xhonturqve; por ata nuk e kuptojnë se fshatarët e armatosur një ditë mund t'u kthejnë edhe atyre armët.

Dukej sheshit se vartësit, që dëgjonin në heshtje, i kishte mbërthyer vala e dëshpërimit dhe s'pritnin veçse katastrofën.

Esad Pasha, i veshur me uniformën e gjeneralit, kishte vënë duart prapa dhe ecte poshtë e lart nëpër sallonin e gjerë shtruar me sixhade persie. Mbas çdo mendimi që jepte, ai bënte një pushim.

— E keqja qëndron — tha Pashai — se ne kësaj here u treguam syleshë dhe i bëmë llogaritë së 'prapthi. Nuk na kishte shkuar mendja se ata fshatarë morracakë, këmbëzbathur, malarikë, të paditur, turma zhelanësh, do të ngrimin një ditë grushtin edhe kundër nesh. Kundër nesh! — përsëriti dy herë fjalët e fundit Pasha nervoz me sy të çakërdisur, duke i rënë me grusht një tryeze të madhe prej druri arre, vendosur në mes të sallonit.

— Do të ishte e udhës të iknim prej këtej, o Pashë i ndritur! — i tha Selim Aga. — Sot për sot s'ka rrugë tjetër!

— Ti je gomar! — i tha Esadi me përbuzje. — Mos kujton zotrote se kemi ndër mend të heqim dorë nga cifligjet dhe t'ua japim gati fshatarëve? Ku të mbytemi? Turqia mbaroi! Ne duhet të ngrehim, ja, pikërisht këtu, në këtë vend, që na e kanë lënë trashëgim të parët tanë, një Turqi të vogël, së cilës do t'ia vëmë emrin Shqipëri! Ky vend ka fusha, kullota, vreshta e ullinj, pyje, det e kripë, mademe, e ç'nuk ka! Nuk do të thyejmë qafën asgjékundi, se, për zotin e vërtetë, do të mbetemi për lëmoshë! Diplomacia është një mjet i ynë, që duhet ta përdorim për t'ia arritur qëllimit! A e kuptove, Selim Aga!

— Dhe zotrote, shkëlqesi, të bëhesh mbret! — tha Selimi, që e kishte harruar fare fyren e mëparshme.

— Ja, kështu duhet menduar dhe kështu duhet folur! — iu përgjegj Pasha që u ngrit nga kolltuku dhe filloj përsëri të ecte poshtë e lart sallonit.

Të dy oficerët, që rrinin më këmbë, ktheheshin si me sustë ngado që lëvizte kryetoptanasi, ministri me dy portofole në qeverinë mbretërore të Vudit. Njëri nga ata nuk hapi gojë fare, sikur të mos dinte të fliste.

— E çfarë duhet të bëjmë? — pyeti Selim Aga, që mori zemër na lëvdatat e të zotit.

— Po. Nuk duhet të humbim kohë! Ti duhet të kthehesh në Shijak pranë Këshillit të përgjithshëm të kryengritjes, siç e quajnë ata. Do të mbështetesh te Musa Qazimi dhe të Mustafa Agë Ndroqi. Do t'u bësh propagandë fshatarëve që të kthejnë sytë nga Pasha! Të ndërsesh fshatarët varfanjakë kundër atyre që përhapin gjuhën shqipe me shkronjat latine dhe që duan të mbajnë më këmbë mbretin e krishterë pér të prishur fenë më të mirë të botës, fenë muslimane! A e kuptohe se çfarë duhet të bësh ti dhe miqtë e mi?

Esadi qeshi me vete dhe Selim Agës, të cilit nuk i shpëtonte asgjë, iu duk si një lajthitje e vogël.

— A duhet të bisedoj haptazi me Mustafa Agë Ndraqin? — e pyeti Selimi, që i dinte lidhjet e miqësitë e tyre të vjetra.

— Të bisedosh posi. T'ia thuash atij se së shpejti Pasha do ta shtrojë prapë vendin! Dëgjo këtu! Ty po ta tregojë të fshehtën. Midis meje dhe Mustafa Ndraqit ruhet një armiqësi e vjetër e padeklaruar.

Pa mbaruar mirë fjalën Pasha, u dëgjuan të shtëna pushkësh dhe gjëmime topash nga toka dhe nga deti. Esadi doli në ballkon dhe hodhi vështrimin tej gjerdheve dhe telave me gjemba, që ishin ngritur përpara qytetit. Dukej qartë se atje kishte filluar një përleshje e ashpër midis kryengritësve fshatarë dhe ushtrisë mbretërore.

Një oficer, që brofi në derë të sallonit, tha me një frysme: — Pasha, jemi të rrethuar! Rebelët kanë sulmuar nga të gjitha anët Durrësin! Jemi në rrëzifik!

Esad Poptani, që ishte kthyer në sallon, qëndroi para oficerit të përlyer me baltë nga kryet e gjer te këmbët dhe tha me përcëmim: — Frikacak! Qërohu që këtej! — Pasha qeshi ndën hundë. Shumë prej rrethit të oficerëve nuk e kuptonin rolin e dyfishtë të ministrit të brendshëm, i cili kishte gisht në kryengritjen pér rrëzimin e Fon Vilhelm Vudit.

Oficeri, një djalosh i pjekur në moshë nga fisi i Vrionasve, i verdhë dyllë, pasi bëri një nderim të thatë, doli

nga salloni me hap ushtarak me një mendim të dyshimtë  
të papërcaktuar kundrejt ministrit.

Pasha u ul në kolktuk dhe vuri të dyja duart në  
kokë.

— Shkoni, miqtë e mi! — tha ai dhe, si ngriti ko-  
kën, ku spikatnin dy sy të mëdhenj si të çapëlyer nën ca  
vetulla të trasha, shtoi: — Secili në krye të detyrës! —  
Po me vete mendoi: «Më plasi bomba në dorë!»

Të dy oficerët besnikë dolën nga pallati duke e lënë  
vetëm dhe të pikëlluar shkëlqesinë, Esad Pashë Top-  
tanin.

Në oborr mbi muret e trasha prej guri të pallatit,  
bënte roje një skuadër mercenarësh, që rrinte në poz-  
icionë lufte.

## NJË NGJARJE E PAPRITUR

Kryengritësit fshatarë sulmuan disa herë Durrësin e fortifikuar, por pa ndonjë përfundim. Sulmet e tyre u theyn nga zjarri i dendur i ushtrisë mbretërore dhe sidomos nga topat, që qëllonin prej anijeve të huaja në det, të cilat ishin vënë në dispozicion të mbretit Vid.

Në pallatin e Esad Pashës, ministrit më të shquar e më të fuqishëm të mbretit Vid, kishte plakosur heshtja.

Një luftë e rreptë, e papritur kishte nisur pikërisht përpara pallatit. Topi qëlloi muret prej guri dhe njëra nga predhat, që ra në sallën kryesore të pallatit, shkatërrroi çdo gjë që gjeti brenda. Pasha, që po rrinte në një nga dhomat e poshtme, me kobure në dorë, doli vetëtimthi, i tmerruar, në oborr dhe i urdhëroi njerëzit e tij, që kishin zënë pozicione, të luftonin deri në pikën e fundit. Porta e madhe e pallatit ishte myllur nga prapa me lloz prej hekuri. Për ta përforcuar edhe më mirë u vendosën disa trarë të mëdhenj prej ahu. Pasha, me intuitën e tij të mprehtë, e kuptoisi se planet i ishin zbuluar! Ai gjoja përkrahu vajtjen e vullnetarëve patriotë tiranas për në jugë, që të luftonin kundër bandave greke, të cilat kërkonin të formonin të ashtuquajturin «Vorio-Epir», po ana tjetër nxiti njerëzit e tij të paskrupull që t'u prisnin rrugën vullnetarëve tek ura e Lëmuthit, në rrugën e Durrësit. Vetë Esadi, i dorëzoi Fon Vilhelm Vidi kurorën mbretërore në Vid të Gjermanisë dhe tani po ai me anën e agjentëve të tij, nxiste turma fshatarësh kundër mbretit

për ta rrëzuar atë nga froni, e pér t'u shpallur vetë sundimtar i vendit! Pasha mbante lidhje me qarqet qeveritare të Romës, të Beogradit, të Athinës, bile edhe me ato të Francës. Por, tani ministri i luftës, të cilit i ishin zbuluar qëllimet e vërteta ndaj mbretit, gjendej i rrethuar nga garda mbretërore. Jeta e tij ishte në rrezik.

«Ç'të bëj?» mendonte Esadi, ndërsa përjashta krisnin pushkët dhe gjëmonte topi.

Për një çast batareja e pushkëve u ndërpri. Esadi dëgjoi britma e këngë që vinin nga sheshi para pallatit: «Port' e qiellit duhet kthyer... kokë e Esadit duhet thyer!» Ishin turma të rinjsh patriotë, që demostronin në rrugët e Durrësit pér tradhëtinë e Esadit.

— Esad Pasha! — thirri dikush nga jashtë me zë të lartë baritonit: — Dorëzohu!

— Cilët jeni ju, o edepsëzë, që guxoni të sulmoni ministrin? — u përgjegj i zemëruar Esadi, që rrinte pas portës me kobure në dorë.

— Pashë! Në emër të mbretit kemi urdhër t'ju arrestojmë! — iu përgjegj i njëjtë zë dhe pastaj shtoi: — Në qoftë se nuk dorëzoheni të gjallë, kemi urdhër t'ju dorëzojmë të vdekur, o tradhëtar!

— Hiqni dorë nga kjo punë e keqe, ore të mjerë, se litari ju pret të gjithëve — tha Pasha i hakërryer.

Ministri i punëve të brendshme dhe ministri i lufës, tani, e kuptoi fare qartë se mbreti Fon Vilhelm Vidia kishte zbuluar qëllimet dhe kishte marrë vendim ta zhdukte, prandaj s'kishte më vend pér asnjë sqarim. «Çdo minutë humbje kohe është vdekje pér mua! Mos e humb, o shkëlqesi, o pashë, o bej, o mbret i ardhshëm i Shqipërisë! Gjeje një vrimë nga të dalësh!» — mërmëriti nëpër dhëmbë Esadi dhe buzëqeshi me pahir.

— Hapeni portën! — foli me një frengjishte të kuilluar një oficer i gardës mbretërore, njëri nga organizatorët ushtarakë holandezë.

— Dëgjoni zotërinj! — ju përgjegj Pasha me një ton të madhërishëm, që të kallte frikë dhe respekt njëkohësisht. — Më jepni dy orë kohë! Lejoni të dalin nga pallati dy oficerët e mi, pér t'i dërguar një letër mbretit.

Unë do të rri i mbyllur në pallat! Si të vijë përgjigjja nga mbreti, edhe ju edhe unë do të zbatojmë urdhërin e lartmadhërisë! Pra të mos lëmë të derdhet gjak kot së kоти! Pranoni, zotërinj?

Ra një heshtje e përkohshme! Nga jashtë, pas një copë here, u dëgjua prapë zëri i baritonit: — Pranojmë, o pashë! Dy oficerët tuaj janë të lirë të dalin nga pallati dhe të shkojnë te mbreti! Në po presim dy orë!

Pas gjysmë ore Selim Aga dhe ai oficeri tjetër që s'fliste dolën nga pallati. Secili prej tyre mbante në gji një letër të mbyllur e të vulosur, të shkruar nga Esadi. Njëra letër ishte për mbretin dhe tjetra për konsullin e Italisë. Ushtarët dhe turma e të rinjve, që kishin zënë rrugën, pasi i vështruan me dyshim u hapën vend kalimi të dy njerëzve të besuar të toptanasit.

Esad Pashë Toptani rrinte i ulur në kolktuk me krahet e kryqëzuar në kraharorin plot dekorata. Ai po priste i menduar përgjigjen nga mbreti dhe nga konsulli italian, me të cilin e kishte lidhur një miqësi e vjetër që pat nisur në zyrat sekrete të Ministrisë së Brendshme në Romë. Esadi treti shikimin larg në horizont dhe vetëm atëhere vuri re dégët e një kumbulle të porsaçelur, që përplaseshin me forcë mbi murin e gurtë. Ai mendoi: «Ty, o gjeneral, o pashë, o mbret i ardhshëm, hero i papërkultur, që ke parashikuar të ardhmen, të të zëjë frika? E nga kush? Nga ai Vilhelm Vidi, njeriu më i paaftë që ke njojur? Mblidh mendjen, ore Pashë!» Esadi filloi të shkonte nëpër mend si në një paradë gjithë ngjarjet më të shënuara të jetës së vet, situatat e ndera, njerëzit e shquar, që kishin lënë mbresë në kujtesën e tij, kurthet e dredhitë që u kishte ngrehur rivalëve në Stamboll, Janinë, Shkodër, Tiranë e gjetiu.

## ESADI KUJTON

«Atdheu dhe çifligjet tona atje buzë Adriatikut janë në rrezik! Që tani do të shkoj në pallatin Ylldiz!» Kështu tha ai atëhere dhe shkoi drejt në pallatin perandorak. Esadi, duke iu ngjitur shkallëve, i hodhi një vështrim qytetit që andej dhe tha nëpër dhëmbë: «Stambolli është kryeqyteti më i bukur i botës! O zot më bëj mbret të Stambollit dhe një ditë shporre atë sulltan që fshihet 'pas kofshëve të grave të harem-it!»

Në një nga sallonet e Pallatit perandorak, ai takoi një mikun e tij, adjutant të sulltanit, dhe ia tregoi fije për pe planet e tij.

Menjëherë, së bashku, shkuan te Tahir Pashë Kraja, kryekomandant i gardës perandorake, me të cilin toptanasi, përvèç miqësisë, ishin të lidhur edhe me krushqi. Tahir Pasha, pasi e dëgjoi me kujdes mendimin e Esadit dhe ia pëlqeu planin, ia paraqiti te Sultani, që atë çast, të dy vëllezërit.

Kolonel Esad Pasha iu drejtua Abdyl Hamitit të dytë, që rrinte ulur në froni perandorak me madhështi: «Madhëri! Kemi nderin e lartë t'ju njoftojmë se ne arnautët kemi marrë një vendim: Meqenëse Greqia synon të zaptojë krahanat e kombësive shqiptare, banorët e të cilave kanë qenë e do të mbeten nënshtetasit më të bindur e më të besuar të Madhërisë suaj, dhe janë të vendosur ta mbrojnë e ta ruajnë froni e lartë Tuaj dhe porosinë e Madhërisë suaj, kemi vendosur që të lëshojmë në të katër anët e vendit të arnautëve zërin e kushtimit për të rrrokur

armët të gjithë sa jemi të aftë për luftë dhe t'u thyejmë brinjët grekëve, të cilët duan të rrëmbejnë tokat që trashëgojmë nga të parët tanë dhe që na i ka mbrojtur Dovleti. Ju marrim këmbë e dorë që të na lejoni për këtë luftë e të na e lini drejtimin e saj ekskluzivisht ne shqiptarëve. Dhe, po s'u futëm në Greqi, drejt e në Athinë, ja ku po ju themi se keni këtu peng kokat tonë dhe besën e mikut tuaj të shtrenjtë, të Tahir Pashës!»

Fytyrën e egër, të zgjuar dhe të frikshme të sulltan Hamitit, të cilit, i bënë përshtypje fjalët e Esadit, e përshkoi një buzëqeshje e ngazëlluar dhe një mjegull, si një tyl i hollë, ia mbuloi shikimin kur picëroi sytë. Sulltani po përfytyronte që tanë fitoren e sigurt mbi grekët e pasbesë. Por kjo ndjenjë kënaqësie u zhduk përnjëherësh; një dyshim ia brejti shpirtin dhe mendoi: «E kush do të na japë fitoren? Shqiptarët! E kush u beson arnautëve? Mos vallë po bluajnë plane të reja si herët e tjera? Prit!»

— Këtë çështje, «evladllarëm» do ta kuvendoj më parë me këshilltarët dhe gjithësesi do t'ju njoftoj me anën e Tahir Pashës. «Ashk ollsun size!»

Me kaq mori fund takimi me sultananin dhe Esad Top-tani nuk u interesua më nëse perandori e kishte pleqëruar ose jo propozimin e tij me këshillin e lartë ushtarak; për të pati rëndësi vetëm fakti që të pasnesërmen Tahir Pasha i kishte dhënë përgjegjen pozitive prej sultananit dhe dekretin për të disponuar shumat kolosale të fondeve në Ministrinë e Financave të Stambollit për nevojat e luftës. Miqtë e Esatit u nisën për në Shqipëri që të nxisin e të mobilizonin forca kundër Greqisë. Toptanasit, duke përfituar nga ndjenja patriotike që ishin ngjallur në kom-bësinë shqiptare, sidomos pas Lidhjes së Prizrenit, mundën të grumbullojnë disa forca, të cilat së bashku me repartet e ushtrisë turke pothuajse nga të gjitha krahinat shqiptare u përqëndruan te portat e Janinës. Këto forca të mëdha ushtarake i komandonte Esadi. Sulltani, nëpërmjet korrierëve, i dërgoi ato ditë Esadit fermanin që e gradonte nga kolonel në «Pasha».

— Dëgjoni, vëllezër shqiptarë! — u foli Esadi ush-

tarëve të rradhitur në formacione lufte, në fushën e Janinës para dyerë të qytetit.

— Ju do të luftoni për mbrojtjen e tokave amëtare, të cilat grekët kërkojnë të na i shkëpusin nga vatanit. Sulmoni me trimëri, si u ka hije shqiptarëve. Sa për atë valiun e Janinës, Osman Pashën, ja ku e keni! — dhe ja bëri me dorë.

Me urdhërin e Esad Pashës, që ishte emëruar kryekomandant i qytetit, e kishin lidhur valiun e Janinës Osman Pashën dhe i kishin varur në qafë një këmborë. Dy ushtarë têrhiqnin këmborën dhe zhurma përhapej deri larg brenda qytetit.

— Qetësi! — u briti Esadi ushtarëve, që gajaseshin së qeshuri. — Ky edepsëz u thoshte shqiptarëve «pis arnaut». Ja tani si e pësoi!

— T'i presim kokën qafirit! — foli një ushtar nga radhët e para.

— Ta têrheqim zvarrë me kuaj! — tha një tjetër.

Ushtria queshte dhe bënte zhurmë. Përpara tyre rrinte kokulur valiu, në një gjendje të mjerueshme. Atë e detyronin ushtarët të tundte kokën për të tundur këmborën. Turma fshatarësh, që disa ditë më parë kishin hequr të zitë e ullirit ngajeta e rendë e lodhur me mjerime e skamje, të armatosur dhe të hazdisur këndonin, hiqnin valle dhe argëtoheshin me valiun turk të Janinës.

Pasha thirri me një zë solemn, që u përhap në gjithë ushtrinë: «Atij që guxon të fyejë shqiptarët, trima, fisionikë e bujarë do t'i pritet koka, qoftë edhe vali!»

Esadi u a bëri me dorë xhelatëve, që rrinin në këmbë pranë një trungu. Trompetat filluan të binin pa ndërpërje. Osman Pasha, i lidhur, u kërrus me forcë mbi trungun e sharruar. Sopata e xhelatit, që ishte një arab i fuqishëm me trup si të ariut, ra mbi qafën e majme të turkut nga Izmiri dhe ia këputi kokën. Ata që ishin në radhët e para të ushtrisë britën: — Oho... oho...» Një grup ushtarakësh e oficerësh brohoritën: «Rroftë Esad Pasha!»

— Merrjani kokën dhe dërgojani në Stamboll! — dha urdhër Esadi. Korrierët, pasi e mbështollën kokën me një

copë beze të bardhë dhe e paketuan në një thes të linjtë, hipën në një karrocë, që tërhiqej nga dy kuaj arabë. Para se të niseshin, Esad Pasha i dorëzoi njërit prej dy shoqëruesve, një zarf të dyllosur.

Trupin e cunguar të Osman Pashës e hodhën në një gropë dhe e mbuluan me dhe.

Esad Toptani kishte planet e veta. Me këtë sjellje ai kishte për qëllim të bënte për vete shqiptarët.

Pashai tiranas synonte të arrinte dy qëllime njëherësh: së pari, të fitonte lavdi dhe një ditë, pasi të hiqej qafe sulltan Abdyli i paaftë e frikacak, të bëhej mbret i kësaj pjese të imperatorisë.

Lufta filloi. Grekët u thyen keqas. Për disa javë ushtria përparoi deri në afërsitë e Athinës.

Një mbrëmje ushtria po pushonte në një fushë afër një qyteti të vogël të lashtë. Esadin, që po flinte, e zgjuan. Një korrier që vinte nga Stambolli i dorëzoi një letër, të cilën ia dërgonte vetë sulltan Abdyl Hamidi. Toptanasi e hapi letrën shpejt e shpejt dhe, në dritën e një qiriut të trashë, lexoi përbajtjen. Mbreti e përgëzonte për fitoret dhe e dekoronte me medaljen më të lartë «Kahramanloku». Mirëpo njëkohësisht sulltani në këtë letër e urdhëronte të pushonte menjëherë luftën dhe t'i tërhiqte trupat në kufitë e mëparshëm. Midis Turqisë dhe Greqisë ishte nënëshkruar paqja.

— Ah, o sulltan frikacak! Ah, mor budalla! — thirri Esadi me zë të egërsuar. E mblodhi letrën shuk në njërin grusht dhe e flaku tutje me neveri. Pastaj, kur pa korrierin që rrinte më këmbë, thirri i zemëruar: — Jashtë, o bir qeni!

Korrieri u largua me nxitim nga çadra, ndërsa Esadi me sy të llahtarisor nga tmerri, me duart në kokë u ul në cep të shtratit pranë një grekeje gjysmë të zbuluar.

Pas disa ditësh Esadi mësoi se shkak i urdhërit të sulltanit për të pushuar luftën kishte qenë nota kërcënuese që kishte marrë prej mbretit të Anglisë.

«Planin tim për hipjen në ndonjë shkallë më të lartë duhet ta konsideroj të dështuar» tha me vete Esadi. «Por, sidoqoftë, kjo luftë ma shtoi namin dhe më hapi një per-

spektivë për t'ua arritur qëllimeve të mia! Turqia e ka marrë të tatëpjetën! Kombet e ndryshme po fitojnë auto-nominë; pra, pse të mos themelojmë edhe ne një mbretëri nën sundimin tim?»

Esad Toptani, pas Luftës turko-greke, vizitoi Romën, Vjenën dhe Parisin. Ai deklaroi se 'po shkonte për pu-shime, por në prapaskenë Toptanasi i kishte vënë vetes detyrë që të takohej me diplomatë dhe qeveritarë të këtyre shteteve me influencë. Esadi ishte i informuar mire për krizën ekonomike që kishte plakosur Turqinë dhe për milionat që osmanllintë kishin huajtur nga shtetet e perëndimit. Ai po përpinqej që të shkëpuste ç'ishte e mundur nga Perandoria Otomane, që po perëndonte.

Esad Pasha e nuhati se ngado që shkonte edhe në kryeqytetet e Evropës, Sulltan Abdyl Hamiti i kishte vënë prapa spiunë, që ta vëzhgonin dhe ta informonin Portën e Lartë për veprimet e qëllimet e udhëtimit të tij. Përveç detyrave politike, Esadi, i mësuar me gratë e haremave, nuk linte pas dore edhe qejfet.

Esadi luajti politikë të poshtër gjatë këtyre takimeve. Ai u premtoi diplomatëve të Evropës dhe të Ballkanit gjithshka: lidhje tregtare, përfitime ekonomike të mëdha, pyje, krahina të tëra, veç që ata ta ndihmonin, të mbështesnin kërkessat e tij për t'u shpallur sundimtar. Edhe ata nga ana e tyre i akorduan shuma të mëdha kredisht nëpër bankat e kryeqyteteve të tyre.

Esadit i kishte lënë mbresë viti 1908, revolucioni i xhonturqve në korrik të këtij viti, ku morën pjesë aktive edhe shqiptarët, sidomos Kosova. Kryengritësit shqiptarë luajtën një rol vendimtar për fitoren e revolucionit xhonturk dhe për rrëzimin nga froni të Sulltan Abdyl Hamitit të dytë, duke u nisur nga qëllimet e tyre kombëtare dhe sociale për të arritur pavarësinë kombëtare dhe reformat ekonomike. Esad Toptani, kur pa që sultani Abdyl Hamiti mori të tatëpjetën, priti çastin e duhur për ta kthyer pllakën, për t'u hedhur kundër tij. Me qëllim që të fitonte pozita të reja, ai u premtoi xhonturqve shërbime. Esad Toptani mori guximin dhe me dinakërinë që e karakterizonte arriti të vihej në krye të komisionit

parlamentar që do t'i njoftonte Abdyl Hamitit të dytë shfronëzimin e tij. Kur e kujtonte skenën në Pallatin Ylldiz, Toptanasi vinte buzën në gaz dhe ngërdheshej me përcëmim. Gjenerali toptanas i vajti sulltanit në dhomën e gjumit, pa e njoftuar sipas etiketës mbretërore, dhe, kur ia njoftoi vendimin e parlamentit, përdori një shprehje të zakontë dhe ton mospërfillës.

«Lartmadhëri — filloj Esadi — dijeni se nga ky çast keni rënë nga froni!...»

Sulltani u zverdh si limon dhe gjithë dufin e urrejtjes, që i kishte lindur në shpirt kundër asaj bote të re të krijuar në perandorinë e tij të përjetshme, ia përplasi Esad Toptanit, që i rrinte mbi kokë si një xhelat.

«Mallëkuar qofsh për jetë nga profeti ynë Muhamed Mustafai!» tha duke ngritur duart lart dhe, ashtu i ngrirë, mbeti gjersa u largua Esadi dhe parlamentarët e tjerë.

Kur plasi kryengritja e përgjithshme për shpalljen e pavarësisë dhe ngritjen e flamurit të Skënderbeut në Shqipëri, Esadi ndeji i rezervuar, i fshehur nëpër qoshet e Stambollit duke vrojtuar situatën, për të marrë vesh se ç'rrugë duhej të ndiqte.

\* \* \*

Në ditët e para të tetorit të nxehjtë të vitit 1912 plasi Lufta ballkanike kundër Turqisë, që po jepte shpirt. Esadi, që në atë kohë sillej haremëve të Stambollit, nëpërmjet ndërhyrjeve dhe makinacioneve, i shkëputi Ministrisë së Luftës një dekret qeveritar, që e emëronte atë zëvendëskomendant të garnizonit të Shkodrës. Pasi arriti nga Stamboli në Tiranë, mobilizoj një ushtri të madhe të mbledhur nga Tirana, nga prefektura e Durrësit, nga Mati e Dibra, duke u bërë thirrje bashkatdhetarëve që të shkonin në luftë për mbrojtjen e trojeve shqiptare nga copëtimi dhe robërimi i serbomëdhenjve dhe i malazëve. Esad Pashë Toptani marshoi në krye të kësaj ushtrie drejt Veriut dhe hyri në Shkodrën e rrethuar, që qëllohet

me topa nga të gjitha anët. Garnizoni i Shkodrës kishte afro gjashtë muaj i rrethuar dhe luftonte dhëmb për dhëmb me armiqtë, që e sulmonin herë pas here me tërbim, sulme që thyheshin në muret e kështjellës së vjetër të Rozafatit. Pikësynimi i ushtrive serbe e malazeze ishte që të dilnin në Durrës, në Shëngjin e në Vlorë. Po qarqet kapitaliste të Italisë, të Austro-Hungarisë dhe të Gjermanisë, të trembura nga rreziku serb në Adriatik, filluan nga ndërhyrjet. Esad Toptani u informua për këto lajme, me anën e një letre që i dërgonte një mik i tij, një diplomat italian, që ishte njeri me influencë në qarqet qeveritare të Romës. Letra që vinte nga Durrësi ra në dorë të sekretarit të Pashës në nënprefekturën e Tiranës dhe nëpërmjet një korrieri, që mbante lidhje të rregullta në linjën Tiranë-Shkodër, i ra në dorë zëvendëskomandanit të garnizonit Esad Pashë Toptanit. Në një letër të dytë, mbështjellë në një zarf të vulosur me dyll të kuq, Pashai informohej edhe për shtëpitë e djegura dhe për shkatërrimin e vreshtave tek stani i gegëve në Tiranë nga ushtritë pushtuesë serbe, si hakmarrje kundrejt qëndrësës që bënte ai në Shkodër. Kryetoptanasi ishte në dijeni të plotë të përpjekjeve luftarake dhe diplomatike që po bënte Komiteti organizator, i kryesuar nga plaku Ismail Qemali, për shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë. Pikërisht për këtë arësy Pasha i Tiranës kurdisi një plan të ri që të sulmonte me garnizonin e Shkodrës Shqipërinë e porsakruuar dhe me anën e forcës ushtarake t'u kundërvihet Ismail Qemalit dhe patriotëve të tjerë si Hasan Prishtina e Bajram Curri dhe të bëhej ai sundimtar i vendit. Por, për t'ia arritur këtij qëllimi duhej më parë të hiqte qafe komandantin e garnizonit Hasan Riza Pashën dhe t'i zinte vendin. Ky ishte një pasha arab nga Bagdati, i cili duke njojur trimëritë e shqiptarëve, u bënte thirrje ushtarëve që të luftonin për mbrojtjen e atdheut. Esadi e thirri për darkë Hasan Riza Pashën. Pas darke, kur komandanti i garnizonit të Shkodrës po kthehej në shtëpinë e tij, një pritë e kryesuar nga besniku i Esadit, Osman Bali, e qëlloi prapa shpine Hasan Rizanë, i cili pas një ore mbylli sytë përgjithmonë. Të nesërmen me 31 janar të vitit 1913

komiteti ushtarak shpalli komandant të garnizonit të Shkodrës Esad Pashë Toptanin. Fill pas kësaj mënxyre, që ndodhi në shtabin e garnizonit të Shkodrës, që përbëhej nga reparte të rregullta të ushtrisë turke dhe nga reparte vullnetare shqiptare, ushtritë serbe e malazeze filluan një ofensivë të re, e cila zgjati tri ditë e tri net pa puhuar. Ajo ishte një nga përleshjet më të përgjakshme që ndodhën në gjashtë muajt e fundit të kësaj lufte. Shqiptarët, me gjithëse të uritur, pa ujë dhe të lodhur u mbrojtën me heroizëm të rrallë dhe nuk i lëshuan asnje pëllëmbë tokë armikut. Taraboshi, ky mal i zhveshur që s'ishte veçse shkëmb i zi, u skuq nga gjaku i shqiptarëve që mbronin Shkodrën. Esadi sillte tanë ndër mend këtë betejë dhe i dukej sikur kishte ndodhur dje.

«— Dëgjo, Pasha! — i kishte thënë një ushtar nga fshatrat e Tiranës: — Ne, në Shkodër, po luftojmë që armiku të mos copëtojë tokat tonë! Le të ngrëmë pra flamurin kuq e zi, që u ngrit edhe në Vlorë! Le të marrë vesh bota se jemi shqiptarë!»

Esadi qeshi me cinizëm, po nga ana tjetër, ndonëse i çuditur, mori një mësim. Ai zbuloi se në radhët e ushtrisë së tij kishte ushtarë që mendonin për pavarësinë e Shqipërisë dhe i vuri gishtin kokës. Esad Pasha nuk u përgjegj dhe u tregua mospërfillës për kërkësen e ushtarit që guxonte të hidhte atë bombë që Esadi ia kishte plasur në dorë edhe Hasan Rizait. Turma e ushtarëve që ishte aty përreth komandantit të ri të garnizonit, brohoriti për flamurin dhe pavarësinë e Shqipërisë. Pasha u ktheu shpinën ushtarëve dhe, pa thënë asnje fjalë, shkoi në çadrën e vet ngritur mbi një bregore rrëzë Ruzafatit.

Epopeja e luftës së Shkodrës, e cila është një nga betejat më të përgjakshme të luftës ballkanike, i kishte lënë mbresa të pashlyera pashait të Tiranës. Ushtritë malazeze, pasi pushtuan Krajën, Gucinë e Tuzin, duke përfituar nga mashtrimi që u bënë malësorëve se gjoja po luftonin për débimin e turqve dhe pavarësinë e Shqipërisë, erdhën në periferi të Shkodrës. Artileria e Kral Nikolles u vendos në Muriqan dhe nga majat e atyre maleve

qëllonte me predha fushën e Bunës, bile dhe bregun e Drinit. Pas disa ditësh ushtritë malazeze u hodhën përtëj Bunës dhe zunë pozicione në Daragjat të Shkodrës.

Taraboshi ishte e vjetmja mburojë e qytetit. Garnizoni turk i Shkodrës përbëhej në pjesën më të madhe nga shqiptarët që kishin ardhur vullnetarë. Shkodra, në këmbët e malit të zhveshor të Taraboshit, mbulohej ditë e natë me tym dhe flakë nga goditjet e parreshtura të artilerisë dhe nga sulmet e kundërsulmet e palëve ndërluftuese. Esadi, që kishte zënë vendin e Hasan Riza Pashës, ndiqte me dylbi nga kështjella e Rozafatit fatet e luftës.

Kjo luftë e zhvilluar në Shkodër, në kuadrin e Luftës ballkanike, përbante në vetëvete një mëri qëllimesh. Turqit mbronin pozitën e tyre të fundit në Ballkan. Malazezët, serbët, bullgarët, grekët synonin copëtimin e tokave shqiptare. Një pjesë e shqiptarëve, sidomos malësorët e veriut, mendonin se malazezët po sillnin lirinë në tokat e tyre, kurse të tjerët, duke luftuar krah garnizonit turk të Shkodrës, mendonin se kishin gjetur rrugën më të drejtë pér të mbrojtur atdheun nga copëtimi. Esad Pashë Toptani kishte qëllimet e tij. Ai donte të vendoste pushtetin e tij në Shqipëri, duke iu kundërvënë qeverisë së Ismail Qemalit, të krijuar më 28 nëntor 1912 në Vlorë. Mali i Taraboshit, fusha e Shtoit, buzë e Vrakës, Kodrat e Tepes, u bënë varri i ushtrive malazeze të Kral Nikollës, dhëndrrit të Viktor Emanuelit III. Malësorët, kur shihnin se Kral Nikolla kudo që shkelte ngrinte flamurin e Malit të Zi, largoheshin. Tani të gjithë shqiptarët prisnin që Esad Pashë Toptani të bënte atë që nuk e realizoi Hasan Riza Pasha: të ngrinte flamurin e Shqipërisë në kështjellen e Teutës dhe t'i tregonte Evropës së këtu nuk eshtë Turqia por shteti i ri i pavarur i Arbërisë. Por Esadi kishte qëllimet e tij. Pashai dinak, më 22 prill 1913, râ në marrëveshje me prinçin trashëgimtar Danielin, pér ta dorëzuar Shkodrën pa armë, me kusht që ushtria e tij e rrethuar të dilte nga qyteti e armatosur dhe me ushqim pér tri ditë. Kalorësia e gardës së mbretit të Malit të Zi e përcollti me nderime Esad Pashën në

krye të garnizonit turk deri në të dalë të Shkodrës në fshatin Balldre të Lezhës. Pashai i Tiranës, i kënaqur nga vepra që kishte kryer, hipur në një kalë të bardhë, hidhte herë pas here vështrimin prapa, ku e cte shumë ngadalë një pjesë e ushtrisë së tij, fare e dërmuar dhe e rraskapitur nga luftrat e rrepta gjatë këtyre gjashtë muajve. Ai ua kishte frikën turmave të ushtarëve shqiptarë, të cilët e shfaqnin haptas zemërimin e tyre për dorëzimin e Shkodrës Malit të Zi. Esadi filozofonte me veten e tij: «Këto turma zhelamanësh janë si ajo kopeja që shkojnë nga t'i ngecin brinjët! Kështu është krijuar nga zoti, disa njerëz të zgjedhur janë caktuar për të sunduar dhe për të krijuar historinë, kurse turmat e popullit duhet t'u nënshtrohen vullnetit të tyre».

Esadi e vlerësonte veten e tij për ushtarak të mbauar. Jo vetëm kaq, por ai mbarrej se edhe në diplomaci po shkëlqente. Pashai toptanas e kishte rregulluar me diplomatët e Serbisë dhe të vendeve të tjera të Evropës që, me dorëzimin e Shkodrës pa luftë, ai të siguronte përkrahjen e tyre për të qenë sundimtari i ardhshëm i Shqipërisë, qoftë edhe i një pjesë të saj. Me ndërmjetësinë e tij dhe në marrëveshje me qeverinë e Turqisë, ushtria turke, nëpër vaporet italiane, u largua nga Durrësi për në Stamboll.

Esadi formoi qeverinë e vet dhe kërkoi kështu shpërndaljen e qeverisë së Ismail Qemalit nga Vlora në Durrës.

Synimet e Esadit ishin të qarta: qeveria e Vlorës duhej likuiduar. Esadi duhej të ishte pushteti i plotfuqishëm i Shqipërisë.

\* \* \*

Kujtimet e së kaluarës, që e kishin mbërthyer në vend ministrin e arrestuar, i prishi e shtëna e një topi, që villte zjarr në anën verilindore të qytetit, ku ishin rreshtuar forcat e fshatarëve kryengritës. Këto forca nuk

po shkuleshin nga pozicionet e tyre megjithë zjarrin e pandërprerë të ushtrive mbretërore, të ndihmuara edhe nga artileria e flotës së huaj. Kryetoptanasi kishte mbledhur rreth tij bejlerët, agallarët e mëdhenj, bajraktarët, arhondët pasanikë, që përbënин kastën më reaksionare e konzervatore të vendit. Pashai u ngrit më këmbë me nervozizëm dhe, pasi vuri duart prapa, filloi të ecte poshtë e lart nëpër sallë duke vështruar herë pas here vendin ku zhvillohej beteja.

Megjithëse garda mbretërore e kishte rrethuar dhe po e mbante në arrest, Esad Toptani po bënte plane për t'ia filluar përsëri një puçi të ri. Duhej të merrej vesh me Serbinë. Të takohej me Pashiqin! Sa për Kosovën, atij i qe mbushur mendja se ajo fushë e madhe dhe e begatshme do të ishte shpërblimi më i madh për mbretin e serbëve.

Kosovën, Serbia ua kishte shkëputur fuqive të mëdha të Evropës, si shpërblim për luftrat që kishte bërë kundër Turqisë. Por nga Esad Toptani dhe njerëzit e këtij kallëpi mbreti dhe qeveritarët serbë kërkonin që këta çifligarë e sundimtarë t'i hidhnin ujë zjarrit dhe t'i bënин zap kryengritësit kosovarë kryeneçë. Esad Toptani po i mendonte e po i stërmendonte këto duke përcaktuar jo vetëm politikën e tij të jashtme por edhe të brendshme.

Njëri nga njerëzit e tij trokiti në derë. Esadi u kthye nga oficeri besnik dhe, pasi u shkëput prej mendimeve që po i zienin në kokë, pyeti:

— Ç'ka ndodhur, o djemtë e mi?

— Ka ardhur një zotëri i huaj — tha oficeri: — Kërkon të takohet më ju, shkëlqesi! E kemi futur në oborr.

Esadi hodhi menjëherë vështrimin posht dritäres dhe kur pa mikun e tij Baron Aliotin, të veshur me frak të zi, me monoklin mbërthyer pas syrit, tek po rrinte me kokën lart e të kthyer nga ballkoni i pallatit, i qeshi buza dhe e pushtoi një ndjenjë lehtësimi, iu duk sikur gjaku i ngrirë filloi t'i rridhte i ngrrohtë nëpër damarët e trupit. Ai e kuptoi se kishte shpëtuar!

— Po! — i tha Pasha oficerit — ky éshtë konsulli i Italise, miku im! Shkojmë, o djemtë e mi! Fati na buzëqeshi edhe kësaj here!

Pasi zbriti shkallët, Esad Pasha i zgjati dorën mikut të tij dhe e përqafoi me mallëngjim.

— Kërkesa juaj u pranua, shkëlqesi! — i tha baroni. — Ju tani jeni në dorë të qeverisë italiane!

Lutja për strehim politik, që Esadi i kishte kërkuar përfaqësuesit të qeverisë italiane në Durrës, ishte pranuar! Kjo shënonte një fitore të diplomacisë së krye-toptanasit.

— Largo hemi, o Pasha i madh! — i tha konsulli për ta ngritur moralisht mikun e tij, që rrezikohej të vritej.

Esadi me baronin dhe suitën e tij hypën në anijen italiane, kapiteni i së cilës dha urdhër për të ngritur ankorën nga skela e ndërtuar me dru.

Ekuipazhi i anijes e priti me nderime Pashanë, që parakaloi në revistë. Esadi, kur ktheu kokën prapa dhe pa Durrësin, i cili iu duk i shkretë ashtu i rrethuar nga telat me gjemba dhe moçalishtet, tha me vete: «Një komplot i madh që dështoi!» Por ai, si një njeri fodull, këmbëngulës, diplomat dhe dinak, nuk i humbi shpresat.

Pashai, i mbështetur pas parmakëve të vaporit, me vështrimin e zymtë drejtuar nga bregdeti që sapo vinte e largohej, i tha me ton të madhërishëm mikut të vet, Aliotit:

— Unë po iki, po ta dini se do të kthehem prapë! Kalin e Trojës e kam lënë brenda! Vilhelm fon Vidi éshtë i pazoti. Ai do ta dorëzojë froni!

## NË DURRËS BIE MJEGULLA

Vilhem fon Vidi iku përgjithmonë nga Shqipëria. Në Durrës pushtetin e mori turkomani Mustafa Agë Ndraqi. Turmat fshatare të armatosura silleshin qyteteve e fshatrave dhe shpeshherë ato vepronin sipas kokës së tyre. Në zyrat e kadastrës së Durrësit një turmë e revoluuar fshatarësh të armatosur, pa pyetur për krerët e tyre turkomanë, rrëmbyen me dhunë regjistrat e kadastrave të tokave, që i zotëronin bejlerët dhe agallarët, e i dogjën.

Esad Toptani, pas marrëveshjeve që bëri me qarqet politike të Romës u hodh në Athinë. Qeveritarëve të Athinës u bëri pretime, me anë të të cilave ai i linte dorë të lirë realizimit të qëllimeve të tyre për formimin e «Vorio-Epirit». Nga Athina, Pashai i Tiranës doli në Nish të Serbisë. Aty ai u takua dhe lidhi miqësi me kryetarin e qeverisë, Pashiqin, dhe zhvilloi bisedime sekrete me mbretin Pjetër. Pashiqi e Pjetri, të thyer nga hovi i parë i ofensivës austro-Hungareze, ishin tërhequr me repartet më të freskëta në Nish, me qëllim që të organizonin rezistencën ndaj ushtrive të dinastisë së Habzburgëve.

Esadi doli i kënaqur nga këto bisedime diplomatike. Ai e quajti një fitore të madhe ndihmën që i dha qeveria e mbreti i Serbisë për realizimin e qëllimit të tij, marshimin gjer në Durrës, marrjen e pushtetit, dhe fill pas kësaj shpalljen si mbret të Shqipërisë, qoftë edhe në një pjesë të saj.

Pashai toptanas nga Nishi hyri në Dibër dhe, sipas

marrëveshjeve me bajraktarët e vendit, ai mundi të rekrutonte me rrögë mbi katërmijë mercenarë, të cilët i armatosi me armët e municionet e furnizuara nga Pashqi e Kral Pjetri. Hordhia mercenare ia nisi marshimit nëpërmes grykave e maleve të Veriut për të arritur sa më parë në Tiranë. Ajo e cte pa pushuar asgjékundi, me qëllim që t'i gjente në befasi fuqitë e fshatarëve të armatosur, pjesa dërmuese e të cilëve u kishte ikur komandantëve të tyre të maskuar si esadistë. Gjithashtu Esadi nuk ishte i sigurt nëse forcat fshatare, që ndiqnin myftiun e Tiranës dhe turkomanin fanatic Mustafa Agë Ndraqin, që ishte shpallur edhe kryetar i pleqësisë së Durrësit, do të pranonin t'i dorëzonin atij pushtetin.

Hordhia mercenare, e komanduar nga bajraktarët e Dibrës, në krye të së cilës qëndronte si komandant gjenerali Esad Toptani, pasi eci për një kohë të gjatë, vendosi të pushonte vetëm një natë në Burgajet të Matit, tek sarajet e pinjollit të ri të zogollëve, Ahmet Zogut. Esadi ishte lidhur nëpërmjet krushqisë me zogollët. E éma e Ahmetit rridhete nga gjaku i toptanasve.

Pashai i Tiranës qëndroi në Burgajet për dy qëllime: të pushonte disa orë ushtria e tij dhe njëkohësisht ai të mësonte pikëpamjet politike të Ahmet Zogollit dhe të rrethit të tij. Esadi e kishte kuptuar, me atë intuitën e tij prej tirani dhe diplomati oriental, se diçka po bluhej në kullén e zogollëve. Ai, me mendjen e tij, e cilësonte Ahmetin si një kundërshtar të rrezikshëm për pushtet. Megjithëse ai kishte informata se pinjoli i ri i zogollëve po preqatitej dhe po bënte plane për të dalë një ditë në skenën e politikës shqiptare, prapëseprapë mendoi se biseda kokë më kokë mund të ishte frutdhënëse.

Pritja e zogollve në dukje paraqitej miqësore, por Esadit vazhdimisht nuk iu hoqën dyshimet e ndonjë kurthi të pabesë.

Bisedat që zhvilloi atë natë Esadi me Ahmet Zogollin jo vetëm që ishin të matura, por edhe të prera. Zogu i ri fliste pak, por edhe përgjigjet që jepte rreth pyetjeve të stërholluara e me kunja, që i bënte dajë Esadi, ishin mjaft të goditura. Zogu, në mënyrë të papërcak-

tuar, i premtoi atë natë Esad Pashës se do ta ndihmonte në operacionet që kishte nisur kundër rivalëve të tij dhe sidomos kundër turmave fshatare të armatosura që po ngrinin krye kundër zotërve të tyre.

Esad Toptani atë natë që bujti në kullat e Burgajetit nuk vuri gjumë në sy. Ai kishte porositur dy oficerët e tij më besnikë që të bënин roje përparrë shtëpisë dhe një grup besnikësh të rrinë pas dere. Ata mbanin armët gati për çdo të papritur. Ishte e qartë se Esadi dyshonte për ndonjë atentat nga Zogu e njerëzit e tij. Në sytë e pashait toptanas Ahmet Zogu i ri ishte një gjarpër i rrezikshëm, që po pregeteje ta kafshonte në çastin më të papritur dhe më të volitshëm. Esadit nuk i hiqej nga mendja ajo fjala e vjetër: «O zot, më ruaj nga miqtë se nga armiqtë ruhem vetë».

Të nesërmen Ahmet Zogolli u soll shumë i përzemërt dhe i afërt, sikur të mos ishte ai i natës së kaluar. Ai i kishte pregetitur dajë Esadit një nga të papriturat më të mëdha! Gjashtëqind pushkë matjane, të komanduara nga i vëllai i tij më i madh Xhelal Zogu, ishin radhitur në sheshin para kullës së vjetër me armët në sup. Kur doli në oborr Esadi, që të ndahej me nipërit e Matit, tabori i mercenarëve matjanë, i rreshtuar në formacion ushtarak, brohoriti: «Rroftë Esad Pashë Toptani! Rroftë Pasha!..»

Esadi, sa i hutuar nga e papritura, aq edhe i gjëzuar nga gjithë ato trupa që i vinte në dispozicion Burgajeti, vuri buzën në gaz dhe përshëndeti duke u ngritur dorën ushtarëve matjanë të njojur për trimëri. «Bijtë e mi shëndet paç!» — u tha Esadi dhe, për të shprehur mirë-njohjen ndaj të nipit, iu drejtua Ahmetit, që i rrinte fare pranë: — Të falem nderit, o nip! — Dhe e përqafoi mi-qësisht.

Në krye të ushtrisë mercenare Esadi arriti shumë shpejt në Tiranë, duke goditur fshatarët kryengritës fare në befasi. Turmat e armatosura fshatare, të tradhëtuara nga krerët turkomanë, të gjetura në befasi, u larguan në panik fshatrave përreth.

Esad Pasha ndeji pak ditë në Tiranë, se nxitonte për

në Durrës, atje ku ishte vendosur selia e qeverisë të kryesuar nga Mustafa Agë Ndraqi, që kishte marrë pushtetin pas largimit të Vudit nga Shqipëria. Qëllimi i Esadit ishte të merrte qeverinë në dorë dhe të shpalaj sundimtar i vendit. Kësaj pune ai ia arriti pa mundime, sepse qeveria e Mustafait përbëhej në pjesën më të madhe nga esadistë, që deri në atë kohë edhe nuk ishin të deklaruar. Kështu që Mustafa Agë Ndraqi, kryetari i qeverisë, ia dorëzoi me lehtësi frenat e pushtetit Esad Pashë Toptanit. Kon-sujt e fuqive evropiane në Durrës e njohën menjëherë qeverinë e Esadit, të cilin prej kohësh e kishin të vetin.

## KRYENGRITJA KUNDER ESAD PASHE TOPTANIT E KASTËS SË TIJ

Ngjarjet ishin rrokullisur me shpejtësinë e lumenje zhurmëmëdhenj pas shirave të mëdha. Në Durrës Esad Pashë Toptani, i kthyer me ndihmën e qeverisë serbe të Pashiqit e Kral Pjetrit, po punonte i etur për të forcuar e për të shtrirë sundimin e qeverisë së tij nëpër krahinat e Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut. Përsa u përkiste krahinave të Jugut, me sa dukej, Pashai as që çante kokën fare. Kjo kishte lidhje me bisedimet që kishte zhvilluar ai me qeveritarët e Athinës. Myftiu i Tiranës, që konsiderohej kundërshtari i qeverisë së Esadit, kishte hequr dorë nga kryesia e Këshillit të përgjithshëm të kryengritjes fshatare duke ia dorëzuar pushtetin Esadit, ashtu siç bënë në Shkallë të Tujanit edhe krerët e tjerë me Mustafa Agë Ndraqin në krye. Musa Qazimi kryeagjenti i xhonturqve, tani hynte e dilte në pallat të Pashës si në shtëpinë e tij dhe si shpërblim i nënshtrimit ndaj qeverisë së Esadit ai u emërua nënprefekt i Tiranës. Shumë nga fshatarët kryengritës, që ishin zhgënjer nga premtimet e krerëve të këshillit të përgjithshëm, kur kuptuan tradhëtinë dhe dorëzimin e pushtetit Esad Topitanit u tërroqën në panik nëpër shtëpitë e tyre. Ram Leka, Mal Xhoka dhe fshatarë të tjerë kryengritës sille shin me armë në dorë pyjeve e grykave duke përhapur fjalë në popull për rrezikun që kërcënonte fshatarësinë me rikthimin e Esad Toptanit në pushtet. Bejlerët e agallarët e mëdhenj të fshatrave filluan përsëri të vendosnin

taksa dhe të kërkonin borxhet e vjetra, sidomos kamatat e faizeve të papaguara.

Me kthimin e Esadit në krye të pesëmijë mercenarëve të rekrutuar në veri me paratë e Serbisë populli ishte shqetësuar. Thuhej se Esadi dhe bejlerët e tjerë do t'i detyronin fshatarët të shisnin tokat që i kishin në kufi me çifligjet e tyre. Gjithashtu bëhej fjalë edhe për krijimin e disa çifligjeve nga ana e qeverisë.

Përsa u përket ngjarjeve ndërkontaktore, fshatarët nuk dinin shumë gjëra; por shtrirja e Luftës së parë botërore edhe në tokat e tyre ishte tanimë e sigurt. Pas shai, i lidhur me Serbinë, ndillte fatkeqësi për vatanin.

\* \* \*

Le të kalojmë ca kohë më parë. Muzgu i mbrëmjes kishte mbështjellë si me një napë të errët fushën që shtrihet rrëzë kodrave të fshatit Sharrë. Kishte mbetur vetëm një fshatar, që po punonte ende me par mendë. Ai quhej Haxhi Qamili. Djersa i kullonte nga mjekra dhe këmbët e zbutura plasa-plasa i digjinin nga lodhja e tepërt, si kur të shkelte mbi thëngjij të ndezur. Haxhiu nuk i hiqte sytë nga brazda e arës që çante par menda dhe ai mekanikisht lëvizte pér të shpuar qetë e këputur nga puna pa ndërprerje e asaj dite të mërzitshme. Fshatarit i ziente koka nga mendime të ndryshme, të turbullta, të mjer-gullta dhe shqetësuese. C'duhej të bënин fshatarët tani pas kthimit të papritur të Esadit?

Prej kohësh Esadi dhe bejlerët e tjerë ia kishin vënë syrin fushës pér të zgjeruar çifligjet e tyre. Dhe ja, tashti Esad Toptani kishte sjellë me vete pesëmijë basibozukë e bajraktarë nga veriu, të cilët do t'u binin fshatrave. Haxhi Qamili kujtonte të kaluarën, dhunat, vrasjet që kishin kryer bejlerët në këto fshatra. I ati i tij, Qamil Meta, pas kthimit nga ushtria si bedel i djalit të Galip Beut, i detyruar nga qahajai, kishte hyrë si shërbëtor në sarajet e Esad Toptanit në Lëprakë. Qamili

i kishte treguar të birit ngjarje të shëmtuara që kishin ndodhur në derën e toptanasve.

Haxhiu i ri, që nga natyra ishte një fëmijë i myllur në vetëvete, prej kohësh regjistronte në kujtesë gjithshka thuhej pér punët e poshtra që kryenin në popullin e varfër bezlerët. Bile njëherë, kur sa po kishte mbushur të katérmbëdhjetat, ndërsa i ati po u tregonte pér një poshtërsi të beut toptanas, ai ishte ngritur më këmbë dhe, me një shpërthim të papërbajtur, kishte goditur me sopatë sofrën, ku po hanin darkën, duke bërtitur: «Ju shoftë boja bezlerëve. Ja, me këtë sopatë, do t'ua pres kokat bezlerëvet!» Të atit i kishte ngecur kafshata e misërnikës në <sup>+</sup>. Kur u rrit, Qamil Xhameta pa me sytë e vet poshtësitet që bënин bezlerët. Atij i pikonte në zemër pér gjendjen e vajtueshme të fshatarëve të varfër, që vuani të zitë e ullirit.

Dhe ja, tashti Esad Toptani dhe qeveria e tij e bezlerëve po u vinin përsëri lakun në fyt fshatarëve. Kështu po arësyetonte Haxhi Qamili me vete. Një grumbull harrabelash të trembur fluturuan mbi kokën e tij dhe fshatari sikur u zgjua nga gjumi, hodhi par mendën tutje dhe foli me zë: «Dhe ti, o Haxhi Qamil, o kokëthartuar rri në fshat pas bishtit të kaut! ?» Pasi i zgjidhi qetë dhe i lëshoi të kullotnin lirisht ku të donin, ai filloj t'i ngjitej me vrap së përpjetës drejt fshatit.

Haxhi Qamil Xhameta njihej nga bashkëfshatarët si burrë trim, bujar dhe i ndershëm. Ai, që atë natë, bisedoi me burrat e fisit të tij dhe i ftoi disa prej tyre t'i shkonin pas. Haxhi Qamili ua shfaqi haptaz qëllimin e tij bashkëfshatarëve: të sulmonin Tiranën, dhe të ngrinim krye kundër qeverisë së Esad Pashë Toptanit.


Atë natë Haxhi Qamili bëri pér vete dy mbëdhjetë fshatarë të armatosur, të cilët, të lidhur besa-besë, nën udhëheqjen e fshatarit mjekërosh vendosën të sulmonin zyrat e qeverisë së Esad Pashë Toptanit në Tiranë. Me t'u errur, kryengritësit, të vendosur në një shkolonë, nën udhëheqjen e Haxhi Qamilit, zbritën kodrave të Sharrës dhe u nisen drejt fushës së Tiranës. Kur mbërriten në fushën e Shallvares, Haxhi Qamili dha urdhër që të që-

llonin me armë në drejtim të qytetit. Britmat e luftëtarëve corrën qetësinë e natës duke u përhapur fushës. Çeta kryengritëse bëri dhe një ndalesë prej disa minutash pranë mureve të xhamisë së vjetër në hyrje të pazarit. Haxhi Qamili kishte trilluar një rrëng. Pëllumbi, me urdhër të komandantit të çetës, ia dorëzoi armën e gjatë shokut pranë dhe me vrap pëershkoi rrugicën me kall-drëm derisa doli para zyrave të nënprefekturës duke thirrur si i çakërdisur: «Haxhi Baba me pesëmijë fshatarë hyni në Tiranë! Po plaçkisin pazarin! I vunë zjarrin sajjeve të bejlerëvet! Ja mbërrijtën, ja mbërrijtën mu para zyrave të qeverisë!»

Xhelal Zogu me xhandarët e tij liruan nënprefekturën dhe, në një panik të vërtetë, ua mbathën në pikë të vrapit përtej qytetit. Me të zbardhur dita, ata kishin ikur dy orë larg Shkallës së Tujanit, në drejtim të Burgajetit të Matit.

Çeta e fshatarëve kryengritës të Haxhi Qamilit pushtoi zyrat e qeverisë së nënprefekturës. Tërë natën, derisa zbardhi mirë dita, fshatarët kryengritës qëllonin me pushkë kot së koti pér të dhënë përshtypjen se përjashta në rrugë po bëhej batërdia. Të nesërmen fjala mori dhenë. Qytetarë të thjeshtë, armiq të betuar të Esadit, vinin turma-turma pér të përhëndetur clirimtarin e Tiranës, Haxhi Qamilin. Korrierët u nisën fshatrave. Po atë ditë nga fshatrat e krahinës së Pezës, grykës së Erzenit, rrëzës së Dajtit dhe deri fshatarët e Fushë Krujës u derdhën me qindra e mijëra pér në Tiranën e cliruar. U desh vetëm një shkëndijë që të ndizte barutin e derdhur hapësirave të fshatrave.

Valë-valë ngriheshin fshatarët dhe ndiqnin pas Haxhi Qamilin, dhe kryengritja e armatosur e fshatarëve brenda pak ditëve u përhap në të gjitha krahinat e Shqipërisë së Mesme, në Tiranë, Shijak, Fushë Krujë, Bregun e Matës, në Kavajë, Peqin, Fushë Myzeqe dhe në malësinë e Tiranës e të Çermenikës. Emri i Haxhi Qamilit apo Haxhi Babës u bë i njobur nga fshatarësia dhe urdhërat e tij bëheshin ligj pér të gjithë. Esad Pashë Toptani e qeveria e tij mbetën të izoluar në Durrës, të mbrojtur nga telat me gjemba.



\*  
\* \*

Ram Leka njihej familjarisht prej kohësh me Haxhi Qamil Xhametën. Gjatë viteve të fundit ata shpesh takohen në bisedonin. Për kryengritjen kundër Vudit dhe qeverisë së tij të pashallarëve, ku bënte pjesë edhe ministri Esad Pashë Toptani, ata kishin qenë të një mendimi, por kur bisedohej pér flamurin kuq e zi, pér intrigat e komplotet e myftiut të Tiranës kundër pavaresisë së Shqipërisë, mendimet e tyre ndaheshin. Haxhi Qamili e quante flamurin me zhgabën dykrenare flamurin e nemces, kurse flamurin me gjysmë hënë e pranonte si flamurin e fesë muslimane. Sa pér punën e «Vorio Epirit» ata i dënonin grekët, të cilët donin të shkëputnin tokat e Jugut nga vatani. «Bandat greke t'i luftojmë pa mëshirë» thoshte ai. Pas kthimit të Esadit në Durrës, Haxhi Qamili filloi ta urrente myftiun e Tiranës dhe ta quante atë tradhëtar, sepse kishte pranuar t'i jepte toptanasit pushtetin dhe të bëhej nëpërës i qeverisë së tij.

Në fushën e Shallvares kishin ardhur edhe pishtarinjtë. Mal Xhoka nuk po merrte pjesë në festën që po bëhej aty dhe në qëndrimin e tij dukej se diçka e shqetësonë.

Papritur fshatarët e armatosur i hapën rrugën një grupi njerëzish të armatosur, në krye të të cilëve ecte si fortunë myftiu shkurtabiq, Musa Qazimi.

Një pjesë e fshatarëve, sidomos të moshuarit, e nderasuan me respekt duke vënë dorën në zemër, kurse të tjerët me sy të ngrirë hodhën vështrimin nga Haxhi Baba, i cili me frenat e karrocës në dorë kishte ndaluar në mes të fushës duke i dalë përballë myftiut.

Pas një çasti, myftiu më këmbë dhe Haxhi Baba në pajton, veshur me uniformën e gjeneralit, po qëndronin fare pranë njëri-tjetrit duke u vështruar sy më sy për disa minuta.

Fshatarët e armatosur po prisnin me ankth që midis tyre të ndodhë ndonjë e papritur. Mendohej se do të ishte Haxhi Baba ai që do të nxirrte nagantin dhe do ta

qëllonte myftiun tradhëtar, që i kishte rënë ndër këmbë Esad Pashës.

Hoxha me çallmë të bardhë në kokë, i veshur me xhybe të zezë dhe me nagant në brez, pas vështrimeve të dyshimta, hapi krahët dhe, duke buzëqeshur, thirri:

— Dëgjoni, vëllezër! Këshilli i përgjithshëm i kryengritjes sot paradite, në mbledhjen e tij të parë, emëroi komandant të Ushtrisë kryengritëse fshatare, Haxhi Qamil Xhametën! Rroftë Haxhi Qamili! — Brohoritjen myftiu e bëri me zë të lartë dhe me një ton të madhërishëm.


Fshatarët, që e respektonin myftiun si të parin e fesë muslimane, nga gjëzimi që ai po pajtohej me Haxhi Qamilin, komandantin e tyre, ia kthyen duke bërtitur pa radhë... — Rroftë... rroftë... Haxhi Qamili!.. Rroftë Haxhi Baba komandanti ynë!

Haxhi Qamili e kuptoi se kundërshtimi i tij për të mos u pajtuar me myftiun dhëlpërak, do të krijonte pakënaqësi e përçarje në radhët e fshatarëve kryengritës. Ai, me një buzëqeshje të shtirë, me sytë përdhe, pa zbritur nga karroca, ashtu në këmbë, e shtërngoi me inat dorën e zgjatur të myftiut.

Musa Qazimi atë ditë kishte mbledhur disa nga ish-anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm që gjindeshin në Tiranë dhe shpejt e shpejt kishin marrë vendimin e emërimit të Haxhi Qamilit si komandant i Ushtrisë fshatare kryengritëse. Ai e dinte mirë se ky emërim dhe Këshilli administrativ i përgjithshëm ishin krejtësisht formalë, sepse Haxhi Qamili dhe fshatarësia kryengritëse, që tani kishin ngritur krye kundër Esad Pashës dhe bejlerëve, nuk e përfillnin atë dhe bënин sipas kokës së tyre.

\*  
\* \*

Ditët që pasuan, Haxhi Qamili komandant i Ushtrisë kryengritëse fshatare, u muar me pastrimin e qytetit nga bejlerët dhe nëpunësat e miqtë e Esad Pashë Toptanit. Disa prej tyre edhe i burgosi. Forcoi pushtetin e fshata-



rëve. Në zyrat e nënprefekturës emëroi nëpunës, të cilët përkrahnin kryengritjen fshatare. Nxori urdhëra për të mos paguar faizin. Sekuestroi pasurinë e bejlerëve dhe të nëpunësve të qeverisë së Esad Pashë Toptanit, duke i kthyer ato në prona shtetërore. Vendosi qetësinë dhe ndaloi rreptësish vëllavrasjen. Vjedhësit dënoheshin rënëndë me prerjen e dorës së djathë. Në krye të një grupei fshatarësh të armatosur, që i mbante pas ngado që shkonte, me hunj zjarri të ndezur përshkoi qytetin anembanë duke lajmëruar më përpara arësyet përsë do të digjeshin sarajet e Esad Pashë Toptanit te stani i Gogëve dhe kullat e tij në Laprakë.

\* \* \*

Sarajet e Esad Pashë Toptanit thoshin se ishin ndërtuar dyqind vjet përpara. Dy herë ustallarë të ardhur nga Dibra u kishin bërë riparime dhe shtesa këtyre sara-jeve. Herën e dytë punimet i drejtoi një mjeshtër italian. Esad Toptani trashëgonte nga të parët e tij dy palë shtëpi të mëdha: sarajet te stani i Gogëve ndërtuar në rrëzë të kodrave e të Selitës dhe kullat e Laprakës në pjesën jug-perndimore të fushës së Tiranës. Mbi pullazet e mbuluara me tjegulla të kuqe evrope ngriheshin shumë oxhaqe të larta që dukeshin nga çdo anë e qytetit. Populli kurrë nuk guxonte të ndërtonte shtëpi me oxhaqe si bejlerët.

— O burra pas meje — thirri një kryengritës fshatar mjekërosh që me pishën e ndezur në dorë u nis në drejtim të kodrave.

Një grup fshatarësh të rrethuar, që sic duket e kishin komandant, e ndoqën nga pas.

— Ku po shkojnë, pyeti Mal Xhoka njërin nga këta trima, që kishte mbetur prapa nga shokët.

— Te stani i Gogëve! — tha ai. Të djegim shtëpitë e bejlerëve dhe t'i bëjmë shkrumb e hi.

— Si? — i thirri Asllani picalliotit.

— Do të djegim sarajet e Esad Pashës, more! — u

përgjegj ai duke shpejtar që të kapte shokët e tij që iknin si furtunë me pisha të flakëruara nëpër duar.

— A shkojmë edhe ne me ata? — e pyeti Asllani komandantin e kryengritësve të Pishtarit. Për të luftuar e pér të shkatërruar bejlerët kemi zbritur në qytet.

— Të nisemi që ç'ke me të tha Mali dhe ja bëri me dorë shokëve që ta ndiqnin. Pa humbur kohë pishtarët me pushkët në sup u turrën në drejtëm të sarajeve të krye-toptanasit.

Fjala pér djegjen e sarajeve të Esad Toptanit u hap në qytet si zjarri në pyll. Berberët e përhapën të parët këtë lajm.

Mbyllni qepenet e dyqaneve — u dha urdhër Rrem Akshiu kovaçëve që ishin në dallgën e punës.

— Po djegin sarajet e Esad Toptanit — i tha Rerema si i çakërdisur mikut që kishte në krah, Safet argjentarat, një burri të moshuar me një fytyrë të ngjallur.

— E mora vesh! Fundi i botës! — tha tregëtari i arurinave që mbante xhaketë, pantallona dhe një fes të ri kadicifeje në kokë. — Me fshatarët po bashkohen lapangjozët, cirakët, e fukarenjtë e qytetit — tha përsëri ai.

Te sheshi i pusit ishin mbledhur një turmë qytetarësh me sytë që u shndrisnin nga urrejtja. Disa prej tyre kishin nëpër duar shpata e thika, kazma e shkopinj, aty-këtu dhe pushkë të gjata e naganta me mulli. Të gjithë mbanin qeleshe të bardha, brekushe të zeza dhe breza të kuq lidhur fort pas mesit.

— Rroftë kryengritja! — bërtiti një cirak furxhi dhe ngriti pushkën lart.

— U lumtë fshatarëve që rrrokën armët.

— Poshtë Esad Toptani dhe bejlerët — ja priti një djalosh i bëshëm që punonte te një hanxhi si nallban.

Treqind vjet nuk guxoi njeri të ngrejë dorën kundër Toptanasit — tha tregëtari i arurinave me sytë e hapur jashtë mase, duke iu drejtuar Rremës që rrinte fare i shastisur.

— Ikim sa më shpejt që këndeje, se na piu e zeza!

— Kanë ardhur kohë të vështira — iu përgjegj nëpër dhëmbë Safet argjëndari duke kapsallitur sytë.

Turma qytetarësh që e mësuan ngjarjen u derdhën drejt sarajeve të Esad Pashë Toptanit për të bërë sehir flakën që tanimë dukej nga të gjitha sokaqet e qytetit. Shtëpitë e ulta prej balte aty pranë sarajeve reflektonin ngjyrën alle të zjarrit, që sa vinte shtohej dhe dukeshin sikur fryheshin dhe lartësoheshin.

Turma të reja qytetarësh ja befën përpëra sarajeve të Esadit dhe u përzjenë me fshatarët kryengritës. Disa prej tyre akoma hynin e dilnin në kthinat e poshtme të sarajeve me pishat e ndezura në duar, për të gjallëruar edhe më shumë zjarrin.

Në mesin e turmës së revoltuar të fshatarëve qendronte Haxhi Baba me fytyrë të ngazëllyer. Ai herë-herë qeshte me vete dhe pastaj përsëri binte në mendime. Ai po shihte me sytë e tij se sa përshtypje u kishte bërë njerëzve kjo skenë.

Kullat e feudalit të kredhura në zjarr e flakë po fillonin të shembeshin përpëra popullit.

Së pari ishin rrafshuar magazinat e çiflikut. Flaka dilte si gjuhë e madhe nga dritaret dhe pullazi i drunjëtë i sarajeve kërciste. Aty-këtu filluan të bien trarët që mbanin çatinë. Dritaret me ornamente gdhendur në dru, binin për tokë me zhurmë.

— Rroftë Haxhi Baba! — thirri një fshatar me zë kumbues.

— Rroftë kryengritja fshatare!

— Poshtë Esad Pashë Toptani!

Njerëzit morën guxim dhe tani që po shikonin me sytë e tyre kullat e paprekshme shekullore të Esad Pashë Toptanit në valën e flakëve e të zjarrit, nuk pyetën më për asgjë. Të revoltuar thërrisin, brohorisin dhe shanin me çmundnin bejlerët dhe Esadin.

Më në fund çatia e sarajeve të Esadit ra për tokë duke tërhequr me vete dhe një pjesë të mureve. Në fillim u ndje një zhurmë e llahtarshme, pastaj u ngrit një re pluhuri.

Haxhi Baba me sytë e perënduar qendronte në vend si statujë dhe nga reflektimi i flakës dukej i kuq si gjaku.

Mal Xhoka që rrinte mbi murin e rrënuar ngritë pushkën lart dhe qëlloi tri herë.

— Të lumtë — tha Haxhi Baba që e miratoi veprimin e tij.

Pas kësaj edhe qytetarët kryengritës të bashkuar me luftëtarët e zbritur nga fshatrat, filluan të qëllonin me pushkë.

Haxhi Baba priti sa ra për tokë pullazi i sarajeve, pastaj mblodhi pas trupit pallton e tij të madhe që i vinte deri në fund të këmbëve dhe u nis për në qytet. Ai tanë e cte me hapa të ngadalta dhe pak si i menduar. Ushtarët e tij u mblodhën sa hap e mbyll sytë dhe filluan të ecnin të rreshtuar pas tij. Ai ndaloi një çast në një bregore dhe thirri me zë kërcënues.

— Burrani të shkojmë pa filluar nata në Laprakë. Të djegim edhe atje sarajet e dyta të Esad Toptanit.

— Të mos i mbetet fara bejlerëve. T'i djegim dhe t'i shuajmë përgjithmonë filluan të thérresin kryengritësit si në kor. Bashkë me shokët e tij të Pishtarit, Mali ishte vënë të arrinte urdinë e Haxhi Babës me hunj zjarri në-për duar.

Tërë atë natë tiranasit soditën sarajet e Esad Pashe Toptanit. Skena e djegies së sarajeve do të mbetej e parharuar për gjithë jetën e tyre.


Djegia e sarajeve të Esad Toptanit në Tiranë pati jehonë në tërë qytetin dhe në të gjitha krahinat e vendit. Ky akt ishte një kushtrim lufte.

Pas kësaj ngjarjeje mijëra fshatarë nga të gjitha anët zbritën në Tiranë, Shijak, Kavajë, Peqin, Elbasan dhe u turrën kundër qeverisë së bejlerëve të kryesuar nga Esad Pashë Toptani.

Asokohe Tirana u bë kryeqyteti i kryengritjes fshatave. Tirana kishte rreth 'pesëmbëdhjetë mijë banorë, plus qindra mijëra luftëtarë që vinin e shkonin.

Vala e kryengritjes fshatave, po përhapej në të gjitha krahinat e vendit, veçanërisht në ato të Shqipërisë së Mesme.

Djegia e shtëpive të mëdha të Esad Toptanit, Fuad Toptanit dhe bejlerëve të tjera, pati një jehonë të madhe




në popullin e qytetit dhe në të gjitha krahinat e Shqipërisë së Mesme. Sipas Haxhi Qamilit djegia e shtëpive të bejlerëve rriste shpirtin luftarak dhe urrejtjen e fshatarëve kundër tyre. Kur flaka po ngrihej në qiell dhe sarajet e Esad Pashë Toptanit të pushtetshëm dhe të parprekshëm po binin e po rrenoheshin nga themellet, Haxhi Qamili, duke ngritur lart hurin e zjarrit, bërtiti: «Tashti e gjeta». Dhe, me këtë shprehje ai pati parasysh mënyrën që duhej të përdorte për t'u dhënë zemër e guxim turmave fshatare në luftën e tyre kundër pushtetit të Esad Pashë Toptanit dhe të bejlerëve të tjerë.

Një javë pasi u dogjën sarajet e bejlerëve në Tiranë kryetari i qeverisë, Esad Toptani, nga Durrësi i rrethuar i dërgoi një letër nënprefektit Abdulla, ku e urdhëronte të arrestonte dhe të dënonte rreptë Haxhi Qamilin duke e akuzuar «ihrok, katël, tebdil Hyqymet» tri pika këto të kodit penal turk që e dënojnë fajtorin me litar. Në fund të letrës pashai shkruante se nga inati e zemërimi nuk kishte mundur të mbyllte sytë tri net me radhë. Nënprefekti ishte prej kohësh një simpatizues i kryengritjes fshatare, por këtë e kishte mbajtur fshehur. Me hyrjen e fshatarëve kryengritës në qytet, ai deklaroi haptazi se e urrente Esad Pashë Toptanin dhe kastën e bejlerëve.

Nënprefekti kryengritës ia tregoi letrën Haxhi Qamilit. Pastaj të dy, kokë më kokë, hartuan përgjigjen që do t'i kthenin Esad Toptanit.

Topçiu Mehmet Shega në krye të një skuadre luftetarësh u nis për në Durrës për t'i shpënë përgjigjen Esadit. Ai e vendosi topin mbi bregun e mullirit dhe me saktësi qëlloi tri herë me top pallatin e pashës në Durrës. Një nga sekretarët me shkollë që mbante pas e informoi Haxhi Qamilin për myftin e Tiranës që kishte tërhequr një shumë të madhe florinjsh nga Esad Toptani, si shpërblim për bashkëpunimin e tyre në dorëzimin pa armë të Shkodrës në kohën e Luftës ballkanike.

Thuhej se këto ishin dymbëdhjetëmijë napolonat flori që mbreti i Malit të Zi i kishte dhënë si shpërblim Esad Toptanit, komandantit të ushtrive në Shkodër, për dorëzimin e qytetit.



Lajmet e ardhura në shtabin e Haxhi Qamilit bënин fjalë për lëvizjen e një ushtrie të Esad Toptanit, e cila, duke kaluar nëpër Ishëm, kishte si qëllim të sulmonte Tiranën nga prapa. Ajo po qëndronte ende aty, sepse prishtë të vinin forca matjane të Zogollit nga Burgajeti nëpër Krujë dhe së bashku të fillonin sulmin.

Haxhi Qamili, me të hyrë në fushën e Ishmit, u dha urdhër një grupi fshatarësh që t'u vinin zjarrin mullarëve të barit, mullarëve të kashtës dhe kasolleve të barinjve. Gjysmë ose pasi u lëshua ky urdhër, fusha digjej tym e flakë dhe me sa u muar vesh më vonë, forcat armike esadiste, të përqëndruara në kalanë e Ishmit, ishin tmerruar nga përshtypja e një ofensive të jashtëzakonshme nga ana e rebelëve fshatarë të udhëhequr nga Haxhi Qamili.

Grupet e fshatarëve përparonin me shpejtësi drejt Ishmit, duke çarë përmes tymit e flakës fill pas komandantit të tyre trim e sypatrembur, Haxhi Babës. Dhe, ndërsa po britnin: «O burra përpara! Bini armikut! Hyxhym, hyxhym! T'i zëmë me dorë, me dorë!» çanin me guxim drejt fushës, duke kërcyer rrëketë dhe rrënjetë e pemëve të vjetra. Ata fundoseshin deri në kyçet e këmbëve të veshura me opinga lope në moçalishten, e cila ishte bërë llucë nga shirat e pandërprrera të javës së kaluar. Mushkonja e lloj-lloj insektesh fluturonin me vrull nëpër atmosferë dhe shumë prej tyre përplaseshin mbi fytyrat, duart dhe trupin e fshatarëve kryengritës. Krismat e pushkëve përhapeshin fushës që shtrihej deri nëdet.

Forcat mercenare, që ishin rekrutuar me rrogë nga Esad Toptani, nuk e duruan dot rrebeshin e asaj furtune që po afrohej nga çasti në çast, por të frikësuara në palcë, për të shpëtuar lëkurën, i braktisën pozicionet dhe i mbathën në pikë të vraptit buzë detit për t'u têrhequr sa më parë në strofkën e tyre, në Durrësin e mbrojtur nga topat, dhe nga vaporet luftarake të huaja, që i kishin ardhur në ndihmë Esad Pashë Toptanit.

Kurse forcat e Burgajetit, me të dëgjuar thyrjen e turpshme të Esadit në Zezë, nuk hynë fare në Krujë, por për têrë natën u kthyen në kështjellën e tyre.

Në këtë luftë, trimëria dhe aftësia ushtarake e tre-guar nga Haxhi Qamili e rritën shumë personalitetin e tij në sytë e fshatarëve kryengritës. Fshatarët e Fushë-Krujës, të fushës së Ishmit dhe deri ata të bregut të lumi Mat u cuan të gjithë dhe u radhitën në ushtrinë kryengritëse fshatare të udhëhequr nga Haxhi Qamili. Në Krujë Haxhi Qamili dogji teqen e bektashinjve, duke u nisur nga fakti se vetëm sekti syni, përfaqëson fenë islamë.

Tokën ua shpérndau fshatarëve të varfër, Dervishë-ve e babait, të cilëve u ruajti mjekrat, u la aq tokë sa për të jetuar. Kopetë e bagëtive i sekuestroi duke i bërë pronë të shtetit. Në Krujë u emërua nënprefekt Alushi, i vëllai i vjehrrit të tij nga fshati Borizanë. Në sheshin e kështjellës së vjetër të Skënderbeut, Haxhi Qamili gjykoi vetë në prani të popullit kruetan Cen Kupin, vëllain e Abaz Kupit, i cili kishte luftuar përkrah Esad Toptanit në betejën e fshatit Zezë. Vendimi me vdekje u ekzekutua nga vetë ai që e gjykoi, nga Haxhi Qamili.

Në fshatin Kurbin të Fushë-Krujës, Haxhi Qamili bisedoi me fshatarët për vëllazërimin midis të krishterëve e myslimanëve që luftojnë kundër bejlerëve. Manastirin e Kurbinit ai e dogji njëloj si teqet e bektashive dhe tokën ua shpérndau të varfërve. Klerikët duhej të punonin si gjithë të tjerët. Ai i urrente parazitët. Të nesërmen, Haxhi Baba në krye të ushtrisë së tij shaluar pelës së bardhë u nis për në Milot. Sapo hyri në zyrat e këshillit të kryengritjes së Milotit, ai dha urdhër që të shkonin dy lajmëtarë në fshatin Vrinjoll dhe të thërrisin Aliun e Lam Asllanit dhe Manin e Mustës, dy kaçakë të mëdhenj që kishin kryer disa vrasje për hakmarrje dhe kishin pasur një farë bashkëpunimi me forcat esadiste. Për habinë e milotasve, të nesërmen në kohën e drekës u dorëzuan në zyrat e qeverisë së kryengritësve fshatarë dy kaçakët më trima dhe më të dëgjuar të atyre krahinave. Ata rrinini para Haxhi Qamilit me armë në dorë dhe kokë-varur.

Komandanti i ushtrisë fshatare Haxhi Baba i qortoi për punët e tyre të këqia dhe dha urdhër që të dorë-zohen armët.

— Merre pushkën, o Haxhi Baba! — i tha Mustakur pa se shoku i tij e hodhi armën pér tokë. — Nuk e di se si zoti na i mori mendtë dhe u dorëzuam si bagëtia!

— Unë ju çarmatosa pér të çue në vend benë — ia pat Haxhi Baba dhe ndërkokë iu afrua shokut të tij Zenel Shelqisit, të cilit i tha:

— Jepuni armët tuaja Mustës dhe Aliut të Lam Asllanit, — dhe duke u kthyer nga kaçakët shtoi: — Këto pushkë që dorëzuat ishin të Pashës, kurse këto janë armët e kryengritjes fshatare. Dhe tashti, të niseni vetë pér në Tiranë dhe t'i thoni drejtorit të burgut t'ju fusë brenda! Kur të kthehem në Tiranë, punën tuaj do ta gjykoj vetë. Hajde, nisuni tashti!

Të dy kaçakët e Milotit të pashoqëruar nga rojet, vajtën me këmbët e tyre në burgun e Tiranës. E éma e Lam Asllanit i doli pérpara Haxhi Qamilit, duke iu lultur pér djalin e saj që të mos e vriste. Ai i tha nënës plakë që të kthehej e qetë në shtëpi dhe të mos kishte fare merrak pér djalin, se Baba nuk i vret trimat. Ata duhet të kryejnë një farë dënim.

Nga Miloti Haxhi Baba u nis me ushtrinë e tij pér në Ishëm. Rrugës duke kaluar nëpér fshatrat, populli i dilte pérpara dhe e pérshëndeste me pérzemërsi çlirimtarin. Kudo që shkelte këmba e tij, fshatarët rrëzonin kryepleqtë dhe zgjidhnin këshillin e kryengritjes që quhej qeveria e fshatarëve. Në Ishëm Haxhi Qamili nuk pati dhe aq punë, se fshatarët i kishin qëruar vetë hesapet me pushtetin e Esad Pashë Toptanit. Mësuesi i fshatit Xhafer Zelka, që kishte ardhur nga Tirana iu afrua vullnetarisht Haxhi Babës, i cili e emëroi sekretarin e tij.

Pas dy ditësh Haxhi Qamili u largua nga Ishmi. Populli i armatosur e përçollti komandantin deri jashtë murave të kalasë. Një djali dymbëdhjetëvjeçar tërhiqte nga dora plakun e verbër shtatëdhjetëvjeçar Dan Rahmanin, i cili ecte në krye të turmës, që kishte dalë të përcillte komandantin e ushtrisë fshatare. Një natë pérpara ai kishte biseduar me Haxhi Qamilin gjatë e gjerë pér punët e qeverisjes në fushën e Ishmit. Kur komandanti i kryengritjes ngriti dorën, turma që po e ndiqte pas qëndroi

në vend. Ai vuri dorën në supin e plakut aty pranë dhe tha: — Mbetshi me shëndet! Qeverisni me drejtësi. Hapni sytë, e mos lejoni më të kalojnë këndejej bejlerët. — Pastaj iu drejtua Danit. — Ti je plak dhe 'pa sy, por veshët i ke pipëz dhe i dëgjon e i kupton të gjitha punët. Ty të lë zëvendësin tim, dhe të ngarkoj për të drejtuar punët e qeverisë së halisë së këtij vendi. Nuk dua të dëgjoj grindje e përçarje midis fshatarëve dhe as prapësira! Hajde, të mirë u pafshim!

Nga Ishmi, Haxhi Qamili u vendos në kullat e Veli Bej Jubës, dhëndrrit turk të Esad Toptanit, në Kamëz. Bujqit e priten me nderime të mëdha.

Haxhi Baba, me litar në dorë, filloi të maste tokat e Veli Beut dhe pas çdo matjeje u thoshte bujqve që i shkonin nga pas: Kjo është toka jote. Ta gëzosh e ta hash me shëndet!»

Ndarja e tokës së bejlerëve në Kamëz pati një jehonë të gjerë në shumë çifligje dhe bujqit, që kishin 'punuar shekuj me radhë për llogari të bejlerëve, tani panë se mund të vinin dorë mbi tokat e pronarëve.

Një bujk i tha Haxhi Babës se Man Picari, komandanti i një urdie të fshatarëve kryengritës kishte përvetësuar një trastë me mexhide të bardha argjendi nga kasa e Veli Bej Jubës.

Sipas urdhërit të rreptë të Haxhi Qamilit paratë e grabitura nga kasat e bejlerëve duhej të regjistroheshin dhe të hynin në buxhetin e shtetit. Ai e thirri Man Picarin para shtabit dhe i kërkoi llogari për shkeljen e ligjit të halisë. Mani e pranoi fajin. Haxhi Baba, i zemëruar, nxori nagantin nga brezi dhe për pak e qëlloi në kokë. Një fshatar i armatosur nga të këshillit ia kapi dorën komendantit dhe e ndaloi të kryente vrasjen. Fshatari i tha me zë të ulët në vesh: — Haxhi Baba, fale kësaj here! Mani është penduar. Atë e kemi shokun tonë.

Haxhi Qamili e pranoi këshillën e fshatarit dhe me sy të skuqur nga inati e futi nagantin në brez, duke menduar se vrasja e Man Picarit mund të sillte përçarje në radhët e tyre dhe se gjyqi do t'i vinte mend për jetë atij. Man Picari, i njohur për trimëri, po qëndronte i heshtur

dhe i bindur duke pritur me gjakftohtësi dënimin. Shpërthimeve, zemërimit dhe vendosmërisë së Haxhi Qamilit, i bindeshin të gjithë.

Në Shënavlash të Durrësit Haxhi baba, pasi i qëroi hesapet me bejlerët dhe kontrolloi forcat e armatosura që do të sulmonin Durrësin, u nis me shpejtësi për në Shijak. Treqind shpirt i shkonin pas Haxhi Babës, Komendantit të kryengritjes fshatare. Këta ishin fshatarët më besnikë dhe më trima të ushtrisë së kryengritëse. Përveç punëve të tjera, në Shijak Haxhi Baba; në prani të popullit, hodhi nga bregu në pellgun e lumiut të Erzenit gurin e shenjtë. Në këtë «vend të mirë» vinin nga ana e anës gratë shterpe dhe fërkoheshin tek guri, i cili, sipas dervishëve kishte cilësi t'i ndihmonte. Njerëzit detyroheshin t'i paguanin të holla ose prodhime me natyrë teqes, që i shërbente «gurit të mirë». Atë ditë kur e hodhi gurin e mirë në lumë Haxhi Qamili tha:

— Dëgjoni, popull! Po të jetë «guri i mirë» le të dalë prapë në breg.

Dervishin që merrej me shërbimin e «gurit të mirë» e shtroi në hu përpara njerëzve. Që nga ajo ditë nuk u dëgjua më «guri i mirë». Ai jo se nuk besonte paragjykmet fetare, por këto i luftonte kur kishin të bënин me grabitjen e shfrytëzimin e fshatarëve.

Në të kthyer për në Tirana, Haxhi Qamili ndehti një natë në Ndraq. Ai u çudit se si ende aty në fshat qeveriste çifligun dhe ullishtat e tij i vëllai i Mustafa Ndraqit, Ibrahimini i cili, kohët e fundit, si gjithë agallarët e mëdhenj, ishte lidhur shumë me Esad Pashë Toptanin. Me urdhër të komendantit Ibrahimin e Stafën i arrestuan dhe duarlidhur i dërguan në burgun e Tiranes, për t'i gjykuar. Ullishtat e agallarëve të Ndraqit u sekuestruan nga qeveria e halisë.

Kryengritja fshatare kundër qeverisë së Durrësit të Esad Toptanit dhe feudalëve të tjerë të Elbasanit, Beratit dhe bejlerëve të Kavajës, Myzeqesë e tjerë tanimë ishte përhapur si lavë vulkani, duke përlarë çdo gjë që dilte përpara.

Haxhi Qamili vepronte sipas kokës së tij dhe nuk e

pyeste fare myftiun e Tiranës Musa Qazimin, i cili formalisht mbante ende detyrën e kryetarit të Këshillit të përgjithshëm të kryengritjes fshatare. Midis tyre kishte mosmarrëveshje të mëdha. Myftiu nuk i shikonte me sy të mirë veprimet e Haxhi Qamilit për shpërndarjen e tokave dhe të tjera cenime që ai u bënte agallarëve, shumica e të cilëve ishin miqtë e tij më të ngushtë.

Në Elbasan Haxhi Qamili gjeti një myfti tjetër, po aq të rrezikshëm sa Musa Qazimin. Ky quhej Haxhi Hy-seni, një turkoman i njohur i cili, persekutonte patriotët dhe të gjithë ata njerëz të shkolluar që përhapnin idetë kombëtare dhe u mësonin të tjerëve shkrim e këndim në gjuhën shqipe, me shkronja latine. Por, edhe Haxhi Qamili ra në batakun e tyre, duke errësuar perspektivën e lëvizjes antifeudale. Ai kryesisht u muar me rregullimet e punëve që kishin të bënин me tokën dhe vendosjen e qeverimit të drejtësisë fshatare. I detyroi disa tregëtarë dhe agallarë të Elbasanit t'i paguanin bashkisë 500 napolona flori, të cilat do të përdoreshin për të rifilluar punimet e lëna pasdore, që nga viti 1908 për hapjen e një kanali vaditës në Zaranikë. Këto punime ishin penguar nga ndërhyrjet e Vërlacit e të Biçakçinjëve, që ishin çifligarët më të mëdhenj të Elbasanit, të cilët nuk kishin interes për hapjen e kanalit. Uji i Zaranikës ishte pronë e tyre dhe këta ua shitnin fshatarëve dy mexhide dy gisht ujë, për të vaditur parcelat e tyre.

Ashtu si edhe në kazatë e tjera, tellallët e Haxhi Qamilit shpallën edhe në Elbasan urdhëresat e ligjet e kryengritjes fshatare: «Heqja e faizit dhe detyrimi i fajde-xhive pér t'ua kthyer fshatarëve». «Mbyllja e shtëpive publike». «Heqja dorë nga vrasjet pér gjakmarrje». «Ulja e çmimit të drithërave të bukës». «Shtetëzimi i ujit pér vaditje». «Konfiskimi i pasurisë së bejlerëve dhe nëpunësve të mëdhenj, që i kanë shërbyer qeverisë të Esad Toptanit dhe të Vudit. Konfiskimi i tokave dhe i kopeve të bagëtive të teqeve dhe manastireve». Por, këto masa nuk u zbatuan tërësisht.

Pushteti i kryepleqëve nëpër fshatra e lagje qytetesh u rrëzua. U ngritën këshillat e administratës së krye-

ngritjes fshatare të përbëra prej pesë-gjashtë vetësh. Midis tyre ndaheshin detyrat, njëri merrej me financat, tjetri me ruajtjen e rendit publik, me shëndetësinë dhe të tjera. Kryetari i këshillit ishte nëpunës i përhershëm dhe paguhej me rrogë. Pranë nënprefekturës qëndronin pesë xhandarë për të zbatuar urdhërat që jepeshin. Ushtarët që shërbenin një muaj deri tre muaj paguheshin me ushqime, bereqet, fasule dhe vaj, sipas frymëve që kishin në shtëpi. Shërbimi ushtarak bëhej i shkurtër, me qëllim që të mos rëndonte në punët e bujqësisë. Pushteti i kryengritjes fshatare tanimë ishte vendosur në Tiranë, Krujë, Milot, Fier, Berat, Mallakastër dhe nga Jugu deri në Pogradec. Korça, Gjirokastra dhe bregdeti i Himarës ishin nën sundimin e bandave greke dhe të grekomanëve Kryengritja fshatare nuk e njihte «Vorio — Epirin» dhe ata ishin në luftë me bandat greke. Shkodra administrohej nga një komision i përbërë prej elementësh, katolikë e muslimanë, të cilët qeverisnin në emër të Komisionit Ndërkombëtar.

Kryengritësit fshatarë dhe Haxhi Qamili përpinqeshin me sa mundnin që ta shtrinin sundimin e tyre në të gjitha krahinat e banuara nga shqiptarët, qofshin myslimanë ose të krishterë.

## NJË KUJTESË JO E LARGËT

Mali u nis prapë në drejtim të fshatrave të Shijakut, që të takohej me taborrin e tij kryengritës. Rrugës ndaloj në dy fshatra ku kishte miq të ngushtë. Natën e parë e kaloi në lagjen e epërme të Kasharit, mbi urën e Lëmuthit.

Mali me të zotin e shtëpisë, mësuesin, që ishte kryetar i njërsë nga familjet e para që ndihmuat për hapjen e shkollës shqipe të fshatit një vit më parë, kujtuan ngjarjen e lhidhur të Urës së Lëmuthit.

Mësuesi i Kasharit, burrë i pjekur, ishte i informuar nëpërmjet gazetave shqipe të cilat btoheshin nga kolonitë shqiptare të Rumanisë, të Amerikës dhe të vendeve të tjera dhe hynin fshehurazi në Shqipëri, për gjendjen politike ndërkontinentale, për konfliktet midis shteteve si dhe për pikëpamjet politike të fqinjve dhe fuqive të mëdha evropiane për çështjen shqiptare. Mësuesi i Kasharit kishte dëgjuar e kishte komentuar për këto çështje edhe në klubet patriotike shqiptare në qytetin e Tiranës e të Durrësit. Mali dëgjonte me vëmendje dhe herë pas here bënte ndërhyrje duke pyetur për njëren ose për tjetrën çështje. Nuk ishte hera e parë që komandanti i kryengritësve të Pishtarit dëgjonte biseda të tillë. Xhaxhai i tij, Ram Leka, i kishte krijuar edhe raste të tjera bisedash të këtij lloji, përmes së cilave Mali ishte vënë në kontakt me patriotë që luftonin për pavarësinë dhe përparimin e kulturës shqiptare.

Ata folën për kryengritësit fshatarë, që kishin rrrokur armët kundër pushtetit të bejlerëve dhe kundër kryeqifligarit më të madh, Esad Pashës, për punët e flamurit e të pavarësisë së Shqipërisë, që ishin ngatërruar aq shumë, sa nuk dihej ç'rrugë do të merrnin.

Biseda po përqëndrohej kryesisht te fshatarët pa tokë dhe për masat popullore të Tiranës.

Fshatarët patriotë dhe masat populllore të Tiranës si edhe krahinave të tjera të vendit, dërguan forcat e tyre vullnetare për në Jugë, që të luftonin kundër forcave greke e grekomane vorio-epirote, që, të ndihmuar drejt për së drejti nga Athina, kërkonin të copëtonin krahinat shqiptare e t'ia aneksonin Greqisë. Batalioni vullnetar tiranas, që u nis për në Jugë, rrugës këndonte këngë patriotike dhe në krye të tyre Rama valviste flamurin e Shqipërisë kuq e zi, që ishte ngritur dy vjet më parë në Vlorë, pas pesëqind vjet robërie nën osmanllintë aziatikë. Mësuesi i Kasharit i tregoi Malit se dy muaj përpara kishte dëgjuar nga një besnik i Esad Pashës një sekret që, përvëç Osman Balit, nuk e kishte ditur asnjeri tjetër. Kishte qenë fjala për mbledhjen e një force që duhej të zinte rrugën e Durrësit dhe të mos linte asnje fuqi tjetër të kalonte për në kryeqytet. Dhe me të vërtetë, më 17 maj të vitit 1914, këta mercenarë, të armatosur nga Pasha, pikërisht ata që kishin luftuar nën komandën e tij në rrëthimin e Shkodrës, ish-mercenarë nga vilajetet e largëta të Turqisë, të udhëhequr nga agallarët e tyre, kishin sulmuar te Ura e Lëmuthit pranë Kasharit batalionin e vullnetarëve tiranas, që me këngë në gojë dhe me flamurin e Shqipërisë në ballë, po shkonin në Jugë për të luftuar kundër «vorio-epirotëve» për bashkimin e tyre dhe pavarësinë e Shqipërisë. Në këtë kohë, nëpër fshatrat e Shqipërisë së Mesme kishin ardhur oficerë civilë të dërguar si agjentë nga Komiteti xhonturk i Stambollit, të cilët, të lidhur me një aleancë të fshehtë me Bullgarinë, me qëllim që në Luftën e parë botërore të hidheshin në anën e gjermanëve, kërkonin të 'prishnin asnjanësinë e Shqipërisë, praktikisht të qeverisë së Vudit, duke i hedhur shqiptarët në luftë kundër serbëve e grekëve, që ishin aleatë me Anglinë, Francën e Rusinë. Borgjezia e re turke, me këto lidhje ushtarake dhe politike, po pregatitej të merrte pjesë në skenën e Luftës së parë botërore, me perspektivë që ta ringjallte përsëri perandorinë e sulltanëve. Si pikë më të favorshme ata menduan Shqipërinë, ku kishin sunduar pesëqind vjet dhe kishin lënë gjurmët e tyre thëllë në ndërgjegjen e popullit të shty-

pur, të mashtruar e të paditur. Me këto manevra politiko-ushtarake, xhonturqit kërkonin që të ruanin përsëri sundimin e tyre në Ballkan.

— Sa për myftiun e Tiranës, Musa efendinë, atë e njoh mirë! — i tha mësuesi i Kasharit Malit. Ai është hoxhë me medrese të lartë dhe të gjithë miqtë e tij të ngushtë i ka në Stamboll. Më ka rastisur dy a tri herë të bisedoj me të dhe i kam kuptuar mendimet e tij politike. Është i zgjuar dhe kërkon pozitë. Para ca kohe, kur Ismail Qemali ngriti flamurin në Vlorë, ai e ktheu pllakën me shqiptarët, sepse kishte marrë vesh, nëpërmjet miqve të tij, që edhe qeveria turke ishte detyruar ta njihet pavarësinë e Shqipërisë. Por, kur Esad Pasha u kthye nga rrëthimi i Shkodrës në krye të një ushtrie të madhe në Tiranë dhe ngriti qeverinë e tij në Durrës, myftiu i Tiranës e ktheu përsëri pllakën. Musa Qazimi një kohë u lidh me Esad Pashën dhe në Kongresin e Krujës ai ishte njeriu më i besuar. Esad Pasha do të shkonte në Krujë si njeriu më i pushtetshëm i vendit dhe Myftiu i Tiranës kishte për mision që ta shpallte atë mbret, të Shqipërisë, por ky komplot dështoi nga planet që kishin kurdisur fuqitë e mëdha evropiane, të cilat kishin vendlisur të dërgonin në Shqipëri Vilhelm Vidin. Esad Pasha e ruajti kartën. Ai nuk shkoi në Krujë. Myftiu i Tiranës hapi fjalë se Esadi ishte i sëmurë dhe kongresi u shpërndaa pa ia arritur qëllimit për një kohë. Më vonë rrugët e myftiut të Tiranës dhe të Esad Pashës u ndanë, si duket një herë e përgjithmonë. Stambolli, që filloi të shohë tek Esad Pasha ambiciozin dhe rivalin më të fortë kundër rikthimit të politikës së tyre në Shqipëri, e shpallën top-tanasin tradhëtar të fesë e të Turqisë dhe e dënuan në mungesë me vdekje. Pasha i Tiranës ia kishte kthyer shpinën Turqisë pasi e kishte kuptuar që osmanllinjtë nuk do të merrnin kurrë më veten dhe të arrinin të merrnin prapë sundimin e botës që ku lind e gjer tek perëndon. Për Esadin ishin forca të reja ato që do të sundonin botën, dhe ai mendonte se këto ishin Anglia, Franca, Rusia dhe aleatët e tyre. Muza Qazimi ishte informuar për politikën që do të ndiqte Esad Pasha nga miqtë e tij,

bashkënëxënësit e medresesë së lartë të Stambollit. Këta ia kishin treguar atij të gjitha. Musa efendiu ishte i njo-hur si filogjerman. Gjermanët, thoshte myftiu i Tiranës, janë përkahësit e botës muslimane. Ai e dinte edhe qëllimin e gjermanëve, pér t'iu kundërvënë englezëve. Musa Qazimi shpresonte se, pér shërbimet që do t'i sillte Turqisë, do të arrinte të zinte një nga pozitat më të larta të pushtetit të ri që do të vendosej në Shqipëri. Kështu politika e tij u nda nga ajo e Esad Pashës dhe midis tyre filloi armiqësia.

Mësuesi i Kasharit i tha Malit se qëllimet politike, si të Esad Pashës ashtu edhe të Musa Qazimit, i kishte kuptuar fije e pér pe Abdi Toptani, i cili, megjithëse rridhete nga derë e bejlerëve, ishte larguar prej tyre; punët që kryente tregonin se ishte me të vërtetë një patriot i flaktë. Ai, jo vetëm që përpiquej pér pavarësinë e Shqipërisë, por kërkonte edhe të ngrilhej një qeveri demokratike në dobi të përparimit e të popullit. Mal Xhoka po çuditej nga të gjitha këto biseda që po i tregonte mësuesi i Kasharit, i cili kishte disa muaj që rrinte i mbyllur në shtëpi dhe nuk e nxirrte as kokën te dera. Bile, po të mos kishte qenë vëllai i tij i madh një nga më të afërmit e Man Picarit dhe të Osman Balit, ndoshta do ta kishin mbyllur në burg ose do t'i kishin dhënë plumbin, ashtu siç ua kishin bërë disa shokëve të tij që kishin rënë në dorën e esadistëve të tërbuar ose të halldupëve të myf-tiut të Tiranës.

Komandanti i Pishtarit u mundua të kapte një pjesë të mirë të këtyre mendimeve dhe të politikës së ndërlidhkuar që po luhej në vendin e tij dhe në botë. Një pjesë e bisedave me mësuesin i kishin shpëtar, por në mendjen e tij kishin zënë vend dy ide fare të qarta: «kryengritësit fshatarë duhej të luftonin në dy drejtime: pér rrëzimin e pushtetit të bejlerëve dhe pér pavarësinë e Shqipërisë. Mal Xhoka nuk mund të kuptonte dhe një gjë: Përse Haxhi Baba e fshatarët e tjerë të tërhiqeshin nga hundët prej myftiut të Tiranës dhe pse mësuesi i Kasharit, mësuesi i Shijakut, telegrafisti i Tiranës e të tjerë të mos ngrihen që t'u delnin krah kryengritësve?

Gjithashtu Mali nuk e kuptione përse këta miq të familjes së tij ishin mbështetur te mbreti i huaj Vilhem Vid, i cili kishte mbledhur rrëth vetes ajkën e bejlerëve dhe në krye të tyre kishte vënë Esad Pashën. Përse këta burra patriotë nuk vinin në fshat e të merreshin vesh me kryengritësit? Malit i bënte përshtypje kjo ndarje dhe kjo ftohtësi e patriotëve kundrejt kryengritësve fshatarë, që ishin ngritur të luftonin kundër bejlerëve, kundër padrejtësive.

Mësuesi i Kasharit queshte me pyetjet që herë pas here i bënte djaloshi, nipi i mikut të tij, Ram Lekës. Kur mësuesi i tha atij se patriotët kishin frikë të takoheshin me kryengritësit fshatarë, se i priste plumbi kokës ose litari në fyt, Mali mbeti gojëhapur.

Mësuesi e mylli bisedën, që po vazhdonte prej disa orësh, me pesimizëm: «Sot, ore vëlla, Shqipëria është bërë lëmsh e li! Disa kërkojnë të lidhen me turkun, ca të tjerë me grekun, me Austrinë, me Serbinë, me Malin e Zi, Italinë e dreqi e merr vesh se me kë! Po katoljmë kohë të vështira!

— Dëgjo, o zotni mësues! — i tha Mal. Xhoka — Kur merr flakë pylli, s'ka fuqi që ta ndalojë! E, pra, edhe kryengritja e katundarëve nuk ndalet, ajo në mos sot nesër, një ditë do të fitojë. Katundaria bën shumicën e popullit dhe ka të drejtë të vendosë një qeveri që të qeverisë me drejtësi.

Këto ditë në Kashar s'kishte as edhe një farë gjallërie. Shumica e burrave kishin ikur pas kryengritësve fshatarë, disa u shkonin pas Picarëve, ca të tjerë Haxhi Babës dhe një pakicë kishin mbetur ushtarë të Pashës.

Fshati kishte mbi treqind shtëpi të shpérndara kodrave dhe fushës që shtrihej midis Tiranës dhe Vorës. Tokat më pjellore nën ujë ishin pronë e një grushti agallarësh, kurse kodrinoret zotëroheshin prej fshatarëve të mesëm e të varfër. Në fshat kishte mjaft shtëpi, pjesëtarët e të cilave punonin si argatë në tokat e agallarëve.

Në orët e vona dikush trokiti në derën e mësuesit. E zonja e shtëpisë, para se ta hapte, lajmëroi të birin. Sipas zakonit të mikpritjes e zonja e shtëpisë e ftoi të panjohurin të urdhëronte në kullën e miqve. Mali u habit sa

ç'u gëzua kur pa se miku i orëve të vona ishte xhaxhai i tij, Ram Leka.

— Grekët po pushtojnë Beratin dhe italianët zbaruan në Vlorë! — tha ai me një frysë, pa u përshtendetur me të nippin.

— Po ti për ku je nisur kështu? — e pyeti Mali pa e kuptuar qëllimin e ardhjes së tij në Kashar.

— Po kthehem nga Tirana. Bisedova me Haxhi Babën.

— Mos keni menduar ju se Haxhi Baba do të pranonte të luftonte kundër «Vorio-Epirotëve»? — pyeti mësuesi duke shprehur dyshimin.

— Po si kujton ti, zoti mësues, se me, kryengritësit fshatarë luftojmë vetëm kundër bejlerëve? Jo, ore mik, gabohesh. Para rrezikut të copëtimit të atdheut ne nuk vëmë asgjë tjetër! — i tha me vendosmëri Ram Leka.

— Mendoni ju kështu! Unë të njoh, o Ram Leka, e di që ti je patriot e shqiptar i flaktë; ama si ti nuk mendoni Musa Qazimi, ai po e tërheq nga hundët atë komandantin tuaj, Haxhi Qamilin, — ia pat mësuesi që vuri re se fjalët e tij e pikëlluan Ram Lekën, i cili ra në hesh-tje dhe dëgjoi me vëmendje bisedën e mësuesit, po atë bisedë që kishte dëgjuar edhe Mali tërë atë natë.

Ramës i hyri krimbi i dyshimit. Atij iu kujtua takimi dhe bisedat e zjarrta me Haxhi Babën. Kryetari i kë-shillit të kryengritjes fshatare të Pishtarit ia tregoi me hollësi mësuesit bisedën që kishte pasur me Haxhi Babën. Babai i Ramës dhe Haxhiu kishin qenë miq të vjetër. Miqësia e tyre ishte lidhur në atë kohë kur të dy tok kishin shkuar ushtarë bedela për hesap të djemve të Galip Beut dhe të Veli Agës. Pesë vjet të dy bashkëfshatarët kishin shërbyer ushtarë në ranishtet përvëluese të Afrikës, duke hequr të zitë e ullirit. Pas kthimit nga ushtria Qamil Metën e kërkoi qahajai i Esad Toptanit ta merrte si trim në sarajet e Pashës në Laprakë të Tiranës. Atje Qamili njohu së afërmë jetën dhe sjelljet e bejlerëve duke krijuar në shpirtin e tij një urrejtje dhe përbuzje të tmerrshme që ua trashëgoi dhe fëmijëve.

— A e di ti, Haxhi Baba, se greku ka shkelur viset tonë: Korçën, Gjirokastrën dhe bregdetin e Himarës? —

këto fjalë Leka ia tha Haxhi Babës në zyrë të qeverisë.

— Ej... kjo qenka punë e keqe! — ishte përgjigjur komandanti i ushtrisë fshatare duke fërkuar mjekrën e zezë sterrë dhe kish shtuar: — Gjirokastra, Korça dhe Himara janë vatanë ynë, ore!

Në Shkodër kam qenë, se e solli lufta. Edhe në Durrës kam qenë, se aty i hipëm vaporit dhe bashkë me disa shokë të mi shkuam pér të vizituar Meqe Medinë, por në ato qytete që thua ti, ku paska shkelur greku, nuk më ka rastisur të shkoj — kishte thënë Haxhi Baba dhe, pasi kishte rënë përsëri në mendime, duke thithur çibukun me sy të ngulitur përtokë kishte thënë: — Megjithëse kemi dalë të luftojmë bejlerët pér të vendosur qeverinë tonë të drejtësisë dhe s'kemi pasur ndër mend të përzihemi me krajlët e huaj, ne do t'u thyejmë brinjët grekut e çdo krajli tjetër që na bie në qafë!

— Nuk pret puna, Haxhi Baba! Duhet t'u bëjmë thirrje të gjithë kryengritësve fshatarë, të nisemi pér në jugë dhe t'i presim hovin grekut, që po përpinqet ta copëtojë vatanin! — i kishte thënë Ram Leka.

— Nuk thua keq, mor babë, po këtë punë duhet ta bisedojmë dhe ta vendosim në Këshillin e përgjithshëm! Pastaj duhen mbledhur ushtarët që janë shpérndarë andej-këtej se, aq sa mund të mblidhet një thes me pleshta, aq mund të mblidhen edhe ushtarët e Haxhi Qamilit! — Dhe kur qe ngritur në këmbë ashtu, papritur, ia kish plasur gazit me të madhe.

— Haxhi Baba, vatanë është në rrezik! Duan të na copëtojnë kofshë e thelë! Në një anë greku, në anën tjetër serbi, kurse në Vlorë italianët. Thonë se jemi turq dhe e kanë ndarë mendjen të na sulen e të na shqyejnë — i kishte thënë Leka, që nuk qe tundur nga karrikja, se e kish kuptuar se Haxhi Baba kërkonte t'i jepte fund bisedës.

— Dëgjo, o Ram Leka! — Unë e di se ti e ke fjalën pér flamurin e kuq me pulastre të zezë në mes! Ky është flamuri që kanë sajuar bejlerët dhe e kanë sjellë nga nemsja. Flamuri i halisë dhe i muslimanëve është gjysmë-hëna, pér këtë nuk ma mbush mendjen asnjeri. Sido që të jetë, ne nuk na prish punë flamuri.

Puna e parë që kemi për të bërë është të zhdukim farën e bajlerëve dhe toptanasve t'ua shkulim rrënjet nga ky vend. Po ta bëjmë këtë, atëhere do t'u vimë hakut edhe grekut edhe serbit, edhe nemeses, edhe Italisë dhe çdo krali tjetër të huaj që do të na bjerë në qafë.

Pasi Ram Leka tregoi takimin e fundit në Tiranë me Haxhi Qamilin, iu kthye mësuesit: — Unë jam i bindur që kryengritësit fshatarë do t'i dalin zot vendit. Kohët kanë ndryshuar, Haxhi Baba është prishur me Musa Qazimin dhe me agallarët e Ndroqit. Ata i ruhen Haxhi Qamilit dhe puna ka shkuar aq larg sa ata nuk i besojnë njëri-tjetrit për të bërë pjesë në një qeveri. Kur Haxhi Baba është në Tiranë, Musa efendiu shkon në Elbasan dhe kur Baba ikën në Krujë, myftiu kthehet në Tiranë. Ka kohë që nuk puqen të dy bashkë. Shpresoj se Haxhi Baba do të nisë forca për në jugë, për t'u prerë hovin grekëve dhe, po t'u qepën, o zotni mësues, ushtarët e Haxhi Qamilit, për nder, të vënë përpara!

— Ashtu qoftë! Por një gjë të thotë mësuesi, o Ram Leka, atdheu është në rrezik! Pavarësia e Shqipërisë fluturoi!

— E pra, o zotni mësues, po qe kështu, mos u futni nëpër rrëzat! Dilni haptaz dhe i princi popullit të paditur të gjejë rrugën e humbur! E, që të fitoni besimin e kryengritësve fshatarë, duhet të ngrini edhe ju pushkën kundër bajlerëve dhe Esad Toptanit! — i tha Leka mësuesit me një ton plot nervozizëm.

— Jemi të humbur! — tha i dëshpëruar mësuesi. — Ne patriotët jemi të përçarë, të paktë në numër, të pafuqishëm! Dhe më e keqja është se një pjesë e patriotëve janë të lidhur pas qerres së bajlerëve dhe aq më tepër kur presin shpëtimin nga krajlët e huaj. Ram Leka, i lodhur nga rrugëtimi i gjatë, uli kokën dhe filloi të mendonte.

Ram Lekës sikur po i kthjellëshin mendimet. Ai po e kuptonte se në kryengritjen fshatare ishin shfaqur tri rryma: Një palë shkonin pas tarafit të myftit të Tiranës Musa Efendi Qazimit, i cili e kishte shpallur programin e tij që në Shijak, se luftonte për një Shqipëri të bashkuar me Turqinë, ose të sillej si sundimtar një nga prindët e Portës së Lartë. Sipas këtij programi politik,

flamuri i Shqipërisë do të ishte me gjymëhënë, gjuha zyrtare, turqishtja dhe kryetari i fesë muslimane do të caktohej nga Stambolli. Tarafi i Musa Qazimit mbështetej tek agallarët turkomanë të fshatit e të qytetit, tek hoxhallarët reaksionarë e injorantë, që tërhiqnin pas disa turma fshatarësh të paditur duke shfrytëzuar urejtjen për bejlerët dhe fanatzimin e tyre fetar.

Në rrymën e dytë mund të futeshin ata që shkonin pas Esad Pashë Toptanit. Këta kishin ngritur krye kundër mbretit të krishterë Vilhelm Vid dhe kërkonin që vendin e tij ta zinte një princ musliman. Konkretisht bëhej fjalë për Esadin. Udhëheqësit e kësaj rryme ishin oficerët e mashat e Esadit si Osman Bali, Mustafa Agë Ndroqi, i cili luante një politikë të dyfishtë: edhe me myftiun e Tiranës edhe me Pashën. Me zhvillimin e ngjarjeve të mëvonshme, pas kthimit të Esad Toptanit në Durrës, Mustafa Agë Ndroqi tregoi fytyrën e tij të vërtetë, doli haptaz se ai ishte mik i Esadit. Turmat fshatare, që shkonin pas këtij tarafi, kur e kuptuan se krerët e tyre ishin sahanlëpirës të Esad Toptanit dhe të bejlerëve të tjerë, u larguan nga ata. Rryma e tretë e kryengritjes fshatare ishin turmat e varfëra, të shtypura dhe bujqit e çifligjeve të bejlerëve të Shqipërisë së Mesme dhe të Myzeqesë. Udhëheqësit e kësaj rryme, të cilët luftonin për liri e tokë, luftonin me vendosmëri kundër pushtetit dhe shfrytëzimit të bejlerëve e të agallarëve, përvendosjen e drejtësisë fshatare, ishin masat popullore, sidomos ato të fshatit dhe komandantët si Haxhi Qamili, Reshit Gjata, Ram Leka, Mal Khoka, dhjetëra udhëheqës të tjerë të padëgjuar.

Me heshtjen që kishte pllakosur, të gjitha gjymtyrët e plakut fshatar patriot sikur u plogështuan. U ndje se biseda kishte marrë fund!

Të nesërmen Mal Khoka u nda prej xhaxhait dhe u nis për në fshatrat e Kavajës, ku e priste kompania e Pishtarit. Ram Leka, fillikat i vetëm, mori rrugën për në Tiranë, që të kërkonte sa më parë forca nga Haxhi Qamili për t'i dérguar në Berat, Vlorë, Pogradec, kurse mësuesi, me t'u larguar miqtë nga Kashari, përsëri u fsheh në magazanë e barit.

## FSHATARËT KRYENGRITËS SULMOJNË KAZATË

Kur arritën në fshatin Kullas, luftëtarët u shpërnda-në nëpër shtëpi për të ngrënë darkë dhe për të pushuar, me qëllim që të nesërmen të ishin të çlodhur për të filuar sulmin e dytë mbi kaza.

Mali menjëherë shkoi në kullën ku ishte caktuar. I zoti i shtëpisë dhe dy burra nga të taborrit të tij, Asllani dhe Rama, ia kishin shtruar me raki.

— Hajde, o Mal Xhoka, hajde! — i tha Asllani. — Përse rri kështu mendueshëm? Si duket atje në fshat ke lënë pëllumbeshën! Hi-hi-hi! — qeshi ai.

U ul pranë tyre dhe me buzën në gaz u tha bashkë-luftëtarëve:

— Ju po pini raki! Do t'ju padis te Haxhi Baba! — dhe tundi gishtin.

— Haxhi Baba e ka ndaluar rakinë për të rinjtë, që, kur pinë, marrin zjarr si flakë e kaçarrumave! — iu përgjegj Asllani dhe ia shkrepi përsëri gazit.

Pas rakisë u shtrua një darkë e mirë, e preqatitur me kujdes. I zoti i shtëpisë ishte mik i kryengritjes fshatare, dhe kjo u duk jo vetëm nga pritja e përzemërt që u bëri kryengritësve, por edhe nga informatat që dha rrith gjendjes në fshatrat përreth.

Të nesërmen, pazbardhur mirë dita, nga Shijaku erdhë te Mal Xhoka një korrier, që e dërgonte personalisht Haxhi Baba.

— Ti je Mal Xhoka, or vëlla! Po ku je, more, se më

ranë këmbët duke të kërkuar poshtë e lart krahinës! — tha me një frymë fshatari, një mesoburrë me flokë të gjatë dhe me mjekër të parruar prej kushedi sa muajsh. Atë po e shoqëronin Naimi dhe një luftëtar tjetër i Pishtarit, me të cilët ai ishte takuar në lagjen e poshtme të fshatit Kullas dhe e kishin sjellë te komandari i tyre.

— Urdhëroni! — i tha Mali, që ishte ngritur më këmbë e po rrinte mbështetur pas pushkës së gjatë italiane.

— Vij drejt për së drejti nga Haxhi Baba! — i tha lajmëtari. — Më ka porositur Baba të të njoftoj disa punë me rëndësi, që duhet t'i kryesh këtyre anëve!

— Me se e provon se të ka dërguar Haxhi Baba? — i tha Mali fshatarit, që ishte armatosur me një karadake të vjetër në brez.

— Po, ke të drejtë! Harrova! — iu përgjegj korrieri, që sakq nxori nga xhepi i brekusheve të zeza prej pëlhure një shami të kuqe me pikla të zeza dhe ia dha Malit.

Komandanti i Pishtarit, pasi e vështroi shaminë me kujdes dhe numëroi katër nyje të lidhura, ngriti sytë nga i panjohuri dhe tha:

— Po! E ka dërguar Haxhi Baba! Më thuaj çfarë porosie ke!

Korrieri vështroi njerëzit që e rrethonin dhe pastaj Malin.

— Të largohen shokët nga kulla? — pyeti Mali korrierin e Haxhi Babës.

— Si të duash! — iu përgjegj pa të keq fshatari.

— Jo, unë e kam zakon të mos u fsheh asgjë shokëve të mi! — i tha Mali dhe, pasi ktheu kokën nga i zoti i shtëpisë, që ishte bërë gati të largohej, shtoi: — Sa për Dikun mos u bëj fare merak, ky është yni!

— E mirë pra! — tha korrieri që vinte nga shtabi i ushtrisë fshatare, të vendosur në Shijak. Ai u tha shkurt për çka kishte urdhëruar Komananti i përgjithshëm i ushtrisë kryengritëse fshatare.

— I thuaj Haxhi Babës — tha Mal Khoka me pushkën e ngritur lart, që e tundte në ajër si një cingël — se nuk do të lemë kusur kundër bejlerëve!

— Do t'ia them! — tha korrieri dhe, pasi nderoi me dorën në zemër duke mërmëritur nëpër dhëmbë një tunjatjeta të gjatë u têrroq të dilte mbrapsht nga dhoma.

— Prit! — i thirri Mali, të cilit iu kujtua diçka që kishte harruar. — Unë po dérgoj një lajmëtar menjëherë qysh tami për t'i thënë Ramës të niset për në Shijak. Hajde, pra, këmbë tê lehta e dalç faqebardhë! — Korrieri sapo zbriti shkallët e kullës u bë erë duke vrapiuar tatëpjetë kodrës dhe, ashtu siç ishte, këmbëzbathur, ra në fushë.

Kompania e pishtarakëve, me komandant Mal Xhokën, u nis për në Fushë-Kaza. Nga lindja, mbi majat e kodrave filloj tê agonte. Fshati ku arritën ata ishte ngritur në fushë dhe ndahej në katër lagje kryesore. Midis kasolleve prej kashte e shtëpive prej qerpiçi, që ishin gjysmë tê rrëzuara, kishte aty-këtu edhe ndonjë shtëpi ndërtuar me gurë dhe me tulla tê kuqe, që shquheshin nga tê tjerat. Shumica e fshatarëve ishin bujq, punonin në tokat e bejlerëve dhe fare pak prej tyre zotëronin toka. Në një copë vend tê veçuar, që vinte si bregore rrëthuar me hardhi, ishte ndërtuar me gurë një kullë e madhe dykatëshe. Mbi çatinë e mbuluar me tjegulla tê kuqe katër oxhakë që tymosnin dukeshin si roje përballë shtëpive tê ulëta përdhese tê fshatit.

Kryengritësit, kur erdhën para portës, vrojtuan një copë herë vendin. Kudo zotéronte heshtja. Kur ngriti sytë lart, Mali pa se kulla e lartë kishte trajtën e një kubi. Për t'u ngjitur në katin e sipërm ishin ndërtuar shkallë tê pjerrëta me bloqe gurësh tê bardhë. Mbi derën e katit tê dytë dhe mbi çardak dilte si gjuhë një ballkon i vogël me tri frëngji, sa për të vënë tytën e pushkës. Bujqit që i panë rendën te sheshi para kullës dhe u bashkuan me kryengritësit. Nga mënyra se si u mblodhën ata dhe si u përshëndetën me luftëtarët, u duk fare qartë se e dinin me kë kishin tê bënин. Ca fshatarë tê zbathur, me brekë dhe këmisha tê gjata, lanin ftyrën e pinin ujë te çezma e ndërtuar me bloqe guri, në ballin e së cilës ishte shkrojtur një mbishkrim turqisht. Disa prej bujqve po kërkonin armë.

Një nga bujqit, që dukej më i vjetri midis tyre, iu afroa Mal Xhokës dhe i tha në vesh me zë të ulët:

— Hasan Beu është miku i Musa Qazimit dhe nuk duhet ta prishim!

Mali e vështroi me inat plakun. Kjo vërtetonte edhe një herë kontradiktat që ekzistonin midis kërëve të Këshillit të përgjithshëm të kryengritjes fshatare.

— Dëgjo, o mik! — i tha me zë të lartë Mali. — Hasan Beu është i poshtër! Ai ju ka zaptuar tokat. Është fajdexhi. Ju ka shtruar në dru kushedi sa herë për kundërshtimet më të vogla. Përveç të tjerave beu është edhe pusht!

— Ta djegim! — briti njëri nga bujqit, një burrë i ri, dhe ngriti lart karafilen që shtrëngonte në dorën e djathë.

— S'ka lënë gjë pa u punuar bujqve ky i 'pashpirt!

— tha një tjetër.

— T'ia sheshojmë kullën rrafsh me tokën, ashtu siç dogji Haxhi Baba sarajet e Esad Toptanit në Tiranë.

— Unë nuk e harroj atë që i ka punuar ai tim eti! — tha një tjetër.

— E ku tregohen të këqiat e bejlerëve!

— Pse e zgjatni! O burra, të hyjmë në kullë! — briti një fshatar i gjatë sa një hosten.

— O Thanas, tregoi Malit se ç'ka bërë Hasan Beu, kur hynë herën e parë në Durrës Mustafa Ndroqi dhe Musa Qazimi! — i tha një fshatar i ri shokut të tij pranë, që dukej më i mbajtur e që ishte veshur ndryshe nga bujqit, me pantallona e xhaketë.

— Cili je ti? — e pyeti Mali djaloshin që dukej si qytetar.

— Nuk jam i huaj! — u përgjegj ai që e kuptoi dyshimin e komandantit kryengritës dhe pak si me ndrojtje shtoi: — Djalë bujku!

— Po çfarë punë bën këtu në fshat?

— Mësues!

— Është kaur! — paditi plaku që nxori në shesh të fshehtën se Hasan Beu ishte mik i Musa Qazimit. — E quajnë Thanas.

— Muslimanë e të krishterë, një perëndi na ka kri-

juar! — i tha Mali dhe shtoi: — E dini ju se çfarë ka thënë Haxhi Baba? Bujqit, muslimanë e të krishterë, janë vëllezër, se ata njëloj vuajnë nga bejlerët. Fenë e ka secili pér hesap të vet.

Fshatarët, kur komandanti i taborit kryengritës pér-mendi emrin e Haxhi Babës, jo vetëm që heshtën, por dëgjuan me vëmendje. Kjo tregonte se ata, megjithëse nuk e kishin njohur së afërmë kamandantin e tyre, ushqenin respekt pér të, si trim dhe kundërshtar i bejlerëve.

— Pa dëgjoni se ç'ka bërë Hasan Beu në Durrës! — briti Naimi. Folë, o Thanas!

— I ka hipur në kurri një bujku që kishte kundërshtuar t'i jepte faizin!

— A e dini ju urdhërin që ka nxjerrë Haxhi Baba? — thirri Mali dhe, pér t'ua bërë më të qartë fshatarëve, ngriti qafén e gjatë dhe një copë herë hodhi vështrimin mbi të gjithë ata njerëz që ishin grumbulluar rrëth tij. — U ka dërguar telegram të gjitha kazave se në pushtetin e këshillave kryengritëse fshatare ndalohet rreptësisht faizi! Bejlerët, agallarët e tuxharrët janë të detyruar t'u kthejnë faizin fshatarëve. Dhe këtej e tutje kush guxon të marrë faiz do të dënohet tamam si vjedhësit.

— Si ta thonë emrin ty, o plak? — e pyeti si me të hakërruar Mali atë fshatarin që i foli në vesh pér miqësinë e Hasan Beut me Musa Qazimin.

— Sherif! — iu përgjegj ai me ndrojtje.

— Po të dëgjoj se merresh me punë pérçarëse, ta dish se do të të var ja këtu në degë të këtij frashëri! Ikën ato kohëra kur Esad Toptani hidhte gurin e fshihte dorën. Musa Qazimi është arratisur dhe nuk dihet se ku i ka humbur fara. Po ta kapë, Haxhi Baba do ta shembë në dru, se ai qerrata myfti na kishte qenë lidhur me agallarët dhe me të huajt! Ne kemi punët tona. Ne nuk përzihemi me kralët e huaj, secili në vendin e tij..

— U bë drekë, o Mal Xhoka! — i thirri Asllani. — O burrani të kryejmë punë!

— Mirë thua, o Asllan. E zgjatëm muhabetin. Hajde, pra, çuna, suluni mbi kullën e beut e mos t'i mbetet nam e nishan! — briti Mal Xhoka.

\* \* \*

Një qetësi e kobshme kishte mbuluar kullën e Hasan Beut, që dukej si një shtëpi e boshatisur. Katër trimat, që beu i mbante nga pas, nuk ndiheshin gjallë. Ata e kishin kuptuar nga lëvizjet që po ndodhnin aty përreth se ishin të rrerthuar nga kryengritësit fshatarë, por, duke ditur miqësinë midis Hasan Beut dhe Musa Qazimit, nuk e prishnin fare gjakun. Madje aty në kullë të tyre kishte ndodhur një ngjarje e papëlqyer dhe të gjithë ishin të zënë.

Mbrëmjen e shkuar, në qejf e sipër, Hasan Beu, gjysmë i dehur, kishte goditur me kobure çengien e tij të preferuar. Hasani, ulur në qoshe të oxhakut, kishte zënë kokën me të dyja duart dhe pa pushuar thithte çibukun e larë me ujë sermi. E shoqja, një grua e thyer në moshë, që, si të gjitha gratë e tjera të bejlerëve, pranonte në heshtje marrëdhëniet e burrit të saj me çengitë, e ngjalur ca nga pleqeria e ca nga të mirat, qante me dënesë duke gërvishtur faqet e duke shkulur flokët. Në mes të kullës shtruar me qilima dhe me lëkura kafshësh, dërgjej kufoma e çengisë mbuluar me një copë të hollë mëndafshi ngjyrë manushaqe.

Hasan Beu kishte rënë në mendime të thella dhe as po ndjente se rrerth kullës po grumbulloheshin kryengritësit.

— Ej, ej... hapeni portën! — briti Mal Xhoka duke goditur me kondakun e pushkës në derë.

— Hape, o Hasan Bej portën, se të erdhi fundi!

— Thyjeni derën! — thirri Thanasi!

Kryengritësit dhe fshatarët, nja dyqind e ca shpirt, bënin zhurmë dhe secili këpuste të shara sipas mënyrës së tij.

Kaloi një copë herë dhe askush nuk po përgjigjej nga brenda. Mali për një çast dyshoi se mos të zotët e shtëpisë kishin ikur dhe i shkoi mendja për ndonjë tradhëti.

— Ngjituni, djema! — urdhëroi komandanti më të rinjtë, të cilët menjëherë u kacavarën nëpër muret prej

guri duke u mbajtur me thonj si macet e egra. Të tjerët e patën më të lehtë të ngjiteshin mureve, sepse ndihmoheshin nga shokët e tyre, që i zinin për dore. Disa të shtëna u ndjenë nga frëngjitet e ballkonit të rrumbullaktë në katin e dytë të kullës. Nga muri ra Thanasi pa frymë, para këmbëve të Malit!

— Më vranë! — tha Thanasi dhe mbylli sytë përgjithmonë.

Mali, i pikëlluar, e mori mësuesin në kraharor, ia shqeu këmishën me forcë dhe menjëherë vuri re një vrimë në anën e majtë të kraharorit. Ai e kuptoi se Thanasi kishte mbaruar. Me kujdes e uli për tokë dhe, me shaminë e kuqe me pikla të zeza, që mbante në qafë, i mbuloi fytyrën e rreshkur nga dielli.

— Do ta varrosim me nderime! — tha Mali dhe iu drejtua shokëve: — Bjeruni qenye dhe mos limi këmbë të gjallë!

Filloi pushka. Xhamet thyheshin e tjegullat kërcisin dhe vendi ku binin plumbat bëhej tym e flakë.

Trimat e Hasan Beut, kur panë se shtëpia ishte e rrethuar nga të gjitha anët dhe se turma e fshatarëve kryengritës ishte shumë e madhe, pushuan së qëlluari dhe, si pa të keq, zbritën poshtë duke bërtitur e duke sharë fshatarët për punët e këqia që po bënin. Me sa u muar vesh nga qëndrimi i tyre naiv, ata nuk e dinin se plumbat e tyre kishin qëlluar për vdekje njërin nga fshatarët kryengritës.

— E ç'bëni kështu, more të paudhë! — thirri Kalemi, një nga shërbëtorët më të vjetër të Hasan Beut.

— Do t'u shqepim në dru! — tha trimi i dytë dhe shtoi: — A nuk shihni se i thyet xhamet e tjegullat! Do t'i paguani shtrenjtë!

— Hasan Beu do t'ju padisë te Musa Qazimi dhe mjerë ju, pastaj! Do t'u varin nga gjuha për krimet që po bëni kundër njerëzve tanë!

Disa nga fshatarët e kishin hapur portën e mbyllur me lloz nga brenda. Turma e kryengritësve, që kishin mbërritur te shkallët e kullës, po rrinte e heshtur. Ata, si të habitur, dëgjonin britmat e të sharat e trimave të Hasan

Beut, që nuk kishim kuptuar se si qëndronte puna. Turma e fshatarëve përnjëherësh kthyen kokat kur panë Mal Xhokën me Thanasin e vrarë nëpër duar.

— Ju e vratë, o sahanlëpirës të bejlerëve! — briti Mali dhe me zë më të ngritur tha: — E, shokë, ç'prisni? Qërojini këta qen!

Kryengritësit fshatarë me armë nëpër duar, të egër-suar edhe më fort nga gjaku që kullonte prej zemrës së shokut të tyre të vrarë, qëlluan me breshëri në drejtim të shkallëve të kullës. Sa hap e mbyll sytë të katër mercenarët e Hasan Beut e paguan me jetën e tyre shërbimin ndaj bejlerëve.

Pas Malit, iu ngjitën shkallëve të kullës Asllani, Naimi dhe fshatarët e tjerë, kurse disa nga kryengritësit u shpërndanë **dhomave** dhe **korridoreve** të shtëpisë së madhe dhe **kontrolluan nëpër arkat e raftet**. Plaçkitën të gjitha sendet e shtëpisë dhe nuk lanë gjë pa nxjerrë në oborr. Dy fëmijë, një djalë zevzek pesëvjeçar dhe një vajzë të shëndo-shë, i shoqëronte një plakë e mbajtur dhe e veshur mirë. Në një kthinë tjetër gjetën edhe dy gra më të reja fshatare, që shërbenin si kuzhiniere në derë të Hasan Beut.

Mali, me dhjetëshen në dorë dhe pushkën krahëqafë, kur hyri në kullë dhe pa Hasan Beun që kishte shtangur dhe po rrinte në qoshe të oxhakut, me të vdekurin në mes të dhomës dhe një grua që qante në anën tjetër, u hutua. Çfarë kishte ndodhur?

— Kush jeni ju? — tha beu pas një copë herë.

— Kryengritës fshatarë! — iu përgjegj Mal Xhoka.

— Ushtarë të Musa efendiu? — pyeti Hasan Beu.

— Jo! — tha prapë Mali. — Jemi ushtarë të Haxhi

Qamilit!


Hasani u hodh përpjetë duke harruar gjithshka.

— Po si guxoni të hyni në shtëpi të tjetrit si kusarët!

— u hakërrua Hasan Beu. — A e dini se me cilin keni të bëni?

— Po! — tha xha Asllani. — Me një bej, një qerrata!

— Do t'ju padis te myftiu!



— Mirë, na paditni! — tha Naimi. — Por më parë na thoni ç'është ky i vdekur këtu, midis jush.

— Në shtëpinë time bëj ç'të dua! — tha beu, që kujtonte se kryengritësit e dinin ngjarjen.

— Po ti, ore muzikant — i tha Mali një cigani — që rrinte pas perdes! Tregona çfarë ka ndodhur këtu, se për besë!..

Cigani i hutuar tregoi fije e për pe ngjarjen me çen-ginë.

— Mirë! — tha Mal Xhoka. — Çohu, bej, se tashti ka ardhur radha të provoj unë mbi kokën tënde se sa nishanxhi jam!

— Prit! — tha xha Asllani. — Më parë Hasan beu të na e hapë këtë arkë prej hekuri.

Beu, kur e pa se çdo kundërshtim do të ishte i kotë, mendoi që ta hidhte lumin duke i shpërbllyer rebelët me florinj. Hapi arkën e hekurt me një çelës të çuditshëm me duart që i dridheshin nga nervozizmi.

Ndërkaj Naimi e zuri të zotin e shtëpisë nga zverku dhe e hoqi mënjanë. Xha Asllani futi dorën në kasën e hekurt dhe sakaj nxori andej një qese plumb të rëndë me verdhushka.

— Qenkan dupje turqie! — tha Asllani dhe qeshi me të madhe. Pastaj futi dorën përsëri disa herë me radhë dhe nxori qese të tjera me florinj, me menduhi, me më-xhide turku, unaza e gjerdanë prej floriri, inxhi, byzylyqe, si edhe disa pako me pare letër, që kryengritësit nuk i njihnin.

— Cfarë paraje është kjo? — pyeti Mali.

— Pare serbi!

— Mos dredho! — e kërcënoi Naimi.

— Ku i ke marrë? — tha Mali.

— Kur ishim me Pashën në Nish! — iu përgjegj Hasan Beu.

— Përse u ndave me Esad Pashën! — e pyeti xha Asllani.

— Sepse u lidha me Musa Qazimin! Pasha hoqi dorë nga Turqia, kurse unë e shikoj shpëtimin e vatanit vetëm

nga Porta e Lartë e Stambollit. E, ata turqit do të na ndihmojnë, se jemi të një feje, jemi muslimanë, turq!

— Ju shiteni edhe te djalli, vetëm t'ju japid para e çifligje — i tha me përcëm Mali.

— Fjalët e tepërtë janë fukarallëk! — tha me qesëndi Hasan Beu, i cili shpresonte ende se do t'ua hidhte rebelievë me dorëzimin e pasurisë, e cila po i therte në zemër! — A jeni të kënaqur tani? Shkon nga këmbët sytë dhe më lini në punën time!

— Dëgjo xha Asllan! Merre Naimin dhe Lamin dhe, pasi t'i numëroni një për një e të shkruani në letër shumën e përgjithshme të parave e të sendeve që u gjetën tek Hasan Beu, nisuni që sonte, kështu siç jeni, për në Shijak dhe t'i dorëzoni në arkën e qeverisë!

— Si urdhëron, o komandar! — i tha xha Asllani.

— Ju, o shokë! — u tha Mali fshatarëve që rrinin te dera dhe bënin sehir — varrosemi këtë grua të gjorë!

— Po zonjën e beat ç'ta bëjmë? — pyeti një nga kryengritësit.

— Në qoftë se zonja ka dëshirë të shikojë se si do të japë llogari i shoqi, le të qëndrojë! Nëse nuk ka qejf le të shkojë ku të dojë!

Zonja e kuptoi rrezikun që i kanosej të shoqit, se ajo kishte dëgjuar se si e kishin pësuar edhe bejlerët e tjerë në Tiranë, Elbasan e gjetkë; u ngrit nga kolltuku dhe, pasi e vështroi të shoqin, doli nga dhoma duke thënë:

— S'kam ç'të bëj! Po iki në derë të babait!

Hasani nuk u besoi as syve, as veshëve, kur pa e dëgjoi sjelljen e së shoqes.

— Hajde pra të mbarojmë punë! — tha Mali dhe doli jashtë në oborr, ku ishin grumbulluar kryengritësit dhe fshatarët e Fushë-Kazasë.

Mal Xhoka, Asllani dhe Naimi kishin qëndruar në shkallët e kullës. Fshatarët e grumbulluar rrinin përballë tyre. Në një anë dy fshatarë të armatosur kishin vënë mes Hasan Beun, që rrinte kokulur para bujqve, që një ditë më parë kishin qenë rajat e tij.

Të gjithë tani po prisnin se çfarë do të ndodhë me Hasan Beun, që tërë jetën kishte qenë zot i paprekshëm.

i atij vendi. Fshatarët çuditeshin se si ndërruan aq shpejt punët para syve të tyre. Kishin kaluar vite e shekuj dhe ata nuk kishin guxuar të ngrinin dorë kundër bejlerëve dhe pasurisë së tyre, që e quanin të shenjtë e të dhuruar nga perëndia! Kurse tani përpara kishin zotin e tyre me një pamje prej fajtori, që kërkonte mëshirë.

— Dëgjoni, vëllezër! — tha Mali. — Ne erdhëm këtu që të rrëzojmë pushtetin e beat dhe të ngrëmë këshillin e qeverisjes prej fshatarëve. A e shihni pra se ç'domethënë bashkim? Tani s'ka forcë të na dalë përpara! Të flasim për krimet dhe të zezat që kanë bërë bejlerët mbi kurrizin e fshatarëve nuk mjafton as edhe një natë dimri! Ne s'kemi kohë të përsërisim ato që dihen. Tani puna është se ç'duhet të bëjmë! Ju e dini se Esad Toptani u kthyte prapë në Durrës! Musa Qazimi ka tradhëtar kryengritësit, se ai maskara kishte qenë lidhur fshehurazi me disa nga bejlerët e Ndroqit, të Tiranës dhe të Elbasanit.

— E morëm vesh! Mos e zgjat, se na zu mbrëmja thirri një nga kryengritësit. — Duhet të shkojmë në kaza.

— Hajde, pra, na thoni se ç'duhet të bëjmë! — tha një nga fshatarët.

— Sillni një litar këtu! — tha Mali.

— Merre! — i tha një plak. — Është nga malli i Hasan Beut!

— Urdhëro, o Hasan Bej! — i tha Mal Xhoka. — Shtrije litarin! Hajde ti, o plak, që i ke pasur më frikë bejlerët! Zgjidhe tokën ku e do! Mate! Hë, bej, luaj këmbët, shtrije litarin! Ngulni hunjtë. Ma merr mendja se dhjetë dylym tokë janë! Katër frymë jeni apo jo! E gëzofsh, or mik! Hajde ti tjetri!

— O Mal Xhoka mos luajte mendsh! — i briti Asllani. — Pse, ore, ne do të merremi me këtë punë? E ku kemi kohë, ore komandar! Le ta bëjnë këtë dava vetë fshatarët dhe këshilli që do të zgjedhim me dëshirën e pëlqimin e tyre. Ne e bëmë punën tonë! Beun e hoqëm qafe! Hajde, vëlla, të nisemi!

— Ka të drejtë, Asllani! — tha një kryengritës tjeter.

— E pra ç'të bëjmë me Hasan Beun?

— Koburen kokës!

- Prit, ore mik! — tha një fshatar. — Të na japë Hasan Beu tapitë e tokave!
- Ti je fyell, o perëndi! — tha një tjetër dhe ia plasi gazit.
- E ç't'i duam ne tapitë e beut!
- Të djegim kullën dhe letrat që ka aty brenda!
- tha një fshatar i bëshëm këmbëzbathur.
- Qetësi, o vëllezër, nuk po marrim vesh se ç'bëhet!
- thirri Mali. — Hajde, pra, nxirrni bereqetin nga hambarët dhe e vendosni ja këtu, në shesh të fshati, dhe shpérndajeni midis jush. Por, më parë, do t'u epni atyre që nuk kanë bukë në shtëpi, fukarenjve dhe jetimëve!
- E drejtë!
- Hajde pra, fillojmë!
- Një grup fshatarësh, me pisha të ndezura, hynë nëpër kthinat e kullës.
- A e nxorët bereqetin e plaçkën jashtë? — thirri përsëri Mal Xhoka.
- Po, ore, dhe nuk kemi lënë gjë prej gjëje brenda, përveç katër faqeve të mureve — u përgjegj një fshatar.
- Jepni pra flakën kullës së beut! — tha Mal Xhoka.
- Nuk shkuan veçse pak minuta, kur flaka doli nga dritaret dhe catia.
- Dëgjo, o Mal Xhoka, do të të dënojnë rreptë për veprën që po bën, se unë jam turk i vërtetë! — tha Hasan Beu mbytur.
- Një fshatar e kapi nga zverku Hasanin dhe e hodhi për tokë.
- Hiqeni që këtu! — thirri Asllani.
- Qetësi, vëllezër! — Turma që gumëzhinte si koprashë bletësh heshti, dhe Mal Xhoka vazhdoi: — Hajde, si doni ta dënoni Hasan Beun?
- Ta djegim në zjarr!
- Nuk djeg shqiptari në turrën e druve!
- Ta varim!
- Më burrërore është ta pushkatojmë!
- Ta burgosim — tha një plak.
- Turma ia plasi gazit.

— Flisni, vëllezër! ju e keni në dorë! — u tha Mali fshatarëve!

— Të pushkatohet! Të pushkatohet! — britën si në kor fshatarët.

— A ka mendim tjetër! — tha komandari.

Turma heshti.

— E, pra, populli të dënon me pushkatim, o Hasan Bej — tha Mali.

Asllani, Arifi dhe një dy fshatarë e zunë prej krahësh Hasanin dhe e vendosën nën frashërin në mes të sheshit. Hasan Beu nuk mundi të qëndronte më në këmbë, po u shtri për tokë duke ulërirë dhe duke u lutur: «Mos më vrissni, mos më vrissni!» Do t'jua jap të gjitha: pasurinë, tokat, paratë. Ju kam falur faizet edhe borxhet!

— Tani që do të shkosh në botën tjetër dashke të na i falësh të gjitha... — tha një fshatar nga rreshtat e para dhe qeshi me të madhe: ha... ha... ha!..

— Nuk të lusim më të na i falësh, do t'i marrim vetë — tha Arifi.

— Qëlloni! — briti Mali — dhe i pari tërhoqi këmbëzën e pushkës. Pushkatarët, që ishin vënë në rresht, qëlluan njëherësh! Beu u drodh një herë, pastaj mbeti ashtu sic ishte, shtrirë, përmbyss, pa jetë.

— Hiqeni që këtej! — urdhëroi Mali.

Dy fshatarë e zunë kufomën nga duart e nga këmbët dhe e hoqën nga sheshi i fshatit.

— E, vëllezër, ç'të bëjmë tanë? — tha komandari dhe hodhi vështrimin nga turma e fshatarëve që kishin rënë në qetësi. Secili mbante një qëndrim të ndryshëm nga tjetri.

— Ju po ikni! — tha ai plaku që kish ngurruar ta dënonin beun dhe, duke vështruar me sy të dyshimtë komandarin e kryengritësve, shtoi: — Vijnë të tjerët dhe na punojnë qindin!

— Formoni këshillin e kryengritjes fshatare dhe merrini vetë në dorë punët e qeverisë! i tha Mali. — Ja, merrni këto gjashtë pushkë dhe me ato që keni formoni çetën e kryengritësve të fshatit.

— Hajde, kë do të zgjidhni për këshill? — pyeti Asllani.

Fshatarët, pasi propozuan e miratuan anëtarët e këshillit dhe zgjodhën kryetarin, ia filluan britmave për të shtypur atë ndjenjën e panikut, farën e së cilës e kishte hedhur plaku, që nuk kishte besim në të nesërmen.

— Të bashkohemi, o vëllezër, edhe ne me ushtrinë kryengritëse! — u bëri thirrje një fshatar dhe me pushkën në sup doli nga radhët e turmës e u bashkua me kryengritësit.

— Toke, o vëlla! — i tha Mali.

— Edhe unë do të vij me ju! — tha një djalosh i ri.

— Megjithëse e kam këmbën të thyer, deri në kaza do të vij edhe unë me ju.

— Rroftë Mal Xhoka! — u dëgjuan zërat e ndryshëm, të fshatarëve që kishin marrë pjesë në djegien e kullës dhe në pushkatimin e Hasan Beut.

— Rroftë, rroftë Mal Xhoka! — përsëriti turma me të cilën u bashkuan si në kor edhe kryengritësit.

Fshatarët filluan të ndiznin pishat dhe t'i mbanin nëpër duar. Nga kulla e djegur e beut shpërhente ende aty-këtu ndonjë flakë dhe menjëherë ndihej shembja e ndonjë muri, ose trari. Fshatarët nuk po shikonin më andej. Të gjitha ato që ndodhën, dukej sikur u lanë pasdore dhe tani njerëzit mendonin se ç'duhej të bënin më tej.

— Të hamë darkë! — tha kryetari i këshillit, një nga bujqit më të varfër të fshatit, një burrë që sapo i kishte kaluar të tridhjetat, por nga pamja e jashtme dukej si një plakush i mjerë.

— Si thua, Asllan! — pyeti Mali.

— Të hamë darkë dhe të pushojmë disa orë. Të nisemi për në kaza me tre orë natë!

— Hajdeni, pra, djema, të shkojmë nëpër kasollet, kryetari.

— Ju hajdeni me mua! — u tha një fshatar katër luf-tëtarëve që ishin pranë tij.

— Kurse ju të tre, pas meje!

— Ti, Mal Khoka, Asllani dhe Naimi do të shkoni në kasollen e varfër të bujkut — tha kryetari.

— Zemër të bardhë dhe bujari! — u përgjegj Mali.

Kryengritësit u shpërndanë nëpër shtëpitë e fshatarëve, pér të ngrënë darkë e pér të pushuar.

Në orën tre buçiti daullja! Fshati u ngrit i téri më këmbë. Kryengritësit dolën tek sheshi i fshatit. Vullnetarët, pasi u ndanë me gratë, me fëmijët dhe me prindët e tyre, me trasta e shporta nëpër duar, u bashkuau me ushtrinë fshatare.

Turma e kryengritësve fshatarë, që tashti përbëhej prej afro treqind vetësh, nisi marshimin pér në kaza. Disa prej tyre kishin hipur në kuaj, por shumica ecnin më këmbë. Në mes të turmës dy qerre të ngarkuara me ushqime të plaçkitura nga kulla e Hasan Beut përbënин nozullimin e repartit kryengritës.

— Ja fillojmë këngës, o burra! — tha Mali që printe taborin, shaluar një pele të bardhë.

— Mirë të shkoi në mend, se, pér nder, më janë qepur sytë e po më lidhen këmbët nga gjumi i mallëkuar — tha Asllani.

Kryengritësit ia filluan këngës:

«*Krisi pushka-o në Shkozet,  
Kujtoi Vidi se u ba qamet,  
S'bahet luftë me katundar.*

*Bini çuna, o ju faltë zoti,  
Se princ Vidin s'e ze këtu moti,  
Kemi lentun-o prej baroti!*

*Mal më mal-o këndon bilbili,  
Rrofsh e qofsh Haxhi Qamili...  
Rrofsh e qofsh o më gjithë hali,  
Qite Vidin më bejlerë e gjithë urdi...*

*Mal në mal-o këndon bilbili,  
Rrofsh e qofsh, moj katundari!*

Vullnetarët e Fushë-Kazasë, ish-bujqit e Hasan Beut, nuk kishin vënë gjumë në sy, se tërë ato orë që u kishin mbetur, ishin marrë me preqatitje. U ndanë me gratë dhe u lanë porosi pleqve për kohën që nuk do të ishin pranë shtëpisë. Ndihmuani edhe amvisat për të gatuar bukë e gjellë, që do t'i merrnin me vete. Disa prej tyre u morën edhe me pastrimin e armëve, që i nxorën nga fundi i dheut, ku i kishin fshehur kushedi sa kohë përpara.

— Ej... ej... ku po shkoni? — briti një njeri që kishte hipur në majë të një kavaku, që dukej sikur arrinte qiellin.

Kryengritësit qëndruan në vend dhe po prisnin lajme të tjera. Po ai zë tha:

— Xhandarët ju kanë prerë rrugën! Kthehuni... Xhandarët... xhandarët...

Mali vështroi Asllanin dhe zëvendëskomandantin që e cte kaluar përkrah tij.

— Ngjitju kavakut! — i tha Asllani.

Naimi nuk e bëri fjalën dy, hoqi opingat e, pasi la armët në tokë, me një hop iu kacavar trupit të kavakut e, si mace e egër, filloj t'i ngjitej asaj peme të lartë, majat e së cilës nxinin nga çerdhet e lejlekëve. Kryengritësit vërenin njeriun që po i ngjitej kavakut, kurse Mali me Asllanin, Arifi dhe disa bujqë të tjerë të fshatit vajtën me kuajt e tyre mbi një bregore nja njëzet metra më tej.

— Një tabor me xhandarë, me një çauš në krye, po iknin me vrapi nga e majta e qytetit, në drejtëm të Rogenzinhës!

Fshatari vrojtues, sipas porosisë që i dha Naimi, vazhdoi të qëndronte në majë të kavakut, i fshehur pas çerdheve të lejlekëve shtegtarë.

— Ku dreqin shkojnë? — pyeti Mal Xhoka shokët aty pranë.

— T'i ndjekim! — tha një nga fshatarët.

— Ata kanë rënë në erë dhe po ua mbathin! — tha manevr për të na têrhequr jashtë qytetit, qoftë se ua duhet të ecim drejt kazasë.

— Edhe unë ashtu them! — u përgjegj Mal Xhoka.  
— Po edhe ne duhet ta bëjmë një zigzake.

— Hajde, pra, na pri, o komandar! — i tha Asllani, i cili luante rolin e këshilltarit në kompaninë e kryengritësve.

Mali ua bëri me dorë kryengritësve që kishin ndaluar. Të gjithë bënë nga e djathta nja tridhjetë hapa prapa, në drejtim të një gryke që vinte midis dy kodrave.

Sipas organizimit që ishte bërë, tabori ose kompania fshatare kishte edhe një kavaleri të vogël. Fshatarët i sillnin kuajt nga shtëpitë e tyre, ndërsa pjesa tjetër ishte rrëmbyer nga stallat e bejlerëve. Pushkatarët ndaheshin në grupe prej njëzet a tridhjetë vetësh me nga një komendant në krye. Ishte krijuar edhe artileria me topçinj me përvojë. Përveç këtyre kishte dhe kompani që merreshin me transportimin e ushtarëve, të ushqimeve dhe të municioneve. Në ushtrinë fshatare kishte edhe njerëz që dinin të mjekonin plagët e të pregatisnin barna vetë. Organizimi ishte bërë sipas kazave, por disa grupe fshatarësh të armatosur duhej të mbeteshin në fshatrat dhe qytetet, për të ruajtur rendin publik.

Freskia mëngjezore, që të ngjethte pak trupin, tani sapo kishte filluar të largohej. Kryengritësit, pasi hynë në grykë, morën përsëri nga e majta dhe iu ngjitën kodrës së Buallit. Qerret e kuajt mezi po tërhiqeshin nëpër një rrugë të pjerrët, që vinte si shulore. Para tyre, atje përtej, shtrihet fusha dhe qyteti i Kavajës.

— E, ecim, vëllezër! — u foli Mali shokëve që rrinin si të shushatur në majë të kodrës dhe sodisnin detin.

Kryengritësit filluan përsëri marshimin në drejtim të kazasë. Qyteti dukej i humbur midis kopshteve me pemë dhe pjergulla.

Nga maja e kodrës, vërtiteshin lart në quell disa skifterë. Kuajt e ligur të fshatarëve tundnin kokat nga lodhja. Fshatarët, mbathur me opinga, veshur me brenevrekë të bardha të linta, me krahë të mbështetur mbi pushkët e varurë në supe, ecnin pa rregull, duke hedhur këmbët e rreshkura herë nëpër gurë, herë në tokën e tharë, prej së cilës ngruhej një re e dendur pluhuri. Kryengritësit zbritën kodrën. Tani atyre u kishin mbetur vetëm disa

dhjetëra metra për të arritur në periferinë e qytetit. Midis gardheve me kallama u dukën kasollet e shtëpitë prej balte të bujqve e argatëve të bezlerëve. Pak si mënjanë, në të hyrë të një zabeli, kryengritësit takuan një grup fshatarësh të armatosur me pushkë të gjata, kobure e cfurqe. Disa rrinin ulur mbi gurë, disa ishin shtrirë në barin e ri dhe ca të tjerë qëndronin më këmbë. Kuajt e gomarët e tyre me samarë kullosnin disa metra më poshtë në një si gropë.

Mal Xhoka mbajti kalin dhe, pasi u ngrit mbi yzengjitet, vështroi me dyshim vendin përreth, po kur dalloi se ishin fshatarë të thjeshtë të veshur me brekushe të zeza, xhokë me thekë me qeleshe të bardha si cilindra dhe të mbathur me opinga u qetësua. I ra kalit dhe, i ndjekur nga shokët, iu afrua fshatarëve të fushë-kazasë. Si zbriti, përshëndeti me përzemërsi:

— Tungjatjeta, o burra, e mirë se rrini!

— Mirë se vini, o vëllezër! — i tha një fshatar i kaluar në moshë me një lungë sa një gushë gjeldeti në fyt dhe që mbante në prehër një pushkë belgjane të trashë e të shkurtër.

— Këta, o komandar, janë njerëzit tanë! — ndërhyri udhërrëfyesi.

— Menduam të presim sa të takonim ndonjë tabor si ky juaji! — tha po ai plaku me gushë dhe shtoi: — Kallaballëku bën fuqinë!

Bujqit e qytetit u ngriten më këmbë për të përshëndetur miqtë që po vinin nga krahinat e tjera ku ishte shtrirë kryengritja fshatare.

Ata filluan të bisedonin sikur të ishin të njojur prej kohësh.

— Çfarë arme qenka kjo? — pyeti Arifi një djalosh ezmer nga ata të kazasë.

— Martinë! — iu përgjegj tjetri, që nuk e lëshonte armën nga dora edhe pse Arifi po ia tërhiqte.

— Nga je ti!

— Nga Kavaja! — i tha djaloshi që ishte veshur me brekushe dhe xhaketë. — Po ty nga të kemi?

— Unë jam nga fshati Dajt, por kam dy vjet që kam ardhur në Pishtar, buzë Erzenit. Atje në malësinë tonë zë dielli vetëm dy orë në ditë. Në faqen e malit veshur me gështenja është një shtëpi e veçuar nga fshati, një shtëpi e errët me dyer e dritare gjithnjë të mbyllura. Gjakmarrësi ka dy vjet që vazhdimisht zë pritë rrëth e qark shtëpisë. Vetëm tani, që u lidh besa, u largua gjakmarrësi. Po të të bjerë rruga ose po të zuri ndonjë hall, bujrum në shtëpi time!

— Dëgjo këtu! I sheh këto kodra, këto shkurre e zabele! Sa më thellë të futesh, aq më shumë pyje ka! Një komit mund të rrojë atje i qetë njëzet vjet, ose gjithë jetën, fare pa frikë, pa u diktuar nga qeveria. Sa herë që të jetë nevoja vetëm ose me shokë të vish tek unë!

— Ku, në Pezë? — tha Arifi dhe qeshi.

— Në Pezë! — iu përgjegj djaloshi. — Atje kam miqtë e babës.

— Toke, pra! — i tha Arifi dhe shtoi: — Ne po lidhim miqësi me besa-bessë! — dhe, pasi i zgjati dorën, ia shtrëngoi fort.

— Mirë, pra! Na qoftë sahati i hajrit! Bëhemë miq! — iu përgjegj djaloshi me zjarr. — Mua më quajnë Vangjel Kavajasi!

— Qenke kaur! — tha Arifi dhe qeshi me të madhe.

Rrotull tyre ishin mbledhur fshatarë kryengritës, që po dëgjonin këtë bisedë të gjallë. Arifi nxori shishkun nga këllëfi prej lëkure dhije, që e kishte futur në brezin e kuq, dhe me një lëvizje të prerë shpoi me majën e thikës gish-tin e madh. Gjaku plasi si curril.

— Ma jep thikën! — briti djaloshi kavajas dhe ia mori nga dora e pastaj shpoi edhe ai gishtin e madh të dorës së djathtë.

Të dy fshatarët, i zgjatën dorën njëri-tjetrit, u kërrusën njehërësh mbi gishtat e tyre të prërë dhe pinë gjakun e njëri-tjetrit.

— Hajde, qofshi për jetë shokë e miq! — i tha Mal Xhoka, që kishte dëgjuar bisedën e tyre. — Pasi të mbarojë kryengritja do të vij edhe unë në gostinë tuaj të lidhjes burazerë!

— Po ta shtroni me raki e mish sqapi të pjekur, po vij edhe unë — u hodh e tha një bujk nga Myzeqeja.

Komandanti i Pishtarit, pasi bëri një ndalesë të vogël dhe pasi u muar vesh me ata që do të bashkoheshin me taborin e tij, ia hypi kalit dhe thirri:

— Hopa... Përpara, vëllezër, drejt kazasë!

Kalorësit ia morën trokthi, kurse këmbësorët, me pushkët lart, vraponin duke thirrur: «Urra... urra... aaa... aaa... bini, bre, bini!...

Tabori i Malit u hap në një vijë fronti nja pesëdhjetë metra nga ana e lindjes së qytetit. Nga jugu sulmonte një tabor tjetër kryengritësish. Drejt rrugës po vinte një grup ushtarësh të Esad Toptanit, që tërhiqnin mushkat e ngarkuara me topa të çmontuar lidhur pas samarëve, kurse një top të madh me tri rrota e tërhiqte një mushkë e fuqishme. Mali hodhi vështrimin në fushën e betejës dhe pa një grup fshatarësh të shaluar, që po sulmonin drejt një poste xhandarësh. Prapa tyre një grup përpinqej tanjiste topin në breg. Ai vuri buzën në gaz nga kënaqësia që edhe fshatarët kryengritës do të kishin një top.

Armët që mbanin nëpër duar fshatarët kryengritës ishin të llojeve më të ndryshme.

Topi i vendosur mbi shkëmb filloi të qëllonte herë pas here Durrësin e rrethuar nga forcat kryengritëse fshatare. Vetëm një rryp toke lidhte Durrësin me Tiranën, kurse të gjitha anët mbuloheshin me ujë. Nga deti qëllonin me topa pozitat e kryengritësve fshatarë flota ushtarake italiane e greke, që mbanin anën e Esad Toptanit. Nga ana e Shjakut kishte sulmuar në krye të ushtrisë fshatare vetë Haxhi Qamili, por sulmi kishte dështuar, dhe shkaku ishte rrezja e shkurtër e frontit të luftës.

Në Kavajë bejlerët dhe nëpunësat e qeverisë së Vudit ishin kthyer me Esadin. Të shkëmbi i Kavajës, grupet fshatare sulmonin nga të gjitha anët qytetin. Xhandarët sapo kishin marrë vesh për afrimin e kryengritësve fshatarë, një pjesë kishin zhveshur uniformat ushtarake, ndërsa të tjerët ia kishin mbathur për në Lushnjë.

Oxhaqet e bejlerëve nuk tymosnin atë ditë. Dhe kjo tregonët fare qartë se atyre u kishte hyrë frika në palcë.

Tabori i Mal Xhokës tanimë kishte hyrë në qytet! Nëpër rrugë nuk pipëtinte asgjë. Banorët ishin mbyllur nëpër shtëpitë nga frika e luftës. Dyqanet, të mbyllura me qepena prej druri, dukeshin fare të shkreta. Në anën tjetër të pazarit, nga shtëpitë e ulëta përdhese, të rre-thuara me mur qerpiçi, gjysmë të rrëzuara ose që kishin lëshuar bark, shquhej një godinë e madhe dykatëshe me dritare me xhamë, me ballkone e divane të mbajtura nga shtylla të larta, me pullaz mbuluar me tjegulla dhe me disa oxhaqe ndërtuar me tulla të kuqe, që binin në sy nga larg. «Kjo do të jetë shtëpi bejlerësh!» — tha me vete Mali, që po ecte kaluar në ballë të ushtarëve të tij. Të shtëna pushkësh erdhën nga muret e larta të sarajeve të bejlerëve. Një kalorës i hipur në një kalë gërdallë, nga ata të bujqve të fushës, ra poshtë pa jetë, sikur ta kishte kositur njeri. Mali, që e pa, por që nuk kishte kohë të qëndronte, nxori një britmë lufte.

Kryengritësit fshatarë filluan të shtinin me pushkë e kobure në drejtim të mureve të sarajeve të bejlerëve. Kurse kalorësit qëllonin me pushkët që mbanin me një dorë, duke ecur trokthi. Muret e shtëpisë së lashë të pa-prekshme të beut të Kavajës u drodhën nga krismat e pushkëve. Mali kishte qëndruar në një kopsht para sarajeve dhe po vrojtonte vendin me dylbi. Një njeri u rrokullis ndanë rrugës. Nëpër frengjité e mureve tytat e pushkëve villnin zjarr. Pas një copë herë vendin përreth e mbuloi tymi e flaka. Mali dha urdhër të pushonte qitja. Por disa nga pushkatarët, që nuk dëgjuan urdhërin, vazhdonin të qëllonin herë pas here. Tytat e pushkëve të vendosura nëpër frengjité nuk vollën zjarr. Ndërsa komandari i taborit po mundohej të gjente arësyet e pushimit të zjarrit nga ana e xhandarëve, porta e madhe e kullës u hap dykanatash dhe dy veta me shami të bardha dolën pérjashta.

— Pas meje, burra! — briti Mali dhe mori përpara me revan në krye të kalorësve që e ndoqën nga pas.

Këmbësorët vrapan pas pararojës duke thirrur dhe duke sharë mbarë e prapë bejlerët. Pasi hynë brenda në oborr, ushtarët kryengritës qëndruan para shkallëve të

drunjta dhe dritareve të skalitura me figura gjeometrike. Një plumb, që s'u muar vesh nga erdhi, qëlloi në kokë Vangjel Kavajën, që disa orë përpara piu gjak vëllazërimi me Arif Dajtin. Shokët në fillim nuk e kuptuan se cilin qëlloi plumbi. Vangjeli me kokën e biruar tejpërtej ndejeti një çast mbështetur pas një pishe dhe mandej menjëherë u rrëzua për tokë. Gjaku i kuq rrođhi në plloçat e bardha prej mermeri. Arifi, pasi shtyu me bërryl nja dy veta, që i kishin dalë përpara, u hodh mbi shokun e vrarë dhe vetëtimthi u përpooq t'i zinte me shaminë e kuqe të qafës vrimën e kuqe të hapur tamam në lule të ballit. Por çdo gjë ishte e kotë, gjaku vërvshonte si burim dhe shamia iu bë qull. Arifi, kur pa sejeta e burazerit të tij kishte mbaruar, ia uli kokën që mbante në dorë dhe ia mbështeti mbi xhokën e shtruar në vend të jastëkut. Mali ia mbuloi kokën me shami. Arifi u ngrit më këmbë dhe qëndroi disa sekonda me një vështrim fare të ngrirë, pastaj sokëlliti me një zë të egër dhe u turr nga shtëpia. Hyri brenda në një nga kthinat e shtëpisë shumë të madhe dhe, pa parë se me cilin kishte të bënte, qëlloi me pushkë ku mundi. Një shërbëtor, që kishte qenë aty ra përmbyss, kurse tjetri, një plak që tèrë jetën u kishte shërbyer bejlerëve, u kërrus si një kërmill dhe mbeti ashtu i palëvizur, si i kallkanosur. Nër odat e sarajeve hynë edhe fshatarët e tjerë të armatosur dhe me bajonetat e hapura të pushkëve shkatërronin arkat, raftet e orenditë e tjera. I zoti i shtëpisë, një nga bejlerët më të shquar të parisë, ishte zhdukur pa lënë nam e nishan, sikur ta kishte përpirë dheu. Të parët e tyre kishin menduar edhe për rreziqet që një ditë mund t'u kanoseshin nga armiqtë, prandaj i kishin marrë masat. Beu i madh ishte fshehur në murin e sajuar nga të parët e tij, një mur i trashë, që mbyllej e hapej nga një derë falso me blloqe guri. Pas atij murit vinte një kthinë e fshehur, që në rast nevojë nxinte deri pesëmbëdhjetë njerëz. Në atë vend ishte struktur beu me familjen e tij. Mal Xhoka rrinte përjashta në oborr dhe priste që kryengritësit të nxirrin Jashtë të zotin e shtëpisë.

— Po vijnë ca kalorës me ngut — thirri një kryengritës. Mali ktheu kokën nëpërmjet portës së hapur dhe pa se

nga kreu i rrugës, në krye të kalorësve të veshur me qillota e xhaketa dhe me shpatën zhveshur, po vinte Xhavit Beu shtatlartë. Komandari e kuptoi vetëtimthi rrezikun që i kanosej dhe, pasi u kthye nga fshatarët, bërtiti:

— Tradhti... tradhti, vëllezër... po na qëllojnë pas shpine! Ejani shpejt pas meje! — ia hipi kalit dhe, duke i rënë në bark me thembra me sa fuqi pati, iku revan pas shtëpisë, drejt një kopshti që dukej si një zabel i vogël i shoqëruar nga shokët e tij.

— Kapeni tradhtarin e turkut! — thirri Xhavit Beu.

Mali kishte arritur para një gardhi të lartë, që dukej i pakapërcyeshëm. Ai tërhoqi frenat e kalit, që u ngrit me të dyja këmbët e para dhe ra mbi gardh. I kapur fort pas kreshtës së kalit dhe pa marrë parasysh ferrat që e shponin, Mali kërceu në anën tjetër. Njëri nga djemtë e taborit, djalili i të zotit të shtëpisë ku Mali kishte bujtur një natë përpara, kur pa se ç'po ndodhë, u turrpas komandarit për t'i ardhur në ndihmë. Kali i tij i ligur u rrëzua në mes të ferrave, ndërsa kalorësi ra përbys. Xhavit Beu, që e arriti i pari djalin e bujkut, e goditi me majën e shpatës. Pas tij e qëlluan me shpatë edhe kalorësit e tjerë trupin e djaloshit të mjerë. Kali i Xhavinit nuk bëri më dot përpara, ai i u tremb ujit që rridhte rrëmbyeshëm në një vijë, menjëherë pas gardhit. Kalorësit e tjerë filluan të qëllonin me thembra e me kërbaçë kuajt që kundërshtonin të hidheshin përtëj.

Xhavit Beu me forcë, duke ulëritur si kafshë, ktheu kalin dhe u turr nga porta e madhe duke bërtitur: — Pas meje... aa... aa... oo... na iku, na iku!..

Kalorësit u vunë revan pas beut të tyre.

Beu i Shënavlashit, luante një rol të dyfishtë: ishte një ndër agjentët e fshehur të Esadit dhe hynte e dilte tebdil në pallatin e tij. Nga ana tjetër ai mbante lidhje edhe me Musa Qazimin. Luftonte dhe vriste pa mëshirë ata që ishin patriotë shqiptarë dhe mbronte ata bejlerë që ishin për bashkimin e vendit me Turqinë dhe që përkrahnin programin panislamik të Kongresit të Shijakut të frymëzuar nga turkomanët e agjentët xhonturq.

Pas sulmit të Mal Xhokës në Fushë-Kaza, Xhavit

Beu, i informuar për vrasjen e një mikut të tij, me të cilin kishte lidhje krushqie, e ndoqi mjaft armikun, por s'e arriti dot. Ai e dinte se midis Mal Xhokës, Rom Lekës dhe Haxhi Qamilit kishte mosmarrëveshje në lidhje me flamurin dhe me shkrimin e gjuhës shqipe në alfabetin latin, por dinte edhe se, përsa i përket luftës kundër Esad Toptanit dhe bejlerëve të tjerë mendimet e veprimet e tyre përputheshin krejtësisht. Ai nuk kishte mundur të zbulonte nëse kishte dorë edhe Haxhi Qamili në vrasjen e mikut të tij, apo kjo ishte vepër e Mal Xhokës, e këtij fshatari të rrezikshëm, që ishte edhe njeri i mësuar, lexonte e shkruante shqip. Xhavit Beu nuk arrinte të përcaktonte qëndrimin e sjelljet e Haxhi Qamilit, i cili shtihet sikur ishte fanatik i fesë turke. Mos vallë këtë e bënte për të marrë në duart e veta pushtetin që kishte myftiu i Tiranës, duke shfrytëzuar fanatizmin në radhët e disa fshatarëve, sidomos të moshuarve, të cilët dikur kishin luftuar në radhët e ushtrisë së osmanlinjve? Po atëhere, si shpjegohet që ky Haxhi Qamili e njerëzit e afërt të tij, rrafshonin teqe e tyrbë dhe u vinin zjarrin pa mëshirë? U prisin mjekrat baballarëve dhe dervishlerëve dhe gjithë atyre hoxhallarëve që bënин nuska dhe gënjenin popullin? A nuk ishte ai, Haxhi Baba që, duke hedhur gurin e mirë në Erzen, u kishte dhënë një grusht fanatikëve të Shijakut e të Kavajës? Po çudia më e madhe ishte që Haxhi Qamili respektonte të krishterët dhe i quante vëllezër. Në Elbasan kishte urdhëruar të gjithë të krishterët të mos kishin frikë dhe detyrimisht të shkonin në kishë e të merrnin pjesë në meshat e tyre! Kur vjen puna ky mjekërcjap bashkohet pra, me këdo nga halia, për të luftuar bejlerët! Po ky Haxhi Qamil mjekërcjapi ishte, që në Valijas vuri litarin, u shpérndau tokën e huaj bujqve duke u thënë: «Ta gëzoni tokën, ajo u përket fshatarëve që e vadisin me djersë e gjak!» Këto punë të padëgjuara, që t'i rrëmbesh tjetrit tokën e pasurinë, të bëjnë të luash nga mendtë. Këtu qëndron rreziku! Ka të drejtë Esadi kur thotë se ky qen i tërbuar e i lëshuar nga zinxhirët do të na hajë të gjithëve; si mua ashtu edhe myftiun budalla të Tiranës, që i dha atij edhe pushtet! Ky u mësoi fshatarëve e bujqve

atë që nuk e kishin dëgjuar kurrë në jetën e tyre: merrni me dhunë pasurinë e bejlerëve, se u përket juve! Kurse ne përrallisim, jo duam princ Vidin, jo princ musliman nga Stambolli, jo të lidhemi me Austrinë, se ajo e ka në zemër Shqipërinë, Kral Pjetri ka dekluarar pavarësinë e Shqipërisë, Italia do të japë huara, jo kjo po ajo! Rreziku, si për turqit, si për kaurët, agallarë e bejlerë, është kryengritja rebele e Haxhi Qamilit! O burra të lidhemi njëri me tjetrin dhe ta zhdukim këtë farë të hidhur, se, përnder, na mori lumi të gjithëve!» Këto po bluante ndër mend Xhavit Beu që kishte qënduar mbi një bregore dhe po vrojtonte se nga ia mbajti armiku i tij.

Mal Xhoka me një grup fshatarësh kryengritës, pasi iu shmangën goditjes së befashishme të kalorësve të Xhavit Beut, këtij spiuni të rrezikshëm të Esadit, zuri pritë në bokat e Përroit të Poçes, prapa të cilit ishte një mulli i rrënuar i lënë pasdore. Pishtarakët i lidhën kuajt pikërisht aty në lëndinën e vogël që dikur kishtë shërbyer si shesh para mullirit ku fshatarët prisnin me kafshë të ngarkuara radhën për të bluar misrin. Komandantit të Pishtarit i vinte plasja që u gjet ashtu pa pregetitur dhe i pambrojtur nga sulmi i rrufeshëm i Xhavit Beut aty te sarajet e beut të Kavajës.

— Zini prita, o burra, dhe pregetituni për betejë!  
— i urdhëroi ai shokët.

Për të tërhequr në betejë armikun e egërsuar, Mali u ngrit më këmbë mbi një kaçube në majë të bokës së zhveshur dhe qëlloi me pushkë në drejtim të kalorësve që shqueshin fare qartë jo më larg se rrëth dyqind metra nga prita e tyre. Pasi qëlloi tri herë me radhë, nxori një britmë lufte që të kallte frikën... «E... eo ooo-aaa-».

Mercenarët e panë zotin e tyre me vështrime të dyshimta. Ata e dinin mirë se çfarë i priste po të përllesheshin ballë për ballë me kryengritësit kokëshkretë. Xhavit beu sedërmadh, që e kuptoi hezitimin e njerëzve të tij, nxori nagantën nga brezi dhe pa pritur mendimin e tyre, u sul drejt mullirit duke ulëritur si ujk i uritur. Kalorësit u detyruan ta ndiqnin beun e tyre.

Me t'u afruar jo më shumë se tridhjetë metra, kalorë-

sit, nën breshërinë e plumbave të kryengritësve, u hodhën nga kuajt dhe u hallakatën në tokën djerr duke zënë kush e kush ndonjë breg apo shkurre për të shpëtar ko-kën. Dy prej tyre ranë pa jetë.

I treti i plagosur në shpatull u rrrokullis poshtë në vijën e mullirit. Të tjerët të tmerruar nga klithmat e Xhavit Beut filluan të luftonin.

Beteja nisi e ashpër.

Mali vuri në shënjestër një mercenar. Trupi i bëshëm i tij dilte mbi vendin e pritës. Një e qëlluar në shenjë bëri që armiku të lante duart nga kjo jetë.

Komandanti i Pishtarit në mesin e zjarrit të betejës përpiquej të zbulonte njerëzit e Xhavit Beut, por ende nuk po i shquante. Mali, për të mashtuar armikun, la xhokën në pozicionin fillestar dhe barkazi doli në krahun e djath-të, që ishte një pozicion dominues. Dhe, me të zënë pritën e re, ai filloi të qëllonte mbi njerëzit e beut. Kur Mali e kuptoi se njerëzit e Xhavit Beut po tërhiqeshin zvarrë-zvarrë nga fusha e betejës, ai u ngrit më këmbë dhe, duke ftuar shokët, sulmoi i pari. Kryengritësit fshatarë, me britma, sulmuan përpara duke u dhënë një zjarr të fortë armiqve. Ata përparuan një pesëdhjetë metra dhe zunë bri-njën e vijës së mullirit.

Mali kërkonte me sy Xhavit Beun. Nga krahu i majtë, në të hyrë të zabelit, që dukej si arnë në faqen e asaj kodre, ai dalloi disa kalorës që iknjn revan njëri pas tjetrit.

Xhavit Beu po ikte nga fusha e betejës! Mali e njoihu nga pela e bardhë e cila fluturonte në rrugën që për-shkonte mesin e zabelit. U ngrit në gjunjë dhe shpejt e shpejt mori nishan në një pikë të bardhë. Pastaj u ngrit më këmbë dhe, duke bërtitur, u hodh në sulm i shoqëruar nga shokët. Ata që mbetën, nga njerëzit e Xhavit Beut ngritet një shami të bardhë ngulur në majë të bajonetës.

Beteja kishte marrë fund! Përfundimi i saj: dy të vrarë, katër robër dhe Xhavit Beu me qehajanë e tij, një sahanlëpirës nga Gosta. Një grup mercenarësh ia kishin mbathur vrapi. Fshatarët robër të vënë në shërbim të beut, u luteshin kryengritësve t'u falnin jetën.

Nga ana e pishtarinjve mbeti vetëm një i vrarë.

Kryengritësit u nisën për të pushuar dhe për të ngrënë drekën drejt fshatit në majë të kodrës.

\* \* \*

Në rrugët e kazasë mbretëronte rrëmuja. Disa fshatarë hapën dyqanet dhe u duk qartë se po plaçkitnin, me gjithëqë ky veprim dënohej nga komanda e tyre. Ca të tjerë, të armatosur, shoqeronin dy njerëz që i kishin lidhur dhe po i çonin diku. Pranë sahatit, që përngjante si një kullë romake, një grup fshatarësh të armatosur kishin vënë në faqe të murit një caush dhe po pregetiteshin për ta pushkatuar. Të shtëna pushkësh dëgjoheshin andej-këndej.

Në pazar, nëpër taftabenat e mejhaneve ca njerëz ia kishin shtruar me raki e meze dhe, duke bërë potere, ngrenin dolli për fitoren, për përbysjen e pushtetit të Esad Toptanit!

— Ta pimë për shëndetin e Haxhi Qamilit! — bërtiti një picalliot!

Një fshatar i gjatë si purtekë ulliri u duk në rrugën e Shijakut duke thirrur: — Po vjen Haxhi Qamili... po vjen Haxhi Baba! Në rrugën kryesore befi një tabor me ushtarë. Në krye ishin trumbetierët, që u binin trompetave. Pas tyre vinte kavaleria e formuar nga tridhjetë kalorës dhe në krye, shaluar një pele të bardhë, ishte Haxhi Qamili; me shtat nën mesatar, me mjekër ngjyrë kënaje, veshur me uniformën e një gjenerali, me një këllëç lidhur pas mesit dhe me kobure në brez. Baba, me buzën në gaz, nderonte majtas e djathtas fshatarët e armatosur dhe qytetarët që rrinin trotuarëve. Fshatarët e armatosur të hallakatur, që nuk dinin gjë ende për ardhjen e Haxhi Qamilit, sidomos ata që ishin shtruar në pazar, sapo dëgjuan emrin e Komandantit të ushtrisë fshatare mblodhën poçet e rakisë dhe i zhdukën. Të gjithë e dinin se Haxhi

Baba, po të shihte se ushtarët e tij pinin raki, i vriste në vend!

Turmat e fshatarëve të armatosur dhe vegjëlia e kazasë u mblodhën te sheshi i sahatit pranë zyrave të hyqy- metit pér të pritur prijësin e kryengritjes fshatare, Haxhi Qamilin. Disa prej fshatarëve, që ende nuk e kishin parë Haxhi Babën, shtyheshin të dilnin në rreshtat e para.

— Rroftë e qoftë Haxhi Qamili! — briti një fshatar.

Turma rrëth sheshit thërriste si e xhindosur: «Rroftë Haxhi Qamili, shpëtimtari i halisë!»

Haxhi Baba kafshonte buzët plasa-plasa dhe me sytë gjysmë të perënduar, fërkonte mjekrën. Ai rrinte mbi pelën e racës arabe duke e mbajtur me vështirësi ngazellimin që e kishte pushtuar.

Para disa muajsh ai nuk kishte qenë gjë tjetër, vetëm një copë fshatar nga Sharra e Tiranës. Ditëve të pazarit zbriste në Tiranë me gomarin e ngarkuar me presh. Pasi shiste gjysmën e preshve dhe gjysmën ua shpërndante fukarenje, kthej i menduar në shtëpi. Tashti atë po e brohorisnin qindra e mijëra fshatarë si shpëtimtarin e tyre, që kishte guxuar i pari të ngrinte grushtin dhe t'i vinte zjarrin Esad Pashë Toptanit e bejlerëve të tjerë. Kësaj herë Haxhi Qamili, i shkëputur nga myftiu i Tiranës, luf- tonte në krye të fshatarësisë kundër Esadit të paprek- shëm dhe kundër bejlerëve të tjerë.

Ishte krenar dhe i gjëzuar në shpirt pér respektin që i bëhej.

Pér kryengritjen fshatare dhe pér Haxhi Qamilin shkruanin edhe gazetat e Evropës. Në ushtrinë e tij, sipas raporteve të dërguara nga komandantët e të gjitha kazave, bëheshin mbi tridhjetëmijë ushtarë të armatosur. Repar- tet e ushtrisë fshatare përbëheshin kryesisht nga këmbë- sorë, por komanda e tyre formoi edhe artilerinë me dyzet topa!

Haxhi Baba zbriti nga pela.

Kryetari i këshillit të kryengritjes fshatare të kazasë e përshëndeti Komendantin e ushtrisë fshatare duke e përqafuar fort.

— Ku e keni telegrafistin? — pyeti Haxhi Baba dhe

shtoi: — Duhet t'u bëjmë njoftim të gjithë kazave për ta rrëzuar qeverinë e Esadit dhe t'u japim lajmin e çlirimt të Kavaiës.

Turma filloi të fliste e të gumëzhinte. Një qytetar thirri nga mesi i turmës:

— E kanë futur në burg!

— Lirojeni dhe sillmani menjëherë këtu! — briti me zemërim Haxhi Baba duke iu drejtuar fshatarëve të armatosur.

Një grup fshatarësh të armatosur, që e dinin se ku ishte burgosur telegrafisti, u zhdukën si erë nga sheshi dhe pas disa minutash sollën para komandantit të tyre telegrafistin, një burrë të ri, të pashëm, të veshur me pantallona, me xhaketë dhe një festë të zezë prej kadifeje në kokë.

— Përse rri kokulur? — e pyeti Haxhi Qamili.

Turma kishte rënë në qetësi, sa dëgjoheshin edhe zhu-katjet e mizave.

— Ngreje kokën! — vazhdoi Baba. — Të kemi futur në burg, se i ke shërbyer qeverisë të Esad Pashës! Bashkohu me ne!


— Nuk kam gjë për të ndarë me fshatarët! — u përgjegj telgrafisti dhe shtoi: — Unë jam i varfër dhe jetoj vetëm me rrogë!

— Shko, pra, e puno në telegrafhane, se edhe ne do të të japim rrogë.

— Mirë, Haxhi Baba, do të punoj me ju! — tha telegrafisti i çelur në fytyrë nga kjo e papritur.

— E patë! — tha Haxhi Qamili duke iu drejtuar turmës: — Baba, nëpunësit e vegjël që ia kthejnë Pashës i pranon në punë! Le të bashkohen me ne!

Haxhi Qamili nuk dinte se çfarë t'i thoshte asaj turme që e rrethonte, e cila priste të dinte se si do të qeverisej vendi pas rrëzimit të qeverisë së Esad Pashë Toptanit dhe pas përmbysjes së bezlerëve. Baba e ndjente që i mungonte diçka. Iu afroa njërit prej njerëzve më të afërt, Reshitit, dhe i tha në vesh disa fjalë me zë të ulët. Reshitit luajti kokën dhe vuri buzën në gaz. Ai ishte fshatar kryengritës nga Qafë Krraba e Elbasanit dhe nuk dinte më tepër se Haxhi Qamili.



## ESAD PASHA DHE ÇENGIA

Xhavit Beu, që ishte piviti<sup>1)</sup> më besnik i Esadit, e informoi kryezotin se çengia e tij, e bija e Cijes, e zënë me bejlerët, nuk ishte gjetur në shtëpinë e saj në Tabakhanë! Kjo lagje e vogël me shtëpi përdhese, të ulëta, të ngjitura njëra me tjetrën, që dukej si çerdhe lejlekësh, shtrihej gjatë bregut të Reçes, që derdhej diku pranë urës romake, në Lanën pranë Rrapit të Tabakëve. Shtëpia e Cijes, e futur në një si gji brenda përroit, rrëthuar nga pjergullat e pemët e tjera frutore dhe e mbuluar me tje-gulla të kuqe, dallohej nga kasollet e tjera e nga disa shtëpi që mezi mbaheshin më këmbë.

Dashnore e Esad Pashës kishte qenë dikur Cija, po tani ajo qe plakur dhe vendin e saj e kishte zënë e bija shtatëmbëdhjetëvjeçare, që ishte ku e ku më e përsosur dhe më e bukur se e ëma! Cija falënderonte fatin që Pashai i Tiranës ishte përsëri jarani i shtëpisë së saj dhe që kështu ajo jetonte midis të mirave. Kishin dysheqë leshi dhe jorganë atllasi. Dhoma e shtruar me sixhade ngrohej dimrit me stufë prej qeramike, të ardhur nga Italia. Ushqimet nuk mungonin kurrë dhe ato, nënë e bijë, nuk kishin punë tjetër vetëm e vetëm se të stolise-shin, të hanin e të pinin, të këndonin dhe t'i binin dajres. Sipas marrëveshjes, çengia e re duhej të priste dhe të bënte dashuri vetëm me jararin e saj, Esad Pashën. Por krye-

---

1 pivot — spiuun (këtu)

toptanasi merrej edhe me punët e shtetit dhe herë pas he-re zhdukej për një kohë të gjatë.

Kohët e fundit Ezmerinës, bijës së Cijes, i kishte rënë më qafë një tiranas që kryente detyrën e fillorojtësit, i cili ishte i njojur në qytet për çapkënllëqet që bënte. Ceni, një burrë i pashëm me shtat të lartë, me ca sy gri të më-dhenj dhe të hazdisur, me një hundë të rregullt, ishte armik i betuar i Esadit, jo vetëm se e urrente si feudal dhe tradhëtar që ishte lidhur me njëqind qeveri, por edhe për kapadaillëqet e tij. Cija kishte pasur edhe herë të tjera oferta nga fillorojtësi, por ajo nuk i kishte pranuar, pasi ato mund të binin në sy dhe të merreshin vesh nga pivitet e Esad Toptanit. Përveç të mirave që solli në shtëpi të çengisë, Ceni i premtoi Cijes se marrëveshjet me Ezmeri-nën do t'i mbante shumë të fshehta.

Sapo kishte hyrë vjeshta e vitit 1914, kur Esad Top-tani me ndihmën politike dhe financiare të qeverisë serbe u kthye në Tiranë. Esadi ndeji pak ditë në Tiranë, sepse ai nuk e ndjente veten të sigurt. Përpara se të largohej për në Durrës, ku do të formonte qeverinë, mendoi t'i bënte një vizitë çengisë së tij, Ezmerinës! Iu zgjua një kuj-tim i fashitur, që i fliste për një lumturi të ëmbël. Pashait i fërgëllonte zemra kur mendonte se do të kishte përsëri në krevat Ezmerinën e re, lozonjare.

Esadi u xhindos kur mori vesh se Ezmerina e tij nuk gjendej atë mbrëmje në shtëpi dhe për fat të keq Xhaviti, i dërguari i pashait, nuk e kishte takuar as edhe të ëmën. Shtëpia e ndërtuar nga toptanasi ishte e kyçur! Pas hetimeve që bëri të nesërmen, Xhavit Beu i tregoi pashës fije e për pe historinë e çengisë së tij. Ceni jetonte me Ezmerinën si burrë e grua. Jaranit i duhej të bënte shumë për çenginë, që ajo të mos mërzitez. Çdo të enje në shtëpi të tij bëhej aheng me një grup njerëzish të kufizuar, që ishin shokët e tij të ngushtë, midis të cilëve ishte edhe një prift ortodoks me origjinë nga Elbasani. Kur bëhej në qejf nga rakia dhe ahengu, prifti kërcente vallet e napolonit; kjo valle, mënyra se si hidhej e përdridhej prifti dhe si i tundej mjekra e zezë sterër, që dukej si fshesë, ishte nga skenat më argëtuese për çenginë. Ceni

kalcante ditët pa e çarë kokën për zakonet dhe thashethemet e të tjerëve.

Fillorojtësi i shërbente qeverisë kryengritëse fshatare dhe e lëvdonte Haxhi Qamilin, i cili u kishte ardhur hakut të gjithë bezlerëve. Ai nuk ishte dakord me Haxhi Qamilin vetëm për ndalimin e rakisë!

Esad Toptani e njinte fillorojtësin dhe e dinte fare mirë që ai nuk e dorëzonte kurrë vullnetarisht Ezmerinën. Sipas një bisede që bëri një ditë përpara me qahajin për çështjen e Ezmerinës, Esadi vendosi të merrej vetë me këtë punë. Në mesnatë, Esadi, i veshur tebdil, shkoi në shtëpinë e Hysen fillorojtësit në lagjen Ismail Efendi. Shtëpia ishte rrëthuar nga një kopsht portokallash dhe hurmash. Pashai trokiti në derë.

— Kush troket në këtë orë të vonë? — u dëgjuat një zë i mbytur brenda oborrit.

— Jam një mik i largët! — tha Esadi dhe u bë gati të sulmonte kundërshtarit me një kamë, që e mbante të fshehur nën gunën e veshur mbi uniformën ushtarake të gjeneralit.

— O, mirë se vjen, o mik i largët! — iu përgjegj me përzemërsi fillorojtësi dhe shtoi: — Prit sa të vihem!

Ceni ia kishte bërë beftin rrezikut! Hapi portën përnjëherësh. Me njëren dorë mbante nagantën dhe me tjetren një bastun prej druri shkoze. Mysafiri, me kokën të lidhur me shami, hapi sytë që i ndrisnin në atë errësirë dhe për një çast qëndroi i hutuar nga ajo e papritur. Fillorojtësi e njohu pashanë nga trupi mesatar dhe i bëshëm dhe, sa hap e mbyll sytë, e qëlloi ku mundi: në zverk, në sup dhe pas shpine! I paftuari ra për tokë dhe rënkoj si qen i rrahu. Pasi e mblodhi veten, u ngrit më këmbë dhe u sul nga rrugica të ikte! Ceni e la të ikte, kinse i panjohuri t'i kishte shpëtuar nga duart. Fillorojtësi u bind krejtësisht që ai ishte Esad Pasha, kur e pa tek po ikte, nga trupi i ngjeshur dhe nga të ecurit, që i përnga jante atij të një ariu.

Kryetoptanasi, i zemëruar nga rrengu i atij qytetari

sherrxhi, që përveç dajakëve i kishte rrëmbyer edhe Ezmerinën, urdhëroi Xhavitin dhe një oficer tjetër që ta arrestonin dhe ta burgosnin fillorojtësin e rrezikshëm, i cili po komplotonte kundër qeverisë legale, si bashkëpunëtor me kryengritësit rebelë të Haxhi Qamilit. Cen fillorojtësi po atë natë ua mbathi nga qyteti në Picall dhe të nesërmen u bashkua në pyjet e Sharrës me komitët e Haxhi Qamilit. Ezmerinën, të nesërmen, me një karrocë të mbuluar, njerëzit e Esad Pashës e dërguan në sarajet e Esadit në Laprakë. Pas disa ditësh, kur Esad Pashë Toptani u nis në krye të ushtrisë mercenare për në Durrës, mori më vete edhe Ezmerinën. Çengia udhëtoi me një karrocë të veçantë, që tërhiqej nga dy kuaj të bardhë, e shoqëruar nga dy oficerë besnikë të pashait.

## NJË KOMPLOT TJETËR

Esad Pashë Toptani rrinte i rrethuar në Durrës, prej nga drejtonte luftën kundër forcave kryengritëse fshatare, të cilat sulmonin herë pas here qytetin e mbrojtur mirë.

Luftrat e Rashbullit dhe ato të buzës së detit, nga ana e shkëmbit të Kavajës, ishin nga më të përgjakshmet. Fshatarët sulmonin me guxim dhe i afroheshin Durrësit në afërsitë e lagjeve të para. Po kur fillonte qitjet artilleria tokësore, e ndihmuar edhe nga anijet luftarake italiiane, ata detyroheshin të tërhiqeshin të dëshpëruar dhe të dërmuar nga predhat.

Esadi, i veshur me rroba të zeza, me një pallto të madhe të çarë nga prapa, me këmishë të kollarisur, me papion të lidhur pas fytit, me një kallpak të zi prej kadiifeje në kokë e me një bastun elegant në dorë, rrinte përpara një topi fushor me rrota, duke vrojtuar zhvillimin e betejës. Gjenerali toptanas trupmesatar, dhe me gjoksin të mbushur me dekorata, kishte një pamje impozante, të kultivuar qysh në rini në rrethet perandorake turke. Ai besonte se gjaku i fisit të tyre toptanas ndryshonte nga ai i njerëzve të tjerë, aq më tepër nga ai i njerëzve të thjeshtë, siç ishin fshatarët e barrikadës tjeter prapa telave me gjemba. Duke qenë i sigurt se gjendej jashtë rrezikut, Pasha i Tiranës rrinte enkas në ballë të fushës së betejës para topit, për të ngritur moralin e njerëzve të tij. Në Durrës konsullatat e fuqive evropiane vazhdonin të qëndronin dhe secila kryente akte spiunazhi e diverzioni në interes të shtetit që përfaqësonte.

Esadi, duke parë fushën e betejës, mendonte qëllimet e tij, vrullin e tërbuar të papërmabjatur të turmave fshatara, që luftonin egërsisht kundër forcave të komanduara prej tij.

«Si do t'i dilet në krye kësaj gjendjeje?» pyeste veten Esad Pasha! A nuk kishte ndodhur një rebelim i padëgjuar edhe në çifligjet dhe në bujqit e tij? Katundarët e armatosur komandoeshin nga një farë Haxhi Qamili, një rebel i paditur, që deri dje dinte vetëm të lëronte tokën dhe të priste dru e asgjë tjetër. E pikërisht pra ky njeri po udhëhiqte turma fshatarësh të armatosur kundër pashës e kundër kryezotit të tij!

Një korrespondent i gazetës «Korriere dela Pulie» iu afroa Esadit dhe, pasi e përshëndeti me kokë si xhentëlmen, i kërkoi leje t'i bënte dy fotografi. Esadi e mbajti një çast frymën dhe, kur e pa se ai mbaroi së fotografuari, përshëndeti me një buzëqeshje të lehtë dhe, me një lëvizje të rëndomtë të kokës, i dha të kuptonte korrespondentit që ta linte të qetë. Esadi ishte mësuar t'u jepte intervista gazetarëve të huaj. Artikujt që shkruheshin në gazetat e kohës, ai kishte porositur që t'ia dërgonin dhe, nëpërmjet të tyre, «mbreti i ardhshëm i Shqipërisë», siç e quante ai veten, informohej pér qëndrimet politike të shteteve dhe pér marrëdhëniet diplomatike midis tyre. Ai i quante gazetarët si një mjet i mirë komunikimi me rrethet politike të qeverive të botës dhe pikërisht pér këtë arësy pajtohej në shumë gazeta. Një natë përpëra u kishte hedhur një sy gazetave «Dielli», «Atdheu», «Korriere dela Pulie», «Società italo-albaneze di komerçio e navigacione, Roma», «Besa shqiptare», «Athina», «Bashkimi i Parisit» edhe një gazetë të çuditshme, që e nxirrin në Itali socialistët. Në këto faqe të gazetave mësoi pér gjendjen e luftës, pér marrëdhëniet diplomatike midis shteteve dhe pér mjaft lajme e ngjarje në Shqipëri. Kryengritjen fshatare kundër Esad Pashës e quanin revoltë alla Panço Vila. I kishte bërë përshtypje një artikull i «Diellit», që dilte në gjuhën shqipe në Boston «Gjeneral Isa Buletini dhe Dejli Telegraf» më 5 maj 1913 merr intervistën në hotel «Grand» në Londër. Isai ka deklaruar: «Luftova dhe në Qimarë

kundër grekëve dhe i ndoqa dy ditë larg. Duke vizituar vi-set e Jugut u gëzuash tepër, se i pashë të gjithë që janë vëllezër shqiptarë, dhe kjo më bëri të gëzohem shumë. Tani erdha në Evropë të kërkoj drejtësi!.. Atje s'ka drejtësi. Mali i Zi, Serbia po e përfshijnë Shqipërinë. Austria dhe Italia kërkojnë të kenë edhe ato fitime. Ardha këtu në Londër, si delegat i Kosovës dhe si delagat i guvernës provizore, që të protestoj. Tërë jetën time deri sa të jap shpirtin, do të luftoj kundër serbëve, grekërve, malazezëve, itali-anëve dhe austriakëve, të cilët do të kërkojnë të pushtojnë krahinat shqiptare të vendit tim!»

«...Isa Buletini — thoshte më poshtë gazeta shqiptare — nuk është vetëm një gjeneral, por edhe një politikan që ka kuptuar gjendjen politike ndërkombëtare dhe përpjekjet që duhen bërë...»

Qenka puna se rajatë kërkojnë të na grabisin pasurinë dhe të bëjnë barazinë! Dashkan që ne toptanasit, vrijo-nasit, bejlerët dhe pashallarët, të ulemi në rangun e tyre dhe të bëhemë njëlloj si ata! Këtë duan ata? Litari, vetëm litari, dhuna do t'i bindë turmat rebele dhe do t'i detyrojë të ulin kryet si më parë! Por sot nuk mjafton vetëm dhuna. Duhet përdorur edhe politika. Ata duhen diskredituar si rebelë, si kusarë, si kriminelë, si grabitës. Oficeri iu lut Esadit të topitur që të largohej nga pozicioni para topit. Ata po pregetiteshin të qëllonin mbi pozicionet e kryengritësve në drejtim të Shkozetit. Pushka filloj të rra-llohej. Topi gjëmoi dy orë pa ndërprerje. Një oficer, që erdhi nga via e parë e frontit, pasi nderoi me një frymë, duke qëndruar para ministrit të brendshëm si statujë, tha:

— Shkëlqesi! Fshatarët u thyen dhe janë tërhequr në pozicionet e tyre të mëparshme.

Esadi, i hutuar që nuk e kishte mendjen te beteja që po zhvillohej prapa telave me gjemba e gjerdheve të Durrësit, nuk i tha asgjë oficerit, po i heshtur ktheu shpinën dhe u largua në drejtim të qytetit.

Tani në Shqipërinë e Mesme ishin krijuar dy push-tete: pushteti i kryeçifligarit Esad Toptani dhe ai i kryengritjes fshatare. Esadi kishte ditë që po vriste mendjen duke thurur komplotin e tij të madh pér ta shuar një herë

e mirë kryengritjen rebele të fshatarëve. Sipas informave që kishte marrë nga spiunët e tij të shpërndarë nëpër kazatë e krahinat ku kishin pushtetin fshatarët, disa prej të cilëve fshehurazi bënин pjesë edhe në këshillat e kazave, mësoi se midis Musa Qazimit, myftiut dinak të Tiranës dhe Haxhi Qamilit ishte hapur një hendek i thellë dhe pritej të fillonte vëllavrasja. Esadit i kujtohej biseda e fundit me myftiun shkurtabiq, ditën e tretë të kthimit të tij triumfal në Durrës. Musai i kishte kërkuar Esadit që qeveria e tij të respektonte programin e shpallur në Shijak. Nëpërmjet një ligjërave të hollë, myftiu ia kishte thënë shkoqur mendimin e tij pér ta ndarë pushtetin midis tyre. Myftiu Musa Qazimi i kërkoi pashës që t'i ndanin përgjysmë të hollat që ai kishte marrë nga Pashiqi dhe Kral Pjetri. Këto ishin disa nga kushtet që i vuri myftiu pashës pér t'u lidhur me të. Por Esadi kishte kurdisur komplotin e madh që Musa Qazimi nuk kishte si ta dinte. Gjithashtu pashai toptanas nuk i besonte më myftiut, i cili, me ndikimin e pozitës fetare, tërhiqte pas vetës disa turma fshatarësh të moshuar të molepsur nga feja dhe turqizmi. Interesat e tyre politike ishin kryekëput të kundërta. Musa Qazimi, si turkoman të shërbente edhe xhon-turqve dhe njëkohësisht bënte politikën austriake e gjermane; kurse Esadi ishte shkëputur nga politika e xhon-turqve përfundimisht.

Esadi nuk mundi ta arrestonte në Durrës Musa Qazimin, kryetarin e këshillit të qendrës, i cili, së bashku me Haxhi Hysenin e Elbasanit dhe krerët e tjerë, ishin ideo-logët dhe frymëzuesit e rrnymës turkomane të kryengritjes. Ata bënin një luftë të ashpër dhe të egër, sidomos kundër patriotëve që kishin qenë bashkëpunëtorë e miq të Ismail Qemalit. Pashai i Tiranës arësyen e mosarrestimit të Musa Qazimit ia tha vetëm Xhelal Zogut. «Nuk duhen egërsuar fshatarët!» Esadi parashikonte që Musa Qazimi të vritej nga vetë Haxhi Qamili, i cili nuk e pyeste më atë. Ndërkohë një korrier i posaçëm i solli në fushën e betejës një telegram. Pasha e lexoit telegramin tepër sekret, që vinte drejt për drejt nga Pashiqi. Kërkohet aprovimi që ushtria serbe të kalonte kufirin e Shqipërisë. Korrieri i dorëzoi Esadit

edhe një notë proteste të dhënë nga konsulli italian, i cili kopjen e origjinalit ia dërgonte edhe qeverisë greke në Athinë. «Italia nuk ishte dakord që në ujërat e Durrësit të lundronin anije greke». Esadi pohoi se edhe ai ishte dakord me qeverinë italiane! Pa humbur kohë, Pasha harroi dy telegramme me rëndësi: njërin për qeverinë serbe, në të cilin njoftonte se ishte dakord të zbatuhej kalimi i ushtrisë serbe në tokën shqiptare dhe tjetrit për qeverinë greke, që kjo të largonte anjen ushtarake greke nga ujërat rreth Durrësit. Esadi, duke e ndjerë veten shumë të lodhur, po dhe të gëzuar, u largua nga fusha e betejës, u ngjit në karrocën e tij luksoze dhe u drejtua në rezidencën e tij, një ndërtesë e madhe me stil oriental, pranë skelës.

\* \* \*

Esadi urdhëroi shërbëtorin të thërriste Xhavit Beun. Xhaviti ishte një burrë i gjatë, truplidhur me hundën me kurriz i veshur me uniformë oficeri gjysmaustriake, gjysmë turke, hyri në dhomën e shtruar me qilima dhe qëndroi kokulur përparrë pashait.

— Ngrije kokën, Xhavit Bej! — i tha me qejf Esadi.  
— Dëgjo këtu! Tashti e kemi fitoren në pëllëmbë të dorës!

Xhavit Beu mori zemër nga pamja e gëzuar e shkëlqesisë dhe bëri dy hapa përparrë, duke hedhur vështrimin nga telegrami që tregoi me gisht Esadi.

— Ti nuk di të lexosh. E, pra, po ta them unë. Sonte ose nesër ushtritë tona aleate serbe, do të kalojnë kufirin. Ato do të vijnë në Tiranë dhe në Durrës.

— Mjerë leckamanët! — tha Xhaviti dhe, duke harruar që, ishte përparrë kryezotit të tij, fërkoi pëllëmbët e bufatura dhe shtoi: — Me top do t'i grizmë rebelat, që guxuan të ngrenë krye kundër Pashës sonë!

— Thirre të vijë këtu edhe tjetrit! — porositi Esadi të njëjtin shërbëtor, që rrinte përjashta derës dhe mbante veshët pipëz për të dëgjuar shkëlqesinë e tij.

Në zyrë hyri edhe adjutanti i dytë.

Esadi ia tregoi edhe atij ngjarjen. Xhavit Beu u habit nga ndryshimi që pësoi në fytyrë pashai.

— Nuk duhet të dehem përpara se ta arrijmë fitoren — tha ai dhe shtoi: — Harrova! Haxhi Qamili dhe turmat fshatare ndoshta edhe ata të qyteteve do të luftojnë kundër ushtrisë serbe të Kral Pjetrit. Dihet se Haxhi Qamili dhe shokët e tij janë njerëz pa përgjegjësi dhe bëjnë si t'u thotë koka. Neve nuk na intereson të zgjasë kjo luftë. E, pra, ju keni detyra me rëndësi për të kryer! — tha Pasha dhe i shikoi në sy të dy oficerët për të kuptuar gatishmërinë e tyre.

— Shkëlqesi, tashti që fitorja po na buzëqesh, jam gati të kryej çdo mision — tha Xhavit Beu duke ngritur kokën lart.

— Përulem Pasha ndër këmbët tuaja! — tha oficeri i dytë, një bajraktar dibran besnik, që nuk i ishte ndarë Esadit dy vjetët e fundit, ngado që kishte shkuar nëpër Evropë.

— Rroftë mbreti i ardhshëm, Esadi i plotfuqishëm! — thirri Xhavit Beu për të mos mbetur prapa oficerit të parë, që i bëri elozhe Pashait.

— Ti, Xhavit Bej, do të kthehesh përsëri në Tiranë dhe do të futesh në sferat e Këshillit të përgjithshëm të kryengritjes fshatare. Do të mësosh për gjendjen ushtarake dhe për preqatitjet e tyre për luftë. Veçanërisht informohu për këto gjëra: Sa ushtarë disponojnë dhe si po i shpërndajnë forcat. Në ç'vende do t'i zënë pritat. Sa municion ka çdo ushtar. Sa ushqime do të marrin me vete. Pastaj do të bisedosh me krerët e tyre, nëse do të bashkohen me shkodranët ose jo. Përpiku të zbulosh qëllimet e Bajram Currit, të Isa Buletinit dhe të udhëheqësve të tjerë kosovarë. Mos kanë dërguar, vallë, delegatët e tyre të merren vesh me Këshillin e kryengritjes fshatare? Do të dërgosh një nga oficerët tanë të zbulimit në Elbasan, për të sjellë lajme të hollësishme lidhur me preqatitjet e luftës dhe me lëvizjet e forcave kryengritëse atje. Do të pyesësh për Ahmet Zogollin, të mësosh se si qëndron puna e tij; ku gjendet dhe çfarë planesh ka në lidhje me luftën kundër ushtrive serbe. Tani merre këtë medalion floriri dhe fshihe

mirë! Pasi të mbledhësh këto informata, ti personalisht do të shkosh si pivot i Pashës në kuarterin e ushtrisë serbe, që së shpejti do të hyjë në Shqipëri dhe mund të vendoset prapa malit të Dajtit, në fshatin Pashkashesh. Aty do të takohesh me komandantin serb Miloviçin. Tregoi medalionin dhe ai do ta kuptojë se të ka dërguar Esad Pasha. Jepi fije e për pe informatat që do të mbledhësh. Kurse ti — iu drejtua oficerit tjetër — do të kthehet në Durrës dhe do të më njoftosh për të gjitha gjërat që të kërkova. Hajde, pra, nisuni!

Xhavit Beu ishte mavijosur në fytyrë. Ai vështroi me ca sy si të ngrirë medalionin e florinjtë, ku ishte stamposur një portret që i përngjante atij të pashait toptanas.

— Po. Është kopja ime! — i tha Esadi, i cili e kuptoi hutimin e Xhavitet dhe qeshi nën hundë.

— Rruga është me rreziqe, o Pasha i lartë! — tha pa e fshehur drojtjen Xhaviti dhe shtoi: — Më duhen ca para për rrugën.

— Ky është shërbimi i fundit dhe pas kësaj të pret karriera, pasuria, çifliku i ri, qejfet dhe një titull. Shko tani! — i tha dhe, pasi i zgjati dorë<sup>1</sup> e futur në dorezë të bardhë prej lëkure shevroje, u ngrit më këmbë. Kjo do të thoshte se çdo bisedë kishte marrë fund.

\* \* \*

Pasi dolën të dy oficerët hyri një korrier i ri, që vinte nga Tirana.

— Shkëlqesi! Pasha i ndritur! — tha me drojtje e respekt i porsaardhuri duke i dorëzuar një letër. E shkruante një nga sekretarët e tij, Ibrahim efendiu. Letra shkruhej turqisht. Sekretari informonte kryetarin e qeverisë së rrëthuar në Durrës, se në Tiranë kishin plasur mos-marrëveshje midis krerëve të rebelëve. Haxhi Qamili me Reshitin, Qirën, Metin, Lekén dhe ca fshatarë të tjerë të panjohur, nga ata që Esadi as ua kishte dëgjuar

emrin, kishin lidhur një itifak të ri dhe u kishin dërguar një notë qeverisë serbe dhe qeverisë të Italisë, Greqisë, Austrisë, Francës, Rusisë dhe Turqisë se ata shpallnin asnjësinë e Shqipërisë dhe se nuk ishin me asnë shtet, po kërkonin të rronin në paqë me të gjithë. Dhe, sa për kryengritjen që kishin nisur, ajo ishte punë e brendshme e tyre dhe nuk kishte të bënte me marrëdhëniet me shtetet e huaja.

Informata e Ibrahim efendiut vazhdonte ende. Shkodra, që ishte nën pushtetin formal të disa përfaqësuesve të fuqive evropiane, shtetet e të cilëve ishin efektivisht në luftë njëri me tjetrin, kishte dërguar një delegacion, të përbërë nga oficerë shqiptarë, për të biseduar me Haxhi Qamilin me qëllim bashkimi, por ende nuk diheshin përfundimet. Flitej, se edhe Bajram Curri me Isa Buletinin kishin kërkuar të rënditnin forcat e tyre me ato të kryengritjes fshatare dhe të luftotonin bashkarisht kundër ushtrive serbe të pushtimit. Oficerët dhe patriotët e Elbasanit e të Tiranës po bashkoheshin me rebelët e Haxhi Qamilit për të luftuar kundër ushtrive të huaja. Mijëra vullnetarë fshatarë po shtonin radhët e ushtrisë fshatare. Haxhi Qamili kishte thënë se para rrezikut që i kërcënohej vatanit, duhej të bashkoheshin të gjitha forcat popullore të Shqipërisë.

Pasha, pasi e peshoi mirë me mendjen e tij informatën që jepte Ibrahimit për patriotët që përfaqësonin njërizit e ditur dhe me arësim, që po bashkoheshin me rebelët fshatarë, iu drodh zemra! «Ja, këtë s'e kisha menduar!» murmuriti.

— Shko, shko biri im! — i tha Esadi korrierit, dhe, pasi u qetësua e e mblođhi vetën, tha me zë fare të ulët: «Shpresa në zotin! Unë jam shprehja e vullnetit të tij! Si të jetë shkruar do të bëhet!»

Pashai, si doli nga zyra, vajti në një kthinë të mënjanuar të pallatit, në katin e sipërm, që vështronë nga deti.

## MAL XHOKA NË TIRANE

Pas disa muajsh nga fillimi i kryengritjes fshatare, krerët dhe komandantët e njësive luftëtare u takuan dhe u përqëndruan në fushën e Tiranës. Në Durrës, megjithë rrethimin që vazhdonte të qëndronte si darë e hekurt, Esadi e ruante ende pushtetin e tij duke u mbrojtur vazhdimisht.

Mal Xhoka hyri në qytet nga ana e kodrave të Saukur. Kur po kalonte me kalë nga fusha e Beshirëve, vuri re se shumica e arave kishin mbetur të papunuara. Në krahun e djathtë të Shallvares dritat e zbeta të kandileve me vajguri nëpër shtëpitë e ulëta përdhese formonin siluetë të çuditshme hijesh nëpër oborret.

Tirana nuk kishte më shumë se katërmijë shtëpi të shpërndara në pesë lagje të mëdha. Në qendër të qytetit ishin ndërtuar pazari, hamami, pusi, xhamia, sahati i madh, burgu, hani, telegrafhaneja, zyrat e nënprefekturës, disa kafe e akshihane të vogla. Shumica e shtëpive ishin të ulëta, aq sa njeriu kur ecte rrugës mund t'u çikte me dorë pullazin. Shtëpitë e bezlerëve dhe të agallarëve dallohen në nga shtëpitë e qytetarëve të thjeshtë, sepse ato jo vetëm ishin të larta me dy kate, me dritare të mëdha, po edhe të ndërtuara me mure të suvatuara bukur dhe me porta e dritare prej druri arre, ose lisi të gdhendura me lloj-lloj ornamentesh orientale. Mbi pullazin e këtyre shtëpive madhështore ngrihen oxhaqet e larta, të ndërtuara me tulla të kuqe. Qytetarët e thjeshtë, tiranas, nuk guxonin të ndërtonin oxhaqe. Kjo gjë ishte e ndaluar. Disa rrugë

që të çonin në qendër të qytetit ishin të shtruara me kalldrëm, ndërsa rrugicat, që kalonin nëpërmes kopshtijeve të mëdha si pyje, ishin tërë baltë. Dimrit balta të ngjitej pas këpucëve dhe rrugët, kur binte shi me shtama, bëheshin pothuajse të pakalueshme. Mali vazhdonte të ekte kaluar përmes qytetit.

Tiranosit e thjeshtë, të cilët tanimë ishin të bindur për qëllimet e mira të kryengritësve fshatarë, nuk jetonin me frikë, si një muaj përpara. Ata kishin filluar të dilnin përsëri nga shtëpitë dhe të vazhdonin jetën si përpara.

Kryengritësit e armatosur kishin ngritur çadërat gjatë bregut të Lanës. Tiranasit e quanin atë ushtria e Haxhi Qamilit, sepse kishin krijuar bindjen se bëhej çfarë thoshte ai. Ushtria fshatare, që kishte hyrë për së dyti në Tiranë, arrinte rrëth pesëmijë shpirt. Shumica e tyre kishin zbritur nga fshatrat e Sharrës, Picallit, të Pezës, Kavarit, të zonës së Dajtit dhe të Malësisë së Tiranës.

Rrugës Mali takoi plot fshatarë të njojur, të cilët përshëndetnin me dorë në zemër e buzegas. Mendoi të kalonte natën në han dhe, pasi të ngopej me gjumë, të nesërmen, me të zbardhur dita, të vihej për të kërkuar Ram Lekën. Kur mbërriti para hanit, zbriti nga kali. Një qytetar barkmadh, me mustaqe gjer te veshët dhe me mëngët të përveshura, po gatuante aty përpara sokakut gjellët për klientët e tij: fasule dhe një kazan të vogël me çorbë.

— Ti je hanxhiu? — e pyeti Mali pak si me drojtje.

— E, unë jam hanxhiu — i tha ai me inat, duke fërkuar sytë që i ishin skuqur nga të fryrët e zjarrit.

— Do të flë sonte në hanin tënd. A më bën një vend?

— Edhe ty të kam mangut! A nuk shikon si janë rrashur njerëzit? — ia pat hanxhiu duke bërë me dorë nga dera e hapur e hanit, ku sundonte një rrëmujë e madhe.

— Më bëj edhe mua një vend! — iu lut përsëri Mali Xhoka dhe, kur pa se hanxhiu nuk po ia varte, filloi t'i hakërhohej: A po më bën një vend mua, po...?

— Hajde, futu! Po gjete ndonjë copë hasër shtrihu! —

i tha hanxhiu pa e parë në sy, dhe vazhdoi të merrej me punën e tij.

Mali e lidhi kalin te dera e hanit, pastaj rëndë-rëndë hyri brenda në sallë. Por kur pa se aty s'kishte ku të hidhje mollën dhe ndjeu një erë të rëndë thartire, doli jashtë i mérzitur, tërhoqi kalin nga kapistra dhe, ndërsa po largohej, i thirri me inat hanxhiut:

— Në dreq të shkosh megjithë hanin tënd!

Malin, që s'dinte se ku të shkonte, këmbët e shpunë te sahati i madh i qytetit. Prapa sahatit ai pa një turmë fshatarësh të armatosur, nja pesëdhjetë shpirt, veshur me brekushe të zeza e qeleshe të bardha, që si tufan derdheshin nga pazari në drejtim të rrugës së Pashës. Nëpër duar mbanin pisha të ndezura dhe nga supet u vareshin pushkët e gjata. Mali e kuptoi se ajo turmë e egërsuar fshatarësh ishte nisur për të djegur sarajet e bejlerëve. Dëgjohej vetëm zhurma e hapave të tyre. Të gjithë duke-shin të heshtur e të zymtë. Ecnin pa rregull, dy e nga dy, katër e nga katër, ca më parë e ca më pas. Mali u fsheh pas qoshes së sahatit dhe vështroi me vëmendje ato fytyra të ngrysura e të rreshkëta fshatarësh se mos njihte ndonjërin, po përvèç një mjekëroshi, që ecte në krye të turmës, ai nuk njoju asnjeri.

— Ky është Haxhi Baba! — tha me vete Mali duke mbajtur frymën nga tronditja. Edhe ai nuk e kuptonte se nga i vinte kjo ndjenjë respekti dhe autoriteti që i ngallte ky burrë me mjekër. Me emrin e Haxhi Qamilit, komandantët e taborreve me fshatarë kryengritës urdhëronin për gjithshka.

Fshatarët kryengritës, me hunj zjarri e pisha të ndezura nëpër duar, u larguan nga rruga e sahatit. Mali doli nga vendi i fshehur dhe nëpër rrugën e Maleshkës në rrugicën plot dredha deri te pisha e bejlerëve. Para një ndërtese të madhe, të vjetër ai pa fshatarë të armatosur, që bënин roje, dhe midis tyre njozu një shokun e tij nga Picalli.

— Tungjatjeta, e mirë se rrini! — u tha Mali dhe u zgjati dorën, i gëzuar që më në fund takoi një njeri të afërt nga radhët e kryengritësve.

— Oh, Mal Khoka! Ku ke humbur, bre burrë? Sa kohë ka që s'të kam parë! — Iu drejtua picallioti dhe e rroku në qafë.

Pasi u përvendetën, Rrema e tërhoqi mikun e tij brenda ndërtësës, në një si paradhomë, dhe u ulën mbi disa arka vajguri.

— Çfarë po bëni këtu? — e pyeti Mali dhe, i habitur, shikoi një fitil të gjatë dinamiti, që përvshkonte arkat dhe futej nëpër një sallë të gjatë.

— Si, nuk e ditke? — i tha Rrema duke qeshur dhe shtoi: — Këtu është burgu, bre Mal! — dhe, pasi hapi derën tregoi me dorë. — Ata pas hekurave, që rrinë ulur mbi arkat e vajgurit, janë të burgosurit.

— Po cilët janë ata? — pyeti i çuditur Mali duke zgjatur kokën nga dera e hekurt.

— Nëpunësat e qeverisë. Miqtë e Esad Toptanit. Kundërshtarët tanë.

— Po ky fitil?

— E ka vënë Haxhi Baba pér t'i trembur — tha Rrema dhe qeshi me të madhe ha... ha... ha...

— Punë e bukur! — tha Mali. — Ku i ka shkuar nëpër mend se! A shkojmë brenda t'i shohim?

— Pse jo, kur të duash — u përgjegj Rrema dhe u ngrit pér ta shoqëruar. — Mua më kanë caktuar komandan të burgut dhe bëj si të më shkrepët. Tani, që po djeqin shtëpitë e bezlerëve, asnjë nuk çan më kokën pér burgun — dhe përsëri Rrema qeshi me të madhe: ha... ha...

Rojtari hapi derën e madhe, që ishte e kyçur me dry, dhe, së bashku me Malin, hynë në një sallë, përreth së cilës ishin vendosur arka vajguri, ku rrinin të burgosurit. Ajo sallë rrith njëzet me njëzet, e mbajtur me shtylla druri në çdo tri metra, mbante erë myk dhe vajguri. Të burgosurit ishin nga gjashtëdhjetë shpirt, veshur me pantallona e xhaketa, me këmisha puplini e të mëndafshëta të bardha me pikë të zeza. Disa prej tyre kishin lidhur edhe papione. Disa mbanin feste të zeza prej kadifeje, kurse ca të tjërë feste të kuqe me xhufkë nga pas. Kjo veshje i dukej Malit shumë e çuditshme dhe qesharake. Llambat e mëdha prej bakri, me poça qelqi të vendosura në çdo

cep të sallës, e bënин natën ditë. Një grup të burgosurish nga fundi i sallës këndonte një këngë patriotike me zë të ulët pa drojtje. Mal Xhoka, që i njihte mirë këto këngë, kapi shkoqur menjëherë kuptimin e një strofe.

— Ja kështu këndojnë gjithë natën! — tha Rrema. — Bukën e gjellën ua sjellin familjet e tyre dhe çfarë ushqimi se! Pula të pjekura, tava Elbasani, fërgesë me mëlçi, bakllavë, ekmek-kadaif e c'të të them! Fshatari fliste dhe queshte pa vënë re hutimin e shokut.

Mal Xhoka vuri re se askush prej të burgosurve nuk hodhi sytë nga ata dhe secili shikonte punën e vet. Nga mënyra se si rrinin duke shin shumë të pikëlluar. Pasi mbaruan një këngë, ata filluan një tjetër. Kësaj here këndonin të gjithë këngën «Për memëdhënë».

Mali e kuptoi se ata ishin tiranas, njerëz të mësuar nëpër shkolla, që bënin pjesë në klubet e shqipes, burra që nënëntor të vitit 1912 kishin luftuar dhe brohoritur për pavarësinë e atdheut e ngritjen e flamurit të Shqipërisë. Këta mësues, nëpunës, tregëtarë, avokatë e doktorë kishin shërbyer në qeverinë e mbretit Vid dhe tani në atë të Esad Pashë Toptanosit! «Kjo është një punë e ngatërruar!» tha Mali me vete dhe shtoi: «Përse këta nuk bashkohen me fshatarët, këtë nuk e kuptoj!»

Mali rrinte si i shastisur duke shikuar të burgosurit. Ai e harroi fare gardianin e burgut.

— Ej, çfarë të ndodhi! — i foli Rrema.

— Hiç, ore, hiç — tha Mali dhe, pasi u përmend, shtoi: — Jam i lodhur e pa gjumë, o Rrem Picalli! — dhe shtrëngoi tëmlat për të justifikuar qëndrimin e tij.

Dikush nga të burgosurit i ra Malit nga prapa, në sup, me çökën e dorës. Fshatari kryengritës ktheu kokën dhe, kur pa se ai i burgosur ishte miku i tij telegrafisti tiranas Met Rizai, u habit dhe iu tha pështyma në grykë, Mali u trondit. «Më mirë të isha vrarë se sa ta takoja këtu në burg!» mendoi.

— Tungjatjeta, o Mal Xhoka! — tha telegrafisti buzegas, duke e kuptuar hutimin e mikut të tij fshatar nga Pishtari. Ata kishin biseduar kaq herë për punë patriotizmi. Telegrafisti i kishte mësuar Malit shkrim e këndim

në gjuhën shqipe me alfabetin latin, historinë e luftrave kombëtare. Kurse tani, ata po takoheshin në burg si armiq!

— Ti këtu? Kjo qenka për t'u vajtuar! — thirri Mali, si i kapur në faj, dhe shtoi: «Një keqkuptim, o mik!» dhe ndërkaq i zgjati dorën dhe e përqafoi.

Si Rëma ashtu edhe disa të burgosur, që po dëgjonin aty afër, mbetën fare të habitur nga ky takim.

— Mbeç me shëndet! — i tha Mali telegrafistit, dhe, duke iu drejtuar komandantit të burgut: — Hajde, Rremë, të ikim që këtej! — dhe, pasi e zuri nga krahу picalliotin e habitur, dolën nga burgu.

— Dëgjo, o Rremë! — tha Mali. — Ne jemi miq, dhe ti më ke besuar mua kurdoherë. Ai telegrafisti është miku im. Unë isha nisur sonte të shkoja pikërisht në shtëpi të tij. Atje shpresoja të takohesha me Ram Lekën. Ti do ta lirosh atë sonte nga burgu dhe unë do të shkoj sonte të flë në shtëpi të tyre. — Pishtaraku e mbante Rremën për krahу përballë vetes, duke e shikuar drejt e në sy.

— Ej, kështu qenka puna? Pse, si kujton ti, se unë nuk i kuptoj këto punë? I kuptoj që ç'ke me të! Merre dhe shko ku të duash! Në fund të fundit ti je komendant tabori, kurse unë një copë roje jam.

Rrema u kthyë në sallën e burgut dhe, pas një copë here, solli në paradhomë telegrafistin e veshur.

— Je i lirë, o zotni telegrafist! — briti Rrema dhe qeshi ha... ha... Kështu kanë ardhur kohërat. Fshatarët varfanjakë të marrin frenat në dorë. — ha... ha... qeshi përsëri fshatari bablok me gjithë shpirt, aq sa iu tund dhe xhoka e zezë me theka mbi sup.

— Hajde të të përcjell — i tha Mali telegrafistit, i cili e kuptoi hezitimin e tij për t'u larguar nga burgu. — E di se çfarë do të thuash? Bisedojmë rrugës. — Hajde, hajde shkojmë në shtëpi — i tha Mali me buzën në gaz duke e tërhequr nga krahу.

— Natën e mirë dhe mirë u pafshim, o Mal Xhoka! — i tha picallioti kur po dilnin nga burgu në rrugë.

— Natën e mirë, o Rremë! — u përgjegj miqësisht

telegrafisti. Rojet fshatare, që ishin përqark, panë me dyshim telegrafistin, që e cte në krah të Mal Xhokës.

— Kalit i dhashë të hante tagji. — i tha një fshatar Malit.

— Të falemi nderit! — u përgjegj Pishtaraku duke e zënë për kapistre kafshën.

Shtëpia e telegrafistit ishte nja dhjetë minuta më këmbë nga burgu.

Nëpër rrugicat e shtruara me kalldrëm, në atë orë të natës nuk ndihej gjurmë jete. Telegrafisti nxori nga xhepi i jolekut sahatin e xhepit dhe, pasi ndezi çakmakun, i tha Malit: — Mesnatë!

— Allaturka? — tha Mali.

— Jo, — u përgjegj telegrafisti — allafranga.

Rrugës nuk këmbyen më biseda.

Telegrafisti trokiti fort me çekiçin e portës në një mënyrë të veçantë. Sikur të kishte qenë pas dere, një grua plakë thirri që brenda:

— Ti je, bir?

— Po, unë jam, nënë. Hape! — tha me zë të lartë telegrafisti.

Porta u hap dhe eëma, një grua e shkurtër, e cila mbante në dorë një kobure me mulli, që ia kishte lënë kujtim i shoqi, iu hodh të birit dhe e përqafoi.

— Cili është ky? — pyeti plaka duke vështruar me kujdes të panjohurin.

— Ta tregoj në shtëpi, — u përgjegj i biri.

Pasi mbyllën portën me lloz nga prapa dhe si kaluan nëpër një rrugicë, ata hynë në dhomën e miqve, e cila ishte e shtruar me qilim dhe përqark me mindere. Plaka solli llambën me vajguri. Mali pa se në njerën faqe të murit varej një sixhade e trashë persiane.

— Tani, nënë, shikoje mirë cili është ky burrë! — tha i biri.

Plaka i afroi llambën fytyrës së të panjohurit.

— Për zotin e vërtetë nuk e njoh! — tha plaka.

— Shikoje, shikoje më mirë, — nguli këmbë Meti duke vënë buzën në gaz.

— Ohu... Mal Xhoka! — thirri nëna dhe përplasi

duart nga habia. — Po ky qenka bërë kapidan e goxha burrë! — shtoi plaka dhe me krahët të hapura e përqafoi Malin si djalin e shtëpisë.

E shoqja e telegrafistit befi në derë të dhomës, dhe, pasi i dha dorën të shoqit, i uroi mirëseardhjen edhe Malit.

— Po si të liruan nga burgu? — e pyeti e ëma pasi të gjithë zunë vend në minder.

— Jam bashkuar me rebelët — tha duke qeshur telegrafisti, që i ra Malit miqësisht në sup.

Fshatarit nuk i erdhi mirë nga shakaja e telegrafistit, dhe këtë e shprehu me një gjest mospëlqimi të ftyrës.

— Është e vërtetë! — tha kokulur Mali. — Ne fshatarët jemi të paditur dhe nuk dimë nga politika! Dëgjo, o Met Rizai! Ta dish ti sa vuaj unë, ja këtu brenda, në zemër e në shpirt! Jemi rebela, po! — dhe tundi kokën me dëshpërim.

— Jo, unë thashë për të qeshur! — ia ktheu telegrafisti, i cili e kuptoj se me fjalët që kishte thënë e kishte fyer Malin.

— Mirë, mirë! Në çdo ushtri fshatarët luftojnë. Fshatarët qëllojnë në pritë. Fshatarët e kanë zanat pushkën. Mos ma merr për të keq, por ju qytetarët, dhe veçanërisht njerëzit e mësuar, të pendës, nuk dinë se ku kapet pushka. Pra, ta themi troc, ne fshatarët jemi të pushkës. E ju, përsë nuk erdhët në fshat të shtroheshit këmbë-kryq me ne dhe të na tregonit rrugën e vërtetë? Përse shumë prej jush u bashkuar me bejlerët dhe me Esad Toptanin? A e di se çfarë kam menduar? Ndoshta po flas një budallallëk. Por po e shpreh mendimin ashtu si e kuptoj. A nuk janë këta bejlerët, që i shërbyen Turqisë denbabaden? Titujt «bej» e «pasha» kush ua dha? Turqia! A i jepet tjetrit titulli pa bërë shërbime? Jo, kurrë! Pas titullit të beut dhe të pashait erdhën edhe mexhidet e florinjtë! Turqia u prish, pashallarët e bejlerët u kthyen në vendin e tyre. Bukur! Njihen me qeveritarët e Evropës, kanë pushtet. Dhe të gjitha këto mund t'i shërbën pavarësisë së Shqipërisë. E, pra, një gjë më është ngulitur

në kokë dhe s'ka burrë që të ma heqë nga mendja. Në qoftë se këta bejlerë dhe pashallarë qenkan penduar pér të kaluarën dhe tani janë kthyer në vatan dhe duan të mirën e Shqipërisë, pérse asnjeri nga ata të mos thotë: «Dëgjoni, vëllezër fshatarë, të një gjaku dhe të një fisi shqiptar! Së bashku do të bëjmë Shqipërinë dhe të mirat do t'i korrim të gjithë. Ne heqim dorë nga tokat e grabitura! Bujqit le t'i gëzojnë tokat e vadirra me djersë të jetën! Nga faizi heqim dorë!» Kaq t'u premtionin ata fshatarëve pa léri të tjerat, jo xhelepin, jo të dhjetat e plot taksa të tjera që rëndojnë mbi kurrizin tonë. Më thuaj, zotrote, me kë do të shkonin atëhere fshatarët? Jo, kurrë nuk do t'i shkonin pas myftiut të Tiranës, Musa Qazimit, Mustafa Agë Ndroqit dhe atyre turkoshakëve të tjerë! E, sa pér punën e fesë, ajo do të sqarohej thjesht! Zotrote dhe shokët tuaj a e besojnë zotin? A falen në xhami? S'ka dyshim që po! E pra, ku qenka ndryshimi nga fshatarët? Ta them unë, zotni! Fshatarët, edhe Haxhi Baba e shokët e tij, mendojnë se feja muslimane është turqizmi. Kurse ju dini ta ndani fenë muslimane nga Turqia! E, pra, kaq gjë, ju që jeni të ditur e me shkollë, do t'ua kishit futur në kokë fshatarëve! S'është puna pér t'i rënë troç këtu. Toka, toka. Cifligjet. Pasuria. Dhe bejlerët e pashallarët nuk e kuptojnë jetën pa to. Tani që fshatari ngriti dorën kundër çifligut, kundër pasurisë dhe vuri dorë në kasat e florinja, bejlerët e agallarët u çmendën dhe nuk po lënë gjë pa shpifur dhe pa përdorur pér ta shtypur këtë kryengritje rebelësh. Ja, këtu qëndron e gjithë puna! — i tha Mali. Duke vënë re se telegrafisti po e dëgjonte me vëmendje, gojëhapur, ai mori guxim të thoshte mendimin e tij deri në fund. — Në radhët e kryengritjes sonë fshatare nuk ka turq dhe ne duam lirinë e bashkimin e të gjithë vatanit. Eeni, pra, midis nesh dhe na tregoni rrugën! — fjalët e fundit, Mali i tha me ton të ngritur.

Telegrafisti sikur u shashtis nga logjika e thjeshtë dhe çiltërsia e fshatarit kryengritës.

Meti nuk foli. Telegrafisti nuk ishte i preqatitur pér të zbërthyer lëmshin e këtyre mendimeve. Ai dhe shokët

e tij të klubeve shqiptare nuk kishin diskutuar asnjëherë për problemet e tokës dhe të fshatarit. E, për më tepër, ata e quanin pasurinë e qytetarit, të fshatarit, të agait, të beut dhe të pashait si të paprekshmë dhe të shenjtë. Madje ata kërkonin që të krijohej një shtet i fortë shqiptar, me një organizim të përsosur të xhandarmërisë, të gjykatave, të pajisur me kod penal dhe me administratë shtetërore, e cila do të siguronte rendin publik dhe veçanërisht pronën e seclit, duke përfshirë edhe të gjitha ligjet e trashëgimisë. Për ata, kryesorja ishte që të bëhej Shqipëria më vete dhe asgjë tjetër. Nacionalizmi u kishte errësuar sytë.

— Fshatarët kërkokan që edhe ne, patriotët e qyteteve, të mos varemi nga bejlerët e pashallarët, po të bashkohemi me kryengritjen e tyre? Për nder, kjo as që më kishte shkuar ndër mend! — thirri telegrafisti dhe e zuri për qafe Malin. — Atëhere del pyetja: Çfarë i duhet fshatarit e bujkut Shqipëria e pavarur? Dje Turqia e madhe, sot «Turqia e vogël» e «pavarur», ku qeverisin përsëri po ata bejlerë, dhe pashallarë të graduar e të emëruar nga sulltani, si Esad Pashë Toptani.

«Bravo ju qoftë! Po ne ku jemi? Jemi fshehur rrëzave, të lidhur pas qerres së bejlerëve dhe të pashallarëve! Të bukur punë që po bëjmë! Po sikur të formojmë një parti demokratike tonen? Telegrafisti e pa veten ngushtë dhe nuk iu përgjegj mendimeve të Mal Xhokës. Por ai në të vërtetë kishte nxjerrë disa përfundime, të cilat nuk guxonë t'i thoshte, sepse mendonte: «Midis idesë dhe veprimit ka një ndryshim të madh!».

Mali rrinte i heshtur. Ai po mendonte se si të takohen sa më parë me Ramën.

— Ti ke të drejtë, o Mal Xhoka! — i tha më në fund telegrafisti pas një heshtjeje mjaft të gjatë.

— Hani gjësend! — tha Nëna e Metit, e cila solli një tabaka me gjellë dhe shtroi për tokë — të unshëm nuk u zë gjumi! — shtoi ajo dhe i hapi rrugë nuses, një gruaje të shkurtër topolake, veshur me fustan, dhe që mbante me të dyja duart një tepsi me bukë dhe gjellë

Të dy shokët hëngrën bukë, pa këmbyer më biseda. Mandej, duke bluar secili në kokën e vet, ranë për të fjetur.

\*  
\*      \*

Dita e re ishte e mrekullueshme.

Pasi u lanë në legen dhe hëngrën mëngjezin, ata filluan të bisedonin për punët e ditës.

— Ti e kupton, o Mal Xhoka, se unë nuk ndahem nga shokët — i tha telegrafisti dhe shtoi: — Po ti, a do të më kthesh pranë tyre në burg?

— E kam menduar atë punë, o zotni telegrafist — i tha me buzën në gaz Mali.

— Të lutem, mos më thuaj «zotni»! Ne jo vetëm jemi miq, por jemi edhe shokë.

— Na është mësuar goja e njerëzve të mësuar nuk u themi dot ndryshe — foli duke qeshur fshatari dhe shtoi: — Unë e kam bërë mbrëmë planin. Ti do të rrish në shtëpi, derisa të takohem me Ram Lekën. Kam menduar se si të nxjerrim nga burgu edhe shokët e tjerë.

Telegrafisti mbeti me gojëhapur. Atij po i bëhej sikur nuk po i dëgjonte mirë fjalët.

Mali e vuri re hutimin e mikut tiranas dhe përsëriti më shkoqur mendimin e tij: — Po! Do të përpinqemi që të lirojmë nga burgu të gjithë shokët tuaj, përvëç ndonjë beu ose ndonjërit që ka luftuar me armë kundër nesh.

— Jo, bejlerët nuk janë në burgun tonë — tha i lehtësuar telegrafisti.

— Mirë pra, unë po dal — i tha Mali.

E shoqja e Metit i dha dorën mikut dhe e nxori në oborr, kurse e éma e përcollti deri te porta. Telegrafisti mbeti në shtëpi në pritje të Malit.

Pishtaraku ja hipi kalit trokthi u nis drejt pazarit. Në qeveri komandanti i Pishtarit pyeti për xhaxhanë e tij një të njohur nga Sharra, i cili i tregoi se Haxhi Baba, Ram Lekën e kishte emëruar komendant të një taborri të madh ushtarësh që bënte stërvitje te fusha e Yzberishit.

Mali sa u habit aq edhe i erdhi mirë që xhaxhai i tij

tani ishte një njeri i besuar i Haxhi Qamilit dhe kishte fuqi pas vetes.

Taborri i Ram Lekës përbëhej nga bujqë të Valijasit, qytetarë tiranas dhe ca malësorë nga fshatrat pas varg-maleve të Dajtit. Ai përbëhej prej më shumë se treqind vetësh. Përveç pushkatarëve, taborri kishte edhe dy topa fushorë, të lënë nga garnizoni turk i Shkodrës, i cili para se të largohej nga Shqipëria për në Turqi ishte vendosur pikërisht në kazermat e ndërtuara nën kodrat e Sharrës.

Mali e takoi xhaxhanë e tij në fushën e stërvitjes. Kompanitë të rreshtuara në radhë prej pesë vetash, me armët në sup ecnin poshtë e lart fushës. Komandantët e tyre jepnin urdhëra dhe u tërhiqnin vërejtjen ushtarëve të veshur civilë që ta hidhnin hapin në rregull dhe jo njëri më parë e tjetri më pas. Me armët përpara, ata fillouan të vraponin dhe kur dha urdhër Rama, të trija kompanitë u shtrinë barkas dhe përparuan në një copë vend duke u tërhequr zvarrë-zvarrë, deri sa zunë majën e kodrës. Topçijtë po pregetiteshin për qitje. Ram Leka i veshur gjysmë ushtarëk e gjysmë civil rrinte mbi një bregore dhe jepte urdhëra, sa në njerin krah në tjetrin. Herë-herë nxehet se nuk i pëlqente ngathtësia e atyre fshatarëve të pamësuar që luftonin në formacione ushtarake dhe thërriste me të madhe. Kur pa të nipin mbi kalë fare pranë vetes, Leka u kthyte nga komandantët e kompanive dhe u tha:

— Qetësohuni! Gjysmë ore pushim!

Ram Leka u përshëndet me Malin dhe, pasi u rrojnë faqe më faqe, u ulën nën hijen e plepave, buzë një vije uji, që përshkonte fushën në vijë të drejtë. Më parë biseduan për shtëpinë dhe pastaj për ngjarjet e rëndësishme që kishin ndodhur pas takimit të tyre të fundit. Mali i tregoi për Kavajën, për vrasjen e Ibrahim Agës dhe së fundi shfaqi mendimin për lirimin nga burgu të telegrafistit e të shokëve të tij të tjerë.

Njëri nga komandantët e kompanive, një fshatar mustaqezi, i kujtoi Ramës se po afrohej dreka dhe e pyeti se çfarë duhej të bënte me ushtarët.

— Të pushoni dhe të hani drekë! Unë po shkoj në qeveri, se më kanë thirrur për ca punë me rëndësi. Komandën merre ti, derisa të kthehem unë — urdhëroi Ram Leka.

Fshatari, duke u larguar, hodhi një vështrim të dyshimtë nga Mali, të cilin nuk e njihte.

— Punët kanë ndryshuar! — i tha Rama të nipit. Ai tregoi për bisedat që kishte bërë me Haxhi Qamilin, si për çështjen me grekët ashtu edhe për preqatitjen që të mbronin vatanin nga sulmi i ushtrive serbe të grumbulluara në kufi. Madje i tregoi se si disa nga njësitet e tyre dilnin edhe fshatrave shqiptare të krahinës së Golllobordës. Mali po e ndjente se ç'besim të madh kishte krijuar Haxhi Qamili te Ram Leka.

— Dëgjo se ç'më tha Haxhi Baba në takimin e fundit që pata me të: «A e di ti se Musa Qazimi e ka kuptuar se unë kam qëllim t'i qëroj bejlerët e agallarët nga faqja e dheut? Dhe ai hoxhë belaxhi tanë ka ngritur kurthe e kérkon të më vrasë! E, pra, puna ka ardhur deri aty ku nuk mban më! Do të ishte mirë, o Ram Leka, ashtu siç më keni thënë ti me shokët e tjerë, të takoheshe me miqtë e tu patriotë të qytetit dhe t'u thoshe që të bëjmë një itifak të ri dhe të shpallim asnjanësinë e Shqipërisë! Të bashkohemi të gjithë, për të luftuar serbin, që kérkon të na zaptojë e të na copëtojë vatanin. Kral Pjetri i ka premtuar Esad Pashës që ta bëjë mbret të Shqipërisë të lidhur mbas qerres së Serbisë».

Pastaj Ram Leka i tha të nipit se tanë ishte koha jo vetëm për të hapur dyert e burgut, e për t'i liruar patriotët e burgosur nga turkomanët, por edhe për të hyrë në bisedë me ta dhe për t'u bashkuar për të mirën e Shqipërisë, për mbrojtjen e pavarësisë së vatanit.

Ramës i sollën pelën e bardhë të marrë nga stalla e çifligut të Veli Bej Jubës nga Valijasi, që ia kish sjellë peshqesh një bej prej Izmiri. Mandej ungj e nip ua hipën kuajve dhe muarën revan fushës së gjerë për në qytet, duke kaluar si në revistë pejsazhet e kodrave të bukura që rrëthonin rrëth e përqark me madhështi Tiranën. Kur mbërriten afër shtëpive të para, ata panë

një grumbull njerëzish, që po bënин sehir një ndërtesë të vjetër të prishur nga themele. Mali, pa zbritur nga kali, pyeti një qytetar se çfarë kishte ndodhur aty. Ai tha se ushtaratët e Haxhi Qamilit po rrafshonin teqen e Bubullimës.

— Hajde! — i tha Leka të nipit, që ia dha të qeshurit duke i rënë pelës në bark me thembrat e opingave prej lëkure lope.

— Ti prit këtu, para namazgjasë! — i tha Leka të nipit. — Kam për të kryer disa punë në qeveri, mandej do të shkojmë për drekë te telegrafisti.

Mali zbriti nga kali dhe e lidhi kafshën e djersitur në trungun e një selvie të re. Namazgjaja ishte një shesh i madh në formë katërkëndëshi, i rrëthuar me mure guri. Në ballë të fushës së namazgjasë, një vend i mbuluar, sa për të ndenjur një njeri më këmbë, shërbente për të ndenjur imami që drejtonte ceremoninë e lutjes së myslimanëve.

Mali priste të ungjin, duke shëtitur nëpër shesh. Pasi doli nga selia e qeverisë, Rama, me kalin për dore, u bashkua përsëri me të nipin. Me shaminë varur pas qafës, fshatari fshinte djersët dhe largonte mizat që e shqetësonin.

— Ja! — i tha Rama të nipit — i mora sekretarit të Haxhi Babës një shkresë me myhyrin e tij për të liruar të burgosurit tiranas.

— Shumë mirë! — i tha Mali, që u gjëzua pa masë. Kryengritësi fshatar vuante shpirtërisht nga përçarja dhe mosmarrëveshjet midis krerëve të kryengritjes fshatare dhe patriotëve të qytetit. Ai mendonte se, po të bashkohen heshin dhe në krye të tyre të viheshin njerëzit e mësuar, punët do të shkonin ndryshe.

Ata u hipën kuajve dhe vazhduan rrugën mes përmes qytetit. Në qytet këtë ditë kishte gjallëri të madhe, Tiranasit zejtarë, gjellëbërës, armëtarë, bukëpjekës dhe bujq, të stolisur me veshjet e tyre karakteristike, punonin si në ethe. Populli i qytetit i bashkuar me fshatarët ishin ngritur më këmbë për të luftuar për mbrojtjen e atdheut. Tellalli, i shoqëruar nga një ushtar i Haxhi Qamilit, kishte që në mëngjez që rrugë më rrugë dhe sokak më sokak

përsëiste urdhërin e qeverisë: «Dëgjoni, vëllezër, Haxhi Qamili ka dhënë urdhër: Furrat e bukëve, akshihanet, kafet, hanet, nallbanët, armëtarët e marangozët të rrinë ditë e natë hapur! Sonte dhe nesër në Tiranë do të grumbullohet ushtria e Haxhi Qamilit...»

Ram Leka pyeti nga kali rojen e armatosur:

— Prej nga, o vëlla, e ka dërguar këtë urdhër Haxhi Baba?

— Nga Elbasani — iu përgjegj roja e tellallit.

— Po vetë Baba, a do të vijë me ushtrinë?

— Atë nuk e di — tha përsëri farkini, që nuk ishte i autorizuar të tregonte se ku gjendej komandanti i ushtrisë fshatare.

Roja fshatare i hoqi vërejtjen tellallit, që nuk e kishte thënë urdhërin tamam ashtu siç ia kishte komunikuar Haxhi Baba!

— Ti je ndonjë komandant me rëndësi — i tha farkini Ram Lekës dhe iu lut ta dëgjonte për së dyti lajmërimin.

Tellalli, një burrë i gjatë, me fes në kokë, me një qafë të trashë e të kuqe, fshinte djersët, që i kullonin si curril duke bërtitur i inatosur:

— Ore, nuk është herë e parë që po jap urdhërat e qeverisë. Ohu, sa kam parë unë! Këtë punë di të bëj unë, le të vijë kush të dojë. Dëgjo, pra, ti që je hipur mbi kalin e bardhë — tha dhe iu drejtua Lekës. — Sonte vjen ushtria e Haxhi Qamilit. Të gjithë ata që duan të dalin vullnetarë le të bëhen gati për të shkuar në kufi, që të mbrojnë vatanin! Nesër të mblidhen para qeverisë në nënprefekturë: hanxhinjtë, bakejtë, bukëpjekësit, kosëshitësit, nallbanët; akshihanet të rrinë sonte gjithë naten çelë.

Çdo fjalë ai kasnec i sprovuar e thoshte shkoqur dhe të ndarë nga fjala tjetër, sikur ta priste me thikë. Pranë tij, grumbulloheshin turma njërzish dhe fëmijësh. Ai, pasi komunikonte urdhërin në një sokak, dilte në një vend tjetër të qytetit dhe, si priste të mblidheshin njërit, të cilët i tërhoqte daullja që gumëzhinte, ia fillonte përsëri avazit... «Ej... ju popull, muslimanë e të krish-

terë, esnafë e bujq, shërbëtorë e zotërinj... përveç bejlerëve, dëgjoni urdhërin e Haxhi Qamilit...»

— Tashti e the shumë mirë! — i tha Mali duke qeshur dhe i ra kalit për të arritur Ram Lekën, që po ikte trokthi.

\* \* \*

Leka shkoi të inspektonte taboret kryengritëse, ndërsa Mal Xhoka u nis drejt burgut. Mal Xhoka ndaloi përparrë derës së burgut dhe u takua me njëzet e katër fshatarë të Pishtarit, që e prisnin atje, sipas fjalës që u kishte dërguar. Në mungesë të tij, pishtarakët i komandonte Naimi dhe Skifter Leka. Pishtarakët u takuan dhe u përshtendetën si vëllezër me rojet fshatare të burgut, bile filluan të këmbejnë dhe mendime rreth ngjarjeve të fundit. Një mustaqezi ankohej se plackën e luftës Haxhi Baba nuk lejonte ta dërgonin nëpër shtëpi. Mustaqeziut i vinte inat kur sillte ndër mend kopenë e dhënve të teqesë së bektashinjve të Martaneshit, të kapur nga Haxhi Baba në fushën e Tiranës. Sipas urdhërit të Haxhi Qamilit, kopeja e dhënve bëhej pronë e qeverisë. Po atë ditë tellalli kishte njoftuar se faizi ishte hequr dhe se të gjithë ata që kishin paguar më tepër se borxhi që u kishin marrë faixxinjve duhej të merrnin paratë nga fajdeshinjtë. Rojet fshatare të burgut, që silleshin nëpër qytet, tregonin se shumë agallarë e bejlerë u kishin kthyer paratë e faizeve fshatarëve. «Borxhin e ke hak t'ia kthesht jetrit, faizi dënohet njëlloj si vjedhja, me prerjen e dorës!» Ky ishte urdhéri i dhënë nga tellalli dy javë përparrë në Tiranë dhe nëpër kazatë e tjera, ku qeverisnin kryengritësit fshatarë. Musa Qazimi e kishte kundërshtuar urdhërin e Haxhi Qamilit në Këshillin e përgjithshëm, por askush nuk ia varte më atij. Autoriteti i Haxhi Babës ishte absolut!

— Urdhëro, Rrem Picalli! — i tha Mali komandantit të burgut.

— C'është kjo, o Mal? — pyeti ai për letrën që zbardhët në pëllëmbën e dorës së tij të errët e tërë kallo.

— Fermani, o Rremë — tha me qesëndi Mali. —

— Ej, fermani! E kush e ka lëshuar këtë ferman? Lala nuk di me këndue, o Mal! Ti që je i këndueshmë <sup>gjallë</sup> ma thuaj çfarë shkruhet atje!

— Fermani i qeverisë sonë shkruan që të lirohen të burgosurit, të cilët nuk janë bejlerë dhe agallarë <sup>gjallë</sup> lexoi me zë të lartë Mali dhe kryqëzoi vështrimin me një <sup>gjallë</sup> të burgosur që e njihte si shokun e telegrafistit, që rrinte përballë tij, me fytyrë të zbetë, duke rregulluar papionin e liruar.

— Ej, thotë fermani që t'i lirojmë të burgosurit? Mirë pra, o Mal, t'i lirojmë! Ata janë vëllezërit tanë. Dhe unë dhe ti i kemi disa miq midis tyre. Të them të drejtën, të gjithë këta tiranas janë burra të urtë e të mirë. Të vjen keq që jemi nda. Po ishallah kanë hequr dorë nga Vidi dhe nga Pashai! — qeshi Reema dhe, duke rrotulluar çelsat nëpër gishta, po i afrohej derës së burgut. Pasi e shkyçi drynin dhe hapi portën e hekurt, fshatari thirri:

— Dëgjoni, o qytetarë! Përveç bejlerëve dhe agallarëve, të marrin plaçkat më krah dhe të dalin menjëherë jashtë të gjithë! Jeni të lirë. Secili në shtëpi të vet! Ky është urdhëri i qeverisë — dhe me dorën e djathtë ngriti letrën duke e tundur në ajër.

Të burgosurit shtangën një cast. Ata filluan të gjallëroheshin kur panë pranë rojes së burgut Mal Xhokën. atë që kishte liruar një natë përpara Met telegrafistin.

— Hajde, pra, pse rrini shtang e s'luani nga vendi si guri i mullirit? Mblidhni plaçkat dhe flur përjashta! Dhe shihni këtu: bëni tobe se s'keni për të përmendur më emrin e princ Vudit, të Sofijes dhe të Esad Pashë Toptanit!

Mali rrinte më këmbë dhe, me armën krahëqafë e buzëgaz, vështronte ata njerëz të heshtur, për të cilët kishte respekt e dhimbje njëheresh.

Të burgosurit, me plaçka më krahë, dolën nga burgu njëri pas tjetrit, pa bërë zë.

— A ma jep për kujtim këtë kapele që qenka si uturak? — i tha Reema një të burgosuri, që kishte lënë mjekër dhe flokët i zgjateshin pas qafe si flokë gruaje.

— Merre, o Rremë! — u përgjegj miqësish i burgosuri dhe qeshi.

— Më duhet t'ia vë dordolecit në arë për të trembularaskat — qeshi me të madhe picallioti.

Dolën nga burgu dyzet të burgosur, shumica të arrestuar me urdhërin e Musa Qazimit, i cili i akuzonte si njërez të rrezikshëm, që kishin përhapur shkrimin e gjuhës shqipe me shkronja latine dhe që kishin luftuar përvavarësinë e Shqipërisë, për ta shkëputur atë nga Turqia. Ca të tjerë ishin burgosur nga Haxhi Qamili si bashkëpunëtorë dhe miq të Esad Pashë Toptanit. Midis të burgosurve kishte nga ata që nuk pranuan të shërbenin nën qeverimin e kryengritjes fshatare.

\* \* \*

Ato ditë në Tiranë, në Elbasan dhe nëpër kazatë e tjera, ku qeverisnin këshillat e kryengritjes fshatare, filuan preqatitjet e etshme për grumbullimin e forcave, të ushqimeve, të armëve e të munitioneve, duke pasur parasysh luftën që do të zhvillohej për mbrojtjen e kufive nga sulmi i ushtrive të huaja serbe. Këshilli i kryengritjes fshatare shpalli nga Tirana paanësinë e Shqipërisë dhe u dërgoi nota konsujve të huaj në Shkodër dhe mbretit të Serbisë në Nish. Në notë thuhej se qeveria e kryengritjes fshatare nuk ishte e lidhur me asnje shtet tjetër, se kjo kryengritje ishte një punë kryesish e shqiptarëve, se nuk kishte të bënte me Italinë, me Austrinë, me Turqinë, as me ndonjë shtet tjetër, se Shqipëria ishte e paravarur dhe asnjanëse në luftën e përbotshme, se kush do ta sulmonte do të pritej me luftë. Nota u bënte thirrje qeverive ballkanike për paqë e miqësi midis tyre duke ndenjur secili brenda kufive të shtetit të vet.

Me sa u muar vesh, pas disa ditësh, qeveria serbe nuk e përfilli fare notën e Haxhi Qamilit dhe repartet e ushtrisë së saj filluan të shkelnin kufitë shqiptarë dhe të futeshin herë pas here në tokat shqiptare nga ana e Gollobordës dhe e Quqësit. Pra ishte e qartë për të

gjithë se kral Pjetri kishte vendosur ta sulmonte Shqipërinë dhe të gjithë e dinin se Esad Pasha kishte pranuar të lidhët marrëveshje me Pashiqin dhe Pjetrin e Serbisë pér t'i lejuar ushtritë e tyre të shkelnin vendin.

Haxhi Qamili, nën presionin e fortë të masave popullore të qytetit e të fshatit dhe të komandantëve të kryengritësve, pranoi bashkimin me patriotët e qyteteve dhe u dha pëlqimin e tij edhe fshatarëve kryengritës që të luftonin krah pér krah pér pavarësinë e Shqipërisë, një kohësish duke mos harruar dhe luftën kundër bejlerëve e Esad Toptanit. Disa nga oficerët shqiptarë në Tiranë dhe në Elbasan, të cilët ishin patriotë, u vunë në krye të ushtrisë fshatare. Masat popullore të qytetit dhe shumë nga patriotët u bashkuat me fshatarët. Kundërshtar i besëlidhjes së Tiranës ishte Musa Qazimi. Haxhi Qamili, kur mori vesh kundërshtimin e tij, dha urdhër pér arrestitin e myftiut të Tiranës, por ky i ra hiles dhe u largua nga qeveria në kohën e duhur, pa lënë gjurmë. Musa Qazimi, turkoman i tërbuar, ai që helmatiste turmat fshatave kryengritëse me farën e panislamizmit, përfundimisht doli jashtë radhëve të saj.

\* \* \*

Në shtëpi të telegrafistit Rama dhe Mali gjetën edhe Asllanin, që po lahej në oborr te gryka e pusit. Një vajzë e re i shtinte ujë me një helmetë të vjetër, e cila bënte punën e kovës së pusit.

— O, mirë se erdhët! bërtiti Asllani dhe menjëherë iu drejtua Malit:

— T'i rregullova punët, në kohën që mungoje ti. U paraqita edhe në qeveri dhe tërhoqa ushqime: fasule, vaj e bukë! Ha... ha... ha... qeshi Asllani dhe shtoi:

— Ja shkëputa magazinierit një gjysmë thesi me sheqer. Sonte, që erdhe ti, do të bëjmë një hallvë të mirë.

Ndërkohë u dhanë te gryka e pusit i zoti i shtëpisë dhe një qytetar i panjohur. I zoti i shtëpisë u tha fshatave kryengritës:

Ju paraqes me një mikun tim. Quhet Xhemal.  
Rama dhe Mali i shtrënguan dorën Xhemalit me  
një përzemërsi të ciltër, sikur të ishin njojur prej kohësh.

— Meti më ka folur shumë për ju — i tha Xhemali  
një burrë i bëshëm, shumë i sjellshëm, që të ngjallte  
respekt apo e njihje.

Edhe jū jeni telegrafist, apo jo? — i tha Mali.  
Si urdhëron! — u përgjegj Xhemali.

I fshehu? — pyeti përsëri Mali.

Jo, — buzëqeshi Xhemali dhe, kur pa se fshatari  
i ri mbeti si i hutuar, shtoi: — Unë vazhdoj punën në  
telegrafën e Haxhi Qamilit. U dërgoj telegramë kazave  
të tjera. Haxhi Qamili e di për mua që jam shqiptar i  
flakte, por di edhe që unë urrej bejlerët dhe veçanërisht  
Esad Toptanin.

Ram Leka buzëqeshi dhe, duke tundur kokën, tha:  
— Sa keq, sa keq u ngatërruan punët!

Cdo e keqe sjell një të mirë — u përgjegj Xhemali.

Dhe çdo e mirë sjell një të keqe. — shwi i zoti i  
shtëpisë.

— Ju ja keni shtruar muhabetit te gryk' e pusit hi...  
hi... hi... qeshi Asllani duke u fshirë me peshqirin që po  
i sillte vajza e të zotit të shtëpisë.

— Ka të drejtë xha Asllani, hyjmë brenda! — tha  
Meti dhe i drejtoi miqtë të dhoma me mindere.

Të katër burrat, të shqetësuar, përsëri nisën bisedat  
për gjendjen e krijuar.

— Unë kam në dorë shifrën sekrete të Esad Toptanit,  
të cilën më transmetoi një telegrafist durrsak, armik  
i betuar i Pashës. — Esad Toptani i ka telegrafuar Pa-  
shiqit në Nish se kah nënë dakord që ushtritë e Kral Pjetrit  
të Serbisë të kapërcenë kufirin e Shqipërisë. Në fund  
te telegramit, Esad Toptani tradhëtar i uron mbretit e  
Pashiqit takimtë mbarësë në Tiranë. Ja, ky është teksti  
i telegramit — që i tha Xhemalit duke shpalosur një copë  
letër të verdhë.

E prakjo është e qartë i thë Meti. — Serbët do  
të sulmojnë Shqipërinë dhe do të bëjnë një udhë e dy

punë: Do të godasin kryengritjen fshatare dhe do t'i jepin pushtetin Esad Pashë Toptanit, që prej kohësh e kanë të vetin. Duan pra të realizojnë ëndrrën e vjetër, të dalin në Durrës e në Shëngjin. Mbaroi pavarësia e Shqipërisë.

— Kurse grekët i kanë ngulur thonjtë në krahinat e Jugut dhe na kanë krijuar «Vorio-Epirin».

— Kurse në Shkodër ende qeveris Komisioni ndërkombëtar — tha Xhemali dhe tregoi shkurtazi gjendjen politike botërore.

— Italianët nga Sazani kanë dalë në Vlorë — shpjegoi Meti.

— Pse nuk thoni se jemi të rrethuar nga të gjitha anët? — ia priti Ram Leka, — i cili ndiqte me kujdes bisedat që bëheshin në atë dhomë të vogël që mbante një erë të rëndë lagështie — Italia ka hyrë në luftë duke prishur asnjanësinë. Stambolli paska nxjerrë një dekret me të cilin e ka shpallur Esad Pashën armik të Turqisë. Shtetet e mëdha të botës janë kacafytur e gjakosur njëri me tjetrin për të sunduar botën. Të dy palët ndërluftuese, si fuqitë evropiane të qendrës ashtu edhe Antanta, në qëllimet e tyre grabitqare përfshijnë edhe copëtimin e tokave shqiptare. Dhe s'kanë turp, bëjnë edhe deklarata sa njëra anë sa tjetra, sikur gjoja përkrahin pavarësinë tonë! Gjenjeshtra, mashtrime! Duan të na shtien në kallëpe e të na përdorin për qëllimet e tyre të luftës, kurse Turqinë e ka marrë lumi.

— Është bërë si një kufomë që po jep shpirt — tha Meti — e që xhonturqit duan ta ngjallin me injeksione. Po këto nuk bëjnë ndonjë fajde.

Mali dëgjonte dhe përpinqej t'i bluante ato mendime që hidheshin aty në atë bisedë, kur Xhemali tha: «Gabimi ynë është që ne u mbështetëm qorrazi te princi i huaj gjerman dhe te qeveria e tij, me Esad Pashën në krye». Komandanti i Pishtarit u hodh përpjetë duke britur sikur të kishte bërë një zbulim të madh.

— Po të ishin bashkuar me fshatarët edhe patriotët kundër Esad Toptanit dhe kundër të gjithë bejlerëve, nuk do të shinte lëmë Musa Qazimi me agjentët e tjerë xhonturq.

— Nuk éshtë ende vonë — ia priti Xhemali. — Kemi kohë pér ta menduar e pér ta vënë në jetë këtë gjë.

— Mjerisht unë e shoh të errët të ardhmen — tha i dëshpëruar i zoti i shtëpisë dhe uli sytë përtokë. — Gjendja éshtë kaq e rëndë, sa nuk e merrni dot me mend. Në një krah serbët, në krahun tjetër grekët dhe në Vlorë italianët, kurse austriakët po turren këmba-këmbës drejt Ballkanit. Ata do të bëjnë pluhur e hi edhe kryengritjen fshatare, edhe patriotët, edhe pavarësinë, edhe flamurin, lirinë dhe çdo gjë tjetër shqiptare. Ne jemi të përcarë dhe nuk do të jemi në gjendje të përballojmë këtë tufan shkatërrimtar që po i vërsulet vendit.

— Mos u bëj merak! Sido që të zhvillohen ngjarjet ndërkombe tarare, bimët shqiptare, që nuk i shkulën shekujt, do të rriten dhe do të lulëzojnë përsëri — tha Xhemali duke i njojur mendimet pesimiste të Metit në lidhje me punët e Shqipërisë dhe duke prekur shokun në pikën më të dobët. — E, pra vëlla, ku toje një herë e mirë se Shqipërinë nuk do ta bëjnë kurrë bejlerët e pashallarët, Shqipërinë do ta bëjnë vetëm populli dhe punët do të marrin rrugë të mbarë vetëm atëhere kur burrat e shtetit dhe trimat do të mbështeten te fshatarët dhe te vegjelia e qyteteve, që përbëjnë shumicën dhe që janë të zotët e gisshit e të pushkës.

— Ti je poet — i tha me ironi Meti.

— Realist — ia priti Xhemali.

Në dhomën me mindere erdhën dhe disa njerëz të tjera. Më vonë një hafëz i ri, pa mjekër, hapi derën me rrëmbim. Ai merrte frymë me gulshim, sikur t'i ishte ngjitur një mali, Pa u ulur mirë, pyeti të zotin e shtëpisë:

— E qëndisi Teuta flamurin?

— Po, — u përgjegj shkurt telegrafisti.

— I thuaj ta sjellë këtu! — e urdhëroi hafëzi i ri, i cili fshatarëve kryengritës, që e takonin pér herë të parë, po u dukej shumë i çuditshëm.

Telegrafisti doli nga dhoma që të thërriste të mbesën.

Hafëzi i ri, nuk kishte as mjekër, as mustaqe. Ky kishte përkthyer syret e kurianit në gjuhën shqipe dhe të premten e parë pas ngritjes së flamurit, në nënstorin e

vitit 1912, në xhaminë e vjetër, për herë të parë në historinë e fesë muslimane në Shqipëri, kishte kënduar lutjet në gjuhën amëtare. Shumica e të pranishmëve atë ditë kishin qenë nga njerëzit e mësuar të qytetit dhe patriotë nga ata që kishin marrë pjesë me armë në dorë në çetat shqiptare të viteve të shkuara. Por kishte pasur edhe njerëz që ishin tmerruar nga guximi i hafëzit kryengritës dhe që e kishin quajtur punën e tij si përmbyssje të fesë muhamedane. Zija beu, dhe një nga tregëtarët e pasur të qytetit, të ngritur nga vendi dhe në shenjë proteste, dolën nga xhamia duke lënë lutjen përgjysmë.


Pasi e thirri telegrafisti, në dhomë hyri e bija, Teuta, që mbante në dorë një copë pëlhurë të kuqe, ku ishte qëndsur shqiponja e zezë dykrenare dhe stolisur anash me fije ari. Të gjithë sa qenë mbledhur e mbajtën frymën dhe, me vështrime të ngrira, ndiqnin çdo lëvizje të asaj vajze të shkathët.

Teuta e hapi pëlhurën e mëndafshtë dhe, pasi e shtroi mbi tryezë, ndenji një copë herë si statujë e mermertë duke vështruar ngjyrat e ndezura kuq e zi. Vajza, me qëndrimin që mbante, nderonte me respekt dhe me passion të zjarrtë patriotik flamurin e Kombit Shqiptar!

Të dymbëdhjetë burrat e mbledhur në atë dhomë kokë më kokë u ngriten më këmbë dhe, të menduar, shikonin shqiponjën dhe cohën e kuqe të mëndafshtë duke përfytyruar të ardhmen e Kombit Shqiptar.

Mal Xhoka krahasonë me mendjen e tij ndryshimet që kishin me patriotët e qytetit.

— Ka ardhur koha të veprojmë. Gryka e pushkës do ta vendosë rrugën tonë. Ngrihem, burra! Të bisedojmë e të veprojmë për bashkimin e të gjithë popullit, pa bejlerë, për të shkuar e për të mbrojtur kufitë tanë nga ushtritë e huaja. Hajde na qoftë sahati i hajrit! — foli në fund Leka dhe, duke i rënë në sup Metit, i tha: — Ti do të vish me ne!



— Prit, o Ram Leka! — i tha Xhemali dhe e prapsi me dorë. Lidhur me telegramin sekret të Esadit, që bën fjalë për marrëveshjen me qeverinë serbe në Nish, ti duhet të takohesh sa më parë me Haxhi Babën dhe t'ia tregosh gjendjen e krijuar, qëllimet e qeverisë serbe për të pushtuar Shqipërinë e Veriut dhe të Mesmen. Pastaj ata kanë për qëllim ta transportojnë ushtrinë e tyre përmes detit, pas shpinës së ushtrive të blokut qendor, në frontin e lindjes. Si shpërblim për rrugëkalimin, qeveria dhe mbreti i Serbisë i kanë premtuar Esad Toptanit jo vetëm se do ta shpëtojnë nga rrethimi i Durrësit, por edhe se do ta shpartallojnë kryengritjen fshatare dhe do t'ia rikthejnë përsëri pushtetin e humbur.

Rama dhe Mali u ulën prapë në minder dhe, me interes të veçantë, ndiqnin bisedën e vlerësimet politike të kohës që po i radhiste dhe analizonte Xhemali.

Fjalët e tij tingëllonin si kushtrim lufte.

— Ja vdekje, ja liri! — briti Xhemali, që kryesonte mbledhjen dhe, mbasi qëndruan më këmbë dy a tri minuta, ai shtoi: — Fillojmë nga puna!

Në dhomë befën edhe disa burra të tjerë. Xhemali e ndërpren fjalën dhe priti sa të zinin vend qytetarët që erdhën me vonesë. Njëri prej tyre, Elmaz armëtar, sapo u ul në minder, nxori nagantën me mulli nga brezi dhe e vuri mbi flamur. — Kush tradhëton atdheun e pret plumbi! — tha ai me ton solemn.

— Jemi të gjithë? — pyeti përsëri Xhemali. Telegrafisti pasi hodhi një vështrim të vëmendshëm nga të pranishmit, u përgjegj: — Po. Asnjë nuk mungon.

Meti doli në korridor dhe bisedoi me zë të ulët diçka në vesh me të mbesën. Porta e oborrit të rrethuar me avlli ishte myllur me shul prej druri. Në qoshe të hajatit rrinte i struktur me pushkën në prehër Skifteri.

— Ecë brenda, rinosh, e dëgjo edhe ti. Deri sa ke kapur pushkën, tani radhitesh edhe ti midis trimave, — i tha telegrafisti dhe e zuri djalin nga krahu.

Skifter Leka, i drojtur, hyri në dhomë. Mali u shtrëngua t'i lironë pak vend.

— Dëgjoni, vëllezër dhe miq! — filloj ligjëratën Xhe-

mali me një ton solemn. — Shqipëria po kalon çaste të vështira. Qëllimi i kësaj mbledhjeje është që të rrahim e të këmbejmë mendimet tona për gjendjen e jashtme dhe të brendshme politike dhe të bashkojmë të gjitha forcat popullore, të fshatit e të qytetit, dhe të luftojmë për mbrojtjen e atdheut nga ushtritë grabitqare të Kral Pjetrit. Duhej dhe do të ishte e udhës që kjo mbledhje të bëhej në mixhliz në fushën e Namasgjasë, dhe jo kështu fshehura, siç po e bëjmë ne. Duhej që në një mbledhje si kjo të merrnin pjesë përfaqësues të kryengritjes fshatare nga të gjitha kazatë e vendit. Duhej të çoheshin të gjithë më këmbë kundër ushtrive pushtuese të Kral Pjetrit, kundër grekërve shovinistë, që duan të copëtojnë tokat shqiptare, kundër të gjithë armiqve që kanë tradhëtuar mëmëdheun. Por...

— Esad Toptani thotë se ushtritë serbe kërkojnë vetëm rrugë për të shpëtuar kokën. — tha dikush. Ishte Mustafai, tregëtar i porcelanit.

Leka dhe Mal Xhoka panë në sy njëri-tjetrin. Ata u shqetësuan se midis tyre gjendej një njeri që sadopak mbante anën e Esadit.

— Lufta botërore nuk ka plasur për sytë e bukur të pashait të Tiranës — u përgjegj Xhemali dhe shtoi: — Pashiqi, Pjetri e zotërit e tjerë të Serbisë e të Malit të Zi atë që nuk mundën të realizojnë në vitin 1912, po përpiken ta realizojnë tanë në vitin 1915! Për çdo njeri me mend në krye është e qartë se kushdo që të fitojë në këtë luftë të përbotshme Antanta ose Austro-Hungaria dhe Gjermania, të dy palët kanë ndër mend ta ndajnë Shqipërinë, si shpërblim për plaçkë lufte. Nuk u duhet besuar deklaratave të tyre të bujshme. I vetmi mjet për të shpëtuar kombin tonë shqiptar është bashkimi i popullit.

— Nuk jam krejt i mendimit me ty, o zotni! — briti hafëzi i ri duke u ngritur më këmbë dhe duke tundur të dy duart në ajër. — Shqipëria ka nevojë për një mik të fortë, për një shtet modern e të përparuar, që ta ndihmojë sinqerisht zhvillimin e këtij vendi gjysmë të egër.

Dhe ja ku po ua them unë me plot gojën: ky shpëtimtar i kombit tonë musliman shqiptar éshtë Gjermania.

— Gjermania, o Hafëz, éshtë një pemë dimërore, që piqet vonë. Ne duam frutat sa më shpejt, dhe kjo pemë me kokrra éshtë Italia — ia priti tregëtari i porcelaneve, një faqekuq, që prej disa vitesh rrihte rrugët e tregjeve italiane dhe bënte allishverishe me tregëtarët e fabrikantët italianë, të cilëve u shiste lëkura e dru arre dhe u blente porcelane e artikuj kuzhine.

— Nuk po më durohet, o burra, t'i them edhe unë dy fjalë! — tha Ram Leka, pa u tundur nga minderi ku ishte ulur këmbëkryq.

Të pranishmit nuk e prisnin që në debatet politike të merrnin pjesë edhe fshatarët.

— Unë jam fshatar dhe nuk di sa ju. Në presim të na mësoni e të na udhëhiqni ju. Por të na udhëhiqni drejt, ama, jo kështu! Esad Pasha mbështetet tek Serbia e Kral Pjetrit. Musa Qazimi te Turqia. Zografi e Spirua te Greqia, Hafëzi te Austria e Gjermania, Mustafai te Italia. Pra, me sa po dëgjoj, zotërinj, ju e mbështetni krejtësisht shpresën për shpëtim vetëm tek të huajt. Dhe tani po haheni se cilin shtet të zgjidhni për mbrojtje! Ju jeni në kundërshtim midis jush. Vaj medet ç'e ka gjetur vatanin! — briti Ram Leka dhe i ra me grusht kokës nga dëshpërimi.

— Shqipëria e sotme i ngjan një fëmije trevjeçare, e cila, pas një sëmundjeje të rëndë, nuk ka besim të ngrihet e të ecë me këmbët e veta! — tha Xhemali që heshti kur vuri re se kërkoi fjalën Ceni nga Priska.

— Sot éshtë koha të rrrokim armët dhe të shkojmë të luftojmë në kufi. Atje, në fushën e betejës, do të bëhet bashkimi! — thirri priskani, që ishte një burrë i paktë në shtat, por trim. Ai ishte një komit i vjetër, që ishte ngritur për liri e drejtësi.

— Hajde, pra! — ndërhyri Mal Xhoka, që deri atëhere nuk kishte hapur gojën. Ai u ngrit më këmbë me pushkë në dorë. Ashtu me atë pozë ai dukej sikur do të sulmonte atë çast. — Këtu, — shtoi Mali, — jemi mbledhur të bisedojmë se si të ngremë më këmbë të gjitha

forcat popullore patriote, fshatarët e qytetarët, oficerët dhe ushtarët, gegët e toskët. Dhe unë them të mos humbim kohë, po t'i përvishemi punës një orë e më parë e të nisemi për luftë, se ndërsa ne bëjmë mbledhje, ka të ngjarë që ushtritë e huaja ta kenë kapercyer kufirin!

— Sa për luftë kundër ushtrive të huaja serbe jemi dakord të gjithë të rrokim pushkët! — tha Hafëzi, i cili e kishte humbur atë entuziazmin e parë.

Telegrafisti Mehmet Rizai tha se ai ishte kundër Esadit dhe se i vinte mirë që Haxhi Qamili dhe ushtria e tij me hunj zjarri nëpër duar u kishin vënë zjarrin saraeve të pashait. Por ai ishte i mendimit se ky zjarr nuk duhej t'i vihej edhe Murat Toptanit dhe Refik Topitanit, që ishin patriotë të zjarrtë pér çështjen shqiptare dhe që kishin mendime dhe ide demokrate e përparimtare pér zhvillimin e përparimin e vendit.

— Po cila rrugë do ta çojë Shqipërinë në çlirim? — tha më në fund telegrafisti. Unë kësaj pyetjeje, që e bëra vetë, nuk di si t'i përgjigjem. Shumë mendime të ndryshme po dëgjojmë.

— Rruga gjendet! — u hodh Xhemali — Të krijojmë një parti revolucionare me bijtë më trima dhe të zgjedhur të fshatarësise kryengritëse, të vegjëlisë së qyteteve, me patriotët e vërtetë, që interesat e tyre personale i sakrifikojnë pér të mirën e popullit. Pragrami i kësaj partie le të jetë bashkimi i të gjithë popullit të fshatit dhe të qytetit, mbrojtja e tërësisë tokësore dhe të drejtave kombëtare të Shqipërisë, përbysja e bejlerëve dhe e pashallarëve. Dhe, ajo që do t'i japë shpirt e do të ndezë zemrat e të gjithëve, le të jetë drejtësia fshatave. Toka t'i jepet bujkut dhe të përbysen një herë e përgjithmonë çifligarët, bejlerët, bajraktarët dhe pushteti i tyre. Atëherë keni pér të parë se si do të vrapijnë të gjithë të luftojnë pér Shqipërinë, pa kursyer as jetën pér mëmëdheun.

— Kësaj i thonë socializëm! — briti tregëtari i porcelaneve. — Dhe socializëm do të thotë përbysja e botës! — shtoi ai me sy të zgurdulluar, që shprehnin tmerrëllahtari!

Biseda u ngatërrua. Me përjashtim të fshatarëve kryengritës, që rrinin të qetë dhe që e pritën me entuziazëm zgjidhjen që i jepte Xhemali, thua jse kjo punë do të bëhej nesër, të tjerëve sikur u ra pika. Qëndrimi i tyre i heshtur e i zyrtë tregonte qartë se midis tyre dhe fshatarëve kryengritës varfanjakë dhe barkzbrasur kishte një hendek të thellë.

— Prona private është e shenjtë! — thirri Mustafai.

— Edhe revolucioni freng nuk vuri dorë mbi pronën — tha hafëzi i ri.

— Po Haxhi Baba dhe shokët e tij ngritën dorë edhe kundër asaj prone, ata vunë dorë edhe në kasafortat me florinj që bejlerët i kanë vënë me djersën dhe me gjakun e bujqve dhe të fshatarëve të varfër — tha Xhemali.

Mal Xhokës gjithnjë e më tepër po i bënин përshtypje arësyetimet e Xhemalit. Ai nuk harronte edhe bisedat që kishin bërë më parë rrëth shkaqeve të Luftës së parë botërore, rrëth shkaqeve të kryengritjes fshatare në Shqipërinë e mesme. Mali kish besim te Xhemali, se ky kishte shëtitur dhe kishte parë shumë.

Në këto çaste te dera e jashtme dikush trokiti me nxitim sinjalin e njohur.

— Ushtritë serbe dolën në Qukës. Ka filluar luftë e rreptë midis tyre dhe kryengritësve fshatarë — thirri një djalë i ri, sapo hyri në dhomën me mindere.

Burrat u ngritën më këmbë dhe të shqetësuar prisnin urdhëra se nga duhej filluar. Mbrëmja po afronte.

— Dëgjoni, o burra! — ia pat Cen Priska. — Të nisemi që tashti, të shkojmë së bashku në Qafë të Priskës, në Qafë të Tujanit e në Qafë të Kërrabës dhe atje, së bashku me fshatarët e tjerë, t'u vëmë pushkën ushtrive të huaja!

E, pra, o burra, të ngrihem! T'u bëjmë thirrje patriotëve qytetarë të bashkohen me fshatarët dhe të zënë qafat, grykat e gërxhet e maleve për të luftuar kundër armiqve pushtues! Koha nuk pret. Të ngrihem sa më parë. Të gjithë e miratuan këtë mendim dhe filluan të ngrihen. Duhej të preqatiteshin për betejat e ardhshme.

## NË VIGJILIEN E LUFTËS

Fusha e Shallvares ishte kthyer në një kamp të vërtetë ushtarak.


Të gjithë u radhitën dhe u vunë ballë për ballë në dy radhë. Haxhi Baba, Komandant i përgjithshëm i ushtrisë kryengritëse fshatare, i veshur me uniformën e gjeneralit, kaloi në mes tyre dhe, kur mbërriti në fund të rreshshit të gjatë u kthye nga fshatarët kryengritës dhe u tha:

— Vellezër katundarë! A doni të luftoni kundër serbit për mbrojtjen e vatanit dhe të lirisë?

— Të gjithë jemi gati, o Haxhi Baba! — u përgjegjën si në kor fshatarët e armatosur.

— Dijeni se duke luftuar kundër ushtrive të Kral Pjetrit — u tha Haxhi Baba me zë të ulët dhe me një ton miqësor — luftojmë kundër Esad Pashës dhe kundër bejlerëve. Ata edepsëzë po na sjellin të huajt në vatrat tona! — Ai uli kokën e për një çast heshti. Pastaj, duke fërkuar mjekrën e ashpër, ra në mendime dhe harroi që kishte përpara pasëqind trupa të zgjedhur nga më trimat dhe më besnikët e ushtrisë së tij fshatare prej tridhjetë mijë shpirt.

— Rroftë Haxhi Baba! — thirri një fshatar trupvogël, përkrah të cilit rrinte Ram Leka. Vala e britmave për shëndetin e komandantit Haxhi Qamili, u përhap në të gjitha radhët e ushtrisë. Haxhi Baba, pasi u përmena, vazhdoi: — Dëgjoni një këshillë të Babës: Po të vritem bëni si të dini vetë, po unë them se duhet të zgjidhni një komandant të ri dhe pastaj përsëri, o burrani, në



luftë! Këtë porosi mos e harroni, dhe tashti të nisemi, e na qoftë udha e mbarë!

Komandantët fshatarë filluan të jepnin urdhëra. Radhët e ushtarëve lëvizën drejt qytetit. Në fillim ecte kaloria, e përbërë prej tridhjetë kalorësish, me në krye Haxhi Babën, shaluar në një pelë të bardhë race arabe. Dy fshatarë u binin trompetave. Pas kalorisë vinte këmbësoria. Ushtarët e Haxhi Qamilit ishin të veshur me brekushe e xhoka të zeza me thekë dhe shumica mbanin në kokë qeleshe të bardha. Me pushkët të hedhura në sup, fshatarët kryengritës turma-turma i vinin pas komandantit të tyre, duke kënduar këngë trimërie. Një grup kalorësish nga radhët e para ia nisen një kënge patriotike.

Pasi doli këmbësoria nga fusha e Shallvares u lëshuan tri mushka, që tërhiqnin tre topa malorë me rrrota. Artillerinë e komandonte një oficer karriere, që ishte bashkuar ditët e fundit me fshatarët. Populli, që kishte dalë për të përcjellë ushtrinë që po nisej për në luftë, e ndoqi atë deri në kodër të Kapilit, mbi fushën e Farkës. Si udhërrëfenjës të taborit kishin caktuar Malin nga katundi Skuterrë. Ai, hipur në një mushkë, ecte përkrah Haxhi Qamilit. Duke vështruar komandantin, atij i kujtohej 28 Nëntori i vitit 1912, kur kishte shkuar si shoqërues i delegatëve në kuvendin e Vlorës, pranë Ismail Qemalit dhe Isa Buletinit. Fshatari kishte nderuar ngritjen e flamurit të pavarsisë shqiptare. Kurse tani ushtria kryengritëse fshatare, e vetmja forcë e organizuar ushtarakë e Shqipërisë, duhej të përballonte agresionin e huaj.

Korrierët, që dërguan komandantët e kryengritësve fshatarë, u nisen drejt Shkallës së Priskës, Shkallës së Tujanit, Qafës së Selbës dhe u shpërndanë fshatrave të rrëzës së vargmaleve të Dajtit, për të dhënë kushtrimin e luftës, për të lajmëruar që të ziheshin pritat në qafat e grykat e maleve, nëpër ato vende nga mendohej se mund të kalonte ushtria serbe.

Taborret e ushtrisë kryengritëse fshatare ngado që kalonin shtoheshin me forca të reja vullnetare. Në fushë të Mulletit zbritën shumë fshatarë të armatosur, që i ki-

shin ngritur korrierët. U mblodhën shumë fshatarë nga Petrela, Arbana dhe nga fshatrat e Pezës.

Haxhi Qamili e kishte hartuar që më parë planin e luftës. Tri taborre do të vazhdonin ta mbanin të rrethuar Durrësin, të ruanin dhe të godisnin me ashpërsi forcat mercenare të Esad Pashës, që parashikohej të shpërthenin ofensivën pas shpine për të pushtuar Tiranën. Një pjesë e ushtrisë së tij ishte nisur nga Elbasani dhe kishte zënë pozicione në Qukës. Sipas urdhërave të dhëna nga shtabi, nën drejtimin e Haxhi Qamilit, nuk u bë e mundur që të përfshiheshin dhe të viheshin në lëvizje drejt fronteve Qafëkrrabë, Qukës dhe Peqin të gjitha formacionet ushtarake të kryengritësve fshatarë, që ishin shpërndarë nga Bregu i Matës dhe deri në brigjet e Vjosës. Arësyet e mospërqëndrimit të këtyre forcave me shpejtësinë e duhur, për të ardhur në frontin e luftës, ishin të shumta: forca të konsiderueshme duhej të qëndronin në rrethin e Durrësit, disa taborre duhej të prisin ushtri-të malazeze, që kishin shpérthyer agresionin nga ana e Shkodrës. Një pjesë tjetër, për mungesë komunikacioni dhe, ndërlidhjeje midis tyre, ishte e izoluar nga shtabi i ushtrisë fshatare. Po kishte pastaj edhe nga ata grupe të armatosura fshatarësh, të cilët iu shmangën largimit nga fshati me qëllim që të mbronin shtëpitë e tyre.

Haxhi Qamili ishte pa arësim dhe horizonti i pikë-pamjeve të tij politike ishte mjart i kufizuar. Ai e kishte kaluar pjesën më të madhe të jetës në fshat me punë bujqësie, për të nxjerrë kafshatën e bukës. Por ai kishte një botë shpirtërore shumë të pasur. Ai bluante në kokë mendime, shoshiste gjithë sa kishte dëgjuar nga të parët e vet e nga gojëdhanat lidhur me luftën e popujve përliri. Ai trashëgonte mjart edhe nga stërgjyshërit e tij, xhametajt e Sharrës, të dëgjuar për trimëri e të zotët e pushkës. Tregonjë se xhametajt nuk u nënshtroheshin kurrë bejlerëve të Arbanës, madje u rrinin me kokën lart edhe toptanasve të Tiranës.

Haxhi Qamili ishte njeri i mbyllur në vetëvete, fliste pak e dëgjonte shumë.

Bashkëfshatarëve dhe qytetarëve të Tiranës nuk u kishte shkuar kurrë në mend se ky fshatar tridhjetegjash-tëvjeçar, një ditë do të shquhej dhe do të bëhej komandant i një ushtrie prej tridhjetëmijë vetësh! Haxhi Qamili, megjithëse nuk dinte as gjeografi, as topografi as edhe shkenca të tjera, e s'kishte njohuri nga arti ushtarak, ishte treguar ushtarak dhe mjeshtër lufte. Aftësitë e tij, në artin e betejës, ishin zbuluar një vit më parë, në përpjekjen kundër forcave të mëdha mercenare të Preng Pashës në Ishëm, përpjekje që përfundoi me fitore të shkëlqyer. Forcat mercenare të Mirditës ishin thirrur aty nga mbreti Vid për të çarë rrëthimin e Durrësit nga kryengritësit fshatarë.

Tani lufta me ushritë e Kral Pjetrit ishte prova e tij më e madhe. Haxhi Qamili duhej të hartonte plane luftarake, që të mund të mbrohej nga një ushtri e rregullt, e armatosur deri në dhëmbë me armët më moderne të kohës dhe e pajisur me artileri. Atë gjithashtu e mundonte përçarja që ekzistonte prej kohësh në radhët e kryengritësve fshatarë dhe sidomos përçarja dhe izolimi nga krahinat e tjera të Shqipërisë! «Ah! — u kish thënë ai oficerëve dhe këshilltarëve në një mbledhje në Tiranë — sikur të vinin pas nesh, në këtë luftë, të gjitha forcat patriotike të krahinave të vendit, ne do ta fitonim betejën dhe do t'i detyronim ushritë e Kral Pjetrit t'u mbathnin këmbëve për në Serbi!» Megjithëse i shqetësuar, Komandanti i kryengritjes fshatare asnjeherë nuk shprehu ndonjë shenjë dëshpërimi. Sipas planit të luftës që kishin hartuar ata nisën forca në të gjitha grykat e qafat e maleve. Gjithashtu u bënë përforcime edhe në grykën e Peqinit, duke menduar se komanda serbe do të dërgonte reparte edhe nga ana e Elbasanit në drejtim të Peqinit, për tu rënë pas shpine fshatarëve, të cilët mbanin të rrëthuar prej disa muajsh fuqitë mercenare që mbronin qeverinë e Esad Pashë Toptanit.

\* \* \*

Mal Xhoka me taborrin e Pishtarit do të zinte vend në majat e maleve mbi Skuterrë. Ai do të përforconte pozitat strategjike ushtarake edhe me fshatarë vendës. Maja e Senaxhares ishte maja më e lartë e atyre shkëmbinjve të zës, të thepisur dhe të zhveshur. Shkalla e Gruas vinte përballë Razoverës, Shkrepi i kuq dhe kodra e Qimeleshit qëndronin si mburojë të fshatit. Rasa Mushkë vinte thikë mbi qendrën e fshatit dhe aty në majë të atij mali të lartë mbi 1500 metra, kishte një grykë të vogël, që zbriste prapa malit të veshur me gështenja e drunj të tjerë. Kodra e Gjyshes dhe vendi Guri Kaluar ishin pozicionet e fundit të frontit mbi qafën e Razoverës. Këtu pri-tej të bëhej ndeshja me ushtritë e Kral Pjetrit, të cilat me vështirësi lëviznin nëpërmes maleve dhe shtigjeve të Çermenikës. Ushtria sérbe tërhiqte me vete edhe artillerinë e rëndë, gjë që vononte përparimin e reparteve ushtarake serbe. Informatorët fshatarë lajmëronin se ushtria e huaj prej rreth njëzetmijë vetësh po përparonte në drejtim të Qukësit dhe disa reparte kishin hyrë në Çermenikë në drejtim të Qafë Kërrabës.

Fshatarët vendës do të furnizonin me ushqime ushtarët e tyre nëpër prita.

Mali u takua me Ram Lekën. Sipas një plani që bënë me Xhemalin, telegrafistin patriot, gjysmën e ushtarëve të tyre do ta vendosnin në Skuterrë dhe vetë u nisën, në krye të një taborri prej dyqind vetësh, përtej grykës së ngushtë të Erzenit për t'i dalë armikut prapa krahëve.

## NJË DETYRË E RREZIKSHME

Mal Xhoka printe përpara. Njëshkolona, e përbërë nga dyzet luftëtarë, i ngjitej së përpjetës që nuk kishte të sosur. Me pishtarakët, përveç Xhemalit, u bashkuan edhe telegrafisti tiranas, arësimtari i Shjakut dhe ai i Kasharit. Këta e ndjenin veten më të sigurt në njësitin e Malit. Met telegrafisti habitej me shkathtësinë, gjallërinë dhe autoritetin që kishte fituar Mal Xhoka.

Xhemali e cte përbri telegrafistit. Ai i tregoi shokut qafën e Rozaverës, e cila zbardhëllonte nga qeleshet e bardha të fshatarëve, sikur ta kishte mbuluar dëbora.

Befas, nja njëzet metra përtej bregut, u dëgjua një zhurmë. Komandanti Mal Xhoka ngriti dorën lart. Luftëtarët u ndalën menjëherë dhe qëndruan më këmbë pa lëvizur.

— Kush jeni ju? — thirri Mali.

— Luftëtarët e Priskës, — tha një zë që prapa bregut.

— Cili është komandanti juaj? — pyeti Mali, që e kishte hequr pushkën nga supi dhe po e mbante në dorë gati për çdo të papritur.

— Cen Priskani — u përgjegj po ai zë.

— Unë jam Mal Xhoka! — u përgjegj Mali, i cili e njoju zërin e Cenit.

— Mirë se vini, burra! — u tha Ceni, që u shfaq sikur të kishte mbirë nga shkëmbi.

Luftëtarët e të dy njësiteve, pasi përshëndetën njëri-

-tjetrin si miq tē vjetër, vazhduan rrugën te bashkuar drejt Pashkasheshit.

Diku, nëpër rrëzët e disa gurëve tē mëdhenj me thepa, u ndje gurgullima e ujërave tē një burimi.

Fshatarët e armatosur bënë një pushim tē vogël pranë atij burimi. Pas një copë here, u nisën përsëri përrugë. Filluan t'i ngjiteshin ngadalë e ngadalë një shkëmbi tē thepisur duke u kapur vende-vende pas njëri-tjetrit. Frynte një erë e ftohtë. Ngjitja bëhej gjithnjë e më e vështirë. Lart në horizont ngrivej drejt qillit tē kaltër tē qershorit një majë e lartë në trajtë koni, mbështjetllë me një pëlhurë tē bardhë resh, që vezullonin si argjend.

Luftëtarët, tē bërë quall në djersë, kur arritën në majë tē malit, hoqën këmishat dhe i nderën shkëmbinjve përt'u tharë. Pas pushimit tē dytë, njësiti i Mal Xhokës zbriti nga maja dhe humbi në pyllin e errët që vishtë faqen e malit. Aty, drunjtë e ahut ishin tē lartë e shumë tē trashë dhe tē paprekur fare nga dora e njeriut.

Sipas taktilës luftarake tē hartuar nga Mali e Cen Priska, që i njihte ato vende pëllëmbë për pëllëmbë, ata do tē kalonin në një rrugë tē vështirë dhe fort tē rrezikshme që tē conte prapa pozicioneve tē zëna nga ushtria e huaj. Si udhërrëfyes mqrën nga Selba një bari tē shkuar nga mosha, që nuk kishte parë kurrë qytet me sy. Ky ishte një burrë fjalëpakë dhe besnik. Udhërrëfyesi, bashkë me pararojën, ecnin nëpër një monopat fare tē ngushtë, ku mund tē kalonin vetëm dhitë ose njerëz tē mësuar maleve.

Fshatarët kryengritës, tē renditur në një varg tē gjatë, dukeshin nga larg si një zinxhir i madh dredha-dredha. Përveç pushkëve tē gjata e rripave me fishekë, tē lidhur pas mesit, ata kishin edhe bohçe, trasta lëkure tē varura pas supit ose çanta ushtarake tē hedhura pas shpine, me ushqime që i kishin llogaritur për dy a tri ditë, po tē hanin me shumë kursim.

Dielli ishte në tē perënduar dhe vendin përreth po e mbulonte dalëngadalë perdja e rëndë e natës, kur udhërrëfyesi e futi njëshkolonën e fshatarëve nëpër një mo-

nopat dhish brenda një shpelle që zgjatej si tunel. Poshtë monopatit binte një humnerë e thellë.

Udhërrëfyesi filloi të kacavirrej pas disa degëve të forta që kishin lëshuar rrënjet thellë nëpër shkëmbinj. Bariu, duke u mbajtur nga degët e bimëve të egra u mundua t'i dilte anash humnerës. Nën shembullin e tij ecnin edhe fshatarët e tjerë me pushkët krahëqafë. Udhërrëfyesi ndezi një copë pishë pér të ndriçuar rrugën e errët. Sapo mbërritën në gjysmën e shpellës, që ishte rreth tetëdhjetë metra e gjatë, ndodhi një fatkeqësi. Një fshatari trupmadh nga Gurra iu këput dega dhe, sao që u mundua të mbahej një çast me duar e me thonj pas shkëmbit të lëmuar, ra poshtë në humnerë duke ulërirë. Pas një copë here nuk u dëgjua më asnje zë dhe nga kjo u kuptua se jeta e tij mbaroi. Fshatarët, të heshtur dhe me zemër të lënduar, vështronin vendin ku kishte rënë shoku i tyre. Asnjeri nuk lëvizi, as nuk napi gojë.

Këtë qetësi të kobshme e prishi Mal Xhoka, që thirri: — Vëllezër fshatarë! Shoku ynë ra dëshmor në krye të detyrës. Burrat dhe trimat e vërtetë, që luftojnë pér liri dhe pér vatan, nuk i tremben vdekjes. Pra, o luftëtarë zemërfortë dhe të papërkulur, ecni përpara! Të shkojmë aty ku na thërrret detyra! — Me këto fjalë komandanti i Pishtarit la të kuontonte se nuk kishte kuptim që ata të kërkonin më nëpër atë humnerë, ku nuk kishte zbritur këmbë njeriu.

Udhërrëfyesi shkau si një gjarpër shkëmbit të ftohtë dhe të lagur. Ai ia bëri me dorë duke lëvizur pishën e flakëruar dhe, pasi ktheu kokën nga shokët, thirri: — Pas meje, o burra, forcë e durim! Ja, dhe pak rrugë dalim në dritë!

Njëshkolona e luftëtarëve filloi të gjallërohej dhe dalëngadalë, të heshtur e të zymtë, si vetë humnera, ata burra të përpjekur me jetën, çanë nëpër errësirë pér të dalë përtej, në qiellin e hapur.

— Dolëm! Shpëtuam! — thirri udhërrëfyesi, sapo mbrriti matanë.

— Dritë, dritë! — tha fshatari i dytë!

— Oh, sa male pa mbarim që paska këtej! — tha një bujk nga fusha, që për herë të parë po dilte jashtë fshatit të vet.

Kryengritësit, pasi dolën të gjithë nga shpella tunel, qëndruan të grumbulluar rrëth komandantit të tyre Mal Xhokës. Ata tashmë, me armët krahëqafë, e ndjenin veten të lehtësuar, sepse e kishin kaluar rrezikun.

Mal Xhoka filloi të vrojtonte me dylbi krahinën dhe vendin përposh fshatit Rozaverë.

— Ja, atje, mbi bregun e zallit, duken disa zjarre!

— tha Cen Priskani.

— Është fshati! — u përgjegj xha Asllani.

Mal Xhoka, që rrinte në qafë të shkëmbit midis dushqeve, pasi hoqi dylbinë nga sytë, tha:

— Nuk është fshat, por kampi armik!

— Po — pohoi Cen Priska, që ia kishte marrë komandantit dylbinë dhe po vëzhgonte me imtësi ato vende të njohura.

Telegrafisti dhe Xhemali, që po rrinin pranë Malit, panë njëri-tjetrin në sy dhe, nga vështrimet që këmbyen u kuptua se ndjenë një farë tronditje.

Komandanti miratoi mendimin e shokëve që të hanin bukë dhe të pushonin një copë herë e pastaj të prisnin sa të errej mirë për të filluar sulmin e befasishëm mbi kampin armik.

Në një copëz lëndinë midis pyllit, shtabi i përbërë nga Mal Xhoka, Naimi, Asllani, telegrafisti dhe Xhemali, u mblohdhën kokë më kokë dhe biseduan një copë herë të gjatë për planin e sulmit të befasishëm mbi kampin armik. Telegrafistit dhe Xhemalit, për herë të parë në jetën e tyre, po u jepej rasti të merrnin pjesë në luftë. Por, nga bisedat dhe qëndrimi që mbanin, dukej se atyre nuk u bënte përshtypje beteja. Xhemali tha se atij nuk i dhimbsej jeta në këtë luftë të drejtë për mbrojtjen e atdheut. Kjo betejë do t'u jepte një mësim të mirë gjithë armiqve që bëjnë plane të pushtojnë e të copëtojnë tokat shqiptare.

Telegrafisti tiranas gëzohej për ndjenjat e zjarrrta patriotike të Mal Xhokës, i cili ishte i vendosur që shqip-

tarët të përpinqeshin shumë pér 'pavarësinë dhe pér përparimin e arësimit e të kulturës në kombin e tyre. Atij iu bë zemra mal kur pa se komandanti i taborit të fshatareve kryengritës të Pishtarit nxori nga gjoksi flamurin kuq e zi të qëndisur me fije ari nga e mbesa. Ai nuk e dinte se Mal Xhoka e kishte marrë me vete flamurin. Xhemali rrinte buzëgaz dhe dukej sikur e dinte sekretin e flamurit. Edhe Naimi e Asllani u hutuan kur panë flamurin e ndaluar nga Haxhi Qamili, i cili e quante atë copë pëlhirë të ngjyrosur kuq e zi me shqiponjën dy-krenare si flamurin e Austrisë dhe të bejlerëve.

— E solla flamurin e Shqipërisë me vete — tha Mali me një ton solemn. — Kur të fillojmë luftën kundër ushtrisë së huaj, do të ngremë flamurin e Shqipërisë. Këtu është kombi i pavarur i Shqipërisë!

— Shumë drejt e ke menduar, o Mal Xhoka — tha Naimi duke i vënë dorën në sup Asllanit trupvogël, që rrinte ulur këmbëkryq dhe fërkonte me gishtërinjtë e zverdhur nga duhani pushkën, të cilën e mbante në prehëri si një fëmijë të përkëdhelur.

Në atë çast erdhën në mbledhje të shtabit Ceni dhe një fshatar i panjohur nga Rozaverja. Ceni, që ishte dërguar në fshat pér zbulim, tregoi pér numrin, armatimet dhe vendosjen e rojeve të kampit në ushtrinë armike. Mali i tha komandantit të Priskës që të ulej pranë tyre, kurse fshatari prej Rozavere, që do të luante rolin e kallauzit, u largua pér të kryer detyrën.

Met telegrafisti dalëngadalë po e kuptonte se Shqipëria nuk mund të bëhet nga një grusht njerëzish, sado të zot dhe të pushtetshëm që të jenë ata. Kështjella e kombit përbëhet nga themelët, muret dhe nga mijëra e mijëra gurë. E, pra, populli duhet të sqarohet se, po t'i mbushet mendja atij, nuk ka forcë në botë që ta ndalë në rrugën e tij. Telegrafistit iu kujtua e mbesa. Ja, flamuri i qëndisur nga Teuta po bëhet flamuri i luftës!

Mali mbloindi taborin e fshatarëve kryengritës dhe u tregoi planin e sulmit të befasishëm mbi kampin armik si dhe qëllimin e tij, pér ta mashtuar armikun, sikur ushtria shqiptare nuk luftonte në Qafë Kërrabë.

Mali foli edhe për punën e flamurit, për nderin e kombit shqiptar dhe në fund të ligjeratës nxori flamurin kuq e zi.

— Ngreje, o Mal Xhoka, ta shohim flamurin kuq e zi! — thirri Cen Priskani.

— Të rrojë flamuri i Shqipërisë dhe poshtë bejlerët! — thirri Arifi, që ngriti të dyja duart lart, deri te degët e një ahu të ri lartësuar midis dushqeve.

— Drejt e ke, o Mal Xhoka. Ky është flamuri ynë dhe nuk do t'ua lëmë më bejlerëve. Ashtu siç u kemi rrëmbyer tokat, do t'u rrëmbejmë edhe flamurin — tha Xhemali, i cili qëndronte midis tyre. Ai u tha fshatarëve se çështja e të drejtave të katundarisë nuk duhej lënë në dorë të të huajve, të xhonturqve, të nemselinjve ose të italjanëve. Se fatet e Shqipërisë duhet t'i merrte në dorë vetë populli shqiptar.

Fshatarët, që nuk shquheshin nga errësira që kishte plakosur krahinën, rrinin të heshtur dhe dëgjonin Xhemalin, dëgjonin fjalën e tij. Mal Xhoka dha urdhër të niseshin në luftë. Fshatarët u vunë në ecje për një. Tanimë ata ishin të preqatitur shpirtërisht për luftë. Në fillim këta njerëz të thjeshtë rrokën armët dhe u hodhën në kryengritje pér të hequr nga zverku shtypjen e rëndë të bejlerëve dhe të Esad Toptanit. Gjatë kohës së kësaj kryengritjeje, këta fshatarë kishin jetuar shumë ngjarje. Pishtarakët, të komanduar nga Mal Xhoka dhe Ram Leka, luftuan pa kompromis kundër bejlerëve për të drejtat fshatare. Ata asnjëherë nuk u gabuan nga parullat e turkomanëve dhe të xhonturqve dhe i dënuan bashkëfshatarët e tyre që shkonin pas qerres së myftiut të Tiranës. Por tani, gjithë ushtria, pa përjashtim, e bashkuar dhe me patriotë tiranas e elbasanas, durrsakë, shijakas, kavajas, kruetanë, peqinas e të kazave të tjera po shkonin në luftë kundër ushtrive të mëdha të një shteti të huaj, mbreti e qeveria e të cilil kishin vendosur të pushtonin Shqipërinë. Zemërimi i popullit kundër pushtuesit shtohej nga dita në ditë dhe fshatarët kujtonin lebetitjen, hutimin, frikën e panikun e grave, të pleqve dhe të fëmijëve që endeshin qyteteve e fshatrave për t'u fshehur e për

t'u shpëtuar masakrave të armiqve, të cilët, kur hynin në tokat shqiptare, plaçkitnin e vrisnin popullin pa mëshirë.

Befas, nga e djathta, buçitën pushkët e mitralozat dhe gjëmuani topat. Grykat, qafat dhe pyjet jehuan nga zhurmat shurdhuese të topave.

Pishtarakët e kuptuan se kjo do të ishte një betejë midis serbëve dhe fshatarëve që u kishin zënë pritë tek qafa e gështenjave, mbi lugjet e Rozaverës.

— Erdhi ora! O burra, të sulmojmë nga krahët armikun! Pas meje! — thirri komandanti dhe u nis me shpejtësinë e erës poshtë malit.

Kompania kaloi me një frymë pyllin e Fraveshit. Nga bgregorja dukej si në pëllëmbë të dorës kampi armik. Fshatarët shquanin fare qartë ushtarët, që iknin sa në njërin drejtim në tjetrin. Kampi armik lëvrinte nga pre-gatitjet. Drita po zbardhëllente krahinën.

— Shiko atje! — i tha Arifi Malit. — Nga qafa, ore, nga qafa mbi kampin!

— Po. Shoh dy kalorës civilë. Ai i pari paska vënë në kokë qylaf të zi — tha Mali.

— Ata janë spiunë — ia priti Asllani dhe shtoi: — me siguri pivitet e Esad Pashës, që marrin e japid me komandën e ushtrisë së huaj.

— Po, e njoh, e njoh atë fytyrë! — thirri Mal Xhoka, që po vrcjtonte me dylbinë austriake. — Duhet të jetë Xhavit Beu, njeriu i Esadit.

Gjashtëdhjetë burra të armatosur rrinin në përgjim dhe prisnin urdhërin e komendantit të tyre pér të sulmuar armikun aty ku s'e priste. Shkalla e Priskës, Shkalla e Tujanit, Qafa e Selbës dhe Qafë Kërraba, kishin ditë që luftonin. Fshatarët trima nuk shqiteshin nga shkëmbinjtë.

Xhemali kishte zënë pozicion në trungun e një gështenje shumë të trashë dhe të lartë. Ai hodhi vështrimin lart nga kurorat e gështenjave, që kishin çelur lule e dukeshin si grumbuj pëllumbash të bardhë. Aroma që lëshonin ato lule ishte e mrekullueshme. Patrioti tiranas mendoi pér këto pyje gështenjash, që nuk ishin vetëm

magjepsëse, po ishin edhe ushqim për komitët që kishin dalë maleve për liri e pavarësi.

Nja dyqind metra nga e majta, nën fshat, spikatnin kopshtet me mollagjeçë.

Meti, me pushkën në dorë, rrinte shtrirë barkas dhe, me sytë katër përpiqej të shquante ushtarët armiq, që lëviznin poshtë e lart kampit.

Telegrafisti vetëtimthi kujtoi historinë e Shqipërisë dhe nuk gjeti dot ndonjë moment historik që populli shqiptar ta lëshonte vendin e tij pa luftë. Jo, kjo nuk kishte ndodhur kurrë dhe nuk do të ndodhë kurrë!

— E, Met telegrafisti, si i ke punët? — pyeti Asllani. — Po mendohesh shumë. A të dhimbsetjeta? Hajd, mos u bëj pishman, se kur vdes për vatan, shpirti të shkon në xhehnet! — qeshi fshatarë me atë zërin e tij karakteristik — hi... hi... hi!..

Telegrafisti e shikoi fshatarin vëngër.

— E, o xha Asllan, mos pyet qysh vdes, po qysh rron! — u përgjegj telegrafisti.

Fshatarë rrudhi buzët dhe, pak me vonesë, ia ktheu po me një proverb të urtë: Koha e mëson njerinë!

Meti miratoi fjalët e xha Asllanit dhe hodhi sytë nga fshatarët kryengritës, që kishin zënë secili një pozicion lufte dhe u habit kur pa se ata rrinin fare të qetë dhe gjakftohtë, sikur të mos donin t'ia dinin fare për rreziqet që sillte lufta.

Komanda e divizionit të ushtrisë serbe, e vendosur në Pashkashesh, që ishte një fshat me nga dyzet shtëpi të shpërndara faqes së malit, nuk kishte parashikuar që prapa malit të thepisur të kalonin fshatarët kryengritës dhe t'u dilnin pas shpine. Vendësit gjithashtu nuk kishin treguar gjë për rrugën që lidhë ato dy malet me njëri-tjetrin!

Mal Xhoka, i cili kishte fituar përvojë në disa beteja dhe e dinte se zëri që lëshohet maleve të mashtron dhe njeriu nuk arrin dot të kuptojë se nga ç'anë i vjen, i posositi shokët, që, kur të jepë shenjën e zjarrit, të gjithë t'i nisin luftës duke bërtitur, që kështu armikut t'i kallëj frika e të binte në panik.

— Zjarr! Zjarr! Bini armikut! Ooooo... — thirri Mal Xhoka dhe qëlloi me pushkë pasi vuri në shenjestër një ushtarak me një veshje të ndryshme nga të tjerët. Pas tij qëlluan edhe fshatarët e tjerë. Zjarri i pushkëve të fshatarëve qe i dendur dhe i befasishëm. Disa nga ushtarët armiq ranë për tokë, sikur t'i kishte kositur njeri me drapër. Dy oficerë u rrokullisën tatëpjetë bregut, kurse tjetri u zhduk. Kampi armik filloj të çoroditej. Ushtarët nuk po merrnin vesh se nga po sulmoheshin dhe iknin sa në një anë, në anën tjetër të zabelit. Një copë herë të mirë, në kampin e huaj ushtarak mbretëroi një panik i vërtetë. Pas gjysmë ore komanda serbe filloj ta mblidhët veten dhe, duke përfituar nga rrallimi i pushkëve të kundërshtarit, mundi të organizonte një batalion të tërë. Po ashtu u gjallërua dhe artileria serbe, që, pasi diktoi pozicionet e fshatarëve kryengritës, ia filloj qitjeve. Topat gjëmonin dhe predhat e tyre binin pa mëshirë mbi degët, trungjet e gështenjave, që copëtoheshin e thyshin duke rënë përdhe me zhurmë.

Mal Xhoka jepte urdhëra duke thirrur me zë të lartë. Shokët e tij luftonin të struktur gropave dhe disa prej tyre qëndronin të shtrirë barkas në tokën e njomur të pyllit. Gjëmimi i topave ishte shurdhues. Asllani, edhe në këto çaste kritike, ku luantejeta me vdekjen, nuk e humbi humorin. Ai se ç'thoshte dhe pastaj ndihej e qeshura e tij e zakonshme.

Mal Xhoka, me të britura e me shenja, u dha të kuptonin luftëtarëve se duhej të tërhiqeshin nga bregorja dhe të hidheshin në një gropë aty pranë, për t'u mbrojtur nga zjarri i dendur e shkatërrues i artilerisë armike. Fshatarët filluan të tërhiqeshin zvarrë-zvarrë duke përfituar nga intervali i qitjeve të topave armiq. Gështenjat e vjetra, me ato trupat e trashë dhe të lartë, ishin mburojë e sigurt për luftëtarët fshatarë. Asllani u kap pas disa barishteve dhe filloj të tërhiqej prapa në drejtim të një vendi që mbrohej nga një copë shkëmb në trajtën e një shpëndi të madh.

Tani pothuajse të gjithë fshatarët u strukën në gropën e mbrojtur nga shkëmbi.

Qitjet e artilerisë pushuan. Nga ana e përtejme e zallit u dëgjuan britma e zëra në një gjuhë të huaj, të pakuptueshme.

— Serbët po sulmojnë — tha Asllani, që ishte llan-gosur me dhe. Kryengritësit kundërsulmuan dhe shpër-thyen një zjarr të dendur që i gozhdoi armiqtë një copë herë.

Mal Xhoka, pasi e peshoi mirë e mirë punën, i ndje-kur nga vështrimet e bashkatdhetarëve që prisnin ven-dimin e komandantit, u ngrit më këmbë dhe, duke marrë përsëri gjallérinë e mëparshme, tha:

— Pas meje, o burra! Ata që dinë të tërhiqen kur e lyp nevoja, dinë edhe të luftojnë. Nga gryka e Pëllumbasit do të dalim në Qafën e Gruas dhe do t'i ngjitemi pyllit të Skuterrës. Atje do të takohemi me ushtrinë to-në fshatare.

Toga fshatare e Pishtarit, pasi i dha një mësim të mirë ushtrisë serbe, duke kositur mjaft prej tyre, madje edhe oficerë të shtabit, u vu në njëshkolonë dhe fshehtas, nëpër pyllin me gështenja, u largua. Duke kërcyer me radhë në shpellën e fshehur nga ahishtet e reja, ata u zhdukën sikur t'i përpinte toka. Mal Xhoka u tërhoq i fundit.

Komanda e ushtrisë serbe, pasi qëlloi me artieri për dy orë rresht pozicionet e shqiptarëve, dha urdhër të nisej sulmi hakmarrës. Ishin vrarë tridhjetë e dy ushtarë dhe ishin plagosur pesëdhjetë e katër veta! Treqind trupa të këmbësorisë u ngjiten fajes së malit në një rrëze frontale prej njëqind e pesëdhjetë metrash në vijë të drejtë. Oficerët u prinin përpara ushtarëve dhe duke britur që-llonin nëpër pyll me pushkë e mitralozë. Sipas taktikës së tyre ushtarake, lëvizja bëhej me ngadalë dhc ushtarët e mbërthyer me rripa, çizme e me helmeta të rënda, të lodhur e të këputur, kur mbërritën nën rrëzën e malit të thepisur nuk kishin fuqi të hidhnin këmbë. Komandanti i sulmit, ishte fare i sigurt që komitet shqiptarë do të ishin gozhduar patjetër në faqen e shkëmbit të pakapërcyeshëm dhe aty, të grumbulluar, ose do të ngri-nin flamurin e bardhë, ose do të luftonin të deshpëruar

derisa të kositeshin të gjithë. Oficeri aristokrat, që i urrente fshatarët për vdekje, po mendonte se si do t'i pushkatonte një nga një këta njerëz të ndyrë, që kishin guxuar të ngrinin dorë kundër pashait të tyre dhe tanë kundër kral Pjetrit. Gjatë gjithë sulmit derisa kishin mbërritur në rrëzë të shkëmbit të thepisur, ata nuk kishin parë këmbë njeriu ose kafshe të gjallë, me përjashtim të një fshatari të vrarë nga predha, që shokët e tij nuk kishin pasur kohë ta varrosnin. Komandanti serb, një burrë i pashëm me mustaqe spic, të zeza sterrë, i veshur elegant, me një uniformë bojë kaki, mbathur me çizme lëkure lustrafin dhe një xhaketë të ngushtë, ku i varej një dekoratë e lartë, ngriti helmetën e hekurt, që i kishte rënë në sy, dhe thirri: — Stoj! Pushoni zjarrin! «Asgjëkundi nuk po gjejmë ndonjë gjurmë. E çuditshme» mendoi. «Jo!» — mërmëriti. «Nuk do t'i pushkatoj, po do t'i çapëlojmë me bajoneta dhe do t'i tërheqim zvarrë-zvarrë me litar fshatrave, për t'u kallur datën këtyre bishave të pashtuara!»

Ky oficer kishte vrarë e kishte pushkatuar me dorën e tij, dhjetëra fshatarë shqiptarë të pafajshëm, që prej Struge, Qukësi dhe deri te krahinat e Çermenikës. Madje, një fshat, e kishin qëlluar me artileri dhe e kishin rrafshuar krejt. Por, megjithatë, lufta në portat e Tiranës nuk pushonte. Shqiptarët luftonin me tërbim. Ai e dinte mirë, nga informatat që kishte marrë prej Esad Pashës, se ushtria rebele i kishte fare të pakta municionet dhe se nuk kish asnjë burim furnizimi. Asnjë fuqi e huaj nuk i përkrahte kryengritësit fshatarë. Italia, Austria, grekët dhe xhonturqit kishin hequr dorë nga ata, pasi lufta që bënин kundër bejlerëve dhe Esad Pashë Toptanit nuk u shërbente më qëllimeve të tyre politike. Kryengritësit fshatarë kishin mbetur vetëm. Ata mbështeteshin vetëm tek pushkët e tyre.

Oficeri priti një copë herë se mos i shfaqeshin hijet e atyre përbindshave që goditën në befasi kampin ushtarak, por, kur pa dhe u bind se aty nuk kishte këmbë


njeriu, tha i dëshpëruar: Ku janë futur këto shpirtra të këqinj?!

Batalioni i këmbësorisë serbe u kthye i lodhur dhe i këputur në kamp.

\* \* \*

Kompania e Mal Xhokës, në kthim, e kaloi më me lehtësi rrugën nëpër shpellë. Atë natë kryengritësit pu-shuan në fshatin Pëllumbas. Fshatarët u dhanë luftëtarëve për të ngrënë e për të pirë. Të nesërmen pishtarakët, pasi kaluan lumin e Erzenit, hynë në pyllin e Skuterrës. Mali nisi një pararojë prej tre fshatarësh: Naimin, Asllanin dhe një fshatar tjetër nga Priska. Ata kishin për detyrë të lidheshin me taborin që luftonte në Qafë Kërrabë. Pas dy orësh në Pëllumbas erdhë Ram Leka vetë i tretë, me një pezakas dhe një picalliot.

Ram Leka u përqafua me Mal Xhokën dhe me radhë me të gjithë fshatarët trima, të cilët i kishin dhënë grushte armikut duke hyrë në midis të kampit të tyre. Ai tregoi mbi gjendjen e luftës në frontin e Qafë Kërrabës dhe, pasi diskutuan për ngjarjet më të rëndësi-shme, pa e fshehur të vërtetë, tha se gjendja e tyre ishte vështirësuar shumë. Pas dy javë luftimesh të përgjakshme u duk sheshit se municioni po i afrohej fundit. Ata qëllonin gjithnjë e më rrallë, vetëm kur armiqtë afro-heshin fare pranë pozicioneve të tyre. Leka nguli këmbë që Xhemali dhe telegrafisti të ktheheshin në qytet. Pas disa ngurrimesh nga ana e atyre vetë, u vendos që Xhemalin dhe Metin t'i përcillte për në Tiranë, Cen Priskani.



## BETEJA E SKUTERRËS

Kryengritësit fshatarë ngritën një kamp të përkohshëm buzë lumiit Erzen. Mal Xhoka i la të lirë luftëtarët që të merreshin me higjienën personale. Armët i lanë togje-togje pranë vendeve me kaçube, gjatë bregut të lumiit. Fshatarët e Pëllumbasit e të Kryeziut sollën ushqime për dy ditë. Sipas inventarit që bënë Mal Xhoka dhe Ram Leka, rezultoi se seicilit prej atyre gjashtëdhjetë burrave u binin nga njëzet e dy fishekë. Ram Leka, dy orë para nisjes për në frontin e luftës, nisi Asllanin te komandanti i operacioneve në Skuterrë. Komanda e forcave fshatare të Skuterrës dërgoi gjithsejt një arkë me fishekë dhe porosiste Mal Xhokën e Ram Lekën të kursenin municionet, se ato ishin të fundit që u dërgonin.

Qafë Kërraba, një lartësi rrëth njëmijë e pesëqind metra mbi nivelin e detit, ishte një vend i thyer, ku maja e maleve vinin valë-valë, njëra pas tjetrës. Midis këtyre vendeve të thyera dhe shkëmbinjve natyra kishte sajuar një qafë, që i përngjante një kërrabe, e cila shërbente si rrugë kalimi midis Tiranës dhe Elbasanit.

Komanda serbe e ndau ushtrinë në dy pjesë, që i shpërndau në dy drejtime: njérën e vuri në marshim nga Qukësi në Elbasan, me qëllim që, pasi të pushtonë qytetin, të përparonte drejt Peqinit për në Durrës, ndërsa pjesën tjetër e nisi nga Golloborda, maleve të Çermenikës për të kapërcyer Qafë-Kërrabën, me qëllim që të pushtonë Tiranën dhe të dilte pastaj në skelën e Rodonit.

**Sipas këtij plani strategjik ushtritë serbe të pushtimit do të bënин edhe pastrimin e krahinave nga kryengritja rebele fshatare.**

Rreth tetëqind trupa të zgjedhur të ushtrisë kryengritëse fshatare që zunë pozicione në malet e Qafë Kërrabës, po qëndronin të patundur prej disa ditësh përpara sulmeve të tërbuara të ushtrisë së huaj, e cila nuk kursente as fishekët, as predhat e artilerisë. Në shtabin e ushtrisë fshatare flitej se komanda serbe kishte vendosur ta tërhiqte ushtrinë në kufijtë e mëparshëm. Flitej se arësyjeja e tërheqjes ishte pengesa që kishin gjetur në grykat dhe gërxhet e maleve për shkak të luftës së rreptë që bënин fshatarët e armatosur. Gjithashtu dhe vetë ushta-rët serbë ishin të lodhur, të rraskapitur e të mposhtur moralisht nga goditjet e tmerrshme që kishin marrë prej ushtrive austro-hungareze, të cilat, pasi kishin pushtuar pjesën më të madhe të Serbisë, po ndiqnin këmba-këmbës ushtrinë e kral Pjetrit.

Ishte një ditë e bukur qershori e vitit 1915. Luftëtarët pas kaq e kaq marshimesh, tashmë po çlodheshin. Dielli ishte si i mbuluar nga një mjegull e lehtë. Frynte një fllad i këndshëm, që megjithatë nuk shkaktonte asnjë lëvizje. Shtëllunga të shpërndara resh, që dukeshin si bashka leshi, lëviznin si me përtim midis grykave të vargmaleve të Dajtit e të Qafë Kërrabës, që krijonin një si mur të lartë mbrojtje nga lindja, verilindja e juglindja e fushave të Tiranës dhe të Durrësit.

Një rrugë zigzake, e shtruar me kalldrëm, e ngushtë sa për të kaluar një mushkë, lidhte Tiranën me Elbasanin. Ushtria fshatare kishte zënë prita në të shtatë grykat e këtyre maleve, duke filluar nga fshati Skuterrë e duke dalë deri në pikën e fundit të malit të Qafë Kërrabës, që merrte fund në një humnerë të vërtetë, në kufi me Pëllumbasin. Vija e frontit, nja tre kilometra e gjatë, kishte formën e një gjysmëharku. Forcat e shumta serbe, në anën tjetër të maleve të Qafë Kërrabës pregatiteshin për një ofensive të madhe. Po, atë ditë mbretoronte një qetësi e plotë. Dukej sikur të ishte bërë

## *ndonjë marrëveshje e përkohshme armëpushimi midis dy palëve luftuese,*

Mal Xhoka me taborrin e pishtarakëve kishte përparruar në një pozicion fare pranë kundërshtarit. Mbi shkëmbin e Qafës së Qimeleshit ai nguli flamurin kuq e zi qëndisur me fije ari e me shkabën e zezë në mes. Flamuri valavitej lehtë. Fshatarët kryengritës për herë të parë, pas dy javë luftimesh, shikonin të valavitej flamuri i kombit shqiptar.

Mal Xhoka ishte shtrirë, sa gjatë-gjerë, në një faqe shkëmbi pranë dy gurëve të mëdhenj, që ishin shkëputur nga maja e malit, dhe po copëtonte me dorë një gurtë zi fare të butë. Ai kishte dëgjuar se nën këta shkëmbinj të zez, nga të cilët kishte marrë emrin dhe fshati Skuterrë, inxhinierët kishin zbuluar diçka me vlerë.

— Shikoni, shikoni majë atij mali, nga e djaththa! — briti Asllani duke u çuar më këmbë i tmerruar.

Të gjithë ndoqën me sy një copë re të përskuqur, që mbështolli papritur majën e thepisur të malit, duke marrë trajta të ndryshme gjatë vozitjes në ajër.

— Ja, tani u bë si kalë! Për besë u shndërrua përsëri! Tani duket si bollë e kuqe, që tërhiqet zvarrë-zvarrë! Kjo nuk është re, por një xhind, që ndjell një fat ugurzi — tha një fshatar thatim koskë e lëkurë, që rrinte shtrirë barkazi pranë Asllanit.

— Kjo re e përgjakur, paralajmëron fundin e botës — tha një burrë i mesëm nga Arbana, që e quanin Man dhe kishte një mbiemër të çuditshëm, Shënmitri.

— Pusho, o kaur frikacak! — e qortoi Asllani dhe ia plasi të qeshurit të vet karakteristik hi...hi...hi!.. — Hala me këto ti? Haxhi Baba e hodhi gurin e shenjtë në pellgun e Erzenit dhe ai nuk doli më. Vrau bejlerët dhe ata nuk u ngjallën më! Hi...hi...hi!.. O Mal Xhoka, që lloje qëlluje atë kuçedër, se ti je i vetmi për nishan! Dhe kanë për të parë këta se si do t'ia mbathë ajo bolla e kuqe.

— Hajde, pra, qëllojmë të dy bashkë! — ia priti Mali, që ishte pak më lart se pozicioni i shokut të Fikasit.

Të dy fshatarët qëlluan me mavzere nga dy herë

tresht, njëri pas tjetrit, në drejtim të majës së malit. Reja e kuqërremtë endej nga era dhe po e kalonte malin.

— Ja, po ikën e plagosur! — thirri një fshatar, duke treguar me gisht renë, që dukej sikur po binte poshtë majës së malit.

— Edhe unë kam qëlluar një herë një judë me pushkë dhe e bëra copë-copë — tha një tjetër fshatar, që u duk sikur mbiu nga kaçubet aty pranë.

Si përgjigje për këto të shtëna armiku ia filloj qitjes me artileri. Kjo ishte një rastësi, që i la gojëhapur fshatarët.

Gjëmimi i topave tronditi dheun. Predhat fluturonin me uturimë mbi kokat e fshatarëve dhe binin kuturu.

— E shikon, o Man Shënnitri? — i thirri me zë të lartë Asllani shokut të tij që kishte pranë dhe shtoi: — Ja si u zhduk bolla e kuqe! Tashti fute kokën si bretkosa në ledh! Hi...hi...hi!..

— Pas topit ata do të sulmojnë — tha Mal Xhoka.

— Ne duhet t'i presim të afrohen fare afër, derisa t'u shquajmë hundë, veshë e sy. E kemi municionin të paktë dhe duhet kursyer çdo fishek — tha Asllani.

— Do të bëjmë luftën e xhokave — tha Mali. — Serbët nuk e njobin këtë taktkë.

Ram Leka u duk se e aprovoi mendimin, pasi pohoi me kokë, ndoshta dhe foli, po zëri nuk iu dëgjua nga zhurma shurdhuese e qitjeve të artilerisë armike.

— Të presim sa të pushojë qitja e topave! — urdhëroi Mali.

Kuajt e lidhur nëpër hunj të ngulur në një fushë të vogël me bar të njomë filluan të hingëlljinë e të hidhen në dy këmbët e përparme.

Disa dhjetëra luftëtarë të ushtrisë fshatare u vranë nga predhat e artilerisë. Një shtëpi nga lagjia e epërme e Skuterrës u sheshua për tokë nga predhat që ranë njëra pas tjetrës në të njëjtën pikë. Pullazi dhe muret e rrëzuara varrossën për së gjalli gjithë familjen.

Kur pushuan qitjet e artilerisë serbe, dielli ishte ngritur fare mbi majat e maleve. Ushtria armike doli nga llogoret dhe duke u rënë trompetave e borive, u hodh në

ofensivë. Tani dalloheshin qartë ushtarët armiq, tek i ngjiteshin malit, të radhitur në rreshta të shtrënguar, që vinin valë-valë, me pushkët që i mbanin të shtrira me bajonetë zërthyer. Ushtarët, si në kor, britnin «Da zhivec Kral Peter! Da zhivec Kral Peter!»..

— Kjo qenka mizëri! — tha Asllani, që ishte ngritur në gjunjë dhe shtoi duke u kanosur: — Ne do t'ua shtypim kokat si pleshtave...

Mal Xhoka e dallonte fare mirë komandantin e tyre, një oficer barkmadh, që mezi hidhte këmbët. Ai, me dorën e djathtë, tundte në ajër nagantën dhe u thërriste ushtarëvë që të sulmonin në drejtëm të pozicioneve të xhokave të zeza të shqiptarëve, të cilat ishin vendosur në mënyrë që dukeshin krejt si njerëz të gjallë.

Asllani, i kënaqur, duke parë që armiqtë përparonin drejt pozicioneve ku ishin vendosur xhokat e fshatarëve, u thoshte shokëve: «Serbët nuk e dinë lojën e xhokave! Duket sheshit se ata u gënjen, e ç'të gënjer se! Hajdeni, hajdeni, afrohuni, o miq të paftuar!»

Armiqtë u ishin afruar fare pranë xhokave. Komandanti i tyre, mbeti prapa ushtarëve. Ai u cirrej dhe i nxiste ushtarët të bënин luftën e bajonetave dhe t'i shqyjen fshatarët.

— Zjarr! Zjarr, o burra! Bjerini armikut! — briti Mal Xhoka nga krahu i majtë i armikut, duke qëlluar me pushkë dhe duke britur Ooooo...Ooooo...Aaaaa. Me pushkën e parë që ai qëlloi kishte vënë në shënjestër oficerin, të cilin, për një çast, vetëtimthi, e përgjasoi me figurën e Esad Pashë Toptanit. Oficeri ra për tokë, sikur ta përpinte ushtria e tij. Kryengritësit fshatarë, të ngritur përgjysmë mbi thepat e shkëmbinje, qëlluan njëherësh pas komandantit të tyre duke bërtitur sa mundnin. Zjarri i armëve ishte i dendur dhe qëllonte krahun e pambrojtor të armikut. Ushtarët e radhëve të para u kositën. Krismat e pushkëve ushtonin anembanë maleve, grykave e qafave, si një gjëmim i papushuar. Nga të shtatë qafat e malit të Skuterrës, të gjitha pritat shqiptare luftonin rreptësish kundër ushtrisë së huaj, e cila, pa marrë parasysh humbjet e mëdha, vërvshonte drejt ma-

jave. E gjithë fusha e betejës u mbulua nga mjegulla e tymit. Fshatarët patriotë nuk tundeshin nga pozicionet e tyre, megjithë humbjet e ndjeshme që pësuan. Plumbat e armikut, binin si breshër gérxheve dhe shkëmbinje duke bërë zhurmë e duke ngritur cifla gurësh. Nga mjegulla, tymi dhe retë e zeza, që po mblidheshin, nuk shihej më as edhe një pëllëmbë vend përpara.

— Prite, o derr! — briti Asllani, i ndezur flakë në fytyrë. Fshatari plak i Fikasit vuri pushkën në faqe dhe, pa marrë parasysh se mund të qëllohet nga ushtarët me helmetë, që ishin afruar nga njëzet metra pranë tij, që lloji borizanin që po i binte borijes pa ndërprerje për të nxitur ushtarët në sulm. Plumbi e la në vend borizanin, ndërsa borija u rrokullis tatëpjetë malit.

Fshatarët thërrisin:

— Bini armikut!

— Aaaa...Oooo... bre burra, mbahuni!.. Mbahuni, bre burra!..

— Prite këtë për pashën!..

— Këtë për Kral Pjetrin!..

Në egërsinë e luftës fshatarët kryengritës, përvëç britave, nuk i linin as fjalët me romuze, që u hidhnin armiqve.

Një plumb nga ata mijëra që fishkullonin ajrin e shpoi në shpatull Asllanin, që po luftonte më këmbë! Në fillim fshatari ndjeu sikur iu ngul ndonjë thikë, po pasi i kaloi dhimbja e parë ai vazhdoi të qëllonte përsëri. Plaga e ngrontë nuk i jepte më dhimbje. Mirëpo, kur gjaku i plasi si curril mbi këmishën e lintë, atëhere ai e kuptoi se gjendja e tij nuk ishte e lehtë. Fshatari hokatar tha me vete: «Kaç e pate edhe ti, o nafakshkurtër!» dhe përsëri qeshi «hi...hi...hi!..» Ai u ul rrëzë shkëmbit, vuri dorën në vendin e gjakosur, të hapur dy gisht mbi sisën e djathtë, dhe i briti Naimit, që luftonte pranë flamurit:

— Jam plagosur, ore Naim! Po vdes!

Naimi erdhë barkas në pozicionin e Asllanit. Flamurin ia dorëzoi një shoku aty pranë. Asllani rrinte në kurriz, duke mbajtur plagën me dorë. Naimi corri këmishën e tij dhe me rrypyat që sajoi ia lidhi plagën shokut.

— Tashti qesh «hi...hi...hi!», se shpëtovë edhe kësaj here! Ri këtu urtë, e mos luaj nga vendi! — i tha Naimi dhe u largua për në vijën e parë të luftës. Më tutje ai pa Bamin të sakatuar nga predha e një topi armik, që notonte në një pellg gjaku.

— Sulm!.. sulm!.. — briti Mal Xhoka me zë të lartë.

— Me dorë, me dorë! — ia priti Naimi.

— Sulm!.. sulm!.. Kapeni me dorë, me dorë — përgjigjeshin edhe fshatarët e tjerë, që ishin ngritur nga pozicionet.

Nga të shtatë qafat e majave të thepisura të Skuterrës, që tani u përngjanin kështjellave, u lëshua në sulm ushtria fshatare. Sulmit të tyre të furishëm s'mund t'i bëhej ballë! Komandantët kishin dalë në krye të togave dhe luftonin si shqiponja duke u kacafytur me ushtarët e huaj. Nga të çarat e reve rrezet e diellit 'po ndriçonin shkëmbinjtë e lagur. Skuadronet serbe u gjetën të rrethuara brenda një lëndine të pështjelluar nga dushqet, mbi brigjet e Rozaverës. Mbi serbët filluan luftën edhe një togë fshatarësh të armatosur, që po zbrisnin nga gryka e Pëllumbasit. Luftëtarët e asaj toge ishin të freskët dhe sulmonin me tèrbim, duke vrarë e duke kositur pa mëshirë armiqtë. Ushtarëve serbë, kur shihnin shokët e tyre që po bëheshin pre e korbave dhe kur dëgjonin britmat e egra të kryengritësve fshatarë, u hyri paniku dhe filluan njëri pas tjeterit të iknin tatëpjetë malit me rrëmujë. Disa prej tyre i hodhën armët dhe helmetat. Dukej se lufta po merrte fund, se po të thyhet ushtria dhe po t'i hyjë paniku, britmat e oficerëve për t'i kthyer praoa s'hyjnë më në punë. Komandanti serb i ofensivës rrinte mbi fshat duke vrojtuar me dylbi zhvillimin e betejës së përgjakshme. Atij i ishte tharë pështyma në grykë. Me një pamje të vrarë nga kjo disfatë e turpshme, ai nuk po mund të kuptonte dot se si nië grusht fshatarësh të sulmonin ushtrinë e tij mbretërore, që tani po ikte në pikë të vravit. Si do t'i dilte përpara, të nesëermen, mbretit, që kishte vendosur të vinte vetë në Tiranë dhë t'u jente pëershëndetjen e fitores?

Kur pa se çdo rigrupim i atyre forcave të shparta-

lluara ishte i kotë, ai i dha urdhër artilerisë të qëllonte faqen e malit, pa marrë parasysh se aty ishin edhe ushtarët e tij.

Mal Xhoka u printe fshatarëve me heroizëm. Pasi qëroi hesapet me një oficer, ai qëndroi pranë një lisi të madh për të parë se q'bënин tē tjerët. Kur pa se batalionet fshatare po zbrisnin drejt fshatit u kujtua përmungesën e municioneve dhe i dha urdhër Naimit t'i frynte burisë për tē dhënë sinjalin e têrheqjes. Sulmi i tyre duhej tē ndalej. Kryengritësit qëndruan në vend. Mal Xhoka pa një nën oficer serb, që po gulçonte nga lodhja e nga frika. Ai zbriste faqes së malit, në drejtim tē një përrroi tē thatë pa ujë. Para tij po zbriste fare i çregullt i gjithë skuadroni ushtarëk. Ata po mundoheshin tē mbërrinin në llogoret që ndodheshin në anën tjetër tē fshatit.

Mali radhiti shpejt e shpejt njëzet pushkatarë në pozicion lufte. Menjëherë u dha urdhër që tē qëllonin. Katërbëdhjetë armiq i lanë hesapet me këtë botë. Të tjerët, që i kishin hedhur armët pyllit, kërcyen breg më breg derisa u hodhën në llogoren e hapur, për tē shpëtuar lëkurën.

Njëzet e katër topa tē ushtrisë serbe, tē vendosur në kodrën më tē lartë, përkundrejt fshatit tē Rozaverës, ia filluan një breshërie tē pandërpërre, e cila vazhdoi rrëth një orë. Predhat binin në faqen e malit dhe bënин kërdinë mbi ushtarët serbë, që po têrhiqeshin. Gjithashtu edhe fshatarët kryengritës pësuan humbje tē mëdha. Në atë faqe mali nuk kishte vend ku tē mbroheshe. Gjysma e atyre gjashtëdhjetë luftëtarëve që kishin korru njië fitore tē shkëlqyer mbi armikun shumë më tē madh në numër, u zhdukën fare pa gjurmë. Në radhët e ushtrisë fshatare nisi një rrëmujë e madhe. Këmbësorët e tē dy palëve u përzien në disa qafa me njëri-tjetrin e luftuan përsëri. Pas një ore fshatarët u kthyen në pozicionet e tyre pas malit, në anën tjetër tē Rozaverës, në krahun e fshatit Skuterrë. Tani predhat kalonin majat dhe binin larg nëpër shtëpitë e shpërndara tē fshatit dhe në arat e në oborret e tyre. Mal Xhoka u dha urdhër atyre që

kishin mbetur gjallë që të têrhiqnin të plagosurit dhe së bashku të zbrisnin në fshat. Ai e dinte tanë fare mirë se ushtarët e tij fshatarë nuk kishin municion të mjaftueshëm. Qëndresa nëpër qafat e Skuterrës ishte e kotë dhe pa shpresë.

Armiku ishte në numër shumë më i madh se sa repartet e vogla të fshatarëve kryengritës. Armatimet e ushtrisë së huaj nuk krahasoheshin me ato të kryengritësve fshatarë. Madje disa nga krerët e tyre, që ishin turkomanë dhe aty-këtu esadistë dhe me mënyra të ndryshme u shmangeshin betejave me ushtrinë pushtuese serbomadhe të kral Pjetrit. Qamil bej Mulleti, një turkoman i njohur i vënë në krye të një tabori fshatarësh nën ndikimin e myftiut të Tiranës i mashtroi kryengritësit. Ai, gjoja sipas urdhërit të shtabit, ikte fshatrave për të zënë pritë «diku» në grykat e Çermenikës. Përfundimisht iu shmang plotësisht betejës. Musa Qazimi, i detyruar vetëm nga presioni i masave fshatare kryengritëse erdhi në Qafë Kërrabë, por ai bëri të gjitha ato ngatërresa për të bindur luftëtarët që të hiqnin dorë nga beteja. Me sa u kuptua më vonë, myftiu turkoman e sabotoi luftën e fshatarëve kryengritës dhe të patriotëve të qyteteve kundër ushtrisë serbe me qëllim, për t'i treguar Esad Pashë Toptanit se ai në të vërtetë përkrahte politikën e tij dhe se kështu premtonte që të vihej përsëri në shërbimin e qeverisë së tij. Musa Qazimi u bëri thirrje fshatarëve të têrhiqeshin nga fronti i luftës, se çdo përpjekje e tyre ishte fare e kotë.

Një shkak tjetër i disfatës së tyre ishte izolimi i kryengritësve fshatarë nga krahinat e tjera të Shqipërisë dhe kjo ishte për rrjedhim të mungesës së një perspektive të qartë politike dhe të organizimit të keq ushtarak. Bashkimi i tyre me patriotët dhe masat popullore të qytetit minohej nga krerët turkomanë, që mundën të zinin vende kyçë me këshillat administrative të kazave dhe në atë të Këshillit të përgjithshëm të kryengritjes fshatare. Edhe ato reparte të kryengritësve fshatarë që morën pjesë në luftën kundër ushtrisë së madhe e të armatosur

deri në dhëmbë të pushtuesve serbë nuk ishin të organizuara mirë.

Por çka është kryesorja, ushtrisë kryengritëse fshatari i mungonin perspektivat politike dhe në krye të tyre ende komandonin disa turkomanë. Ram Leka, Mal Xhoka e shokët e tjerë e pleqëruan gjendjen së bashku me patriotët e qyteteve si me Xhemalin, telegrafistin dhe me Xhafën. Leka u tha bashkëluftëtarëve se, po të ishin të organizuar mirë dhe po të kishin një udhëheqje politike të qartë, ata do të dinin të gjenin rrugët për të vazhduar luftën. Pushkët e municionët do t'uа rrëmbejn armiqve. Madje luftën do ta ndiznin anembanë vendit me çeta, duke i sulmuar repartet e ushtrisë së huaj në befasi dhe nga çdo grykë, mal, fshat, apo kaza, aty ku ata nuk e pritnin. A nuk ishte një shembull i shkëlqyer sulmi i befasishëm i çetës së Mal Xhokës nga gryka e Pëllumbasit kundër kampit armik të vendosur në Pashkashesh? Pasi ata e biseduan gjendjen në një kohë të shkurtër, aq sa i lejonte situata, morën vendim që të tërhiqeshin nga fronti dhe të shpërndaheshin fshatrave. U mendua që të largoheshin nga Skuterra, sa po të errej mirë.

Mal Xhoka zbriti me taborrin e tij në lagjet e poshtme të fshatit dhe në shtëpinë e Ymerit, një mik i tyre, me të cilin këmbeu pak fjalë mbi gjendjen e rëndë të krijuar dhe se çfarë duhej të bënin e nga duhej të tërhiqeshin.

\* \* \*

Ram Leka mori vesh se Musa Qazimi me tre fshatarë kishin ikur gjatë grykës së Erzenit për në Ibë dhe prej andej do të shkonin në Tiranë. Sipas fjalëve që thoshte i zoti i shtëpisë, ku myftiu kishte ndenjur katërmëdhjetë ditë, Musa Qazimi kishte thënë se kryengritja fshatare kishte marrë fund. Kryengritësit fshatarë duhej të shpërndaheshin nëpër shtëpitë e tyre për të shpëtuar lëkurën. Ram Leka e Mal Xhoka, pasi biseduan disa minuta

për planin e shpërndarjes, u dhanë urdhër grupeve të ndryshme fshatare që të grumbullohen te sheshi i fshatit. Mali urdhëroi fshatarët e armatosur që të largo-heshin sa më parë grykës së Erzenit. Të plagosurit t'i linin nëpër shtëpitë e fshatarëve të fushës së Mulletit, Far-kës, Stërmasit dhe Arbanës. Këshilli i kryengritjes fshatare të fshatit Skuterrë kishte ardhur te sheshi. Anëtarët e këshillit, të pezmatuar, rrinën mënjanë, pa ditur se ç'të bënin: të qëndronin apo të iknin nga fshati? Po të iknin nga fshati, ishte rrezik të takoheshin me reparte të ushtrisë serbe, e cila do të qëllonte mbi gratë e fëmijët. Po të qëndronin nëpër shtëpitë e tyre i prisnin masakrat, ashtu siç kishin bërë ushtarët e Kral Pjetrit gjatë kalimit në krahinën e Çermenikës e kudo.

Pas një copë here, sipas vendimit të këshillit, i gjithë fshati u boshatis. Ikën ushtria fshatare, ikën edhe vendësit duke u fshehur shpellave dhe pyllit, në anën tjeter, kufi me Kryezin. Te sheshi mbi fshat mbetën topat pa gjilpëra dhe kazanet e gjellës.

Pas dy orësh batalionet e ushtrisë së Kral Pjetrit ranë në fshat dhe menjëherë u vunë flakën shtëpive që kishin shpëtuar nga predhat e artilerisë. Te Rrumbullakët, që nuk kishin ikur, ushtarët e pushtuesit, i vunë zjarrin shtëpisë dhe qëlluan me armë të katërmëbëdhjetë banorët e saj me pleq, gra e fëmijë, që ishin struktur në kopsht për t'i shpëtuar zjarrit. Të dyzet e katër shtëpitë e fshatit Skuterrë u bënë shkrumb e hi.

Ushtritë serbe, që kishin kapërcyer edhe Qafën e Selbës, Shkallën e Priskës dhe Qafën e Tujanit, rrugës duke zbritur për në Tiranë, digjin shtëpitë e fshatarëve dhe qëllonin me armë popullsinë.

Komandanti i reparteve të ushtrisë serbe, koloneli Milutin Mishkoviç, që kishte drejtuar operacionet luftarakë që nga Ohri, Dibra e Struga, tanë, shaluar kalit të bardhë, i rrethuar nga oficerët e shtabit, ndonëse po ekte përpara si ngadhënjimtar, dukej i mërzitur dhe pa qejf. S'guxonte asnjeri nga oficerët t'i drejtonte fjalën! Milutini e dinte se lufta popullore ishte një luftë shqetësuese,

që nuk shuhej kurrë! Iu kujtua në ato çaste historia e bëtejës së Napoleon Bonapartit kundër Spanjës. Pas pushtimit të vendit në Madrid patriotët kishin filluar luftën e guerrileve, e cila i ishte dukur në fillim qesharake perandorit të Francës. Por më vonë ai e kuptoi se ajo luftë ishte vdekjeprurëse për ushtrinë e tij të pathyeshme. Por Milutini dinte edhe luftën njëzetepesëvjeçare të Skënderbeut kundër hordhive osmane dhe përsëri mallëkonte popullin shqiptar kryeneç. Komandanti serb, përveç parashikimeve që bënte për luftën popullore të fshatarëve kryengritës, shqetësohej edhe për strategjinë ushtarake të hartuar nga Pashiqi, të cilat i qe rritur mendja dhe ishte i bindur se nuk merrte vesh vetëm nga punët e diplomacisë po edhe nga ato ushtaraket. Milutini kishte qenë dakord me oficerin e lartë carist të dërguar nga Peterburgu pranë shtabit serb, i cili nuk e kishte miratuar planin e Pashiqit, që repartet e ushtrisë serbe në këtë kohë të pushtonin tokat e Shqipërisë. Këtë pushtim nuk e lejonte takтика luftarake, sepse ushtria shpërndahej dhe kështu dobësohej mbrojtja kundër ushtrive austro-hungareze, të cilat, me forca të mëdha e të freskëta, po vareshin me shpejtësi nga Jugu i Ballkanit. Por ishte e qartë se pushtimi i tokave shqiptare ishte një punë vëcanërisht e Pashiqit, i cili kishte kryekëput synime politike.

Në krah të komandantit të ushtrive serbe, që po marshonin për në Tiranë, përveç oficerëve, e cte kaluar edhe një nga pivitet më të rrezikshëm të Esad Pashë Toptanit, Xhavit Beu. Ai, përveç letrés së pashait, u kishte dërguar serbëve edhe shumë informata të vlefshme për gjendjen ushtarake e preqatitjet luftarake të ushtrisë rebele fshatare. Ndihamë më e madhe që ai i kishte dhënë shtabit të ushtrisë serbe ishte deshifrimi i sinjalit të borizanve fshatarë për lajmin e mungesës të municipio-neve. Kur Milutini me ushtrinë e tij zbriti në fushë të Mulletit, urdhëroi përkthyesin t'i thoshte Xhavit Beut që ai duhej të mbledhë informata se nga kishin shkuar komandantët e kryengritësve fshatarë dhe vëcanërisht u

interesua për Haxhi Qamilin e disa të tjerë. Sipas zbulimit që vepronte në shtabin e tij ai duhej që këta udhëqës kryengritësish fshatarë t'i arrestonte sa më parë dhe t'i kalonte të gjithë në pushkatim ose në litar, sepse kishte rrezik që ata të riorganizonin përsëri njësi të vogla fshatarësh të armatosur dhe t'u binin në befasi reparative serbe, që do të përhapeshin fushës së gjerë të Tiranës.

Ushtria serbe po përparonte në dy drejtime: Milutin Mishkoviçi me repartet e tij e la prapa Skuterrën e djequr dhe qindra fshatarë të masakruar me bajoneta e të varur nëpër drunjtë gjatë rrugës. Kavaleria serbe ndiqte këmba-këmbës njësitë e thyera të kryengritësve fshatarë gjatë fshatrave të Ibës, Fushës së Mulletit, Lundrës dhe fushës së Farkës, deri sa hynë në qytet. Ndërsa repartet e tjera të ushtrisë pushtuese, që kishin dalë nga Struga në Qukës, Librazhd, Elbasan, vazhdonin të përparonin në drejtim të luginës së Shkumbinit nëpër Rrogozhinë, për të dalë në Durrës. Kësaj rruge tërhiqeshin edhe forcat fshatare të përgjysmuara nga betejat e përgjakshme që kishin zhvilluar në Gollobordë, Qukës dhe Librazhd. Në krye të këtyre fshatarëve të rraskapitur dhe të dëmtuar nga artileria, tërhiqej me kavalerinë e sakatuar edhe Haxhi Baba. Komandanti i ushtrisë fshatare, megjithëse kishte pasur qindra të vrarë e të plagosur dhe pushkët i kishin mbetur fare pa fishekë, kishte vendosur të mos dorëzohej. Ai kishte menduar që të shkonte sa më parë në Shijak, për të grumbulluar forca të reja dhe të sulej shpejt drejt Tiranës për t'u rënë nga të gjitha anët ushtrive armike.

Më 15 qershor 1915 ushtritë serbe shkelën Tiranën. Populli i alarmuar u mbyll nëpër shtëpitë dhe priste me ankth shpërthimin e masakrave nga ushtarët pushtues. Paniku i urisë i kishte detyruar qytetarët që të fshihnin ushqime dhe drithëra. Tregu i qytetit ishte fare i shkretë. Esadistët, sipas urdhërave që u kishte dërguar me korrerët e vet Esad Pashë Toptani, caktuan shpejt e shpejt një delegacion, i cili i doli përpara shtabit madhor të ushtrisë serbe, duke e pritur si çlirimtar të atdheut dhe

shpëtimtar të kombit. Paria e qytetit, nga më besniket e Esad Pashë Toptanit, u premtoi oficerëve serbë se do të jepnin përkrahjen e tyre të gjithanshme në ushqime dhe në ndihma të tjera. Pas disa ditësh ushtria serbe priti me nderime të mëdha mikun e vjetër, Esad Pashë Toptanin, i cili doli nga rrëthimi i Durrësit në saje të bajonetave të Pashiqit e të Kral Pjetrit.

## FUNDI I MYFTIUT DINAK

Musa Qazimi, pasi u kthye nga Qafë Kërraba, erdhi në Tiranë dhe nga telegrafa njoftoi Shijakun për të arrestuar Haxhi Babën, i cili mendonte të riorganizonte forca të reja fshatare për të vazhduar luftën kundër ushtrisë pushtuese dhe Esad Pashës, aleatit të tyre. Me arrestimin e Haxhi Qamilit, myftiu dinak llogariste të pajtohej me Pashën. Njerëzit e Musa Qazimit, të fshehur në zyrat e nënprefekturës së Shijakut, në befasi, iu hodhën Haxhi Babës dhe e lidhën me litar. Atë natë ata e mbajtën të burgosur Haxhi Qamilin, duke pritur urdhërat e reja të zotit të tyre, major Musa Qazimit. Por kryengritës të Shijakut, kur morën vesh arrestimin e komandantit të tyre, në orët e vona të natës u sulën kundër burgut dhe e liruan Haxhi Babën.

Komandanti i ushtrisë kryengritëse fshatare tanë po e kuptonte se rezistanca do të ishte e kotë. Ushtritë serbe e kishin pushtuar Tiranën, Elbasanin dhe po i afroheshin Shijakut. Veç kësaj, shumica e krerëve të kryengritjes dhe qindra fshatarë, pjesëmarrës ak'ivë të luftës kundër bejlerëve dhe ushtrisë serbe, u pushkatuan, ose u varën pa u gjykuar fare. Haxhi Baba u arratis nga Shijaku në pyjet pranë vendlindjes së tij, në Sharrë gjashtë kilometra në perëndim të Tiranës.

Esad Pashë Toptani, hakmarrës dhe gjakatar kundër armiqve të tij, kësaj here nuk pranoi më të bënte kompromis me myftiun e Tiranës. Ai u dha urdhër reparteve

të ndjekjes, të komanduara nga besniku i tij Osman Bali, ta arrestonin hoxhën shkurtabiq dhe t'ia paraqitnin gjyqit të posaçëm, që kryesohej nga Xhelal Bej Zogu. Me vendim të posaçëm gjyqi e dënoi me litar myftiun Musa Qazimi. Ekzekutimi u krye të nesërmen.


Pasi kryengritësit fshatarë që përbënин taborin e komanduar nga Mal Xhoka dolén jashtë rrezikut, u ulën në një lëndinë të fshehur në mes të një pylli të dendur shkurresh. Ata luftëtarë të Pishtarit, që kishin mbetur gjallë nga lufta, të rraskapitur e të lodhur, pa fjetur e të uritur, ranë në gjumë si të vdekur. Të nesërmen në mëngjez, apo zbardhi drita, kryengritësit, me armët pa fiskekë, vazhduan rrugën grykës së Shkumbinit dhe, pas disa orësh, filluan t'u ngjiteshin kodrave të Peqinit. Pas bokave, pishtarakët vazhduan udhëtimin, pa ndërprerje, për t'u kthyer sa më parë në shtëpitë e tyre. Ca luftëtarë nga fshatrat e Shijakut u shkëputën nga shokët e tyre dhe të heshtur, pa thënë asnje fjalë, u larguan nga tabori.

Fshatarët e zonës së Pezës u ndanë grupe-grupe, u shpérndanë nga të gjitha anët e kodrave dhe secili nisej kokulur për në shtëpinë e vet. Mal Xhoka, me dyzet e ca bashkëfshatarë të Pishtarit vazhdoi rrugën gjatë lumit të Pezës për të dalë në grykën e Erzenit.

— Më në fund arritëm — u tha Mal Xhoka bashkë-fshatarëve të Pishtarit.

Tashti të gjithë e merrnin me mend se qeveria e Esad Pashë Toptanit do të hakmerrej kundër tyre. Ata rrjin si të ngurosur mbi bregoren e fundit, prej nga dukej fshati Pishtar. Shtëpitë nxirrin një tym të lehtë nga çatitë. Gratë, fëmijët, nënët, baballarët, gjyshet e motrat prisnin t'u ktheheshin të afërmit e tyre, pa e ditur se shumë prej burrave e bijve të tyre nuk do të ktheheshin më kurri.

— Nuk është e lehtë të ndahemi, unë e kuptoj. —



Por tani pér tani s'kemi rrugë tjetër. Kështu erdhën punët — tha më në fund Mal Xhoka, që rrinte mbështetur mbi pushkën e gjatë, së cilës i kishin mbetur në krehër vetëm dy fishekë.

— Nuk të lëmë vetëm! — ia priti Naimi.

— Ju do të zbatoni urdhërin e komandantit. — ia priti ai. — Shkoni 'pra, pse rrini!? Ju e dini se unë e kam punën ndryshe. Do të qëndroj pyjeve. Kur të vijë koha, do të dal përsëri. Atëherë, kur të dëgjoni kushtrimin e luftës, ta dini se punët do të kenë ndryshuar. Tani, edhe një herë, mirë u pafshim, o shokë e vellezër!

Si tha këto fjalë, përnjëherësh Mal Xhoka i hipit kallit dhe u bë erë. Por, prapa tij u turrën edhe tre fshatarë kryengritës, midis të cilëve Naimi dhe Skifteri, që vendosën të mos e linin vetëm shokun e tyre.

Fshatarët e tjerë mbetën një copë herë pa lëvizur. Por, kur panë se komandanti u largua prej tyre, ata u përmendën dhe secili mori rrugën pér në shtëpinë e vet.

## NJË TAKIM I PAPRITUR

Kishin kaluar gjashtë ditë që kur u shpërnda ushtria kryengritëse fshatare. Esad Pashë Toptani, që kishte qenë i rrëthuar prej gjashtë muajsh, e shpërnguli qeverinë e tij nga Durrësi në Tiranë. Qeveria e Esadit, duke bashkëpunuar me forcat ushtarake të pushtimit, filloi operacionet e pastrimit dhe të ndëshkimeve të rrepta kundër udhëheqësve, komandantëve dhe të gjithë atyre fshatarëve që ishin shquar gjatë periudhës së kryengritjes së tyre kundër bezlerëve. Qindra kryengritës fshatarë u mbyllën nëpër burgje. Disa prej tyre u pushkatuan pa gjyq dhe ca të tjerë, nga më të shquarit, u nxorën para gjyqit të bezlerëve. Në Fushën e Tiranës repartet e ushtrisë serbe grabitnin drithërat dhe dënonin me pushkatim ata qytetarë e fshatarë që nuk u dorëzonin bereqetin. Katërmijë ushtarë robër austro-hungarezë endeshin të uritur rrugëve dhe Fushës së Tiranës! Pothuajse të gjitha këto viktima të luftës pangjermane, vdiqën urie dhe nga sëmundjet epidemike të korrikut të nxehjtë të vitit 1915. Ethet shqiptare, siç e quanin austriakët malarjen, bënин kërdinë në radhët e tyre.

\* \* \*

Mal Xhoka në ato ditë të nxehta, endej pyjeve të Sharrës, Damianit, Arbanës e Picallit dhe përpinqej të

humbe gjurmët. Dy banda të Esad Toptanit, që komandoheshin njëra nga Osman Bali dhe tjetra nga Xhavit Beu ishin vënë në ndjekje. Ata silleshin rrotull fshatrave për të frikësuar njerëzit, duke përdorur kërbaçin dhe pushkatimin. Gjithashtu ata kërkonin Haxhi Qamilin, për të cilin kishin informata se fshihej atyre anëve.

Nga Shijaku, Haxhi Qamili, pasi i shpëtoi arrestimit të Musa Qazimit, po bridhte pyjeve të Ndroqit. Më vonë u largua dhe prej andej. Osman Bali e kishte shoshitur punën. Ai e dinte se kryerebeli Haxhi Baba nuk mund të fshihej këtyre anëve. Prandaj, ai e udhëzoi Xhavit Beun dhe Demirin e Ibrahim Agës, i cili kërkonte hakun e të vëllait kundër Mal Xhokës, të rrëthonin fshatrat e Sharrës, Picallit, Damianit, Arbanës dhe të Vaqarit. Osman Bali donte ta kapte vetë Haxhi Babën për të shtuar shërbimet e tij, të cilat nuk i mjaftonin më shërbimet e së kaluarës. Vrasjen e gjeneralit Hasan Rizai në rrëthimin e Shkodrës dhe shpërblimet që kishte marrë për të edhe Osmani vetë tashti pothuajse i kishte harruar. Osman Bali kishte dëshirë që veç tokave dhe blerjes së një çifligu në fushë të merrte dhe titullin e lartë të Beut. Kur Osman Bali njoftoi pashën për arrestimin e myftiut të Tiranës, Musa Qazimit, Esadi e thirri në prani të ministrave të tij dhe i tha: «Aferim, o Osman Bej!» Osman Bali nuk përbahet nga gëzimi ato ditë. Osmani i transmetoi Esadit kërkësen e Musa Qazimit për t'u takuar me kryetoptanasin. Esad Pasha iu përgjegj se çdo bisedë me Musa Qazimin do të ishte e kotë. Myftiu do të jepte llogari përrpara gjyqit. Esad Toptani nuk pranoi të bisedonte me myftiun dinak, nga frika se ndoshta ia kthente mendjen për të lidhur përsëri miqësi me të. «Jo! Tashti nuk më duhet më ai hoxhë dinak. Në litar!» — briti Pasha dhe doli nga kabineti. Osman Bali e çoi urdhërin në vend. Xhelal Zogu, i caktuar kryetar i gjykatës së qeverisë së Durrësit, e plotësoi dëshirën e Esad Pashë Toptanit. Myftiu e Tiranës e dënuan me vdekje. Të nesërmën atë e ekzekutuan me varje në litar.

Tani Osman Bali kërkonte me çdo kusht që dhe Haxhi Qamilin ta kapte vetë. Me fantazinë e vet ai thurrte ëndrra. Mendonte që pasi ta arrestonte, ta lidhte me hekura dhe ta tërhiqte zvarrë-zvarrë me kuaj rrugëve të Durrësit, të Shijakut e të Tiranës. Ai mendonte që kapja e Haxhi Qamilit gjallë dhe dorëzimi i tij tek Pasha do të ishte shërbimi më i madh që mund të kryhej.

Një përrua i thellë ndante zabelin e dendur nga një shtëpi e veçuar e fshatit. Të zotët e shtëpisë, sipas marrëveshjes me komitin, dërgonin një herë në çdo tri ditë bukë e ushqime, të cilat i fshihnin nën zgavrën e një arre të vjetër, buzë pérroit të thatë.

— Kush je ti? — pyeti një ditë Mal Xhoka njeriu që ishte kërrusur e po gërmonte me duar vendin ku fshiheshin ushqimet. Djaloshi rrinte në këmbë 'pa lëvizur, me pushkën drejtuar gati për të qëlluar armikun.

I panjohuri ktheu kokën dhe lirshëm, sikur po i fliste një miku, tha:

— Jam unë!

Mal Xhoka ngriu në vend kur pa fytyrën mjekëroshë të Komandantit të përgjithshëm të ushtrisë fshatare.

— Ti qenke, Haxhi Baba?

— Po. Unë jam, që mos qofsha, o Mal Xhoka! — iu përgjegj i dëshpëruar Haxhi Qamili, i veshur me uniformë e gjeneralit kryengritës, që ishte grisur si mos më keq. Pastaj, si i zënë në faj, shtoi: — Mos është buka juaj kjo?

— Si duket është buka e të dyve. — i tha Mal Xhoka, i cili dukej nga fytyra se ishte hutuar shumë nga ky takim fare i papritur. Ai zbriti poshtë në përrua dhe, pasi i zgjati dorën Haxhi Babës, e përshëndeti:

— Tunjatjeta, o Haxhi Baba!

— Tunjatjeta, o Mal Xhoka! — ia priti Haxhi Qamili dhe qeshi papritmas «Ho...ho...ho!...»

— Fati na bashkoi — tha Mal Xhoka me buzë në gaz, duke larguar me dorë një degë arre, që vinte e më-njanuar deri afër ujtit.

Të dy kryengritësit fshatarë, njëri komandant i përgjithshëm dhe tjetri komandant i një tabori, u ngjitën lart mbi përrua dhe, duke ecur në muzg krah njëri-tjetrit, pa këmbyer asnëjë fjalë, hynë në zabel. Pasi bënë nga njëzet minuta rrugë, qëndruan në një copë lëndinë fare të vogël, të rrethuar nga dushqet e reja dhe nga disa kaçuba. Haxhi Baba shtroi pér tokë bukën, gjizën dhe dy presh. E ndau ushqimin në dysh dhe, pa thënë asnëjë fjalë, fillouan të hanin që të dy.

— Mbetëm vetëm, o Mal Xhoka! — i tha Haxhi Baba pasi kishin ngrënë bukë dhe kishin pirë ujë në shtamën prej balte. Mal Xhoka nuk iu përgjegj. Ai nuk dinte si ta ngushëllonte Haxhi Babën. Ndejtën një copë herë duke shikuar në sy njëri-tjetrin pa ditur se çfarë të thoshin.

— Flemë? — i tha më në fund Mal Xhoka.

— Mua nuk më flihet — u përgjegj i mërzitur Haxhi Baba, duke zënë me dorë mjekrën e rritur ngjyrë gështenje.

— Nuk duhen humbur shpresat. — tha Mali që e kuptoi gjendjen e rëndë shpirtërore të Haxhi Babës.

— Nuk ditëm të luftojmë — i tha Haxhi Qamili dhe, pér herë të parë, e kapi miqësisht nga krahu Malin. — Mos kujton ti se unë nuk i di se ku janë gabimet? Hë, hë... ata miqtë tuaj tiranas kujtojnë se unë jam budalla.

Mal Xhoka po bluante në mendje disa nga ngjarjet më të shënuara të kryengritjes që kishin lënë mbresë tek ai. Haxhi Qamili nuk e kuptoi se kryengritja fshatare kundër Esad Pashë Toptanit në tetorin e 1914-ës duhej të udhëhiqej nga flamuri kombëtar dhe jo nga flamuri me gjysmëhënë. Sipas Mal Xhokës, kjo ishte fatkeqësia më e madhe dhe një nga shkaqet kryesore të dështimit të kryengritjes.

— Dëgjo, Mal Xhoka! — i tha Haxhi Baba, sikur t'ia kishte lexuar në ballë mendimet që kishte në kokë. — Bejlerët dhe Esad Toptani fituan, sepse kishin ndihmën e kral Pjetrit.

Myftiu Musa Qazimi dhe shokët e tij ishin tradhëtarët e kryengritjes sonë fshatare. Ata na gënjen! Na pri shën mendsh me fenë e turqizmin. Na përçanë me qytetarët e mësuar. E, mos kujto ti, o Mal Xhoka, se dhe unë jam pa faj. Në fund të fundit, çfarë jam unë? Një fshatar i pashkolluar. Fshatarët, pa bashkimin me njerëzit e mësuar dhe vegjelinë e qyteteve, nuk mund të bëjnë asnjë hap përpëra. Por, edhe ata nuk i le baba pa faj. Përse nuk erdhën midis nesh në fillim dhe ta kishin lidhur itifakun e Tiranës më përpëra? Ndoshta punët do të shkonin ndryshe. Oh, po më dhemb koka! — tha Haxhi Baba duke shtrënguar tëmthat me të dyja duart dhe pastaj shtoi: — Po të hiqen qafe Esad Toptani dhe bejlerët, punët rregullohen. Ata ua sjellin fatkeqësitetë fshatarëve.

— Punët u bënë çorbë! — ia priti Mali dhe shtoi: — Patriotët e vërtetë dhe fshatarët kryengritës trima mbetën si trupi pa kokë. Unë i them të gjitha këto, o Haxhi Baba, megjithëse është tepër vonë! Sido që të ndodhë, nga kryengritja e lufta jonë kanë vënë mend njerëzit dhe do të vijë dita të rrokim përsëri armët. Po duhet të lutojmë ndryshe.

Haxhi Qamili mbante sytë përtokë dhe dëgjonte në heshtje, i tronditur thellë në shpirt, për të gjitha ato që kishin ndodhur. Fjalët e Malit i binin në krye si sëpata mbi drurët e pyllit.

— Hé... hé! — fshani Haxhi Baba, pa i hequr sytë nga toka me driza. — Ju vazhdojeni luftën, por baba u dogj! Po, u dogj, po të them, dhe mori yll! — Shprehjen e fundit e tha me ton më të fortë dhe vetëm kësaj here ngriti sytë nga bashkëfolësi.

Mali vuri re se një si perde transparente mbulonte sytë e thellë të Haxhi Babës, mbi të cilat vareshin një palë vetulla të trasha e të dendura.

— Im vëlla dhe dy kushërinjtë e mi që takova mbrëmë më treguan se Osman Bali u qenka kërcënuar. Ai pas ka thënë se Pasha paska vendosur të djegë dhe të shuajë jo vetëm shtëpinë time, por edhe të gjithë fshatin. Dhe tani nuk di si të bëj — tha i dëshpëruar Haxhi Baba dhe po vetë u përgjegj: — Ata janë bejlerë të poshtër. Do të

hakmerren kundër fshatarëve. Dhe mua nuk më bën zemra të pranoj të heqin të tjerët kusuret e mia.

— Çdo dash nga këmbët e veta varet, o Haxhi Baba! — iu përgjegj Mali. — Ne duhet ta vazhdojmë luftën. Nuk duhet të dorëzohemi.

— E drejtë. Nuk i ka hije burrit e trimit të vdesë nën këmbët e armikut — tha Haxhi Qamili duke tundur kokën i pezmatuar.

Nata kishte rënë mbi krahinë dhe qetësia të kallte ndjenjën e trishtimit në këto ditë të vështira, kur kurthet, intrigat, dhe spiunllëqet ishin ngrehur në çdo shteg, në çdo grykë dhe në çdo vend.

— Flemë! — i tha Haxhi Qamili ish-komandantit të Pishtarit duke nënqeshur. Atij iu kujtua se si disa njerëz e kishin raportuar Mal Xhokën si njeri të rrezikshëm në radhët e kryengritësve fshatarë për lidhjet me patriotët tiranas, të cilëve u ishte bërë mendja flamur kuq e zi e shkronja latine.

Dhe ja, tani Haxhi Qamili po rrinte në pyll vetëm për vetëm me Mal Xhokën. Ky ishte kryengritësi i fundit që po i qëndronte pranë në orët më të vështira të jetës së tij.

— Mirë. Flemë! — përsëriti Mali dhe shtoi: — Ditë e re, nafakë e re!

Të dy burrat u shtrinë për tokë fare pranë njëri-tjetrit. Si jastëk vunë një copë dru. Mbyllën sytë, po secilit i punonte mendja gjetiu. Hëna ishte futur nën re dhe pylli shushurinte nga një erë e lehtë. Komandanti i përgjithshëm i ushtrisë fshatare, ai që para disa javësh kishte komanduar tridhjetëmijë fshatarë të armatosur dhe u kishte dhënë grushtin Esad Pashë Toptanit e gjithë kastës së bejlerëve, ai që kishte ngritur ushtrinë fshatare në luftë kundër pushtuesve të huaj serbomëdhenj, ai për të cilin kishin bërë aq e aq raporte e artikuj nëpër gazetat e vendeve evropiane, tani ndiqej këmba-këmbës nga armiqtë e tij dhe flinte në pyll vetëm për vetëm me Mal Xhokën! Haxhi Baba u rrrotullua nga dy herë, pastaj me nervozizëm u ngrit ndenjur. Me pëllëmbët shtrëngoi tëmlat dhe, duke harruar se pranë tij flinte Mal Xhoka, fi-

lloj të fliste gati duke mërmëritur: «Ah, moj kokë e paghdhendur! Ta punoi Pasha dhe Musa Qazimi! Më vjen plasja që nuk munda të vras Esad Pashë Toptanin, atë gjarpër me dyqind krerë! Kam bërë gabime, ndoshta edhe faje. Të më falni, o njerëz të mirë! Ta dini, pra, se qëllimin e kam pasur gjithnjë të mirë. Luftoja për të drejtën fshatare, për tokën dhe lirinë. Luftoja për të shkulur nga rrënjet bejlerët dhe Esad Toptanin, që nuk kishin lënë kusur pa bërë në curriz të fshatarit. Po. E ngritëm grushtin dhe vumë dorë kundër pasurisë së bejlerëve të krijuar me djersën e gjakun e bujqve. Ta dini ju, njerëz, se Baba jo flori, po asnjë kacidhe nuk e ka futur në xhepin e tij! Flortinjtë, mexhidet, tokën dhe çdo pasuri tjetër që u kemi rrëmbyer bejlerëve dhe agallarëve, ua kam ndarë fshatarëve të varfër, jetimëve dhe njerëzve pa përkrahje! Hoqa faizin, që i merrte shpirtin fshatarit. Ndalova të pihet rakia. Ndalova kurvërinë. Dogja shkresat e kadastrave. Dogja teqetë dhe u mora bagëtinë baballarëve dembela. U ruajta mjekrën dervishlerëve që rrinin kot. Ja, shikoni këto duar me kallo! Gjithë jetën kam punuar tokën. E kush nuk i njeh preshtë e mi me nam, që i sillja vetë në tregun e Tiranës? Të krishterët i kam respektuar dhe, ashtu si rrinin hapur xhamitë i kam lënë edhe kishat. Mund ta shpallja veten pashë ose mbret? Po të doja edhe këtë punë e bëja. Kisha fuqinë, dhe, kur ka fuqinë në dorë, njeriu mund të bëjë ç'të dojë. Nuk doja të ishte ashtu siç mendojnë bejlerët, ca të hanë me lugë argjendi e ca të tjerë të jetojnë zbatur e barkzbrazur. Kjo nuk është e drejtë. Ja, këto punëra desha të bëja. Po nuk dita. E pranoj se nuk dita të luftoja. Por nuk pranoj të shpifet për mua. Ashtu duke folur, duke murmuritur nëpër dhëmbë, vari kokën më-njanë.

Mal Xhoka, që nuk e kishte zënë mirë gjumi, dëgjoi pa marrë frymë të gjitha fjalët që dilnin si të mekura nga goja gjithë qime e Haxhi Qamilit. Malin e habitën mendimet e shprehura nga Haxhi Baba.

Mal Xhoka ndenjti dhe një copë herë me veshë të ngre-

hur për të dëgjuar ndonjë fjalë tjetër, por, ku pa se Haxhi Baba më në fund ishte vënë nën pushtetin e gjumit, mendoi: «Duhet të fle, se po zbardh dita».

\* \* \*

Një rreze drite që përshkoi pyllin e errët ra në lirish-ten ku ishin shtrirë komitet për të pushuar. Mal Xhoka, që flinte me pushkën e gjatë të përqafuar, hapi sytë dhe menjëherë hodhi vështrimin nga shoku që ishte shtrirë në krah të tij.

— Paska ikur! — thirri Mali i hutuar dhe brofi më këmbë. Ai hapi sytë rreth e përqark se mos diktonte ndonjë gjurmë të Haxhi Babës, por nga pylli i heshtur nuk mësoi asgjë. Mal Xhoka u mundua të merrte me mend se çfarë do t'i kishte ndodhur Haxhi Qamilit. Ai mendoi: «Haxhi Baba u largua që të mos më rrezikonte mua! Ai kërkon të më ruajë, kurse veten do ta bëjë fidai!»

Pishtaraku e hodhi pushkën në sup dhe, i vendosur për luftën që duhej të vazhdonte, u nis të ikte në anën tjetër të pyllit.

## CILI JE TI, HAXHI QAMILI?

Pas takimit me mbretin dhe kryetarin e qeverisë serbe, Esadi u kthye përsëri në Durrës. Ushtria serbe nuk hyri në Durrës për arësy politike, lidhur me presionet ushtarake të qeverisë italiane.

Me t'u kthyer në Durrës, Esadi vajti në selinë e qeverisë. Një zë i njohur e thirri nga oborri: «Pashë, o pashë i ndritur».

Esadi doli në dritare dhe pa aty poshtë një njeri të lidhur duar e këmbë, rrrethuar nga katër xhandarë të armatosur me në krye besnikun e tij Osman Bali. Esadit i rrahu zemra aq fort, sikur po i çahet kraharoni. Armiku i tij më i madh, që kishte ngritur mijëra fshatarë, që i kishte djegur sarajet, që kishte thyer ushtrinë e mercenarëve të Preng Pashës në Ishëm, ushtrinë e Esad Toptanit dhe të Ahmet Zogut në Zezë e në Krujë, ai që i shpalli luftë mbretit të Serbisë, komandanti i ushtrisë fshatare kryengritëse qëndronte i lidhur me hekura, nën këmbët e tij! Megjithëse kishte smirë për forcën e këtij fshatari laporak, i cili, nga një raja, kishte arritur të bëhej kryetar e komendant i një ushtrie të madhe fshatare kryengritëse, Esad Pasha mendoi t'ia falte jetën. Dhe kjo për dy arësy: nga frika e zemërimit të fshatarëve dhe me qëllim shfrytëzimi për t'ia kundërvënë Mirditës së pabindur. Esad Pashë Toptani dha urdhër ta trajtonin të burgosurin si një oficer të lartë. Dy herë Esadi inkonjito u takua në burg me Haxhi Qamilin, të cilin i propozoi të lidhej besa-besë me të. Pasi ai të pranonte dhe t'i binte ndër këmbë pashait të tij para

popullit, ai do ta bënte komandant tē forcave esadiste pēr tē shtruuar masat fshatare tē revoltuara. Esadi mendonte tē vriste me një tē shtënë dy zogj. Duke e bërë pēr vete Haxhi Qamilin, në një anë shfrytëzonte ndikimin e tij në turmat e bujqve e tē fshatarëve dhe nga ana tjetër forconte pozitat e lëkundura tē bejlerëve çifligarë. Po pēr-gjigjja e Haxhi Qamilit qe e pabesueshme pēr Esad Toptanin. Sharrini kryengritës nuk pranoi asnë bashkëpunim me Esad Pashën. Haxhi Baba nuk pranoi tē vihej në shërbim tē tij dhe tē luftonte kundër vëllezërve fshatarë.

— Dëgjo, o Esad Toptani, se Haxhi Baba dhe fshatarësia kryengritëse ty dhe tē gjithë bejlerët e tjerë ju ka armiq tē betuar dhe nuk pajtohet kurrë me ju! Po tē tē kisha kapur unë, do tē tē kisha vrarë me dorën time! Më kape ti, bëj ç'të duash me mua! Fjalë tjetër bashkë nuk kemi më!

Esad Toptani u largua shumë i inatosur jo vetëm nga guximi i çmendur i Haxhi Qamilit, por më tepër nga ndjenja e mërisë që ajo pjellë e turmave fshatare kryengritëse kishte në shpirt pēr kastën e pushtetin e bejlerëve. Kjo gjë e shqetësonte shumë Esad Pashë Toptanin. Ai nuk e harronte natën kur e kishin njoftuar se Haxhi Baba e fshatarët i kishin djegur sarajet. Një javë rresht nuk kishte vënë gjumë në sy.

— Haxhi Qamili, kryerebeli i kryengritjes fshatare, vrasës, plaçkitës, njeriu që ka ngritur grushtin kundër ligjit, t'i jepet pēr gjykim gjykatës së jashtëzakonshme! — urdhëroi ai.

Urdhëri i Esadit u vu menjëherë në zbatim. Gjyqtari hetues filloi hetimet pēr fajësinë e Haxhi Qamilit.

Në procesin e hartuar nga hetuesia pérshkruhej arrestimi i Haxhi Qamilit dhe veprimtaria e tij si rebel kundër qeverisë së Esad Pashë Toptanit dhe bejlerëve tē tjerë tē Tiranës, Ndroqit, Kavajës, Myzeqesë, Elbasanit, Beratit dhe krahinave tē tjera tē vendit.

Majori Osman Bali, në krye tē një kompanie xhendarësh, rrëthoi Haxhi Qamilin në pyllin Damian, midis fshatit Fortuzaj dhe Urës së Beshirit. Ai e kishte humbur perspektivën e luftës dhe vetë u tha bashkëfshatarëve

që të njoftonin Osman Balin për vendin ku ishte fshehur. Pra, vendosi të dorëzohej. Xhandarët, të komanduar nga Osman Bali, shkuan me vrap në pyll në vendin ku ishte fshehur rebeli. Pas një përleshjeje të dëshpëruar për ta lidhur, ata mundën ta arrestonin Haxhi Qamilin. Të sho-qëruar nga xhandarët, ai u dërgua po atë ditë në burgun e Shijakut. Të nesërmen, me urdhër të Osman Balit, rebe-lin e lidhur e transferuan në burgun e Durrësit.

\* \* \*

Haxhi Qamili, në burgun e Durrësit, priste të dilte para gjyqit. Ai ishte i qetë dhe nuk i bëhej vonë për çastin kur do t'i vinin në fyt litarin. Ai thoshte me vete: «Vde-kja éshtë hak! Unë po vdes si burrat, se kam shti pushkë kundër Esad Pashë Toptanit!»

I kredhur në mendime në vetminë e burgut, Haxhi Qamili filloj të sillte nëpër mend tërë jetën e tij, fëmijërinë, prindët, shtëpinë, vendlindjen e tij. Me sytë e mendjes ai sodiste fshatin ku ishte lindur dhe ishte rritur me njëmijë mundime. Fshati Sharrë ishte ndërtuar në grykat e kodrave të veshura me ullinj dhe të bokave të zhveshura. Vendi i thyer u përngjante dhëmbëve të një sharre; që këtej vinte, ndoshta, edhe emri i fshatit. Lagjet e vogla të shpërndara ishin krijuar sipas fiseve. Fisi më i përmendur dhe i shquar për trimëri e bujari në tërë grykën e Erzenit ishin xhametajt. Familja e xhametajve, pjesëtar i së cilës ishte edhe Qamili, (pas pelegrinazhit në Meqe Medinë mori emrin «Haxhi Qamili») përbëhej prej dyzet e katër frymësh. Ata rronin sipas zakoneve të vjetra patriarkale.

Tokat e bukës së xhametajve në fushën e Xhaferrajt, gjysmë ore larg fshatit, mezi u siguronin prodhime<sup>t</sup> bujqësore të mjaftueshme për jetesën e vittit. Shpeshherë tha-tësirat dhe shirat e parreshtura të korrikut u kishin prishtur prodhimet bujqësore dhejeta e tyre vështirësohej edhe më shumë. Nga çasti në çast, për një trill, tokat e

tyre mund të përvetësoheshin nga bejlerët toptanas. Dy vjet para se të fillonte kryengritja, Qamili ndërtoi mbi pérroin e fushës një urë prej druri, të cilën fshatarët e emërtuan «Ura e Haxhi Qamilit». Në Sharrë dhe në të gjitha fshatrat e krahinës nuk kishte shkolla. Qamili, si edhe të gjithë bashkëfshatarët e tij, ishin analfabetë. Por, megjithëse ata ishin të paditur, jeta i rrahu dhe i pajisi me pérvojë. Qysh fëmijë Qamili ishte edukuar me urretjen kundër bejlerëve dhe agallarëve kapadainj, që merrnin nëpër këmbë të drejtat e dinjitetin njerëzor të fshatarëve. Me mendjen e tij, Haxhi Qamili bluante prej kohësh mendime të turbullta për të ngritur grushtin kundër bejlerëve. Ai priste ditën e volitshme për të kapur pushkën!

Pastaj solli ndër mend si kishte ardhur puna që të përzihej me kryengritjen, si ishte bërë komandant i përgjithshëm i ushtrisë fshatare e të tjera. Ai herë pas here tundte kokën dhe nënqeshte me vete.

Gardianët dhe vizitorët kureshtarë, sidomos ata që kishin hequr të zitë e ullirit prej tij, kur ai pati fuqinë në dorë, rrinin orë të tëra pas hekurave të burgut duke sotur Haxhi Qamilin e lidhur me hekura, që buzëqeshte.

Ditën e tretë, kur hetuesi kishte marrë përsëri në pyetje Haxhi Qamilin dhe kërkonte prej tij pohimin e djegies së shtëpive të bejlerëve toptanas, të Esad Toptanit, Hamid Toptanit, Veli Bej Jubës dhe toptanasve të tjera, në port ndodhi një eksplozion i papritur, i cili vazhdoi pa ndërprerje një copë herë të mirë. U duk sikur muret e burgut po çaheshin më dysh. Atë ditë me hetuesin kishte ardhur edhe kryetari, Xhelal Bej Zogolli, megjithëse sipas procedurës gjyqësore kjo nuk ishte e rregullt. Gjyqtarët, kur ndodhi eksplozioni, dolën me vrap nga burgu dhe në ato çaste harruan fare detyrën.

Gardianët, pasi e mbyllën derën e jashtme të burgut, ikën nga vendi i rojes dhe u fshehën pas mureve të kalasë së rrënuar romake.

— Po zbarkojnë austriakët! — thirri një i burgosur që ishte në dritaren më të lartë të burgut, që shikonte nga deti.

— Shpëtuam! — ia priti një tjetër.

Këta të burgosur ishin disa qytetarë tiranas patriotë, kundërshtarë të Esad Toptanit që përgjithësisht besonin se shpëtimi i kombit dhe pavarësia e Shqipërisë do të si-guroheshin me ardhjen e ushtrive austriake në Shqipëri.

Haxhi Qamili rrinte i qetë, mbështetur pas murit të burgut, dhe, i kredhur në mendime, bënte arësyetime të ngjarjeve të kaluara. Ai tani e kishte fare të qartë se, po të dilte jashtë burgut dhe po t'i rikthehej Iiria, do të luftonte përsëri, por jo në rrugën që kishte ecur deri tani. Ai ishte bindur tashmë për mendimet e drejta të Ram Lekës.

Jashtë në det vazhdonte gjëmimi i topave. Me sa u muar vesh më vonë, nga ato që tregoi një nga gardianët e burgut, dy anije austriake kishin hyrë tinëzisht në portin e Durrësit. Anijet austriake kishin qëlluar anijet italiane të ankoruara në skelë. Lufta midis tyre ishte ndezur e ashpër.

Artileria e Esad Toptanit, e vendosur mbi kodrat e Durrësit, qëlloi anijet austriake. Esad Pashë Toptani, kryetar i qeverisë së Durrësit, i kishte shpallur luftë zyrtarisht blokut qendror të fuqive evropiane, nëpërmjet notës së dërguar Ministri së Jashtme të Austro-Hungarisë në Vjenë. Dy anijet austriake ranë midis një zjarri të dendur të artilerisë së flotës italiane dhe të artilerisë bregdetare të Esad Pashë Toptanit. Njëra nga anijet austriake nuk mundi të ikte jashtë ujërave të Durrësit, ajo pasi mori zjarr, filloi të zhytet në det. Anija e dytë u largua në drejtim të veriut. Të gjitha xhamet e dritareve u thyen copë-copë. Shtëpitë e vjetra u shembën nga tronditja e shpërthimeve. Ajo që prisin të burgosurit e Durrësit, domethënë që të zbarkonin austriakët, nuk ndodhi. Si duket të dyja anijet austriake kishin ardhur në ujërat e Durrësit me qëllim zbulimi. Pas këtij incidenti, Esad Toptani, të burgosurit politikë tiranas dhe të qyteteve të tjera, të cilët ishin nga rrethet patriotike dhe simpatizuese të qeverisë së parë shqiptare të Ismail Qemalit, i transferoi nga burgu i Durrësit në ishujt e Italisë.

Haxhi Qamili u nda atë ditë me të burgosurit poli-

tikë. Disa ditë hetuesi nuk erdhi fare në burg. Gardianët vazhdonin t'i sillnin ushqime të bollshme e të zgjedhura. Kryengritësi fshatar mendoi se ndoshta përsëri Esad Pasha po kurdiste ndonjë dredhi të re. Po Haxhi Baba ishte i vendosur në të tijën dhe kurrën e kurrës nuk do të pajtohej me të dhe me bejlerët. Me mjekrën e futur në gjoksin leshtor, i mbledhur kruspull mbi hekurat, që ia kishin rrëmbyer lirinë, ra përsëri në mendime. I kujtohej i ati i verbër, që i kishte vdekur para disa vitesh.

Një vit para se të shpalaj Hyrijeti, kur thatësia kishte plakosur tokat e çifligjeve të Esad Toptanit, qehajallarët nuk kishin pranuar të bënin asnë zbritje nga e treta që jepnin bujqit prej prodhimeve vjetore.

— Dëgjo, bir! — i kishte thënë atëhere i ati Qamilit të ri. — Mos harro se bejlerët janë armiqjtë më të egër të fshatarëve. Ata një ditë do t'i marrin edhe tokat tonë. Armiku më i rrezikshëm për ne, fshatarët, është Esad Toptani!

Ashtu, i kredhur në këto mendime, ai dëgjoi se po i thërrisin në emër:

— Haxhi Qamil! — thërriste gardiani duke tundur çelësat. — Çohu në këmbë se po vjen Xhelal Beu!

Haxhi Baba i hodhi një vështrim të ftohtë gjykatësit dhe nuk u tund fare nga vendi.

— Ngrehu në këmbë, ore kryerebel! — e qortoi një nga xhandarët matjanë duke e goditur me shqelm.

— E si të ngrihem, more edepsëz? A nuk e sheh se më keni lidhur duar e këmbë? — u përgjegj Haxhi Baba me përbuzje dhe shtoi: — Burri nuk preket kur është duarlidhur.

Xhelal Bej Zogolli, veshur elegant, me rroba frengu dhe me papion në qafë, pasi hoqi qylafin e zi prej kadiifeje dhe fshiu ballin e djersit, tha me zë të lartë:

— Largohuni të gjithë që këtej!

Në qelinë e burgut mbetën vetëm kryetari i gjykatës dhe i burgosuri, që nuk tundej nga vendi ku ishte shtrirë. Xhelal Beu, kur pa se Haxhi Qamili nuk po e përfillte, u afrua fare pranë tij dhe miqësish i pëshpëriti në vesh:

— Haxhi Baba, dëgjo këtu! Kam ardhur të bisedoj si mik për punë shumë të rëndësishme. Esad Pashë Toptani zemërgjerë të dërgon të fala dhe të fal jetën. Por me një kusht, që, kur të të dërgoj përpara tij, t'i biesh ndër këmbë! Pasha më tha se do të të emërojë komandant të operacioneve kundër malësorëve mirditorë e dukagjinës.

Haxhi Qamili vazhdonte të rrinte symbyllur dhe, si nëpër éndërr, filloi të kujtonte të shoqen, Hanën e bukur dhe shumë të dashur. I vinte keq që do të ndahej prej saj.

Bota e kujtonin Haxhi Qamilin për njeri të thyer në moshë, sepse i gabonte pamja e tij e jashtme, po në të vërtetë ai s'kishte veçse disa muaj që kishte mbushur të tridhjetegjashtat.

Xhelal Beu, kur pa se rebeli nuk po e përfillte, humbi durimin. E kërcënoi me të thirrura dhe e qëlloi në kokë me bastunin prej bambuje.

Haxhi Baba u ngrit më këmbë dhe, duke tundur në ajër duart e lidhura me hekura, u mat ta godiste Xhelal Beun. Kryetari i gjykatës u tërroq prapa, se përndryshe nuk do t'i shpëtonte goditjes së befasishme të «rebelit fshatar».

— Ikë, more bej i shitur! Nuk rrehet, more, jo, Haxhi Baba. Nuk luftoj unë, ore, jo, kundër vëllezërve të mi! Muslimanë e të krishterë janë vëllezër, more edepsëz! Nuk pajtohem, ore kurrë me Esad Pashën e me bejlerët! Nuk shitet Haxhi Baba, jo! Po të më binte në dorë Esad Pasha, unë vetë do ta vrisja me dorën time! Qërohu tashti, se të vrava, për atë besë, e për atë nder! Shko e ia kthe Esadit të falat që i bën Haxhi Qamilit. Gjynah që nuk munda ta vras!

I burgosuri, i zemëruar, u hodh përpara gjykatësit me prangat që e shtrëngonin këmbë e duar, por u shemb përdhe. Xhelal Beu me sy të çapërlyer nga urrejtja, turfullonte si kafshë dhe, kur e pa punën pisk, doli me nxitëm nga burgu duke thirrur me nervozitet: — Në litar... në litar, rebelin!

Gardianët dhe xhandarët u hodhën brenda qelisë dhe, pasi e shtytën dhe e rrëzuan për tokë të burgosurin, filluan

ta qëllonin me kondaket e pushkëve ku të mundnin, në kokë, në bark dhe në krahëror. Gardiani më i vjetër e kyçi drynin e derës së hekurt dhe çelësin e vari në qafë.

Të nesërmen Haxhi Qamili, me mundim të madh, u ngjit në dritaren e qelisë dhe vështronët qellin e tymosur të skelës së Durrësit. I habitur dëgjonte zhurmën shurdhuese e të çjerrë të një aeroplani, që endej sipër qytetit duke uturirë. Përsëri gardianët dhe xhandarët, që ruanin burgun, ikën në panik, pa pyetur fare për të burgosurit, edhe pse e kishin për detyrë t'i ruanin. Një çast Haxhi Qamili pa fare qartë kokën e një njeriu dhe lëvizjen e dorës që ai bëri duke hedhur nga qelli poshtë dy bomba, njérën pas tjetrës. Në skelë, pas eksplozionit, plasi flaka mbi magazinën e doganës.

Aeropelanët e Austrisë, të shpikur në prak të Luftës së parë botërore, kishin filluar të bombardonin me bomba dore objektet ushtarake të armikut. Qytetarët ndenjtën dy ditë të myllur nëpër shtëpi, kurse fetarët dhe ho-xhallarët bënin lutje pa u shqitur nga xhamitë e shpërndara lagjeve e rrugicave të qytetit. Artileria e flotës italiane kryqëzoi predhat me qitjet e artilerisë bregdetare të vendosura në Kodrat e currilave. Haxhi Qamili qeshi me vete: «Ho....ho...ho!..» dhe tha me zë: «Ka ndërruar koha. E çfarë nuk po sajognë njerëzit!» Ai, pasi dëgjoi edhe një copë herë zhurmën e aeroplanit austriak, që sa vinte e largohej në thellësitë e detit, zbriti nga dritarja dhe, duke qeshur e duke luajtur kokën, u shtri në rrogzin prej zhuke, e vetmja plaçkë në atë qeli.

\*  
\*      \*

Pikërisht në çastin kur dera me hekura kërciti «kiu... kiu...» duke u varur mbi menteshet e mëdha, Haxhi Baba përpiquej të ngjitej në dritare që të shihte si gjithnjë agimin e ditës së re.

Në qeli ia befi një njeri që po e shikonte për herë të parë. Oficeri trupmadh e fytyrëvrazhdë, i shoqëruar nga

dy xhandarë të veshur me opinga, bërtiti nga praku i derës:

— Pas meje, o rebel!

Xhandarët, apo dëgjuan urdhërin e oficerit, u turrën nga i burgosuri dhe e zunë për krahësh.

— Hiqmuni qafe, ore lapangjözë! Të shitur për pesë kacidhe tek Esad Pasha!

— Do të japësh llogari në gjyq — tha oficeri.

— Vij vetë! — u përgjegj ashpër Haxhi Baba. Ngri-  
ti duart e lidhura me hekura lart e, me sytë të hakë-  
rruar, u sul nga dera.

Xhandarët u prapsën dhe e lanë të burgosurin të zva-  
rritej pas oficerit që printe.

Në oborrin rrëzë mureve të kalasë së rrënuar ishin  
ulur në karrigen e gjerë e të lartë prej druri të zi arre  
gjyqtarët. Mbi tryezën me këmbë të kurbuara ishin një  
dosje dhe një vulë. Xhandarët e armatosur qëndronin  
më këmbë përqark të burgosurit. Kryetari i gjykatës,  
Xhelal Bej Zogolli, i caktuar nga Esad Pashë Toptani,  
hapi dosjen dhe mori nëpër duar disa letra të shkruara  
turqisht. Ngri-  
ti kokën lart dhe pyeti me zë solemn:

— Cili je ti?

— Haxhi Baba, fshatar i varfër nga katundi Sharrë.

— A ke qenë ti?..

— Po.. e ndërpren i pandehuri. — Kam qenë Komandan-  
tant i përgjithshëm i ushtrisë kryengritëse fshatare! —  
tha Haxhi Baba ashpër dhe një nënqeshje i vetëtui në  
këndin e buzëve.

— Komandant i rebelave! — korrigoi njëri nga  
anëtarët e gjykatës.

— Ihrak, katël, tebdil hyqymet! — lexoi gjykatësi me  
zë të lartë nenin e kodit penal të Turqisë.

— Rebela jeni ju, që bashkoheni me ushtritë e hu-  
aja! — u përgjegj Baba dhe shtoi: Unë flas gjuhën e nënës  
dhe ato fjalë që thoni ju nuk i kuptoj!

— Akuzohesh për vrasje, për djegie dhe për rrëzimin  
e qeverisë — i tha Xhelal Beu.

— Po. Kam vrarë dhe kam plaçkitur bejlerët — pohoi  
Haxhi Qamili.

— A e pranon se e ke vrarë Stafén e Ibrahim Agë Ndroqit?

— Po. E kam vrarë, se ishte këlysh i Esad Pashës.

— Ke djegur sarajet e Esad Toptanit, Veli Bej Jubës, Fuat Toptanit dhe të tjerëve!

— Po, i kam djegur shtëpitë e tyre, se i kam pasur kundërshtarë.

— Cili je ti, që merr guximin të djegësh shtëpitë e zotërve të tu? — briti papritmas Xhelal Bej Zogolli, që nuk po duronte më gjakftohtësinë dhe mospërfilljen që tregonte ky rebel kundrejt qeverisë.

Akuza që i bëhej Haxhi Qamilit, Komandantit të kryengritjes fshatare, përmblidhej nga hetuesi në disa fletë të shkruajtura turqisht, që i mbante në dosje kryetari i gjykatës, Xhelal Bej Zogolli. Në këtë padi Haxhi Qamili dhe kryengritja rebele e fshatarëve nuk akuzohej as për lëvizjen kundër mbretit të huaj gjerman, princ Vudit, as edhe për parullat panislamike të kurdisura nga Musa Qazimi e të tjerë agjentë të xhonturqve. Jo! Gjatë procesit të gjyqit nuk u zhvillua asnje bisedë ose pyetje lidhur me këto çështje.

Procesi gjyqësor do të zgjaste dy ditë. Haxhi Qamili, në vetminë e qelisë, e dinte fare qartë se e priste dënim i me vdekje! Kryengritësi fshatar, i mbështetur në murin e ftohtë e me lagështirë të qelisë, kishte tretur vështrimin në errësirë dhe me mend mundohej të freskonte edhe një herë ngjarjet më të rëndësishme të këtyre dy viteve të fundit.

Atij vazhdimisht i sillej nëpër mend pyetja që ia kishin bërë disa herë gjykatësit: «Cili je ti, Haxhi Qamili?» Ai e kujtonte dhe pastaj queshte me zë: «Ho...ho... ho!...» «Çfarë kërkove të bësh, o Haxhi Qamili?» pyeste ai veten dhe përgjigjej po vetë.

\* \* \*

Nga dritaret e vogla të burgut, rrezet e dritës, të thyera nga muret e gurta e të larta, kishin depërtuar në qeli.

I burgosuri hapi sytë dhe, kur pa më këmbë, mbështetur te porta e hekurt, brenda qelisë, pashën, të veshur me uniformën e gjeneralit, mbështetur mbi bastunin e tij, i mbylli qepallat përsëri dhe, për një çast, mendoi se po shikonte një ëndërr. Fantazia e ndezur shpeshherë e çonte Haxhi Qamilin në ëndërrime të çuditshme.

Fshatari kryengritës u përpoq të hapte sytë përsëri, pasi e ndjeu veten që ishte i zgjuar. Qëndroi një copë herë me sytë mbërthyer te figura e njeriut të heshtur, që ishte shfaqur në qeli dhe, pasi u sigurua se nuk ishte pjellë e fantazisë, tha me qesëndi, pa lëvizur nga vendi, ashtu siç ishte i lidhur duar e këmbë, mbështetur pas murit:

— Çfarë kërkon këtu, o Esad Pashë?

— Të merremi vesh, Haxhi Qamil Xhameta — iu përgjegj Pasha me ton miqësor, duke vënë buzën në gaz.

— Unë jam i lidhur më hekura. Po të isha i lirë, do të të çapëloja, bej. Punët tona i ndan gryka e pushkës, o Esad Toptani.

— Dëgjo edhe fjalën time, o Haxhi Qamili — tha Esadi dhe qëndroi i heshtur një copë herë, me sy të mbërthyer te kryerebeli kryeneç. Ai po çuditej me qëndrimin stoik dhe moralin e lartë të këtij fshatari të paditur e rebel. Kjo ishte përpjekja e fundit e pashait tiranas përt'u pajtuar me Haxhi Qamilin, i cili në situatën e re të krijuar i duhej atij për qëllime të veta.

Esadi e kuptoi se ishte i pamundur të miqësohej dhe ta vinte në shërbim të tij Haxhi Qamilin. Ndërkohë gardiani hapi derën dhe në intimitet i tha disa fjalë në vesh.

Pashai u drodh i téri. Atë e kërkonte me urgjencë komandanti i ushtrisë serbe të pushtimit. Me siguri du-

hej të ishte një punë e rëndësishme takimi i tyre në Tiranë. Esadi, me intuitën e tij të mprehtë, e parashikoi katastrofën e re: avancimin e ushtrive austro-hungareze në Shqipëri dhe dëbimin e ushtrisë serbe. Kjo ngjarje patjetër do të shënonte fundin e tij, pasi qeveria e Esad Pashës i kishte shpallur zyrtarisht luftë Austro-Hungarisë dhe përgjithësisht blokut qendror.

Esad Pasha, për të fundit herë, i hodhi një vështrim kërcënues e të neveritshëm njëkohësisht Haxhi Qamilit dhe, pa fjalë, doli i inatosur nga burgu, i shoqëruar nga gardiani trupmadh. Beu toptanas nuk donte ta kuptonte të vërtetën që midis kastës së tij dhe fshatarësisë ekzistonte një armiqësi e vjetër shekulllore.

\*  
\* | \*

Xhelal Zogu e kishte humbur durimin. Ai bërtiste i zemëruar nga kryeneçësia e «kryerebelit» Haxhi Qamili, i cili nuk e përfillte fare vdekjen.

— A pranon se ke vrarë Ibrahim Agën nga Ndroqi,  
— e pyeti kryetari.

— Po. E kam vrarë — pohonte pa të keq Haxhi Baba dhe vazhdonte: — Ibrahim Agë Ndroqi ishte miku i Pashës dhe i vëllai i Mustafa Agë Ndroqit, i cili i dorëzoi qeverinë Esadit.

— A i ke djegur shtëpitë e bejlerëve dhe të Esad Pashës?

— Po. I kam djegur. — tha me ton solemn Haxhi Qamili.

— A u ke thënë bujqve të Veli Bej Jubës dhe të Esad Toptanit të mos i japid të tretën zotërinjve të tyre?

— Po. U kam thënë bujqve që mundin e tyre të mos ua japid bejlerëve.

— A keni plaqkitur pasuritë e bejlerëve? A u keni thyer kasafortat bejlerëve? — e pyeti kryetari duke zgjatur kokën nga i pandehuri, që rrinte ulur për tokë para trupit gjykues, i rrethuar nga xhandarët e armatosur.

— Bereqetin dhe plaçkat ua kam ndarë katundarëve të varfër — u përgjegj Haxhi Qamili qetë-qetë dhe shtoi: — Paratë e florintjtë janë përdorur nga qeveria për punët e popullit dhe të kryengritjes.

Xhelal Zogolli, pasi u hodhi një vështrim kuptim-plotë gjyqtarëve, tha me zë të lartë:

— Zotërinj gjyqtarë, a keni për t'i pyetur gjë tjetër të pandehurit?

Të dy gjyqtarët tundën kokën në shenjë mohimi.

— Fjala e fundit, o Haxhi Qamil Xhameta! — briti kryetari i gjyqit.

Haxhi Baba hodhi vështrimin nga trekëmbëshi dhe i nguli sytë te thyesa e litarit, që lëkundej nga era lehtë-lehtë.

— Kërkoni falje dhe pendohuni për krimet që keni kryer! — i tha gjyqtari i dytë me një ton që shprehte keqardhje.

— Hajde, Haxhi Baba, bjeri në gjunjë dhe kërkoi falje Pashës shpirtmadh e bujar! — tha gjyqtari i tretë.

Haxhi Qamili rrinte pa folur dhe me një pamje kre-nare.

Gjykatësit përpinqeshin ta thyenin Haxhi Babën dhe ta detyronin «kryerebelin» t'i binte ndër këmbë e të gjunjëzohej përpara Esad Pashë Toptanit.


Haxhi Baba, pas një heshtjeje të kobshme, që zgjati disa minuta, tha me zë të rëndë, të përbajtur, po me ton të lartë dhe solemn:

— Jo! Nuk pendohem për veprat dhe punët që kam bërë — dhe shtoi: — Më vjen keq që nuk munda ta vrisja Esad Pashë Toptanin, atë armik të katundarisë!

— Në litar! Në litar! — bërtiti kryetari i gjyqit duke përplasur grushtet në tryezë.

Xhandarët e zunë nga krahët dhe e shtynë të dënuarin drejt trekëmbëshit. Haxhi Baba hodhi sytë më tej dhe vuri re një mulli të vogël. Për një çast iu kujtuan ditët e gëzuara, kur ai, i lirë, shkonte me kafshën të ngarkuar me misër në mulli të fshatit.

— Hiqni duart, po ju them! — u briti Haxhi Baba xhandarëve dhe ngriti pezull në ajër hekurat. Mjekra e



fshatarit tridhjetegjashtëvjeçar kishte filluar të zbardhej nga thinjat. — Eci vetë! — shtoi i dënuari.

Kur arriti para trekëmbëshit qëndroi me kokën lart. Xhelati kishte vënë mbi kokë një këlluf të zi me dy vrima te sytë. Haxhi Qamili u ngjit në fronin e drunjëtë. Laku i litarit i preku kokën.

Papritur, i dënuari me vdekje zbriti nga froni dhe u turr si i xhindosur nga kryetari i gjykatës Xhelal Zogu, që po rrinte mënjanë për të vërejtur se si do të zbatohet vendimi.

— Mos kini frikë! — u tha Haxhi Baba xhandarëve, që i dolën menjëherë përpara për ta mbrojtur Xhelal Beun, i cili nga frika u bë dyllë i verdhë. — Kam një lutje! — shtoi ai.

Gjyqtari dhe të gjithë sa ishin aty shtangën dhe menduan se më në fund i erdhi koha e pendimit Haxhi Qamilit.

— Hajde, folë! — i tha Xhelali.

— Kam një amanet për të lënë: Boja t'u shuhet bejlerëve! — e duke qeshur ho...ho...ho!.. u kthye nga trekëmbëshi dhe hypi përsëri me këmbët e veta në froni e ekzekutimit...

## TAKIMI I FUNDIT NË QYTET

Xhaviti, i graduar major, mori nga kryetari i qeverisë Esad Pashë Toptani edhe titullin e beut. Më kot ai u lodh duke u rënë kryq e tërthor fshatrave e pyjeve, për të kapur armikun e tij, Mal Xhokën. Me kompaninë e ndjekësave të Xhavit Beut u bashkua edhe i vëllai i Ibrahim Agës, i cili kërkonte të hakmerrej kundër Malit. Kaluan disa javë kështu dhe më në fund Xhavit Beu u kthye në Durrës, i lodhur e i rraskapitur, dhe i mëritur se nuk ia kishte arritur qëllimit. Mal Xhoka ishte zhdukur pa lënë gjurmë, sikur ta kishte përpirë toka! Me një dekret të qeverisë ai u shpall «kaçak i rrezikshëm» dhe se për kokën e tij, gjallë ose vdekur, paguheshin pësëdhjetë napolona flori.

Pikërisht ato ditë Mal Xhoka ishte në Tiranë. Në dhomën me mindere, fshatari kryengritës përvçe Xhemal Xhaferrit, Ram Lekës dhe Cenit nga Priska u takua edhe me dy qytetarë të tjerë, që nuk i kishte parë kurrë ndonjëherë.

Tërë natën, nën ndriçimin e zbetë të llambës me vajguri, në dhomën me mindere të telegrafistit tiranas vazhdoi një bisedë e zjarrtë me kundërshtime dhe herë-herë me kryqyzime mendimesh.

Xhemal Xhaferri ishte i mendimit që faktet e dokumentat që kishte mbledhur Mehmet telegrafisti nga telegrafhana duheshin analizuar dhe duheshin lidhur me faktorët e brendshëm e të jashtëm, e pastaj të nxirreshin prej tyre përfundimet e nevojshme.

— Fatkeqësia qëndron se kryengritja fshatare ra viktimi e parullave të xhonturqve dhe të turkomanëve si Musa Qazimi, Mustafa Agë Ndraqi e të tjerëve — tha Meti.

— Gjendjen e kryengritjes fshatare ne e kemi shpjuar jo vetëm një herë dhe zotrote nuk do që të bindesh! — u përgjegj pak i zemëruar Xhemali. — Historia njeh shumë kryengritje fshatare. Fshatarët kanë luftuar përtokën, përlirinë dhe për barazim shoqëror. Ja, pyete Ram Lekën, të të tregojë si qëndronte puna në fshatin e tij. Për çdo vit tokat e fshatarëve rrezikoheshin nga bejlerët dhe agallarët. A nuk kemi me qindra fshatarë, midis tyre edhe miq e të njojur, të cilët, para disa vjetësh kishin tokat e tyre, kurse sot punojnë si bujq te toptanasit?

Ram Leka dhe Cen Priska miratonin analizën që po i bënte Xhemali gjendjes së fshatarësisë dhe merrnin pjesë në këtë bisedë duke treguar shembulla të tjera se si toptanasit e agallarët e Tiranës i zgjeronin përditë çifligjet duke i nxjerrë fshatarët jashtë tokave të tyre.

— Mos harroni, zotërinj, — vazhdoi përsëri, duke marrë një qëndrim prej mësuesi Xhemali — historia bën punën e saj dhe nuk na pyet ne! Revolucionet dhe kryengritjet e masave popullore dhe të fshatarësisë janë si shtërgata, që mbështillet e mbështillet dhe pas një kohe, kur piqet, ajo shpërthen me furi. Kryengritja fshatare erdhi si rezultat i një shtypjeje dhe shfrytëzimi shekuillor të bejlerëve e të agallarëve, si dhe nga rrëthanat e krijuara në politikën ndërkombëtare. Kjo kryengritje e përzjeu popullin dhe e ngriti më këmbë, duke gjallëruar forcat e fjetura prej qindra vjetësh të fshatarësisë, veçanërisht të Shqipërisë së Mesme dhe të fushës së Myzeqesë. Zotërinj ne tani e dimë dhe do ta kemi parasysh kurdoherë se masat fshatare, që përbëjnë shumicën dermuese të popullsisë sonë, janë forca shumë të rëndësishme, të cilat lozin një rol shumë të madh në fatet e komabit. Dua të shtoj edhe një gjë, të gjitha idetë që kanë pasojë të mëdha, janë të thjeshta. E ja, pra, unë mendoj se përparimin shoqëror duhet ta lidhim me problemin e pavarësisë dhe të krijimit të shtetit shqiptar, ose problemin

e pavarësisë dhe të krijimit të shtetit shqiptar duhet ta lidhim me përparimin shoqëror. A nuk është kjo një ide e thjeshtë që po të vihet në jetë do të ketë pasoja të mëdha për fatet e historisë të kombit shqiptar?

Mal Xhoka rrinte hijerëndë; ai vetëm dëgjonte. Sytë e tij shkrepëtin nga guximi dhe vendosmëria. Teuta, e mbesa e telegrafistit, nxori kafetë e dyta.

Në kuadrin e errët të drithares së mbuluar nga një perde e hollë prej nape të bardhë filloj të shquhej agimi. U dëgjua kënga e përgjumur e një gjeli. Por pas kësaj sërih çdo gjë ra në qetësi.

— E, shokë, tani, më në fund, na thoni, ç'duhet të bëjmë?

Këto fjalë të Mal Xhokës ranë si qortim në atë mblehdje. Mali e bëri pyetjen pa menduar se mund të fyhej njeri, po, kur vuri re se burrat mbetën si të hutuar, ai e ndjeu se ishte nxituar.

— Biseda që bëmë sot — vazhdoi ai — ka një rëndësi të jashtëzakonshme dhe ne duhet t'u bëjmë të qartë gjendjen edhe të gjithë fshatarëve të tjerë.

— Ke të drejtë! — ia preu Xhemali dhe shtoi: — Ne qytetarët, e kemi zakon që flasim pak si tepër. Komiteti ynë i clirimit do të kryejë tani për tani disa detyra.

Xhemal Xhaferri foli për punën që do të kryente secili nëpër krahinat e rrethit të Tiranës. Do të formoheshin besëlidhjet fshatare për kushtimin e luftës kundër pushtuesve të huaj dhe për luftën që duhej të bënin përimëkëmbjen e shtetit të pavarur shqiptar. Dhe, kur nga komiteti i Tiranës të jepej shenja, do të formoheshin battalionet me kryengritësit patriotë të arratisur, që do të fillonin luftën kundër armiqve. Xhemali u tha burrave se komitetet e clirimit ishin formuar në të gjitha viset e Shqipërisë dhe se së shpejti do të formohej një komitet për të gjithë vendin.

— Ruhuni se mos ju hyjnë pivitët e bejlerëve dhe të Esadit në këto komitete! — bëri vërejtje Cen Priska dhe vuri buzën në gaz.

— Atëhere mua më duhet ta marr me vete flamurin

e Shqipes — tha Mal Xhoka duke iu drejtuar telegrafistit.  
— Më duhet për të bërë besëlidhjet. — Shtoi ai.

Telegrafisti doli nga dhoma dhe, pas një copë here, ai u kthyte me të mbesën, e cila mbante në dorë copën e kuqe të qëndisur.

— Hape! — i tha Xhemali. — Shtroje këtu në tryezë!

Teuta e shpalosi flamurin. Ram Leka nxori dhjetëshen nga brezi dhe e vendosi mbi shqiponjën e zezë.

— Betoheremi se do të luftojmë deri në pikën e fundit të gjakut për çlirimin e Shqipërisë! — tha Mal Xhoka dhe i pari vuri dorën mbi flamur. Pas tij shtrinë duart edhe të tjerët duke përsëritur betimin. Teuta, që mbeti si e shastisur, pasi mblođhi veten, zgjati edhe ajo dorën te flamuri dhe tha e tronditur:

— Edhe unë betohem!

— Kush do të tradhëtojë besëlidhjen tonë për çlirimin e atdheut do të ndëshkohet me pushkatim! — tha më në fund qytetari i panjohur.

Nëna e telegrafistit, që rrinte në përgjim, hyri si vetëtimë në dhomën me mindere dhe me një frymë tha:

— Jemi të rrethuar! Disa njerëz të armatosur po përpiken të ngjiten mbi avllinë e oborrit!

Xhemali u ngrit më këmbë dhe hodhi vështrimin nga burrat, që rrinin të heshtur dhe fare të qetë.

— Si të bëjmë? — pyeti ai pak i tronditur.

— Do t'u thyejmë brinjët! — ia priti Mal Xhoka, që u ngrit më këmbë dhe nxori dhjetëshen nga brezi.

— Nuk është rasti të derdhim gjakun sonte! Duhet të ruhemini! Na presin shumë punë, vëllezër — tha Xhemali.

— Ashtu është vërtet — tha prerë qytetari i panjohur.

— Nuk ka kohë! — tha nëna plakë e telegrafistit. — Ka një rrugëdalje nga dera e kopshtit dhe nëpër përrua të dilni jashtë qytetit.

— T'i ngjitemi malit të Priskës! — tha Ceni.

Ndërsa burrat po bëheshin gati të dilnin, u dëgjuat një zhurmë këmbësh brenda në oborr. Dikush kishte kërcyer nga muri poshtë. Atëhere s'kishte më kohë për të

pritur. Mal Xhoka u shkëput nga të tjerët dhe, me dhjetëshen në dorë, i doli përpara spiunit që po afrohej.

— Kush je ti? — briti Mali. — Si guxon të hysh në shtëpi të huaj pa leje!

— Jam qeveria. Dorëzohuni, rebela! — thirri njeriu që rrinte i struktur diku nëpër terr.

Mal Xhoka e njohu zërin e spiunit. Ishte Xhavit Qylymi! Po dhe ky e njohu Malin.

— Më në fund të kapa! — briti piviti i Esadit, që tanë ishte vënë në shërbim të italianeve. Ai vuri dorën te llozi, që të hapte portën për t'u futur xhandarët, të cilët bënин zhurmë jashtë në rrugë.

— Po, u takuam më në fund, o Xhavit Qylymi! — i tha Mali.

— Dorëzohu, o Mal Xhoka, se jetën do ta falim! — i tha Xhavit Qylymi me zë lutës.

— Nuk e dua jetën nga ti, o lapangjoz i bejlerëve! Hajde, pra, dil në shesh të burrave! Çfarë pret? Qëllø, apo nuk ta mban? Ke frikë, a?

Xhavit Qylymi, një nga njerëzit më të afërt të Esad Toptanit, nuk kishte ikur jashtë shtetit. Pashai e kishte ngarkuar përsëri me detyra të posaçme. Sipas porosisë së kryeçifligarit Toptanas, Xhaviti shërbente tanë si oficer në qeverinë e re të Durrësit, é cila ishte ngritur dhe mbahej më këmbë nga komanda ushtarake e ushtrisë pushtuese italiane në Shqipëri.

Xhavit Qylymi i kishte sjellë shërbime pas shërbimës Pashait të Tiranës. Tani ai duhej të mblidhë informata mbi gjendjen e krijuar dhe duhej të mbante lidhje me krerët esadistë, të cilëve do t'u jepte kushtimin sapo të njoftonte për kthimin e vet shkëlqesia e tij Esad Pashë Toptani. Por, gjatë kohës së shërbimit si oficer i qeverisë së Durrësit pro italiane, Xhaviti dhe disa shokë të tij do të kryenin operacione pastrimi dhe ndëshkimi kundër elementeve kryengritës fshatarë dhe kundërshtarëve të esadistëve.

Xhavit Beu po rrinte pa lëvizur pas një trandafili të egër duke shtrënguar fort nagandën, që nuk po e

ndizte dot. Vetullat e tij të ngërthyera shprehnin hutim dhe frikë. Pështyma i ishte tharë në grykë dhe i mbahej fryma, ndaj dhe nuk e nxirrte dot zërin. Me sytë të ngrirë qahajai i Pashës, i zhgënjer nga drita e mugët e mesnatës, i shndërronte në njerëz gjithë trungjet ose pemët e oborrit. I bëhej sikur dhjetëra kafshë të egra pa formë, që ai i quante përbindsha, rrinin në gatishmëri dhe nga çasti në çast gatiteshin ta sulmonin e ta shqyenin copë-copë. Ishte ndërgjegja që s'po e linte të qetë spiunin e Esad Toptanit. Ankthi i vdekjes e kishte mbërthyer kokë e këmbë.

— Hajde, pra, shtjerë! — bërtiti Mal Xhoka që shtriu drejt armikut dorën e djathtë, në të cilën kishte shtrënguar fort dhjetëshen turke. Djaloshit luftëtar i shkrepëtitën sytë nga vendosmëria dhe trimëria.

Kur fshatari kryengritës pa që kundërshtari i tij nuk po qëllonte dhe njëri nga mercenarët po i ngjitej murit, qëlloi në shenjë tri herë. Një masë e rëndë e zezë u shtri për tokë. Piviti i Esad Pashës dha llogari për tradhëtitë, kurthet, dredhitë e për vrasjet që kishte bërë.

Mercenari, që sapo i ishte ngjitur murit, kur pa se dikush nën të po qëllonte oficerin me revolver, instinktivist, për të shpëtuar lëkurën e vet, iu hodh kundërshtarit përsipër. Që të dy u rrokullisën përdhe. Filloj midis tyre përleshja vendimtare. Mal Xhoka, ndërsa po përpinqej të çlirohet nga duart e hekurta të armikut, ndjeu se dikush nga prapa po i vinte në ndihmë. Armikut po i priteshin fuqitë.

— Hajde, të ikim që këtej! — i tha qytetari i panjohur, që kishte folur pak më parë në mbledhje. Ai me njérën dorë mbante thikën dhe me tjetrën zuri për krahu Malin.

Fshatari kryengritës dhe qytetari revolucionar, ikën nga fundi i kopshtit, pas gjurmëve të shokëve.

Jashtë në rrugë krisi pushka. Mercenarët qëllonin kuturu në drejtim të shtëpisë. Thyheshin tjegullat dhe xhamet e dritareve tringëllinin me zhurmë.

Ndërkaq Mali, që dalloj dhe vajzën e të zotit të shtë-

pisë midis atyre që po iknin, pyeti:

— Flamurin e more?

— E kam shtënë ja këtu, në gjoks — iu përgjegj Teuta me ndrojtje.

— Shumë mirë! Ai na duhet — tha Mal Xhoka i qetësuar.

Në qiellin që po zbardhëlllohej dukeshin ende shumë yje, që dalëngadalë po e humbisnin ndriçimin e tyre. Para fshatit Shkozë, që ende s'ishte zgjuar, u mblodhën kokë më kokë burrat, po ata që ishin edhe në dhomën me mindere. Sipas vendimit që kishin marrë, ata do të shpërndaheshin fshatrave për të organizuar besëlidhjet, për të luftuar kundër pushtimit të huaj italian dhe për formimin e qeverisë së Shqipërisë së lirë e të pavarur. Ata vendlösën të ndaheshin në tri grupe: Mal Xhoka, telegrafisti, Teuta dhe Ram Leka u nisën për në Bastar, Ceni dhe revolucionari për në Priskë dhe në malësinë e Shëngjergjit, kurse grupi i tretë u nis për në Petrelë, Arbanë dhe Pezë.

Lamtumirë, o Ram Leka! — u tha Xhemali, që u nis për në Petrelë.

— Lamtumirë, o Mal Xhoka!

— Lamtumirë, o Cen Priska!

Burrat i shtrënguan dorën njeri-tjetrit dhe u ndanë me besim të patundur se një ditë do të takoheshin përsëri fitimtarë.

Redaktore: Tatjana Haxhimihali

Piktor: Sadik Kaceli

Tirazhi 10.000 kopje      Format 78x109/32      Stash: 2204-72

---

Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike  
Shtypshkronja «8 NËNTORI» — Tiranë, 1974